



# RAPORTI I ZHVILLIMIT NJERËZOR KOSOVA2004

Ngritja e Qytetarit:  
Sfidat dhe Mundësitë



Publikuar nga:

**United Nations  
Development Programme**

Qyteza Pejton nr. 14  
Prishtinë, Kosovë

*Përkthyes*  
Dukagjin Gorani, Trim Shala dhe Studio Tre Yje

*Dizenji dhe thyerja grafike*  
Lirijon Kadriu, Advertising Studio D-line

*Fotografitë*  
Hazir Reka, Samir Karahoda

*Shtypi*  
Grafika Reznici

Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e Programit për Zhvillim të OKB-së (UNDP), USAID-it/Save the Children, Swiss Development Cooperation-it apo të Qeverisë së Holandës

Nën rezolutën e KS të OKB-së Kosova mbetet formalisht nën administrimin e OKB-së

Botimin e RZHNJK 2004 e mundësoi asistenca e **USAID-it, Swiss Development Cooperation dhe Qeveria e Holandës**

# MIRËNJOHJE

## Ekipi kryesor i autorëve:

Mytaher Haskuka - *Udhëheqës i ekipit*  
Leon Malazogu, Nita Luci, Ilir Dugolli

## Njerëzit kryesor për resurse

Deirdre Keogh dhe Richard Ponzio, UNDP Kosovë

## Konsultuesit:

Heba El-Laithy - *Konsultues Statistike*, Ekrem Beqiri - *Konsultues i Lartë Statistike*,  
Blerim Reka - *Konsultues i lartë akademik*, Visar Berisha - *Konsultues Statistike*  
Genc Krasniqi - *Konsultues Statistike*

## Kontribuesit:

Jelena Bjelica, Bernard Zeneli, Atdhe Veliu, Jenna Slotin, Levent Koro, Vjollca Krasniqi, Nora Ahmetaj, Igballe Rogova, Besnik Pula, Virtyt Gacaferi, Valeria Patruno, Visar Berisha, Genc Krasniqi, Ronnie Andersson, Lulzim Peci, Dejan Radivojević, Edward Rees, Fred Cocozzelli

## Reduktura:

Glenn Hodes - *Kryeredaktor*, Shannon Burke - *Ndihmës Redaktor*

## Recenzentët:

Duškanka Anastasijević - *Iniciativa për Stabilitet European*, Muhamet Mustafa - *Instituti Riinvest*, Nora Ahmetaj - *Qendra për të Drejtën Humanitare*, Jeff Beiley - *Misioni i Administratës së Përkohshme të KB në Kosovë (UNMIK)*, Lucia Elmi - *UNICEF*, Julius Krause - *Departamenti i Punës dhe Punësimit*, Ronnie Anderson - *Zyra e Statistikës së Kosovës*, Sebadin Bytyqi - *Qendra për Studime Politike*, Genc Krasniqi - *Sfera Institute*, Hitomi Honda - *World Vision*, Flora Macula - *UNIFEM*, Vjollca Krasniqi - *Iniciativa e Grave Kosovare*, Feride Rushiti - *Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës*, Ferid Agani - *Ministria e Shëndetësisë*, Shkelzen Maliqi - *Qendra Gani Bobi*, Ilir Berisha - *Ministria e Ekonomisë dhe Financave*, Aliriza Arenliu - *Organizata Botërore e Shëndetësisë*, Lulzim Peci - *Instituti Kosovar për hulumtim dhe zhvillim politik*, Enver Hoxhaj - *Universiteti i Prishtinës*, Shehadah Hussein - *FMN, Banka Botërore në Kosovë*, Rachel Hand - *UNFPA*, Valentina Berisha - *Organizata Botërore e Punës*, Petrit Skenderi - *Njësia e këshilltarit ligjor në OSBE*

## Falënderime të posaçme për:

Burbuqe Dobranja, Anna Castelli, Toshiharu Onishi, Sebadin Bytyqi, Luis Thais, Evliana Berani, Virgjina Dumnica, Sofia Carrondo, Sally Johnson, Abdalla Fareh, Sonja Varga, Conor Lyons, Dagmar Blickwede, Besa Tovërlani

# SHKURTESAT

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	PISK	Plani për Implementimin e Standardeve në Kosovë
BiP	Bilanci i Pagesave	KTV	Televizioni "Kohavizion"
KEFDF	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit të Femrave	RGK	Rrjeta e Grave Kosovare
AQF	Autoriteti Qendror Fiskal	LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
QSFP	Qendra për Studimin e faljes dhe pajtimit	IJ	Indeksi i Jetëgjatësisë
CIVPOL	Policia Civile e KB në Kosovë	OZHM	Objektivat Zhvillimore të Mileniumit
KMDLNJ	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut	MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
IA	Indeksi i Arsimit	IKZHJ	Indeksi Komunal i Zhvillimit Gjinor
BE	Bashkimi Europian	IKZHNJ	Indeksi Komunal i Zhvillimit Njerëzor
RPH	Raporti për Paralajmërim të Hershëm	DP	Deputet i Parlamentit
SPH	Sistemi për Paralajmërim të Hershëm	NATO	Organizata e Paktit të Atlantikut Verior
IZHGJ	Indeksi i Zhvillimit Gjinor	NGO/OJQ	Organizatë Joqeveritare
GDP	Bruto Produkti Vendor	NHDR/RKZHNJ	Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor
MPGJ	Matja e Pushtetëzimit Gjinorë	OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
IZHNJ	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor	PDK	Partia Demokratike e Kosovës
RZHNJ	Raporti i Zhvillimit Njerëzor	IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
ZRZHNJ	Zyra e Raportit të Zhvillimit Njerëzor	PPP	Pariteti i Fuqisë Blerëse
AZHNJ	Anketa e Zhvillimit Njerëzor	PTSD/ÇSPT	Çrregullim nga Stresi Post-Traumatik
IVNJ	Indeksi i Varfërisë Njerëzore	RAE	Romë, Ashkalinj dhe Egjiptian
IDP	Personat e Zhvendosur Brenda Vendit	RTK	Radio Televizioni i Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar	EJL	Europa Juglindore
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim	NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
QNRVT	Qendra Ndërkombëtare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës	ZSK	Zyra e Statistikës së Kosovës
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	PSSP	Përfaqësuesi Special e Sekretarit të Përgjithshëm
ADSK	Anketa Demografike e Shëndetit në Kosovë	StC	Save the Children
KCE	Qendra Kosovare për Edukim	KPM	Komisioneri i Përkohshëm për Media
KFOR	Forcat e Kosovës	UNDP	Programi Zhvillimor i OKB
RZHNJK	Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë	UNFPA	Fondi për Popullsi i OKB
KIPRED	Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim Politik	UNHCR	Komesariati i Lartë për Refugjatë të OKB
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës	UNICEF	Fondi për Fëmijë të OKB
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës	UNIFEM	Fondi për Zhvillimin e Femrës i OKB
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës	UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të OKB në Kosovë
QKRV	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës	BB	Banka Botërore
		OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

# PARATHËNIE

Nëse investimet e jashtzakonshme financiare, politike dhe të sigurisë në Kosovë që nga viti 1999 janë bërë për të rindërtuar stabilitetin, ndërtimin e demokracisë dhe sigurimin që tërë Kosovarët të kenë një hisë në të ardhmen e tyre, atëherë Raporti i Zhvillimit Njerëzor për Kosovën është një vlerësim në kohë të duhur i realitetit dhe ndikimit të trazicioneve të shumta në realitetin e familjeve në Kosovë. Raporti i këtij viti ofron një theksar të tërë të shënimeve që shpjegojnë mënyrat e zhvillimit në Kosovë si dhe si kanë ndikuar humbjet e fitoret e këtyre viteve në rajonet, grupet etnike, demografike apo edhe të moshës. Pamja është e nduar nduarshme me vende të zhvilluara me vende të tjera shumë të lëna pas dore. Politikëbërësit dhe vendimarrësit vetëm me anë të përdorimit të këtyre informatave mund të ndihmojnë ato grupe dhe rajone që janë të lëna pasdore.


Përtej informatave dhe dijenisë, megjithatë, suksesi në tejkalimin e të kaluarës së vështirë të Kosovës përgjatë këtyre proceseve të shumta të tranzicionit shumë do të varet edhe nga, niveli dhe mënyra e angazhimit të qytetarëve të Kosovës, strukturave qeveritare të Kosovës. Mënyra dhe madhësia e "hapjes" së qeverisjes së Kosovës, ndjenja e përgjegjësisë në nivelin komunal dhe atë qendrorë, mënyra se si vendimet mirren dhe burrimet e alokuara, në mënyrë fundamentale do të ndikojnë në mënyrën se si njerëzit do të marrin pjesë në përkrahje dhe kontribuim për arritjen e sfidave të mëdha që janë përpara. Këto çështje janë të rëndësishme së veçantë përderisa zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës janë para nesh.

Analizat dhe idetë në këto çështje kritike që gjinden në faqet e mëtutjeshme, përmbajnë më shumë se 18 muaj konsultime, anketime të familjeve, debate të politikave dhe mbi të gjitha shumë punë. Më shumë se 300 njerëz - akademikë, aktivistë, politikanë, qeveritarë lokal dhe

qendrorë, liderë të komuniteteve, gazetarë - nga të gjitha fushat e jetës kanë kontribuar në një mënyrë apo tjetër në këtë raport. Ne jemi borxhlinjë të mëdhenjë ndaj tyre për angazhimin dhe përkushtimin e tyre në agjenden e zhvillimit njerëzor. Ne kemi bërë përpjekjet tona më të mëdha për të identifikuar shumicën e tyre në anekset e këtij raporti.

Ekipi që ka bërë këtë përpjekje nga dita e parë ka merita të veçanta. Në veçanti ekipi i autorëve, të udhëhequr nga Mytaher Haskuka, përfshirë edhe Leon Malazogun, Nita Lucin dhe Ilir Dugollin. Ata kanë përfutur shumë nga përkrahja e përditshme e Deirdre Keogh dhe Richard Ponzio. Jelena Bjelica, Bernard Zeneli, Atdhe Veliu, Vjollca Krasniqi, Nora Ahmetaj, Igballe Rogova, Besnik Pula, Visar Berisha, Genc Krasniqi, Lulzim Peci, dhe Fred Cocozzelli kanë dhënë kontributin e tyre siç kanë bërë edhe konsultatntët tonë si Ekrem Beqiri, Blerim Reka, Visar Berisha dhe Genc Krasniqi. Zyra e Statistikave e Kosovës dhe këshilltari i tyre i parë ndërkombëtarë, Ronnie Andersson, ka qenë partner kyç siç ka qenë edhe Dr. Heba El Laithy, këshillat statistikore të të cilës kanë vazhduar gjatë tërë procesit, saktësisht secili anëtarë i ekipeve të UNDP-së ka ofruar ndihmë, ka përpunuar pjesë dhe ka ofruar përkrahje morale. Në fund duhet të tregojmë për borxhin e madh që i kemi USAID-it, Save the Children, Swiss Development Cooperation dhe Fondit të Inovacionit (I mbështetur nga qeveria Holandeze), për mbështetjen e tyre financiare në të cilën është varur ky projekt.

Publikimi i këtij raporti vjenë në kohën e tranzicionit në UNDP, një Përfaqësueses i Përherëshëm ka përfunduar punën ndërsa tjetri duke e filluar. Prioriteti i UNDP-së në Kosovë - përparimi i zhvillimit njerëzor në Kosovë - do të mbetet i pandryshuar, siç ka qenë për paraardhësit tonë, siç edhe do të vazhdojë të jetë për ata që do të vijnë pas nesh.



**Robert Piper**  
Përfaqësues i përhershëm  
UNDP Kosovë



**Christine Roth**  
Përfaqësueses i përhershëm  
UNDP Kosovë

# TABLE OF CONTENTS

i	Shkurtesat
ii	Parathënie
1	<b>PËRMBLEDHJE</b>

## **KAPITULLI 1: TRANSFORMIMI I ZHVILLIMIT, NË NJË JETË MË TË MIRË**

11	<b>Definimi dhe matja e zhvillimit njerëzor</b>
11	<b>Raportet nacionale të Zhvillimit Njerëzor</b>
12	<i>Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë (RZHNJK)</i>
13	<b>Trendet në Zhvillimin Njerëzor në Kosovë</b>
14	<b>Komponentat e IZHNJ të Kosovës</b>
14	<i>GDP Bruto Prodhimi Vendor</i>
15	<i>Jetëgjatësia</i>
16	<i>Niveli i arsimimit</i>
17	<b>Varfëria njerëzore</b>
17	<i>Indeksi i Varfërisë Njerëzore</i>
19	<b>Femrat dhe zhvillimi</b>
19	<i>Indeksi i Zhvillimit Gjinerë në Kosovë</i>
20	<i>Masat për Pushtetëzimin Gjinerë</i>
21	<b>Kosova dhe Objektivat Zhvillimore të Mileniumit: Ku do të jemi më 2015?</b>
21	<i>Pse OZHM-të janë të rëndësishme për Kosovën?</i>

## **KAPITULLI 2: SHIKIM NGA AFËR: DISAGREGIMI I INDIKATORËVE TË ZHVILLIMIT NJERËZOR NË KOSOVË**

25	<b>Indeksi i zhvillimit njerëzor në nivel komunal</b>
25	<b>Komponentet e IZHNJ-së komunale</b>
26	<i>Pesë komunat e para dhe pesë komunat e fundit</i>
26	<i>Të ardhurat për kokë banori</i>
27	<i>Indeksi i jetëgjatësisë</i>
28	<i>Indeksi i arsimimit</i>

29	<b>Zhvillimi njerëzor dhe komunitetet etnike</b>
29	<i>IZHNJ sipas komuniteteve etnike</i>
29	<i>Arsimimi sipas etnicitetit</i>
31	<i>Të ardhurat për kokë banori sipas etnicitetit</i>
31	<i>Jetëgjatësia sipas etnicitetit</i>
32	<b>Ndarja Urbane/Rurale në zhvillimin njerëzor</b>
32	<b>Varfëria njerëzore</b>
32	<i>Varfëria ekstreme dhe karakteristikat komunale</i>
34	<i>Varfëria njerëzore sipas popullsisë urbane dhe rurale</i>
34	<b>Zhvillimi gjinor</b>
34	<i>Indeksi komunal i zhvillimit gjinor</i>
34	<i>Disa karakteristika të IZHNGJ komunale në Kosovë</i>
35	<i>Masat e pushtetëzimit gjinorë në nivel komunal</i>
36	<i>Zhvillimi urban/rural në relacion me gjinitë</i>

## **KAPITULLI 3: RISHQYRTIMI I PJESËMARRJES DHE PËRFAQËSIMIT NË KOSOVË**

43	<b>Hyrje</b>
43	<i>Pjesëmarrja dhe përfaqësimi: principe të fuqishme demokratike</i>
43	<i>Pjesëmarrja si faktor esencial në zhvillimin njerëzor</i>
45	<i>Pjesëmarrja në Kosovë</i>
47	<i>Përfaqësimi si faktor esencial për zhvillim njerëzor</i>
48	<b>Pjesëmarrja dhe përfaqësimi: Determinantat kryesore të një demokracie të suksesshme</b>
49	<b>Pengesat në pjesëmarrje dhe përfaqësim më të madh në Kosovë</b>
52	<b>Forcimi i vetëqeverisjes demokratike në Kosovë</b>

## KAPITULLI 4 QEVERISJA: SA ËSHTË LARG NGA NJERËZIT?

- 57 **Hyrje**
- 58 **Sistemet zgjedhore dhe zhvillimi njerëzor**
  - 58 Sistemi elektoral në Kosovë
  - 60 Trendet votuese
- 60 **Partitë politike, pjesëmarrja dhe përfaqësimi**
  - 61 Konteksti i Kosovës dhe partitë politike
  - 62 Përfaqësim më i mirë apo humbje e kredibilitetit?
  - 63 Fuqizimi i kulturës për pjesëmarrje në politikë
- 64 **Vendim-marrja qendrore, pjesëmarrja dhe përfaqësimi**
  - 64 Vendim-marrja koncenzuale
  - 65 Të metat në gjendjen aktuale
  - 67 Fuqizimi i përgjegjësisë
- 67 **Qeverisja lokale në Kosovë: Sa e afërt me njerëzit?**
  - 67 Pjesëmarrja në qeverisjen lokale në Kosovë
  - 68 Teoria e decentralizimit
  - 69 Llogaridhënia dhe qeverisja lokale
  - 70 Decentralizimi në kontekstin e Kosovës
- 71 **Qeverisja në sektorin e drejtësisë dhe të sigurisë në Kosovë**

## KAPITULLI 5: SHUMICA E HESHTUR

- 75 **Hyrje**
- 75 **Femrat**
  - 76 Varfëria e mundësive
  - 76 Trajtimi i femrave në shtëpi
  - 77 Preferenca për djemtë
  - 78 Femrat në tregun e punës
  - 78 Ndarja gjinore e punës
- 78 **Rinia**
  - 79 Papunësia
  - 79 Sfidat në tregun e punës
- 79 **Të varfërit ruralë**
  - 79 Fermerët në mbijetesë
- 80 **Minoritetet në Kosovë**
  - 81 Komuniteti RAE dhe varfëria
  - 83 Serbët e Kosovës dhe siguria

- 83 **Grupet tjera të marginalizuara**
  - 83 Njerëzit që jetojnë me aftësi të kufizuara
  - 84 Konflikti dhe mirëqenia psikologjike në Kosovë

## KAPITULLI 6: NGRITJA E QYTETARIT: PËRQAFIMI I TË DREJTAVE DHE PËRGJEGJËSIVE

- 87 **Ndërtimi i ideve të qytetarisë**
  - 88 Veprimet e menjëherëshme
  - 88 Veprimet afatgjate
- 88 **Reformat kyçe për zgjerimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit për zhvillim njerëzor në Kosovë**
  - 89 Zgjerimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit nëpërmes transformimit të qeverisë
  - 92 Ndërtimi i aleancave në mes të shoqërisë civile mediave dhe sektorit privat për një pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve
- 95 **Promovimi i strategjisë për përforcimin e qeverisjes demokratike**
- 97 **Futnotat**
- 99 **Bibliografia**

## ANEKSAT

- 103 **Aneksi I: Metodologjia e Anketës së UNDP-së për Zhvillimin Njerëzor**
- 104 **Aneksi II: Detajet teknike**
- 110 **Aneksi III: Treguesit e Zhvillimit Njerëzor**
- 132 **Aneksi IV: Emrat e personave që kanë marrë pjesë në konsultimet për RZHNU**
- 133 **Aneksi V: Kosova në shikim të parë**

# KORNIZAT, TABELAT DHE SHIFRAT

## Kornizat

- 1.1 Matja e zhvillimit njerëzor
- 1.2 Regjistrimi i popullsisë dhe shtëpive
- 1.3 Problemet në vlerësimin e BPV-së
- 1.4 Çka është Indeksi i Varfërisë Njerëzore (IVN-1 dhe IVN-2)?
- 1.5 Trendet globale në barazinë gjinore
- 1.6 A janë shënjestrat që kanë të bëjnë me gjinitë të pajtuara në Kajro, Kopenhagë dhe Beijing të mjaftueshme?
- 2.1 Çështjet e matjes: BPV vs. Të ardhurat
- 2.2 Cilat janë dallimet në MZHNJ?
- 2.3 Migrimi
- 2.4 A është pjesëmarrja e femrës e domosdoshme për të ardhura më të larta?
- 2.5 Arsimiti i vajzave: Faktorët e lënies së shkollës
- 2.6 Mësimxënia sipas komuniteteve etnike
- 2.7 Karakteristikat tipike demografike dhe ekonomike të ekonomive familjare të Kosovës
- 2.8 Pabarazitë ndërmjet Komunave në kuptim të komponenteve të varfërisë njerëzore
- 3.1 Çka është pjesëmarrja?
- 3.2 Çka është përfaqësimi?
- 3.3 Ngritja dhe rënia e vullnetarizmit në Kosovë
- 3.4 Lëvizjet shoqërore dhe Aspiratat Kombëtare: Pajtimi i gjaqeve
- 3.5 Standardet për Kosovën: cka do të duhet për implementimin e tyre?
- 3.6 Rinia e Kosovës: Udhëheqësit e Zhvillimit dhe integritimit shoqëror
- 4.1 Partitë politike në Kosovë
- 4.2 Perceptimet dhe vizibiliteti publik i grave politike
- 4.3 Trendet votuese
- 4.4 Femrat në (de fakto) vendim-marrje?
- 4.5 Roli i qeverisjes lokale
- 4.6 Vështrim: Zhvillimi Njerëzor dhe Satisfaksioni me Shërbime
- 4.7 Mechanisms for Participation in Municipal Decision-making
- 4.8 Satisfaksioni dhe pjesëmarrja pozitive:
- 4.9 Konfuzioni rreth përgjegjësisë
- 4.10 Definimi i sektorit të Drejtësisë dhe Sigurisë
- 5.1 Kyçja e gjinive në rrjedhat shoqërore në Kosovë
- 5.2 Ndryshimi i regjimeve gjinore në Kosovë
- 5.3 Ekonomia sociale dhe kooperativat
- 5.4 Të drejtat e minoriteteve
- 5.5 Koekzistenca në Kosovë
- 5.6 Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRVT)

- 5.7 Plagët e freskëta. Përleshjet e Marsit

- 6.1 "Reforma 2004": Model i ri i angazhimit konstruktiv qytetar.
- 6.2 Mbrojtja e të drejtave të minoriteteve: Pjesë esenciale e demokracisë së suksesshme
- 6.3 Mediat e Kosovës gjatë krizës së Marsit 2004

## Tabelat

- 1.1 Komponentet e IZHNI 2001 dhe 2003
- 1.2 Rritja e BPV-së
- 1.3 Shkalla e regjistrimit në arsimimin e lartë
- 1.4 IVN-1 dhe IVN-2 për Kosovë, 2001 dhe 2003
- 1.5 Pjesëmarrja në fuqinë punëtore dhe papunësia
- 1.6 Trendet në zhvillimin gjinor
- 1.7 MBGJ dhe komponentet e saj
- 1.8 Qëllimet dhe shënjestrat globale të mileniumit të zhvillimit
- 2.1 Pesë komunat e para dhe pesë komunat e fundit në Indeksin e Arsimit
- 2.2 Bashkimi i komuniteteve etnike në SZHNJ
- 2.3 Jetëgjatësia sipas komuniteteve etnike
- 2.4 Treguesit e arsimimit sipas vendbanimit urban/rural
- 2.5 Komponentet e IVN-1 sipas ndarjes urbane/rurale
- 2.6 Disa komponente të IVN-2 sipas vendbanimit urban/rural
- 2.7 Komponentet e IZHGI dhe MBGJ-së sipas vendbanimit urban/rural
- 2.8 Komponentet e zgjedhura të MBGJ-së sipas vendbanimit urban/rural
- 3.1 Nuk ka lidhje automatike në mes të demokracisë dhe barazisë
- 3.2 Format e pjesëmarrjes qytetare në Kosovë
- 3.3 Numri i votave të nevojshme për të zgjedhur përfaqësuesin komunal në Kosovë
- 3.4 Trendet e satisfaksionit me institucione.
- 4.1 Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 2004
- 4.2 Përmbledhja e ndarjeve buxhetore
- 4.2 Distanca nga objektet shëndetësore dhe arsimore dhe gjasat për aktivitet politik
- 4.3 Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës 2004
- 4.3 Përmbledhja e ndarjeve Buxhetore: Drejtësia dhe Siguria
- 4.4 Reduktimet në policinë e UNMIK-ut
- 5.1 Pjesa e biznesit të fermerëve në mbijetesë
- 5.2 Përbërja e Shërbimit Policor të Kosovës (Qershor 2003)



## Shifra

- 1.1 IZHNJ i Kosovës për 2002 dhe 2004
- 1.2 Krahasimet regjionale dhe globale të IZHNJ-së
- 1.3 Ndryshimet në BPV për kokë banori në USD, 1985-2003 Ndryshimi në formën e serive kohore
- 1.4 BPV (PPP) Krahasimet regjionale
- 1.5 Jetëgjatësia që nga lindja (në vite) e popullsisë së Kosovës
- 1.6 Krahasimet regjionale të jetëgjatësisë
- 1.7 Shkalla e analfabetizmit në Kosovë
- 1.8 Shkallët e regjistrimit në Kosovë 2001 dhe 2003
- 1.9 Krahasimet regjionale dhe globale të shkallëve të arsimimit të rriturve
- 1.10 Problemet kryesore me të cilat ballafaqohet sot Kosova
- 1.11 Krahasimi i Indeksit të Zhvillimit Gjikor
- 1.12 Disparitetet ndërmjet meshkujve dhe femrave në Kosovë në treguesit e zgjedhur
  
- 2.1 Të ardhurat për kokë banori për pesë komunat e para dhe pesë komunat e fundit
- 2.2 Marrëdhënia ndërmjet arsimimit dhe të ardhurave
- 2.3 Marrëdhënia e pjesëmarrjes ekonomik dhe të ardhurave sipas gjinisë
- 2.4 Pesë komunat e para dhe të fundit në lidhje me jetëgjatësinë
- 2.5 Diferenca komunale në treguesit e arsimimit sipas gjinive
- 2.6 IZHNJ dhe komponentet sipas komuniteteve etnike
- 2.7 Treguesit e arsimimit sipas komuniteteve etnike
- 2.8 Mesatarja e viteve të shkollimit
- 2.9 Nivelet mesatare të të ardhurave të ekonomive familjare, sipas komuniteteve etnike
- 2.10 Burimet e të ardhurave sipas etnicitetit
- 2.11 IZHNJ sipas ndarjes urbane/rurale
- 2.12 Marrëdhënia ndërmjet IVN-1 dhe IVN-2
- 2.13 IVN-1 dhe treguesit e zgjedhur të deprivimit njerëzor sipas etnicitetit
- 2.14 IVN-2 dhe treguesit e zgjedhur të deprivimit njerëzor sipas etnicitetit
- 2.15 Përqindja e njerëzve që jetojnë në varfërinë njerëzore - urbane dhe rurale
- 2.16 Pjesëmarrja gjinore në fuqinë punëtore, sipas tri komunave të para dhe të fundit
- 2.17 Shkalla e të ardhurave në relacion me gjinitë: Top 3 and Bottom 3 Municipalities
- 2.18 Determinantat e MBGJ komunale
  
- 3.1 Demokracia dhe Zhvillimi Njerëzor: Lidhjet
- 3.2 Prej zërit individual deri tek ndryshimi i politikës dhe implementimi
- 3.3 Pjesëmarrja dhe përfaqësimi: Lidhjet ndërmjet llogaridhënies, përgjigjja dhe zhvillimi njerëzor
  
- 3.4 Struktura e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse
  
- 4.1 Trendet votuese në zgjedhjet e vitit 2000, 2001 dhe 2002
- 4.2 Përqindja e njerëzve që mendojnë se mund të ndikojnë në vendim-marrje duke qenë në distancë nga procesi vendim-marrës.
- 4.3 Shërbimet që do të duhej të funksiononin në mënyrë më efektive në nivelin lokal
  
- 5.1 Preferenca për djemtë, sipas moshës dhe vendbanimit urban/rural
- 5.2 Të papunësuar dhe në kërkim të punës
- 5.3 Përqindja e femrave jashtë fuqisë punëtore dhe arsyet, sipas moshës
- 5.4 Përqindja e femrave që punojnë në shtëpi, sipas moshës
- 5.5 Papunësia sipas gjinisë dhe moshës
- 5.6 Papunësia në RAE sipas gjinisë dhe moshës
- 5.7 Trendi i përqindjeve të reposndentëve që ndihen "të sigurtë" apo "shumë të sigurtë" në rrugë.



\* Qytetar: vendas, banor, apo banues i një vendi të caktuar:  
"Ne kemi mësuar të bëhemi qytetarë të botës, anëtarë të bashkësisë njerëzore"  
(*Franklin D. Roosevelt*).

Marrë në gjuhën angleze nga <http://dictionary.reference.com>

# RAPORTI I ZHVILLIMIT NJERËZOR NË KOSOVË

## Ngritja e Qytetarit: Sfidat dhe Mundësitë\*

Pesë vite pas transicionit të udhëhequr nga bashkësia ndërkombëtare, Kosova qëndron në udhëkryq. Paqja dhe stabiliteti e gjykuar barabarësisht nga kosovarët dhe partnerët e tyre ndërkombëtarë kurrë nuk ishte mëtuar të arrihet vetëm përmes marrëveshjeve politike apo grupeve punuese. Përkundrazi, një transicion i suksesshëm varet gati në tërësi nga përparimi qenësor i përditshmërisë së mbarë qytetarëve të Kosovës.

Arkitektët e transicionit të Kosovës kishin llogaritur në këtë. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit apelon për stabilizim ekonomik, demokratizim dhe shërbime të qëndrueshme publike, për aq sa diskuton edhe masat për vendosje të sigurisë dhe realizim të ndryshimeve politike. Megjithatë, imperativi zhvillimor mund të anashkalohet lehtë gjatë një periudhe transicioni, të karakterizuar me ambient përherë të ndryshueshëm, me të hyra të mëdha nga personeli i asistencës në rindërtim, me prioritetet konkurrense ndërkombëtare - me molisjen e përgjithshme dhe 'zjarrfikjen' e vazhdueshme.

Sido që do ta quanit - qoftë 'dividendë e paqes', 'projekte baraspeshuese', 'masa stabilizuese', përpjekje për fitim të "zemrave dhe mendjes" - zhvillimi i Kosovës paraqet një shtyllë kritike të themeleve të paqes. Do të ishte gabim i madh po qe se zhvillimi do të zhvleftësohej duke u kuptuar prioritetet periferik, apo, edhe më keq, po qe se do të shtyhej për 'të ardhmen'.

Mirëpo, edhe nëse ky qëndrim do të ishte i përbashkët, 'çfarëdo zhvillimi' nuk do të ishte i mjaftueshëm. Zhvillimi kuptimplotë, -- i tillë që do të sjellte stabilitet, të konsolidonte demokracinë dhe i cili do të përkthehej në një përparim të qëndrueshëm njerëzor - do të duhej të manifestohej konkretisht, në kuptim të zgjatjes së jetës, përmirësimit të arsimimit dhe të qasjes më të barabartë

ndaj shërbimeve. Një qasje e tillë ndaj zhvillimit do të mundësonte që çdo qytetar të ketë mundësi dhe zgjedhje të barabartë; që fati i tij të mos ishte i paracaktuar, qoftë për të mirë apo për të keq, vetëm për shkak të vendit të lindjes, gjuhës që flet, gjinisë apo besimit. Zhvillimi njerëzor, proces ky i zmadhimit të zgjedhjes njerëzore, paraqet masën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të një përparimi të tillë shoqëror.

Veglat për matjen e zhvillimit njerëzor e vendosin Kosovën në fund të Ballkanit, mes shoqërive më të pazhvilluara të Evropës. Investimet masive në trajnime profesionale, pushtetëzim të femrës, me gjithë krijimin e vendeve të reja të punës, mbesin parakushte për parandalim të ngecjes së mëtutjeshme të Kosovës prapa.

Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë për vitin 2004 (RZHNJK, 2004), analizon pozitën e Kosovës nga aspekti i zhvillimit njerëzor. Duke zbatuar metodologjinë tashmë të etabluar mirë të Raporteve Vjetore Globale të Zhvillimit Njerëzor, të UNDP; Kapitulli I i RZHNJK llogarit vlerat për indikatorë të ndryshëm të zhvillimit në Kosovë. Kosova kuptohet si vend që takon në 'shkallën e mesme të zhvillimit njerëzor': ngjashëm, por në shkallë më të ulët krahasuar me vendet e fqinjësisë dhe me gjerë në rajon, me Slloveninë apo Poloninë\*.

1. Indeksi i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë (IZHNJ), një përmbledhje poenësh që ndërlihdhin shëndetësinë, arsimin dhe indikatorët ekonomikë reflekton një përmirësim modest ç'prej vitit 2001, kur për herë të parë ishin zhvilluar llogaritë e RZHNJ të Kosovës për vitin 2002. Edhe pse themelet relativisht të dobëta të zhvillimit njerëzor vazhdojnë ta mbajnë atë larg shkallës së disa fqinjëve evropianë, bruto prodhimi për kokë banori merret komponentë e IZHN e cila ka përjetuar ngritjet më të larta gjatë periudhës pas

*Kosova rangohet në fund të vendeve të Ballkanit dhe në mesin e vendeve më të pazhvilluara të Evropës*

\* Këto krahasime janë bërë për qëllime statistikore duke shërbyer mjet për të mundësuar të kuptuarit më të drejtë të situatës zhvillimore në Kosovë; rangimet nuk prejdukojnë dhe nuk sugjerojnë statusin e mundshëm të ardhshëm të Kosovës

*Lëvizja e njerëzve të  
shkolluar nga fsbati  
në qytet është duke u  
shtuar në një nivel  
alarmant*

konfliktit. Për komponentat e tjera të IZHN - arsimin dhe jetëzgjatjen - niveli i Kosovës është përgjithësisht më i lartë se në vendet e rajonit, në të cilat ky rangim çalon, edhe pse mestrarja e jetëzgjatjes realisht ka rënë ç'prej periudhës së fundit raportuese.

Varfëria në Kosovë duket të jetë më e ndërlikuar seç është kuptuar në fillim. Derisa një numër i konsiderueshëm i kosovarëve duket të jetë mbetur jashtë rrethit të varfërisë njerëzore gjatë dy viteve të fundit, natyra e varfërisë ka ndryshuar. Jetëzgjatja dhe arsimimi i përgjithshëm ka shënuar rritje, krahasuar me periudhën e hershme të pasluftës, ndërkohë që përqindja e njerëzve të cilët jetojnë në varfëri ekstreme është rritur. Indeksi i Varfërisë Njerëzore (IVNJ), i cili mat vazhdimësinë e mungesave njerëzore dhe përqindjen e njerëzve të cilët jetojnë në varfëri, ka zbritur prej 17.6 % të shënuar brenda RZHNJ 2002, në 9.6 % në RZHNJ për vitin 2004. Ky trend mund t'i atribuohet pjesërisht përmirësimeve në shkallën e arsimimit të përgjithshëm dhe të jetëzgjatjes. Megjithatë, të varfërit kanë më shumë gjasa të jetojnë në varfëri ekstreme, nëse kihet parasysh se 14% e popullatës klasifikohet si thellësisht e varfëruar.

Indeksi i Zhvillimit Gjinator (IZHGJ) për vitin 2004, shpalos një zbrastësi të madhe mes rasteve që i janë mundësuar femrës kosovare. Derisa poenët e IZH Gj të Kosovës vazhdojnë ta vendosin atë në nivelin 'mesatar' të zhvillimit njerëzor sipas këtij indikator, rangimi i IZH Gj ka zbritur konsiderueshëm ç'prej vitit 2001. Është kjo një pasojë e faktit sipas të cilit, mesatarisht, femrat fitojnë katër herë më pak se meshkujt dhe mbeten në masë të madhe të paangazhuara si fuqi punëtore. Rezultatet relativisht të larta në Masat për Pushtetëzimin Gjinator (MPGJ) që llogaritet përmes pjesëmarrjes politike (shembull, numri i ulësive në Kuvend) nuk përkthehen në arritjet reale zhvillimore për femrën, duke ngritur kështu një numër të pyetjeve të rëndësishme rreth strategjive.

Sa për Objektivat Zhvillimore të Mileniumit (OZHM), për të cilat liderët botërorë janë zotuar se do të arrihen deri nga viti 2015, Kosova ballafaqohet me sfida unike të cilat

do të duhej të reflektoheshin në zhvillimin e objektivave të paralogaritura enkas brenda OZHM. Zhdukja e varfërisë mbetet brengë parësore e përcjellë me shkallën e reduktuar të vdekshmërisë së foshnjeve e të fëmijëve, si dhe të rasteve të tuberkulozit, e që numërohen ndër më të lartat në Evropë.

Barazia Gjimore - veçanërisht rritja e mundësive për femrat dhe gratë për ta vazhduar shkollën e mesme, me gjithë përmirësimin e kujdesit amnor - mbesin sfida të tjera gjatë realizimit të OZHM.

Për t'i ndihmuar përpiluesit e politikave dhe faktorët vendimmarrës t'i kuptojnë plotësisht konturat e sfidave zhvillimore të Kosovës, RZHNJK 2004 hulumton për herë të parë dallimet në atë se si popullata brenda njësisë komunale të Kosovës, apo "komunat", është duke përparuar në aspektin e zhvillimit njerëzor. Rezultatet janë befasese dhe mund të përbëjnë një pikënisje kritike për zhvillim të politikave dhe të reformës institucionale. Nuk janë të gjitha komunat e barabarta, e as që të gjitha komunitetet gëzojnë shkallë të njëjtë të zhvillimit. Krijuesit e politikave duhet ta kenë parasysh faktin se zvogëlimi i zbrastësive mes grupeve sociale varet nga ajo se sa janë në gjendje kosovarët të marrin pjesë dhe të ndikojnë në përfitimet nga veprimtaritë zhvillimore. Njohuria më e madhe rreth asaj se në ç'mënyrë popullata përfiton apo çalon në procesin e ndryshimeve sociale mund të ndihmojë në zhvillimin e strategjive të përqëndruara më mirë, veçanërisht ndaj grupeve më të lëndueshme dhe marginale të popullatës. Përfundimisht, kjo do të mund të përkthehet në rezultate më të mira për të gjithë qytetarët. Të kuptuarit më të mirë të tablove të pabarabarta të mundësive, të cilat karakterizojnë zhvillimin aktual në Kosovë, do të mund t'i ndihmonin krijuesit e politikave për të ndërmarrë vendime më të mira rreth prioritetëve, investimeve dhe reformave, veçanërisht të atyre që ndërlidhen me shërbime sociale.

Dallimet në të ardhura dhe në indikatorët e tjerë të mirëqenies janë në zgjerim e sipër përgjatë 30 komunave të Kosovës, duke

përshpejtuar kësisoj 'tharjen e trurit' nga qendrat rurale në ato urbane me një tempo alarmante. Reagimet kreative strategjike të cilat ofrojnë njëfarë cytje për kosovarët ruralë - veçanërisht, për rininë - janë esenciale për ta zvogëluar këtë trend brengosës.

Në Kosovën e sotmem, mbretëron realiteti i mundësive të paracaktuara: ata që janë të lindur në Skënderaj apo Novobërdë do të kenë më pak mundësi se sa ata të lindur në Prishtinë; apo, ata të lindur në familje rome do të kenë më pak mundësi se ata të lindur në familje shqiptare.

Të 30 komunat e Kosovës shpalosin një spektër të gjerë të niveleve të zhvillimit njerëzor. Ekziston një shtrirje prej 16% në IZHN mes Prishtinës në maje dhe Novobërdës në fund. Nivelet e të ardhurave janë përcaktuesit parësorë të këtij dallimi me të ardhurat personale në Prishtinë tri herë më të mëdha se të ardhurat personale në nivelin e Novobërdës. Qartazi, Prishtina ka përfituar disproporcionalisht qoftë nga investimet e vendore apo ndërkombëtare gjatë disa viteve të fundit. Gjithashtu, ka të ngjarë që, në këso rrethana, të vazhdojë tutje migrimi dramatik i njerëzve drejt qytetit kryesor të Kosovës.

Bashkësitë e ndryshme etnike të Kosovës gjithashtu shpalosin, në Kapitullin II, një spektër të gjerë të niveleve të zhvillimit njerëzor, me komunitetin e vet serb që kap nivelet më të larta, dhe me komunitetin e ashtuquajtur "rom, egjiptian dhe ashkali" (REA) i cili qëndron shumë më keq. Nivelet e arsimit janë përcaktuesit parësorë të indikatorëve të ndryshueshëm të zhvillimit për komunitetet e Kosovës, me një shkallë të kombinuar të angazhimit prej vetëm 60% në komunitetin REA, krahasuar me një mesatare prej 90%, për pjesën tjetër të popullatës.

Dallimet në nivelet arsimore gjithashtu i kontribuojnë më së shumti pabarazisë mes niveleve të zhvillimit njerëzor brenda grupeve rurale e urbane të popullatës së Kosovës. Vijimi i shkollës së mesme është 10% më i vogël në zonat rurale se sa në ato urbane. Kosovarët ruralë jetojnë së paku tre

vjet më pak se sa ata nëpër zona urbane dhe fitojnë përafërsisht 25% (300 euro në vit) më pak se kundërpalët e tyre urbane.

Përkundër progresit të konsiderueshëm ç'prej vitit 1999, Kosova ballafaqohet me një 'deficit stagnues të demokracisë', i cili minon legjitimitetin e institucioneve të reja të saj. Çdo ditë e rikonfirmon faktin se pa zgjerim të mirëfillt të kanaleve të dialogut dhe të qeverisjes do të shkaktohen më shumë tragjedi të marsit, ndërkohë që kosovarët do të pësojnë dështime të rënda zhvillimore.

Pjesërisht, mundësitë e pabarabarta mes grupeve të ndryshme shoqërore në Kosovë mund të kuptohen funksion i rregullimeve institucionale demokratike që premtojnë. Masa deri në të cilën realitetet e ndryshme të zhvillimit njerëzor do të vazhdojnë të pandryshueshme për grupet dhe komunat e caktuara do të varet nga ajo se si do të funksionojnë sistemet e qeverisjes në të ardhmen. Arkitektura aktuale e qeverisjes, e konstruktuar në periudhën e pasluftës, duhet të jetë shumë më e haptë për përpunimin dhe menaxhimin e një shumësie të zërave, madje qofshin edhe konfliktozë mes vete. Ajo duhet të ndërlihd energjitë e shoqërisë civile, të grupeve të biznesit e të mediave. Devotshmëria e liderëve të Kosovës për të zhvilluar përpjekje të vazhdueshme - e, ndonjëherë edhe sakrificat të rënda politike -- e të ndryshojnë programet dhe politikat ekzistuese kundruall fytyrës së inercionit byrokratik, do të vëhet në sprovë.

Pa dyshim, çështja e qeverisjes dhe, në veçanti, mënyra se si idetë rreth "pjesëmarrjes dhe përfaqësimit" do të lëshojnë rrënjë në procesin zhvillimor të Kosovës do të jetë me rëndësi kyçe për sfidat e zhvillimit njerëzor në Kosovë.

Në traditën e Raporteve të UNDP për Zhvillimin Njerëzor në shkallë globale, RZHNJK 2004 hulumton aspektin specifik të "përfaqësimit dhe pjesëmarrjes" duke e kuptuar të domosdoshëm për zhvillimin e një botëkuptimi më të thellë rreth mundësive dhe pengesave në rrugëtimin drejt përparimit e zhvillimit njerëzor në Kosovë. Kjo

*Kosova ballafaqohet me "deficit të vazhdueshëm të demokracisë", gjë që rrezikon legjitimitetin e institucioneve të reja të Kosovës*

## Demokracia dhe zhvillimi dy anët e një tregimi kosovar

Pesë vjet pas luftës nevojat dhe sfidat e Kosovës mbesin të shumta. Ekonomia e brishtë, papunësia e madhe dhe një spektër i gjërë i grupeve sociale me nevoja të veçanta për asistencë janë vetëm ca nga çështjet që rëndojnë institucionet e reja dhe të brishta të Kosovës. Megjithatë akëcilit institucion, që ka për detyrë përmirësimin e jetës së kosovarëve, i nevojitet kohë dhe përvojë praktike, në mënyrë që institucionet të transformohen në vegla më efektive, më të përgjegjshme dhe më demokratike të Qeverisë.

Strukturat e posaformuara qeverisëse të Kosovës kanë në dispozicion mjete shumë të kufizuara, përderisa duhet të përballen me kërkesa të mëdha dhe një listë të gjatë të nevojave legjitime në një situatë të post-konfliktit. Njëkohësisht, kapacitetet e qeverisjes janë të goditura nga dekadat e zhvillimit të ultë, diskriminimit, dhe nivelit të ultë të shkollimit. Përzgjedhja e prioriteteve dhe kujdesi i duhur për të gjitha këto brenga urgjente nuk është i lehtë.

Unë besoj thellësisht se demokracia nuk mund të jetë prioritet i dorës së dytë. Nuk ka shoqëri që mund t'i lejojë vetit shkujdesje ndaj principeve bazë të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, përderisa ajo ecën drejtë rugës së gjatë të zhvillimit njerëzor. Demokracia është parakusht për çasjen ndaj çështjeve të tjera në shoqëri. Demokracia është shtyllë bazike dhe mjet për zhvillimin njerëzor. Përderisa demokracia nuk mund të garantojë zhvillimin njerëzor, ajo ka mundsinë e krijimit të një situatë me plot virtute të lira që fuqizojnë njerëzit dhe komunitetet në krijimin e politikave të mira që do të zgjerojnë mundësitë ekonomike dhe sociale. Në të vërtetë unë besoj se demokracia është pjesë integrale e vet zhvillimit.

  
Dr. Bajram Rexhepi  
Kryeministri i Kosovës

temë kishte qenë fokus i konsultimeve të shumta, përfshirë edhe ato në nivele komunale, ndërkohë që partnerët e UNDP në Kosovë e shohin atë si çështje kritike për Kosovën gjatë vitit 2004, për shkak të përsheptimit të transferit të pushtetit nga UNMIK-u në IPVQ, dhe, për shkak të zgjedhjeve parlamentare në pritje të caktuara për tetor 2004.

Veçanërisht, RZHNJK 2004 hulumton se si mund të kontribuojnë - apo, të pengojnë - sistemet aktuale të qeverisjes në pjesëmarrjen publike dhe në ndjenjën e drejtshmërisë së përfaqësimit, e që janë përmbajtje kyçe për zhvillimin njerëzor dhe demokracinë e suksesshme. Nocioni i 'përfaqësimit' thekson procesin politik (i.e. vendimmarrjen, udhëheqjen e partive dhe mënyrën e shpërndarjes së pushtetit), ndërkohë që 'pjesëmarrja' nënkupton angazhimin qytetar (metodat që zbatohen për ta dëgjuar zërin e tjetrit). Një 'rrugë dykahëshe' e angazhimit qytetar, që do të përfshinte organizatat lokale, qeverinë dhe agjencitë ndërkombëtare në Kosovë, do të ishte me rëndësi jetike për një zhvillim efikas e të barabartë. Këto parime demokratike janë barabarësisht kritike për sigurimin e asaj për të cilën angazhohen të gjithë kosovarët gjatë procesit të ndërlikuar e të rëndë të transicionit, të filluar nën mbikëqyrjen e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit.

Siç është detajizuar tutje në Kapitullin III, pjesëmarrja qytetare dhe politike në Kosovë është e kufizuar ndërkohë që modeli i rrezikshëm i shpërthimit jashtë-institucioneve të zërit të qytetarëve - e jo brenda tyre - është në shpalosje e sipër. Njerëzit duken më të prirur për pjesëmarrje 'negative', përmes protestave, se sa përmes kanaleve më pozitive apo më formale, institucionale - çfarë do të ishin debatet publike, artikulimi i alternativave të disenjuara të mirë, apo i kritikave. Përforcimi i ndërsjellë i kësaj mungese të pjesëmarrjes qytetare është dështim i drejtpërdrejtë në 'përfaqësimi'. Sa më i mirë të jetë niveli i përfaqësimit, aq më shumë do të ketë gjasa që njerëzit të përfshihen brenda sferës publike dhe të marrin pjesë më konstruktivisht në proceset demokratike. Për më tepër, pjesëmarrja më

e madhe ngrit legjitimitetin e institucioneve në sytë e qytetarit. Është me rëndësi që sistemi i qeverisjes në Kosovë të mundësojë që qeveria, shoqëria civile dhe sektori privat të avancojnë rritjen e përgjithshme ekonomike dhe zhvillimin shoqëror si mjete të përmirësimit të mirëqenies njerëzore. Ky sistem duhet gjithashtu të avancojë liritë e rëndësishme politike dhe qenësore të njeriut, ashtu që të ruajë dhe të zgjerojë zhvillimin ekonomik dhe t'i ofrojë të gjithëve shans për pjesëmarrje në krijimin e një shoqërie të ndershme në të cilën askush nuk lihet prapa.

Zbritja e numrit të votuesve, proceset e dobëta demokratike brenda partive politike, mbikëqyrja gjysmake e drejtësisë dhe e institucioneve të sigurisë, si dhe hutia rreth kompetencave dhe mbajtjes së përgjegjësisë mes nivelit qendror dhe komunave, janë disa nga sfidat kryesore përballë qeverisjes efikase dhe demokratike në Kosovë.

Kapitulli IV shpjegon përse pjesëmarrjes dhe përfaqësimit i duhet kohë të zë vend në Kosovë, duke ekzaminuar një numër të çështjeve kyçe institucionale dhe duke i testuar ato kundruall këtyre parimeve. Analiza e sistemit zgjedhor identifikon disa aspekte pozitive të sistemit zgjedhor me vota të mbyllura, siç është përfaqësimi më efikas i femrës dhe i komuniteteve të ndryshme etnike në kuvend. Megjithatë, këto aspekte pozitive arrihen në dëm të përfaqësimit gjeografik dhe të lidhjes së drejtpërdrejtë të përgjegjësisë mes votuesve në njërën anë dhe deputetëve të Kuvendit, në anën tjetër. Rrjedhimisht, mund të vërehet se fushatat politike janë më shumë të bazuara në simbole sesa në substancë. Sipas sistemit aktual zgjedhor, mungojnë në tërësi cytjet ekzistuese që do të ndikonin në atë që deputetët të angazhohen më shumë për agjendën e zhvillimit njerëzor. Partitë politike operojnë në mënyra që kufizojnë pjesëmarrjen qytetare, duke vënë theksi të fuqishëm në lojalitetin e vazhdueshëm ndaj liderëve politikë. Kjo është e përforcuar përmes një sistemi zgjedhor ku liderët partiakë përcaktojnë rangimin e kandidatëve brenda listave të mbyllura. Mungesa e demokracisë së brendshme brenda partive politike mund të

*Konfuzioni rreth kompetencave dhe përgjegjësisë në mes të pushtetit qendror dhe komunal është sfidë kyçe e qeverisjes demokratike në Kosovë*

*Personat e rrezikuar  
janë lidhja që  
mungon për arritjen e  
pjesëmarrjes dhe për-  
faqësimit të plotë*

kuptohet ndër shkaqet e dyfishimit të numrit të partive politike vetëm në periudhën mes dy zgjedhjeve komunale. Sidoqoftë, përkundër rritjes së spektrit dhe të zgjedhjes partiake, shkalla e qytetarëve që nuk dalin në votime vazhdon të mbetet e lartë: partia më e madhe politike në Kosovë sot përfshinë rreth 600,000 anëtarë, qytetarë që vendosën të mos dalin në votime gjatë zgjedhjeve të fundit komunale.

Është tepër i ulët të kuptuarit publik të aftësisë së qytetarëve për të ndikuar në krijim të politikave dhe të kërkojnë përgjegjësi nga liderët. Vetëm 13% e qytetarëve beson se mund të ndikojë në proceset e vendimmarrjes politike brenda komunës së vet, ndërkohë që 12% beson se mund të ndikojë në vendimmarrjen politike në nivel qendror. Shpeshherë, brishtësia e koalicionit dhe i modus-operandit të saj, që varet nga konsensusi, ka të ngjarë të pengojë procesin e vendimmarrjes brenda qeverisë qendrore. Krahas kësaj, ndikimi dhe përvoja e vogël e shoqërisë civile e cila premton, me gjithë mungesën e një tradite të konsultimit publik gjatë krijimit të politikave kontribuon tutje në përforcimin e këtij botëkuptimi.

Dega ekzekutive kërkon një sistem më të koordinuar të krijimit të politikave, integrim më të mirë të prioritetëve legjislativ brenda imperativeve programore dhe, mbi të gjitha, kapacitet për të monitoruar dhe për të vlerësuar rezultatet, ashtu që të shtohet përqëndrimi në agjendën e zhvillimit njerëzor. Po këta faktorë do të shkaktojnë sfida gjatë implementimit të politikës së "Standardeve për Kosovën" nga e cila shumëçka do të varet gjatë 12-18 muajve të ardhshëm.

Fuqizimi i qeverisë lokale dhe 'decentralizimi' qartazi paraqesin pikënisjet kyçe për çfarëdo diskutimi rreth qeverisjes. Megjithatë, realiteti dëshmon se dalja e ulët në votime gjatë zgjedhjeve lokale, përsëritja e hutisë së gjithmbarshme rreth përgjegjësisë ndaj shërbimeve publike në nivelet qendrore dhe komunale, si dhe politizimi i përpjekjeve për të pushtetëzuar komunat në aspektin e etnicitetit kanë dekurajuar përpjekjet për ta rritur angazhimin qytetar bren-

da qeverive lokale - duke shkuar kësaj në disfavor të plotë të zhvillimit njerëzor të Kosovës. Roli tradicional i shoqërisë civile si "mbikëqyrëse" e institucioneve të drejtësisë dhe të sigurisë duhet tutje të theksohet në Kosovë, nëse kihet parasysh se këto funksione mbesin të rezervuara për agjencitë ndërkombëtare. Megjithatë, përpjekjet vazhdojnë për angazhim më të madh të qytetarëve në ruajtjen e komuniteteve të tyre. Pjesëmarrja qytetare në çështjet e ndjeshme të sundimit të ligjit paraqet gjithashtu një dimension kritik -- edhe pse shpeshherë të anashkaluar -- të qeverisjes që është me rëndësi të veçantë për Kosovën, marrë parasysh historinë e konfliktit dhe traditën e varfër të institucioneve të ruajtjes së ligjit.

Njerëzit e lëndueshëm mbesin 'lidhësja që mungon' për ngritjen e pjesëmarrjes dhe të përfaqësimit të plotë në Kosovë. Ç'prej femrës së paarsimuar, rinisë së papunësuar, të minoriteteve që druajnë për sigurinë e vet, deri te personat me paaftësi dhe të moshuarit të cilëve i duhet kujdes personal - mbetet përgjegjësi e të gjithë kosovarëve mundësimi që çështjet e tyre të prioritetizohen nga ana e qeverisë dhe e shoqërisë civile.

RZHNJK 2004 vendos theks të veçantë në kosovarët e marginalizuar për të cilët duhet një përpjekje e organizuar që të jenë në gjendje të funksionojnë brenda kornizës së sistemit aktual. Gjatë reflektimit të gjetjeve dhe të shënimeve mbi zhvillimin njerëzor, Kapitulli V tërheq vëmendjen në barrierat strukturore të cilat ekzistojnë mes katër grupeve sociale në raport me përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e tyre: femrat, rinia e papunë, fermerët e varfëruar dhe minoritetet, përfshirë edhe komunitetin rom.

- *Kosova mund të fitojë shumë nga angazhimi proaktiv i femrës në arenat politike, sociale dhe ekonomike. Megjithatë, shumë femra ballafaqohen me mundësi të vogla, jo vetëm në kuptim të arritjeve arsimore, por edhe në kuptim të paracaktueshmërisë së rolit të tyre nga një shoqëri e cila dekurajon angazhimin e tyre, pjesëmarrjen politike dhe motivacionin për të*



kërkuar standard më të mirë të të jetuarit. Të parapëlqyerit e fëmijëve meshkuj brenda familjeve vazhdon të ilustrojë pozitën e palakmueshme të femrës në Kosovë.

- Një vend pune mbetet mbase mjete qenësor i pjesëmarrjes në shoqëri; megjithatë, për dhjetëra mijëra kosovarë të rinj, mundësitë e punësimit janë të vogla. Meshkujt dhe femrat nën moshën 25-vjeçare përbëjnë 52% të popullatës së Kosovës. Ata përbëjnë një fushë të vlefshme të talenteve, të shkathtësive dhe të kreativitetit; përfitimi nga kjo fushë do të çytë tutje zhvillimin e Kosovës. Rinisë kosovare duhet t'i ofrohen mundësi më të mira për të barabarësuar pozitën e vet me kundërpalën evropiane, e që pa dyshim do të sjellte shumë rezultate për të gjithë kosovarët.

- Edhe një segment i gjerë i fuqisë punëtore, fermerët e varfëruar, jetojnë në kufi të mbijetesës duke mbetur të shkëputur nga ekonomia moderne. Fermerët nuk janë pjesëmarrës qenësorë në proceset e krijimit të politikave, e as që marrin pjesë në prioritetet e krijuesve të këtyre politikave -- përkundër faktit se 60% e popullatës jeton nëpër zona rurale ku shkalla e varfërisë është më e larta. Shembull, shkalla e njerëzve të cilët ballafaqohen me varfëri ekstreme është tri herë më e lartë nëpër zonat rurale se sa nëpër ato urbane. Zhvillimi i sektorit bujqësor do të ndihmonte në luftimin e varfërisë rurale, duke i ndihmuar 22% të kosovarëve të cilët jetojnë me më pak se 1 dollar në ditë.

- Komuniteti rom është duke humbur garën e zhvillimit njerëzor. Është kjo një pamje e cila përsëritet përgjatë mbarë Evropës. Shkallët e varfërisë njerëzore janë më të lartat në komunitetet e romëve, egjiptianëve dhe ashkalinjëve (REA). Rreth  $\frac{3}{4}$  jetojnë me më pak se 2 dollarë në ditë, kurse rreth 58% janë të papunë. Mundësitë e punësimit brenda këtij komuniteti janë edhe më të rënda për shkak të profilit të ulët arsimor dhe për shkak të qasjes minimale ndaj resurseve prodhuese. Situata për femrën e komunitetit REA është veçanërisht brengosëse.

Varfëria është shumë më pak e shprehur brenda komunitetit serb; megjithatë, shumë prej tyre vazhdojnë të jetojnë brenda enklavave të ruajtura rigorozisht, me liri të kufizuar të lëvizjes. Siguria është brenga e tyre më e madhe ndërkohë që botëkuptimet në këtë aspekt janë brengosëse. Edhe pse janë bërë përpjekje të mëdha për përmirësim të marrëdhënieve ndëretnike dhe për sigurim të të drejtave të minoriteteve, ende vazhdon ndasia e madhe mes komuniteteve. Vëmendja është e përqëndruar në marrëdhënien skajshëm të politizuar mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës të cilët mbesin të polarizuar në po thuaj akëcilën çështje me të cilën ballafaqohet Kosova. Në anën tjetër, 'çështjet' e zhvillimit dhe brought për komunitetet minoritare si REA, boshnjakët, turqit dhe goranët duket të anashkalohen gati tërësisht, duke rrënuar kësisoj mundësinë e bashkëpunimit, të bashkëjetesës dhe të pjesëmarrjes efikase qytetare nga të gjitha komunitetet në procesin e vendimmarrjes.

Edhe pse shënohet rritje e kthimit të një ndjenje të 'normalitetit' në jetët e familjeve në Kosovë, për shumë prej tyre mbetet çmimi i jashtëzakonshëm i konfliktit i cili dëmton rëndë zhvillimin njerëzor. Gjatë viteve të fundit, kosovarët përjetuan një sërë të ngjarjeve traumatike, përfshirë zhvendosjen masive, dhunën dhe humbjen e familjarëve e të miqëve - implikacione këto me rëndësi psikologjike, që duhet të adresohen. Urrejtja dhe ekstremizmi nuk kanë vend brenda agjendës së zhvillimit njerëzor. Shumëçka duhet bërë ashtu që Kosova të mund të vendoset 'në binarë' të shkallëve të zhvillimit të cilat priten dhe meritohen nga të gjithë. Pa një përpjekje të organizuar që do t'i kushtojë të gjitha grupeve të anashkaluara sociale, arritjet e ardhshme për proceset zhvillimore të Kosovës do të dështojnë në ofrimin e ndihmës atyre që kanë më së shumti nevojë për të.

Sfida kryesore e Kosovës është thellimi dhe zgjerimi i qeverisjes demokratike me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe i zgjedhjeve zhvillimore për njerëzit e rëndomtë. Për ta arritur këtë, duhet të definohen dhe të promovohen të drejtat dhe

përgjegjësitë; duhet të inaugurohen reformat kyçe institucionale ashtu që të zgjerohet pjesëmarrja dhe përfaqësimi; do të duhej të vendosej një strategji e përbashkët implementuese ashtu që të udhëheqej përparimi i demokratizimit dhe i zhvillimit njerëzor.

Përforcimi i nocionit të qytetarisë - të drejtat dhe përgjegjësitë e të gjithë kosovarëve, të ndërlidhura me ndjenjën e përkatësisë dhe të lojalitetit ndaj komunitetit - ndodhet në qendër të çfarëdo përpjekjeje për të përgatitur kosovarët për ardhmërinë e përbashkët. Kjo kërkon një angazhim të organizuar dhe të përbashkët nga akterët lokalë dhe ndërkombëtarë. Peërderisa statusi politik i Kosovës mbetet i pazgjidhur, të gjithë kosovarët duhet të inkurajohen për të kuptuar, promovuar dhe për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale të cilat ndodhen në qendër të qytetarisë.

Reformat institucionale dhe ato në krijim të politikave janë të domosdoshme për vendosje të një qeverisjeje të mirë demokratike, duke ngritur kështu profilin e çështjeve të zhvillimit njerëzor. Sistemi zgjedhor, partitë politike, vendimmarrja qendrore, qeverisja lokale dhe sundimi i ligjit vazhdojnë të mbesin pikënisjet kritike përmes të cilave qytetarët inkurajohen për respektim të legjitimitetit të strukturave qeverisëse, shprehje të lirë të mendimit të tyre dhe të pjesëmarrjes gjatë sjelljes së vendimeve të rëndësishme. Puna duhet të fillojë në reformat e domosdoshme, ashtu që të mund të konsolidohen proceset binjake e të ndërlidhura të demokracisë dhe të ndërtimit të paqes.

A do të jenë në gjendje reformat të cilat sot shqyrtohen nga ana e liderëve lokalë dhe ndërkombëtarë ta pushtetëzojnë mirëfilli kosovarët dhe ta ndihmojnë atë që më efektivisht të përmbush nevojat e veta qenësore dhe aspiratat më të larta?

Me këtë dilemë fundamentale, reformat e prezantuara në Kapitullin VI janë të grupuara brenda gjashtë kategorive të veçanta:

*i) Zgjerimi i pjesëmarrjes dhe i përfaqësimit përmes transformimeve qeveritare;*

*ii) Ndërtimi i aleancave në shoqërinë civile, në media dhe në sektorin privat me qëllim të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit më të madh qytetar, dhe*

*iii) ndihmesa në zgjerim të pjesëmarrjes dhe të përfaqësimit përmes angazhimit më të shkathtë ndërkombëtar. Theset e disa nga propozimet reformuese më me rëndësi përfshijnë:*

- *Reformën e sistemit zgjedhor, me qëllim të përmirësimit të përfaqësimit, të ngritjes së përgjegjësisë së drejtpërdrejtë, të stimulimit të partive për të kërkuar përkrahje të grupeve specifike të votuesve dhe përmirësim të demokratizimit brendapartiak*

- *Reformat parlamentare, për sigurim të supremacisë së Kuvendit të Kosovës kundruall degës ekzekutive qoftë në aspektin ligjor apo në atë praktik, duke shërbyer kështu burim kryesor i pushtetit legjitim e demokratik*

- *Reformat në sektorin e drejtësisë dhe të sigurisë do të duhej të siguronin mbikëqyrje demokratike dhe civile të çështjeve juridike dhe të sigurisë përmes theme-limit të kujdesshëm të ministrive të propozuara nga ana e IPVQ - të asaj të brendshme dhe të drejtësisë.*

- *Reformat në nivelin qendror/komunal, me qëllim të përmirësimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe në ofrim të shërbimeve publike përmes decentralizimit të pushteteve specifike politike, financiare dhe administrative*

- Promovimi i barabarësisë gjinore në vendin e punës dhe në shtëpi përmes rregullimeve të pushtetëzimit të femrës, siç janë pushimi i lindjes për prindin mashkullor, veprime promovuese në praktikën e punësimit, shërbime të sigurisë me theks në përkatësinë gjinore si dhe planprograme mësimore me theks gjinor nëpër shkolla;

- Përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike përmes rritjes së pranisë në media dhe nëpër komunitetet lokale të shqiptarëve të Kosovës dhe të shoqërisë civile serbe, dhe të liderëve politikë në bashkëpunim mbi çështjet praktike;

- Inkurajimi i 'gazetarisë paqësore' përmes mediave të lira dhe të pavarura të cilat pushtetëzojnë qytetarin me informacione, duke ia mundësuar sjelljen e vendimeve konstruktive dhe kërkimin e përgjegjësisë nga liderët e pushtetshëm;

- Rrënimin e barrierave ekonomike që pengojnë ndërmarrësinë lokale dhe krijimin e vendeve të punës, përmes qasjes së rritur ndaj financave dhe shkathtësive afariste;

- Krijimin e një baraspeshe më të mirë mes imperativit të stabilitetit dhe të sigurisë në njërën anë, dhe promovimit të ndërtimit të kapaciteteve lokale dhe të rritjes së demokracisë që mundëson shpërthimin e talenteve të të gjithë kosovarëve, në anën tjetër. Veçanërisht, është me rëndësi zgjerimi i përpjekjeve për ndërtimin e kapaciteteve lokale përgjatë fushave kyçe të IPVQ përmes metodave të cilat zvogëlojnë varësinë nga agjencitë ndërkombëtare dhe këshilltarët e tyre.

Edhe pse promovimi i qytetarisë së mirë dhe hartimi i reformave politike e institucionale paraqesin hapa me rëndësi në të ardhmen, ndikimi i tyre do të ishte i kufizuar po që se do të mungonte përkrahje e gjerë mbarëkosovare dhe po të

mungonte një strategji adekuate implementuese. Mobilizimi i qytetarëve dhe i shoqërisë civile për ta përkrahur ndryshimin dhe të ushtrojë presion mbi praktikën paqësore demokratike kurrë nuk është punë e lehtë, veçanërisht atëherë kur kërkohen sakrificat. Për Kosovën, transicioni i ndërlikuar drejt një sistemi modern demokratik (i cili do të përfshinte një prani të gjerë ndërkombëtare) është ballafaquar - dhe, do të vazhdojë të ballafaqohet - me shumë pengesa e kundërshtime të fuqishme. Mirëpo, prijësit e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit më të madh në qeverisje nuk do të duhej të dekurajohen. Përkundrazi, që të mund të jenë më efikasë, këta agjentë të ndryshimeve do të duhej të bashkonin të gjithë akterët reformues për të qenë në gjendje ta avancojnë agjendën e përbashkët demokratike me një qasje të guximshme dhe strategjike.

Çfarë hapa duhet të ndërmerr Kosova që të jetë në gjendje të sigurohet se është në rrugë të qëlluar drejt përmirësimit të zhvillimit njerëzor për të gjithë qytetarët e saj? Ndoshta, mbi të gjitha, kjo do të duhej të ishte prania e grupit të përcaktuar të liderëve përfaqësues, me një vizion të përbashkët dhe afatgjatë i cili do të mund t'i artikulohej qartë publikut. Është kjo esenciale për arritjen e ndryshimeve konstruktive në shoqëri. Udhëheqja e shkathtë dhe e ndershme, e drejtuar kah e ardhmja, e aftë për të pushtetëzuar akterët e tjerë dhe e ndjeshme për nevojat e grupeve më të lëndueshme, është esenciale për udhëheqjen e një politike ambicioze, por urgjente, dhe të reformave institucionale të mbarështruara në RZHNJK 2004. Kosova mund të transformohet përmes politikanëve të guximshëm e të mençur, përmes shërbyesve civilë, gazetarëve, ndërmarrësve dhe organizatave të qytetarëve - liderë këta të cilët mund të ruajnë dhe të shpiejnë përpara parimet demokratike të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit. Pushtetëzimi i këtyre akterëve mund të krijojë dhe të mirëmbajë një elektorat të madh për ndryshime.

*Sfida primare e Kosovës është thellimi dhe zgjerimi i qeverisjes demokratike në mënyrë që të përmirësohen kushtet e jetesës dhe përzgjedhjet zhvillimore të njerëzve të zakonshëm*



# TRANSFORMIMI I ZHVILLIMIT, NË NJË JETË MË TË MIRË

## Definimi dhe matja e zhvillimit njerëzor

Zhvillimi mund të vlerësohet si një proces i vazhdueshëm i rritjes dhe i përparimit. Si i tillë zhvillimi nuk përfshinë ndryshime revolucionare por nënkupton ekzistencën e një procesi të vendosur, që ka për qëllim përmirësimin e jetës së qytetarit dhe shoqërisë. Koncepti i zhvillimit njerëzor i vendosë njerëzit dhe nevojat e tyre në qendër të procesit.

Zhvillimi njerëzor hulumton zgjerimin e mundësive të përzgjedhjes së qytetarit. Me zgjerimin e mundësive qytetarit duhet t'i sigurohet një jetë e gjatë dhe e shëndetëshme, shkollim, standard të mirë të jetës dhe pjesëmarrje aktive në jetën e komunitetit. Procesi tenton të krijojë kushte dhe mundësi të njejta për të gjithë, në veçanti për ata jeta e të cilëve është e cënuar. Kjo bëhet në mënyrë që të zmadhohet potenciali i secilit person.

Matja e zhvillimit njerëzor tejkalon mënyrat tradicionale të matjes të të ardhurave, që në kohë të caktuara ka shtrembëruar faktin që caku themelor i zhvillimit është pikërisht mirëqenia për njerëzit. Edhe pse matjet tradicionale janë shumë të dobishme, ato dështojnë të zbulojnë përmbajtjen e të ardhurave, apo të përfutuesve të vërtetë të rritjes ekonomike. Në disa raste njerëzit mund të çmojnë më shumë kualitetin më të mirë të ushqimit dhe shërbimet e mira shëndetësore, qasjen më të mirë në shkollim, qasjen më të madhe në përgjegjësi dhe vendim marrje, jetën më të sigurtë apo kushtet më të mira të jetës se sa të ardhurat absolute. Mirëpo, këto të ardhura nuk janë të pasqyruara mirë në statistikat e përgjithshme të të ardhurave.

Politikat nacionale të zhvillimit nuk mund të mbështeten vetëm në gjenerimin e të të ardhurave. Në diskursin zhvillimor, rritja duhet të jetë "mjet" dhe "cak" e jo vetëm cak në vetvete. Qasja e zhvillimit njerëzor tërheqë vërejtjen në ndikimin që kanë politikat zhvillimore dhe si përkthehen ato në jetë më të mirë dhe përmirësim të mirëqenies<sup>1</sup>. Tutje, gjatë viteve të fundit, kjo qasje ka rritur theksin në liritë themelore politike të

njeriut, në mënyrë që të balansohet theksi i zhvillimit njerëzor në zhvillim të drejtë social dhe ekonomik.

### **KORNIZA 1.1: MATJA E ZHVILLIMIT NJERËZOR**

Matja më e mirë e zhvillimit njerëzor është Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (IZHNJ). Ky indeks për herë të parë është përdorur në Raportin e Zhvillimit Njerëzor të botuar nga Programi për Zhvillimin i OKB-së (UNDP) më 1990. Ky indeks është krijuar për të matur zhvillimin edhe me mjete të tjera përveç indekseve rritjes ekonomike siç janë Bruto Prodhimi Vjetor (GDP) apo të ardhurat. IZHNJ në vete përmbanë edhe GDP-në por në të llogaritet edhe jetëgjatësia dhe arsimiti. Krijuesit e këtij indeksi kurrë nuk kanë menduar se ky indeks do të jetë njësi e mjaftueshme matëse, por e kanë konsideruar se kjo do të jetë një mjet që do të ndihmonte që vëmendja të drejtohej në brengat e njerëzve, e jo vetëm në rritje ekonomike. IZHNJ mund të ketë vlerën prej 0 deri në 1. Vendet janë të ranguar në nivel të ultë të mesëm dhe të lartë të zhvillimit njerëzor, varësisht nga vlera e indeksit. Vendet që kanë rezultat më të afërt me 1 janë më të zhvilluara.

Komponentat e IZHNJ janë:

- Jetëgjatësia, indikatorë që tregojnë nëse njerëzit janë duke jetuar një jetë të gjatë (për këtë) edhe të shëndetëshme, por gjithashtu këtu implikohet edhe vendi se ku shkojnë resurset dhe a janë ato duke shkuar në drejtim të duhur, a janë duke u shfrytëzuar për shëndetësi preventive dhe primare, apo për shëndetësi kurative;

- Analfabetizmi dhe mesatarja e viteve të shkollimit, një indikatorë nëse njerëzit janë të gatshëm që të përfitojnë nga frutet e zhvillimit, dhe

- Bruto Prodhimi Vjetorë për kokë banori, që reflekton të ardhurat mesatare, por të llogaritura për fuqi blerëse

Mjetet tjera statistikore për të matur zhvillimin janë Indeksi i Varfërisë Njerëzore dhe Indeksi i Zhvillimit Gjinorë, këto janë të detajuara në vazhdim të raportit.

*Zhvillimi njerëzor nuk e mbulon rëndësinë themelore të rritjes ekonomike për prosperitet. Pa rritje zhvillimi njerëzor është i ngujuar. Por zhvillimi njerëzor bulumton çështjet e vërteta prapa zhvillimit - "si transformohet zhvillimi në përparim të jetëve të njerëzve që e përbëjnë shoqërinë?"<sup>2</sup>*

## Raportet nacionale të Zhvillimit Njerëzor

Në tërë botën Raportet Nacionale të Zhvillimit Njerëzor (RNZHNJ), janë shfrytëzuar për stimulimin e dialogut rreth strategjive dhe objektivave zhvillimore dhe

për të monitoruar gjendjen e zhvillimit njerëzor duke ofruar shënime rreth përparimit dhe thekësimit të pabarazive kritike. Deri tashti janë botuar më shumë se 450 raporte kombëtare dhe rajonale në 135 vende të botës<sup>3</sup>. Përgatitja dhe komentet e vazhdueshme të RNZH NJ inicojnë një proces të formulimit të politikave dhe ndërtimit të koncenusit në mesin e të gjithë pjesëmarrësve të procesit. Ky proces tenton të informojë sektorin privat dhe ate të shoqërisë civile për procesin e vendimarrjes në mesin e menagjerëve të resurseve kombtare. Duke kontribuar ide të reja dhe informacione, duke avokuar për më shumë zhvillim të koncentruar drejt njeriut dhe duke ndihmuar në formimin e një vizioni të përbashkët për zhvillimin, RNZH NJ-të krijojnë prespektiva të reja për zhvillimin kombëtarë.

## Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë (RZH NJK)

Ndërtojmë Ura Drejtë të Ardhmes më të mirë (UNDP 2002), raporti i parë i tillë për Kosovën ka ofruar një pamje të përgjithshme të situatës zhvillimore në Kosovë. Raporti për herë të parë ka prezantuar Indeksin e Zhvillimit Njerëzor (IZH NJ), Indeksin e Zhvillimit Gjinatorë (IZHGJ) dhe Indeksin e Varfërisë Njerëzore (IVNJ). Një nga konkluzat kryesore të raportit ishte se të gjitha rangimet relative duke përfshirë edhe ato që përfshijnë çështjet gjinore e vendosin Kosovën në mesin e vendeve me zhvillim të mesëm. Varfëria është identifikuar të jetë e përhapur por jo e thellë.

Ky raport që është i dyti i tillë për Kosovën, bënë një rivlerësim të situatës zhvillimore në Kosovë, dhe për herë të parë ofron shënime për situatën relative nëpër komunat e Kosovës. Tutje raporti do të diskutojë temën e "pjesëmarrjes dhe përfaqësimit" në kapitullin e tretë të Raportit të Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2004.

### Sfidat statistikore

Përpjekjet për kalkulimin e indikatorëve të zhvillimit njerëzor, si dhe të dhënat tjera standarde statistikore në Kosovë vështirësohen nga mungesa e shënimeve të reja dhe të besueshme. Regjistrimi i fundit i popul-

latës në Kosovë është bërë më 1981. E tërë popullata - individët, familjet, lëvizjet - ish-in përfshirë në regjistrim të popullatës të bërë nga Enti Statistikor i Kosovës (ESK). Shënimet e publikuara nga kjo zyrë deri në vitin 1988 mund të konsiderohen si të besueshme<sup>4</sup>. Megjithatë me heqjen e autonomisë së Kosovës më 1989 shumë të punësuar në institucionet shtetërore ose i kanë humbur vendet e tyre ose i kanë lëshuar ato<sup>5</sup> dhe si rezultat i kësaj institucionet e Kosovës pushuan së funksionuari në mënyrë efektive. Në vitin 1991 është bërë regjistrimi i dytë i popullatës, mirëpo besueshmëria e tij është e dyshimtë, pasi ai u bojkotua nga shqiptarët, të cilët përbëjnë pjesën më të madhe të popullatës.

Mungesa e statistikave të vlefshme është bërë akute më 1990, për shkak të lëvizjeve të mëdha të popullatës ku përfshihet edhe periudha pas konfliktit. Sot edhe të dhënat themelore statistikore siç është numri i banorëve, janë të debatueshme. Në RZH NJK janë përdorur katër llogaritje të ndryshme të cilat ndryshojnë deri në 25%<sup>6</sup>. Për momentin ESK-ja vlerëson se Kosova ka 1.9 milion banorë.

Sa i përket besueshmërisë statistikore, në RZH NJK 2002 është thënë se shënimet statistikore të Kosovës mund të klasifikohen në tri grupe:

- 1) *Shënimet e mbledhura para vitit 1990 kur institucionet shtetërore funksiononin normalisht (të besueshme)*
- 2) *Shënimet e mbledhura prej vitit 1990 deri më 1999, kur institucionet shtetërore nuk funksionin në mënyrë efektive (jokomplete, joadekuate, disorientuese).*
- 3) *Shënimet e mbledhura pas vitit 1999 të mbledhura nga organizatat ndërkombëtare së bashku me ESK (së paku pjesërisht të besueshme) <sup>7</sup>.*

Indikatorët e zhvillimit të prezentuara në RZH NJK 2002 janë kalkuluar nga shënimet e kategorisë së tretë. Megjithate studimet e bëra në këtë periudhë kohore kanë përfshi vetëm demografinë, dhe çështjet sociale, ekonomike dhe shëndetë-

sore; asnjë studim nuk është bërë për të gjetur jetëgjatësinë, një nga komponentat e IZHNNJ. Kështu në vitin 2002 ky indikator është kalkuluar duke përdorur të dhënat e para vitit 1990.

### *Anketa e Zhvillimit Njerëzor*

Shënimet komunale në Kosovë janë shumë të rralla, përveç listave të regjistrimit të bizneseve dhe aktiviteteve ekonomike. Duke e pranuar nevojën akute për shënime më cilësore, RZHNNJ i vitit 2004 morri përsipër

AZHNNJ krijon bazën fillestare të indikatorëve për secilën komunë të Kosovës. Vendimarrësit lokal dhe hisenikët tjerë lokal dhe ndërkombëtarë mund të shfrytëzojnë shënimet e sakta të kategorizuara nëpër komuna për: jetëgjatësinë, analfabetizmin të të rriturit, mesataren e shkollimit, përqindjen e njerëzve pa ujë të rrjedhshëm, përqindjen e papunësisë, përqindjen e njerëzve që jetojnë nën nivelin e varfërisë, përqindjen e njerëzve pa qasje në resurse ekonomike, demografinë familjare, dhe

#### **BOX 1.2: NEVOJA PËR NJË REGJISTRIM TË POPULLATËS DHE FAMILJEVE**

Regjistrimi i fundit i popullatës në Kosovë është bërë më 1981. Një regjistrim tjetër është bërë më 1991, por saktësia e tij është e dyshimtë për shkak të bojkotit të shumicës shqiptare. Për shumë arsye të përshkruara më poshtë, një regjistrim i ri i popullatës dhe familjeve është i nevojshëm.

Enti i Statistikave të Kosovës (ESK) për një kohë të gjatë regjistrimin e popullatës e ka bërë prioritet të lartë. Regjistrimi i popullatës nuk është vetëm numërim i banorëve. Ka 29 çështje kyçe dhe 52 çështje jo kyçe që mund të futen në census sipas Eurostatit dhe rekomandimeve të OKB-së. Këto çështje janë tregu i punës, shkollimi, çështjet demografike (lindja, vdekshmëria, migrimi i brendshëm). Për t'u bërë regjistrimi nevojitet një vendim politik, pasi regjistrimi është një punë e madhe dhe për të nevojiten rreth 7 milion euro.

Regjistrimi i popullatës dhe familjeve janë elemente thelbësore të sistemit statistikor në Kosovë. Statistikat e dyshimta të popullatës mund të zvogëlojnë nivelin e besueshmërisë kur rezultatet e anketës së amvisnive kthehen në statistika të përgjithshme të popullatës. Mungesa e një regjistrimi të mirëfillt të popullatës i dëmton edhe llogaritjet tjera, (për shembull Bruto Prodhimin për kokë banori apo statistikave bujqësore.

Familjet dhe lëvizjet zakonisht janë të përfshira në regjistrim të popullatës. Sot të dhënat statistikore në nivel komunal janë shumë të rralla, mënyra e mbledhjes së këtyre shënimeve në nivel të komunës dhe fshatit është nëpërmes regjistrimit. Një regjistrim i popullatës do të mundësojë edhe kryerjen e një anketimi më efikas të amvisnive, pasi me të dhënat e regjistrimit do të mund të hartohet një mostër më e mirë. Disa pyetje rreth agrokultures gjithashtu do të shpejtonin edhe një regjistrim të agrokulturës.

ESK-ja ka përgatitur një projektligj për regjistrimin e popullatës më 2002. Ky projekt është shikuar nga një grup interministrorë në fillim të vitit 2003 dhe ju ka dhënë Qeverisë së Kosovës. Qeveria këtë ja ka dërguar Kuvendit, i cili e aprovoi ligjin për regjistrimin e popullatës më 11 korrik 2003. Koalicioni Povratak ka pasur vërejtje në ligj kështu që është bërë një panel special për ta shqyrtuar këtë çështje. Paneli është pajtuar me 5 dhejtor 2003 se ligjit i nevojiten pesë amendamente. Kuvendi ka votuar kundër amendamenteve ndërsa PSSP-ja nuk dëshiron ta lëshoj ligjin pa ato amendamente. Kështuqë ESK ende pret për vendimin politik për të bërë regjistrimin.

Enti Statistikor i Kosovës, maj 2004

detyrën e ndërtimit të të dhënave komunale mbi zhvillimin njerëzor. Kështu në mes të vitit 2003 UNDP-ja dhe partnerët<sup>8</sup> e vet nisën punën për Anketën e Komunale të Zhvillimit Njerëzor (AZHNNJ) në mënyrë që të vlerësohen komponentat e Zhvillimit Njerëzor (IZHNNJ, IVNJ, dhe IZHGG). AZHNNJ-ja ka mundësuar që të kuptohet më mirë gjendja relative e secilës komunë sa i përket zhvillimit njerëzor. Njëkohësisht AZHNNJ ka ofruar shumicën e shënimeve të nevojshme për të llogaritur indikatorët e Zhvillimit Njerëzor në Kosovë për raportin e vitit 2004<sup>9</sup>.

mesataren e të ardhurave për familje dhe shpenzimet. Për më shumë detaje rreth anketës dhe metodologjisë mund të shikoni në Aneksin 1.

### **Trendet në Zhvillimin Njerëzor në Kosovë**

Identifikimi i trendeve të zhvillimit njerëzor në Kosovë është në veçanti sfidues. Për shkak të mungesave statistikore, shumë shifra të prezantuara në RZHNNJ 2002 mund të mirren vetëm si vlerësime. GDP-ja për kokë banori dhe niveli i varfërisë janë llogaritur nga AQF-ja<sup>10</sup> dhe Banka Botërore,

respektivisht duke u bazuar në metodat e anketimit<sup>11</sup>.

## Indeksi i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë

Në mes të RZHNJ 2002<sup>12</sup> dhe 2004 është regjistruar një rritje e vogël në agregatin e Ideksit të Zhvillimit Njerëzor për Kosovën<sup>13</sup>.

Me Indeks zhvillimior në vlerë prej 0.734 Kosova takon në mesin e vendeve me zhvillim të mesëm. Pjesa më e madhe e fqinjëve të Kosovës janë në nivel të njëjtë: megjithatë Sllovenia dhe Kroacia gjenden në nivel të lartë të zhvillimit njerëzor. Sa i përket rajonit të Evropës Juglindore, Kosova gjindet në pjesën e ultë të tabelës (shiko figurën 1.1). megjithatë niveli i zhvillimit njerëzor në Kosovë është më i afërt me atë të vendeve si Norvegjia, se sa i atyre që gjinden në fund si Siera Leone.

përderisa Indeksi i jetëgjatësisë duket se ka një rënie të vogël<sup>15</sup>.

## GDP Bruto Prodhimi Vendor

Siç është parë në tabelën 1.2, Kosova ka përjetuar një ngritje të vogël të GDP-së krahasuar me trendin e mëparshëm të raportimit.

### Ndryshimet e GDP-së nga 1985 deri më sot

Figura 1.2 e dhënë më poshtë tregon për ndryshimet e GDP-së gjatë viteve të nëntëdhjeta. Gjatë kësaj kohe GDP-ja ka rënë në mënyrë drastike, gati sa një e katërta e saj në vitet e tetëdhjeta, si rezultat i politikës së Milosheviqit si dhe efekteve të luftës në republikat ish-jugosllave. Që nga viti 2000 Kosova ka pasur një rritje të GDP-së. Megjithatë GDP-ja e Kosovës për kokë banori (siç është llogaritur nga FMN-ja) nuk

TABELA 1.1 KOMPONENTAT E IZHNIJ 2001 DHE 2003

		Indeksi i jetëgjatësisë	Indeksi i mbarvajtjes së shkollimit	Indeksi i regulluar i GDP I (PPP USD)	IZHNJ (PPP)
2001	Shënime ekzistuese FMN	0.818*	0.829**	0.507	0.721
2004	AZHNIJ FMN	0.731	0.923	0.548	0.734


Burimi: \* Begolli I., 2001 dhe \*\* UNFPA/ IOM, 2000, UNDP AZHNJ 2004

## Komponentat e IZHNIJ të Kosovës

Komponentat e IZHNIJ janë të shënuara në Tabelën 1.1. Në mes të RZHNJK 2002 dhe 2004, Indeksi i Mbarvajtjes në Shkollë<sup>14</sup> dhe GDP-ja kanë regjistruar ngritje të vogla,

ka arritur nivelin e vitit 1985. Tutje kësaj duhet shtuar se trendet e rritjes mund të jenë rezultat i parave të donatorëve për rindërtim si dhe tepricave të ardhura nga diaspora, e jo aq nga prodhimi dhe shtimi i vlerës në bazë të prodhimit vendorë.

FIGURA 1.1 IZHNIJ KRAHASIMET RAJONALE DHE BOTËRORE



Burimi: UNDP AZHNJ 2004; UNDP RZHNJ Global 2004

TABELA 1.2 RITJIA E GDP-SË

	2000	2001	2002	2003
GDP, në miliona Euro	1,328	1,536	1,569	1,640
Rritja e GDP (Përqindje)		15.1	2.1	4.5
GDP për kokë banori në □	730	823	826	848


Burimi: FMN vlerësime, Mars 2004

### Krahasimet rajonale të GDP-së

Pariteti në mes të Fuqive Blerëse (PPP) është një metodë e krahasimit të GDP-së në mes të ekonomive të ndryshme. PPP zbulon se çka do të sigurojë (blejë) një dollar në Kosovë në krahasim me atë çka do të sigurojë (blejë) në SHBA.




**FIGURA 1.2 NDRYSHIMET NË GDP PËR KOKË BANORI NË USD, 1985-2003**



Burimi : Riinvest, 1998; Banka Botërore, 2001; FMN 2004

Figura 1.3 tregon PPP-në e llogaritur sipas GDP-së së Kosovës në krahasim me vendet e Evropës Juglindore (EJL). Në vendet e EJL, niveli i PPP-së dallon prej 3 deri 4, që do të thotë se një dollarë mund të sigurojë tri deri katër herë më shumë gjëra se sa në SHBA. Duke u bazuar në krahasim me fqinjët, PPP-ja e llogaritur për GDP-në e Kosovës është 3<sup>16</sup>. GDP-ja e Kosovës sipas PPP-së së llogaritur është 2,660 dollarë. Krahasimi tregon që, përkundër rritjes ekonomike Kosova në periudhën pas konfliktit gëzon vetëm një të tretën e GDP-së së Kroacisë dhe më pak se gjysmën e GDP-së së Maqedonisë apo Bosnjë e Hercegovinës.

**FIGURA 1.3 GDP (PPP) KRAHASIMET RAJONALE**



Burimi: UNDP AZH NJ 2004; UNDP RZHNJ Global 2004


## Jetëgjatësia

Indikatori themelor që mat nëse njerëzit kanë një jetë të gjatë dhe të shëndoshë është indeksi i jetëgjatësisë. Ky indeks është themelor në llogaritjen e IZH NJ. Sipas AZH NJ-së jetëgjatësia mesatare në Kosovë është 68.8 vjet, (67.8 për meshkuj, 69.9 për femra)<sup>17</sup>.

### Trendet në jetëgjatësi

Jetëgjatësia është indeksi më i ndjeshëm i IZH NJ nga veprimet egzogjene, siç janë konfliktet dhe epidemitë. Kështu duhet të kalojë një kohë shumë më e gjatë që ky indeks të përmirësohet dhe të manifestohet në statistikat e përmbladhura agregate, krahasuar me trendet që manifestohen menjëherë. Siç tregohet në figurën 1.4 kanë kaluar përafërsisht 50 vjet që jetëgjatësia te kosovarët të ngritet për 30 vjet. Për ndryshim prej kësaj që nga mesi i viteve nëntëdhjetë mesatarja e jetëgjatësisë ka rënë për pesë vjet, për shkak të konfliktit të vitit 1998-1999. Për shkak të shumë përmirësimeve sa i përket kushteve të jetesës dhe kushteve ekonomike gjatë 4-5 vjetëve të fundit trendi rënës i jetëgjatësisë është ndaluar. Kjo gjithashtu tregohet edhe nga rastet e vdekjeve në periudhën pas konfliktit, të raportuar nga AZH NJ<sup>18</sup>.

**FIGURA 1.4. JETËGJATËSIA NË LINDJE (NË VJET) PËR POPULLATËN KOSOVARE**



Burimi: Begolli I., 2001 dhe UNDP AZH NJ, 2004


### Krahasimet rajonale në jetëgjatësi

Kosova ka indeksin më të ultë të jetëgjatësisë në rajon (shiko figurën 1.4). Njerëzit në Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Maqedoni dhe Kroaci mund të presin të jetojnë tri deri katër vjet më gjatë se sa kosovarët.

## Niveli i arsimimit

Duke pasur parasysh se gjysma e popullatës së Kosovës është nën 25 vjet<sup>19</sup> atëherë

FIGURA 1.5 JETËSGJATËSIA KRAHASIMET RAJONALE




: UNDP, RZHNJ Global, 2004, fq. 237-240; UNDP Kosova, AZHNJ, 2004

mbarëvajtja e mësimimit është e një rëndësie të veçantë për zhvillimin njerëzor. Indeksi i arsimimit është i përbërë nga shkalla e shkollimit të rriturit, si dhe shkalla e regjistrimit në shkollat fillore dhe të mesme. Ky indeks mund të veshetrohet nga këndi i sasisë së resurseve që shkon në shkollim dhe sa janë këto resurse të shpërndara në mënyrë të barabartë në tërë grupet e popullatës.

### Trendet në arsimim

Ngjajshëm me Indeksin e Jetësgjatësisë (IJ), edhe Indeksi i Arsimimit është i ndjeshëm

FIGURA 1.6 NIVELI I REGJISTRIMIT NË SHKOLLË NË KOSOVË 2001 DHE 2003



Burimi: UNFPA/ IOM, 2000b, UNDP Kosovë AZHNJ, 2004

në ndryshimet afatshkurtëra. Shkollimi në Kosovë është përballuar me sfida të shumta gjatë viteve të nëntëdhjeta, dhe në veçanti gjatë konfliktit kur janë shkatërruar shkollat dhe infrastruktura ndërsa universiteti dhe disa shkolla janë mbyllur për kohësisht. Natyrisht se shënimet kuantitative të prezantuara këtu nuk tregojnë tërësisht ndikimin e këtyre ngjarjeve në arsim dhe nuk tregojnë trendet kualitative të shkollimit në Kosovë. Megjithatë, trendet e përgjithshme në Kosovë tregojnë shenja të përmirësimit, së paku sa i përket regjistrimit në shkolla fillore dhe analfabetizëm.

### Shkalla e regjistrimit në shkollë

Shkalla e regjistrimit në shkollë në Kosovë në përgjithësi është përmirësuar që nga botimi i RZHNJK 2002, e në veçanti sa i përket regjistrimit në shkollë të mesme (shiko figurën 1.6). i vetmi përjashtim është shkollimi i lartë ku shihet një rënie (shiko tabelën 1.3). Për shembull Universiteti i Prishtinës ka regjistruar një rënie të regjistrimit të studentëve të moshave 18-24<sup>20</sup>. Këto trende mund të jenë reflektim i trendeve të tjera: (i) disproporcion në mes të kërkesës dhe ofertës - Universiteti nuk arrin të zhvillohet në të njëjtin ritëm me popullatën 18-24; (ii) joshja për studim jashtë vendit dhe rritja e mundësive për një gjë të tillë; (iii) shtyerja e shkollimit të lartë e njerëzve që tashti kanë mbi 24 vjet si rezultat i ndërprerjes së studimeve gjatë konfliktit apo menjëherë pas tij.

TABELA 1.3 NIVELI I REGJISTRIMIT NË SHKOLLIMIN E LARTË

Viti shkollor	Numri i Studentëve	Regjistrimi në Universitet (%)
1970/1971	10.368	15.2
1980/1981	43.321	20.6
1990/1991	29.016	10.9
1995/1996	21.632	11.6
2000/2001	20.277	7.5
2002/2003	23.175	5.0

Burrimi: Shënimet nga 1970 deri 2001 janë nga KEC, "Disa Aspekte të Efektivitetit të shkollimit në Kosovë," 2002

Shënimet nga 2002/2003 janë nga ESK-ja, "Statistikat sociale: Edukimi i Lartë në Kosovë," 2003

## Krahasimet rajonale në shkallën e shkollimit të të rriturit

Siç mund të shihet nga figura 1.7 shkalla e shkollimit është përmirësuar dukshëm gjatë viteve 1960-1980; gjatë kësaj kohë është zhvilluar një rrjet i shkollave fillore dhe të mesme si dhe është themeluar universiteti.

Rezultatet e AZHNJ-së tregojnë se shkalla e shkollimit të të rriturit në Kosovë është 94.2 për qind, që është përafërsisht 1 për qind më lartë se sa është raportuar sipas RZHNJK 2002. Kjo tregon për ndikimin pozitiv të organizatave vendore dhe ndërkombëtare në zhvillimin e shkollimit sidomos sa i përket kurseve të analfabetizmit<sup>21</sup> për më të vjetrit dhe gratë.

Niveli i analfabetizmit në Kosovë është i ngjashëm me atë në Maqedoni, por është më i ultë se në Shqipëri apo në Bosnjë e Hercegovinë. Kosova sa i përket shkollimit ka më shumë gjëra të përafërta me vendet e zhvillimit të lartë njerëzor se sa me ato të zhvillimit të ultë njerëzorë.

kufizuar në energji, informata, resurse, mundësi dhe mundësi përzgjedhjeje. Përjashtimi social apo marginalizimi i të varfërve siguron që zërat e tyre të mbesin të shurdhër dhe nevojat e tyre të papërm-bushura.


"Në Kosovë, varfëria shihet si mungesë e të ardhurave të regullta apo mungesë e plotë e të ardhurave, si dhe mungesë të kur-simeve dhe bagëtisë. Varfëri do të thotë edhe jeta në shtëpi llaqi dhe guri në mungesë të të mirave themelore duke u varur nga mëshira e fqinjëve apo organi-zatave humanitare". Vlerësimi i Varfërisë nga Banka Botërore, 2001.

## Indeksi i Varfërisë Njerëzore

Varfëria është një fenomen kompleks social gjerësia e të cilit është vështirë të matet me mjete standarde. Qasja multidimensionale e matjes së varfërisë mundohet të integrojë dimensionet sociale, ekonomike, dhe poli-tike si dhe pasojat njerëzore e të qentit i var-fër. Indeksi i Varfërisë Njerëzore (IVNJ) i kalkulluar për herë të parë në RZHNJ glob-

*"Varfëri do të thotë mungesa e zgjedhjes dhe mundësive për zhvillim njerëzor"*  
(UNDP, 1997 RZHNJ Global: 15).

FIG.1. 7 NIVELI I ANALFABETIZMIT NË KOSOVË



Burimi: KEC, 200b; UNFPA/IOM, 2000b; UNDP AZHNJ, 2004

## Varfëria njerëzore

Definicioni më i zakonshëm i varfërisë është pamundësia e mbajtjes së një standardi të pranueshëm të jetesës, matur në bazë të nevojave themelore të konsumit<sup>22</sup>.

Definicionet tjera të varfërisë nuk përfshijnë vetëm të ardhurat apo deprivimin material, por edhe qasjen e mangët apo mungesën e plotë të qasjes në shërbime themelore siç janë shëndetësia, shkollimi, uji i pastër, sanitariteti si dhe rrezikimi nga fatkeqësitë e ndryshme. Të varfërit shpesh kanë qasje të

al më 1997, është punuar për të mbluar një prespektivë më të gjërë. IVNJ llogaritet përqindjen e njerëzve që jetojnë në varfëri, ku varfëria llogaritet ndryshe nga definicioni mungesë e parave dhe të të mirave materiale. Siç diskutohet në Kornizën 1.3 ekzistojnë dy indekse të varfërisë njerëzore, që të dyjat janë përdorur në këtë raport. Indeksi i parë IVNJ-1, hulumton paraqitjen e varfërisë më ekstreme, duke përfshirë edhe elementet si qasja në ujë dhe shëndetësi, përderisa indeksi i dytë IVNJ-2 hulumton varfërinë më pak ekstreme.

### KORNIZA 1.3: ÇKA ËSHTE INDEKSI I VARFËRISË NJERËZORE (IVNJ-1 DHE IVNJ-2)?

Varfëria njerëzore është një koncept që përthekon shumë dimensione të varfërisë që ekzistojnë edhe në vendet e varfura edhe në ato të pasura - kjo përfshinë mohimin e mundësive dhe përzgjedhjeve për një jetë e cila vlenë të vlerësohet dhe të jetohet. IVNJ-1 matë mungesën e tri gjërave që gjithashtu maten edhe me IZHJ (jeta e gjatë, arsimimi dhe standardi i pranueshëm i jetës). IVNJ-2 përfshinë edhe përjashtimin social përveç gjërave që përfshinë IVNJ-1.

• Për IVNJ-1 (përdoret për vendet në zhvillim), përjashtimi nga jetëgjatësia matet me mundësinë e njeriut që të jetojë mbi moshën 40 vjeçare në momentin kur ai lindë; përjashtimi nga arsimimi matet me përqindjen e analfabetizmit të rriturit; përjashtimi nga standardi i pranueshëm i jetës matet me dy variabla: përqindja e njerëzve që nuk kanë qasje në ujë të pishëm dhe përqindja e fëmijëve nën moshën pesë vjeçare që janë nën peshë normale.

• Për IVNJ-2 (përdoret në vendet e zhvilluara), përjashtimi nga jetëgjatësia matet me mundësinë e njeriut që të jetojë mbi moshën 60 vjeçare në momentin kur ai lindë; përjashtimi nga arsimimi matet me përqindjen e të rriturve që kanë mungesë të dijenive funksionale; përjashtimi nga një standard i pranueshëm i jetës matet nga përqindja e njerëzve që jetojnë nën nivelin e varfërisë të vendosur në vlerën prej 50 përqind të të ardhurave të pranueshme familjare; ndërsa përjashtimi social matet nga numri i të papunësuarve (ata që nuk kanë pasur vend pune për më shumë se 12 muaj).

*Burrimi Zyra e Zhvillimit Njerëzor, New York*

*Për politikëbërësit  
mungesa e mundësive  
dhe shanseve është më  
e rëndësishme se var-  
fëria në të ardhura,  
pasi e para koncentro-  
bet në shkaqet e var-  
fërisë dhe shpien drejt-  
përdrejtë në strategjitë  
e fuqizimit dhe  
veprimet tjera në  
mënyrë që të përmirë-  
sohen shanset për të  
gjithë  
(Raporti Global i  
Zhvillimit Njerëzor  
1997:5)*

Për politikëbërësit, mungesa e mundësisë së zgjedhjes dhe shanseve ndonjëherë është më e rëndësishme se sa varfëria në të ardhura, pasi ajo fokusohet në shkaqet e varfërisë dhe dërgon drejtë strategjive të fuqizimit dhe veprimeve të tjera që do të mundësonin rritjen e shansave për të gjithë. RZHNJ Global 1997:5.

### Trendet e varfërisë njerëzore në Kosovë

RZHNJK 2004 thotë se totali i njerëzve që jetojnë në varfëri ekstreme (definiuar sipas

IVNJ-1) ka rënë në 9.6 përqind nga 17.6 përqind më 2001. Kjo del në veçanti nga numri i njerëzve që pritet ta mbijetojnë moshën 40 vjeçare dhe një përmirësim në shkallën e analfabetizmit. Nga ana tjetër, kur matet nga pjesa e popullatës që nuk ka mjetet materiale për të siguruar 2,100 kalori në ditë për të rritur<sup>23</sup> atëherë numri i njerëzve që jetojnë në varfëri është rritur nga 11.9 përqind më 2001 në gati 13 përqind më 2003. Pasi IVNJ-2 është matur për herë të parë në Kosovë atëherë nuk mund të bëhet ndonjë krahasim. Megjithatë niveli i papunësisë që është pjesë e IVNJ-2 ka rënë nga 50 përqind në 44 përqind sipas AZHNJ-së (refero në tablën 1.4). Kjo është në ndryshim me perceptimet publike në këtë çështje (shih më poshtë) dhe nga statistikat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale<sup>24</sup> që thotë se numri i të papunësuarve është rritur për 10 përqind gjatë vitit 2003<sup>25</sup>. Sipas AZHNJ dhe siç është thënë në Tabelën 1.5, shkalla e pjesëmarrjes në fuqi punëtore është pak mbi 52 përqind. Përqindja e njerëzve që jetojnë me më pak se 2 dollarë në ditë gjithashtu ka rënë nga 50 përqind në 47 përqind. Këto statistika tregojnë për një rënie të vogël në varfërinë më pak ekstreme.

### Papunësia një brengë e madhe për Kosovën

Një nga mënyrat më të mira për promovimin e zhvillimit njerëzor është që të sigurohet që secili qytetar të ketë shansë të njëjtë për gjetjen e një pune me pagesë fer. Në Kosovë mundësitë e pjesëmarrjes në

TABELA 1.4 IZHJ-1 DHE IZHJ-2 PËR KOSOVËN 2001 DHE 2003

Indekset e Varfërisë Njerëzore	2001	2003
IVNJ-1 (përdoret për vendet/rajonet në zhvillim)	17.6	9.7
Përqindja e popullatës që pritet të vdes para moshës 40 vjeçare	25.3	7.0
Përqindja e të rriturve që janë analfabet	6.5	5.8
Përqindja e njerëzve pa qasje në ujë të pishëm	4.4	27.4**
Përqindja e njerëzve pa qasje në shërbime mjekësore	---	8.9
Vdekshmëria e foshnjave (%)	3.5	3.5
Përqindja e fëmijëve nën peshë normale	4.1	4.0
Përqindja e njerëzve që jetojnë nën standard të pranueshëm	11.9	13
IVNJ-2 (Përdoret për vendet/rajonet e zhvilluara)		36.7
Përqindja e popullatës që pritet të vdes para moshës 60 vjeçare	---	13.4
Përqindja e të rriturve analfabetë	6.5	5.8
Përqindja e njerëzve që jetojnë me dy dollarë në ditë	50.3	47.7
Përqindja e të papunësuarve të moshës 15-64	50-55	44.4

\*Organizata Botërore e Shëndetësisë

\*\* Më 2003 është llogaritur përqindja e njerëzve pa qasje në ujë të rrjedhshëm dhe kjo nuk ka përfshi ujin në shishe dhe rezervoaret kështu që përqindja është më e madhe se ajo më 2001.

ekonomi janë të kufizuara, duke filluar nga shtylla bazike e këtij lloji të pjesëmarrjes puna. Rapoportet e Paralajmërimit të Hershëm<sup>26</sup> (RPH) vazhdimisht kanë treguar se kosovarët janë të brengosur për papunësinë. Rishtasi një anketë e RPH-së<sup>28</sup> ka treguar se vetëm 4 për qind të të anketuarve (pa marrë parasyshë etnicitetin) i

stin e zhvillimit njerëzor<sup>29</sup>.

Për të llogaritur pabarazinë gjinore shfrytëzohen dy indikatorë të zhvillimit njerëzor


- *Indeksi Zhvillimorë Gjinorë (IZHGJ), një indeks i komponuar që matë nivelin e barazisë në mes të meshkujve dhe*

TABELA 1.5: PJESËMARRJA NË FUQINË PUNËTORE DHE PAPANËSIA

	Shkalla e pjesëmarrjes në %			Shkalla e papunësisë në %		
	M	F	Totali	M	F	Totali
Rurale	74.39	25.54	49.54	42.62	65.50	48.62
Urbane	76.64	37.19	55.96	33.48	52.11	39.97
Totali	75.42	30.91	52.47	38.47	58.06	44.42

Burrimi: UNDP AZHNJ, 2004

FIGURA 1.8 PROBLEMET KRYESORE ME TË CILAT BALLAFAQOHET KOSOVA SOT.



Burimi: Anketa e korrupsionit, UNDP dhe Index Kosova, Prill 2004

konsiderojnë mundësitë e punësimit si të mira, përdërisa 14 për qind mendonin se në të ardhmen do të bëhet më mirë. Sipas një ankete<sup>28</sup> të bërë në prill të vitit 2004, 81 për qind të respondentëve kanë identifikuar papunësinë si problemin numër një apo numër dy me të cilin ballafaqohet popullata e Kosovës.

## Femrat dhe zhvillimi

RZHNJK dëshmon se parametrat e zhvillimit njerëzor mund të ndikohen nga gjinia e një personi. Kështu që analizat tentojnë të ilustrojnë mënyrat se si gratë janë të disfavorizuara në bazë të gjinisë së tyre dhe pasojat që ato duhet ti durojnë në kontek-

femrave duke krahasuar komponentat e IZHJ-së.

- *Masat për Pushtetëzim Gjinorë (MPGJ), një indikatorë tjetër kompozit që kapë barazinë gjinore në participim politik, ekonomik dhe qasje në resurse ekonomike.*

## Indeksi i Zhvillimit Gjinorë në Kosovë

IZHGJ për Kosovën për herë të parë është llogaritur në RZHNJK 2002. Edhe pse në mes të botimit të RZHNJK 2002 dhe 2004 është vërejtur një rritje e vogël (shiko tabelën 1.6), rezultati përfundimtarë është

TABELA 1.6 TRENDET NË ZHVILLIMIN GJINORË

Viti	Indeksi i jetëgjatësisë së shpërndarë në mënyrë të barabartë	Indeksi i mbarvajtjes së mësimit i shpërndarë në mënyrë të barabartë	Indeksi i GDP-së i shpërndarë në mënyrë të barabartë (PPP USD)	IZHGJ (PPP)
2001	0.828	0.828	0.452	0.699
2003	0.74	0.917	0.522	0.726


Burimi: RZHNJK 2002 dhe UNDP AZHNJ 2004

se femrat janë më të pafavorizara se meshkujt në shumicën e dimensioneve të IZHJ.

## Krahasimet rajonale të IZHJ

IZHGJ-ja e Kosovës (0.707) rangohet në fund të listës së vendeve me zhvillim të mesëm të këtij indeksi. (shiko edhe figurën 1.8).

FIGURA 1.9 KRAHASIMET E INDEKSIT TË ZHVILLIMIT GJINORË.



Burimi: UNDP Global RZHNJ, 2004; UNDP AZHNJ, 2004

### Komponentat e Indeksit të Zhvillimit Gjinorë dhe dallimet në mes të gjinive

Dallimi i madh në mes të ardhurave në mes të femrave dhe meshkujve në Kosovë është shkaku kryesorë pse IZH Gj në Kosovë është relativisht i ultë. Meshkujt fitojnë rreth katër herë më shumë se femrat (134 euro me 42 euro në muaj), dhe femrat në përgjithësi kanë poste më pak të paguara se meshkujt. Duhet të theksohet se formalisht nuk ka ndonjë rregull që do të përcaktonte që femrat të paguheshin më pak se meshkujt. Dallimi tjetër më i madh në mes të femrave dhe meshkujve është pjesëmarrja në fuqinë punëtore. Përdorësi 75 për qind të meshkujve marrin pjesë në fuqinë punëtore, te fem-

rat kjo pjesëmarrje është 31 për qind. Komponentat e tjera të IZH Gj zbulojnë pabarazi të tjera. Meshkujt kanë në përgjithësi dy vjet më shumë shkollim se femrat, edhe regjistrimi në shkolla fillore dhe të mesme është më i lartë te meshkujt se te femrat, përdorësi analfabetizmi është më i theksuar te femrat se sa te meshkujt (shiko figurën 1.10).

### Masat për Pushtetëzimin Gjinorë


MPGJ përbëhet nga:

- Pjesëmarrja politike dhe në vendim - marrje, siç matet përqindja e femrave dhe meshkujve në parlament/kuvende komunale;
- Pjesëmarrja ekonomike dhe pushteti vendimarrës, e matur me dy indikatorë: përbërja e pozitave si legjislatorë, zyrtarë të lartë dhe menaxherë dhe përqindja e pozitave profesionale teknike në të cilat punët i kryejnë femrat dhe meshkujt;
- Pushteti mbi resurset ekonomike, që matet sipas fitimit të femrave dhe meshkujve duke u matur si (PPP në USD);

### Krahasimet në MPGJ

MPGJ-ja e Kosovës (0.465) e futë Kosovën në mesin e vendeve me zhvillim të lartë njerëzor sa i përket këtij indikator. Kosova është mbi Rumaninë që është në vendin 53 dhe nën Kilin në vendin 52. Ky rangim është rezultat i vendeve të rezervuara në Kuvend, ndërsa të gjitha komponentat e tjera të MPGJ-së janë më të ulta se ato në Rumani dhe Kili (tabela 1.7).

FIGURA 1.10 DALLIMET NË MEST TË MESHKUJVE DHE FEMRAVE NË INDIKATORË TË CAKTUAR NË KOSOVË



Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004

#### KORNIZA 1.4: TRENDET GLOBALE NË BARAZINË GJINORE

Hulumtimet tregojnë për zhvillim të ngadalshëm dhe jo të barabartë në barazinë gjinore. Ka bariera të mëdha në barazinë gjinore në të gjitha sferat e jetës:

- Dy të tretat e 876 milion analfabetëve janë femra.
- Nga 1 miliard të më të varfurve në botë tri të pestat janë femra dhe vajza.
- Përkundër faktit se shumica e më të varfurve në botë janë femra dhe vajza, strategjitë për zvogëlimin e varfërisë janë të pamjaftueshme për të adresuar ndikimin diferencues të varfërisë dhe të pamjaftueshme për të kapur aspektin diferencues të varfërisë.
- Femrat paraqesin një pjesë në rritje të njerëzve që jetojnë me HIV-AIDS. Në vendet me përqindje të lartë të HIV-it femrat dhe vajzat me shkollim të pakët janë në rrezik më të madh të kontraktimit të HIV-it se sa meshkujt.
- Vetëm në 16 vende të botës përfaqësimi i femrave në parlament është mbi 25 për qind. Mesatarisht më 1990, 11 për qind të deputetëve janë femra, ndërsa më 1987 ky numër është 9 për qind.
- Nga 446 ministra të kabinetit femra në 151 vende në vitin 2000, 20 për qind të tyre kanë pasur postin e Ministrisë për femrën apo për çështje Sociale, ndërsa vetëm 5 për qind ishin ministresha të Financave, Ekonomisë apo Zhvillimit.
- Nje e katërta deri te gjysma e grave të botës kanë përjetuar keqtrajtim fizik.
- Gratë dhe fëmijët përbëjnë 80 për qind të 35 milion refugjatëve dhe të të zhvendosurve në botë, dhe ata në veçanti janë të rrezikuar nga dhuna seksuale gjatë ikjes, gjatë qëndrimit në kampe refugjatësh apo gjatë rivendosjes.

Burimi: UNDP, 2003, Gender Thematic Guidance Note, Astrida Neimanis dhe Arkadi Tortisyn, faqe 6. National Human Development Report Office

TABELA 1.7 MPGJ DHE KOMPONENTAT

	MPGJ	Vendet në palament të cilat i kanë gratë (% nga totali)	Femrat në legjislacion, zyrtarët e lartë dhe menagjerët (% nga totali)	Profesionistet femra dhe punëtorë teknik (% nga totali)	Shkalla e vlerësuar e të ardhurave të femrave dhe meshkujve
Kili	0.467	10.1	24	50	0.38
Rumania	0.460	9.9	29	57	0.58
Kosova	0.465	24.1	17	23	0.31

Burimi: UNDP, Global HDR, 2003, AZHNJ, 2004

## Kosova dhe Objektivat Zhvillimore të Mileniumit: Ku do të jemi më 2015?

Në vitin 2000, 147 udhëheqës shtetsh janë pajtuar që t'i çasen problemeve të zhvillimit njerëzor nëpërmes disa caqeve të kufizuara në kohë (25 vjet nga 1990 deri 2015) të cilat njihen si Objektivat Zhvillimore të Mileniumit (MDG). Edhe pse lufta kundër varfërisë është dominante në OZHM janë futur tetë objektiva, që kanë caqet e veta në zvogëlimin e pasigurisë të të ardhurave dhe ushqimit, përmirësimit të shkollimit, barazisë gjinore, përmirësimin e shëndetit të fëmijëve dhe nënave, promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm duke e respektuar ambijentin dhe ndrtimi i partneritetit global. OZHM-të inkurajojnë të gjithë vendet, të pasura dhe të varfura, që të koncentrohen në çështjet e zhvillimit njerëzor.

Në mënyrë që të vlerësohet përparimi drejtë arritjes së objektivave, agjencitë ndërkom-bëtare janë pajtuar në disa indikatorë të qartë. Këto do të masin përparimin në nivel të vendit dhe në nivel global, pasi të gjithë vendet do të përdorin metodologjinë e nje-

jtë. Në mënyrë që të arrihen objektivat në nivel vendorë, duhet të sigurohet përkusht-inimi i vazhdueshëm i antarëve të zhvillimit njerëzor. Një raport vjetorë për OZHM-të është një nga mjetet themelore për të bërë këtë përkushtim. Rëndësia e raportit të OZHM-ve është i dyanshëm: Informimi publik dhe mobilizimi social. Është mjet për ngritjen e vetëdijes, avokimit, ndërtimit të aleancave dhe ripërtrirje të përkushtimeve politike në nivel kombëtarë, si dhe për të ndërtuar kapacitetet kombëtare për moni-torim dhe raportim të përparimit.

## Pse OZHM-të janë të rëndë-sishme për Kosovën?

Përfaqësuesit e Kosovës nuk kanë marrë pjesë në Samitin e Mileniumit në vitin 2000 dhe nuk e kanë nënshkruar deklaratën. Për këtë Qeveria e Kosovës nuk ka ndonjë obligim formal për OZHM-të siç kanë shumë vende të tjera. Megjithatë OZHM-të (shih tabelën 1.7) që kanë dalë nga samiti janë relevante për Kosovën. Në të gjitha pikat Kosova ka rezultat të disfavorshëm në krahasim me Evropën. Varfëria është e shpeshtë, dhe

**KORNIZA 1.5: A JANË QËLLIMET PËR PUSHTETËZIMIN E GRUAS TË ARRITURA NË KAIRO, KOPENHAGEN DHE PEKIN TË MJAFTUESHME?**

Gjatë konferencës së Kairos (1994), Kopenhagenit (1994) dhe Pekinit (1995), qeveritë u pajtuan të arrijnë disa objektiva të ndryshme sa i përket barazisë gjinore. Atë që janë caktuar të arrihen deri më 2015 janë:

- Të ofrohet shkollim fillorë universal
- Të arrihet ulja e vdekshmërisë së fëmijëve të posalindur në 35 për 1,000 dhe vdekshmërinë e fëmijëve nën 5 vjeç në 45 për 1,000.
- Mjekësia reproductive të jetë në dispozicion të të gjithë njerëzve të moshës së caktuar në sistemin e shëndetësisë primare
- Arritja e shkollimit të njëjtë për vajzat dhe djemtë
- Përgjysmimi i vdekshmërisë së nënave
- Vendet me vdekshmëri më të lartë duhet të mundohen të arrijnë shkallën më të ultë se 75 për 100,000 lindje; ato me vdekshmëri mesatare duhet të mundohen që këtë ta arrijnë në 60.
- Të gjitha vendet me vdekshmëri më të lartë duhet të arrijnë jetëgjatësinë më të lartë se 70; të gjitha vendet tjera duhet ta arrijnë jetëgjatësinë në 75.

Megjithatë edhe me arritjen e këtyre objektivave, disa nga objektivat e barazisë gjinore mund të jetë që nuk do të mund të plotësohen. Në mënyrë që të hapen diskutimet dhe të gjinden objektivat tjera, Organizata e OKB-së për Gratë (UNIFEM) avokon konsiderimin e këtyre hapave:

- Të ndalet prezenca disproporcionale e gruas në mesin e të varfurve deri më 2015
- Të barazohen ditët e pushimit për femra dhe meshkuj deri më 2015
- Të bëhen skema sociale për punëtorët e sektorit joformal deri më 2015
- Të rritet pjesëmarrja e gruas në pozita administrative dhe menagjuese për së paku 30 për qind deri më 2015
- Të rritet numri i ulseve për femra në nivel lokal për 30 për qind deri më 2015
- Të sigurohet që të gjitha të punësuarat femra të fitojnë një rrogë prej të cilës mund të jetohej deri më 2015.

*Burrimi: Progress of the World's Women (UNIFEM, 2000)*

*Korniza është marrë nga : zyra e UNDP-së për RZHNJK , "Gender Thematic Guidance Note," July 2003.*

gati gjysma e popullatës duke jetuar në varfëri. Ngjarjet e dekadës së fundit kanë zvogëluar mundësinë dhe kualitetin e shkollimit. Femrat nuk janë të barabarta me meshkujt, në veçanti për sa i përket shkollimit dhe analfabetizmit. Shëndeti i nënës dhe fëmijës është një sfidë e veçantë pasi Kosova ka një shkallë të lartë të lindjeve në krahasim me vendet evropiane. Tuberkuloza është endemike. HIV/AIDS nuk është i përhapur por parandalimi dhe surveimi sistematik është i nevojshëm. Ndotja industriale dhe shtëpiake paraqet kërcënim dhe sfidë serioze për ambientin dhe shëndetin e njerëzve, edhe pse nuk dihet shumë për përmasat e tyre.

Kosova duhet ta hartojë vetë rugën dhe mënyrën se si ti qaset secilit Objektiv dhe indikatorë në mënyrë që të jetë në vijë me realitetin e Kosovës. Për shembull malaria (Objektiva 8) nuk paraqet problem për Kosovën, e problem nuk paraqesin as banorët e deponive (objektiva 11) - edhe pse jeta e banorëve të zhvendosur nëpër kampe mund të ketë ngjashmëri. Në anën tjetër varfëria objektiva numër një do të mbetet prioritet në Kosovë duke pasur parasyshë sfidat ekonomike me të cilat ballafaqohet Kosova. Shkalla e paraqitjes së tuberkulozës (Objektiva 8) është më e larta në Evropë. Shumë vajza të reja e lëshojnë shkollën në moshë të re pas përfundimit të shkollës fillore (objektiva 4). Një panel ekspertësh duhet të thurë objektivat dhe indikatorët e OZHM-ve në mënyrë që ato të validizohen nga konsultantët e partnerëve në këtë çështje (qeveria, shoqëria civile, mediat, organizatat ndërkombëtare, akademikët, etj).

Institucionet e Përkohëshme të Vetqeverisjes (IPVQ) në Kosovë kanë përgjegjësinë për politikat sociale duke përfshirë shëndetësinë edukimin dhe barazinë gjinore dhe atyre u është besuar ruajtja e ambientit. Prioritet i IPVQ-së është fokusimi në përmirësimin e standardeve të edukimit dhe kualitetit të shëndetit si dhe promovimin e zhvillimit vendor ekonomik dhe punësimit. Këto çështje janë ngushtë të lidhura në OZHM-të dhe mund të udhëheqin në alokimin e resurseve. Përderisa IPVQ-ja mund të ndjejë se nuk është pronare e vendosjes së objektivave të OZHM-së, diagnoza rigoroze se si të arrihen këto objektiva do të ndihmonte në afrimin e prioriteteve kombëtare me agjendën ndërkombëtare dhe kërkesat për ndihmë ndërkombëtare.

**OZHM-të dhe standardet tjera**

Planifikimi i politikave në Kosovë është i efektuar nga shumë standarde që kanë të bëjnë me zhvillimin njerëzor në Kosovë. Komisioni Evropian ka një sërë kriteriumesh në procesin e stabilizim asociimit, që ka për qëllim tërheqjen e vendeve të Evropës Juglindore më afër Bashkësisë Evropiane. Duke pasur parasysh statusin e pazgjedhur të Kosovës, BE-ja ka bërë një mekanizëm vëzhgues në mënyrë që të shpejtojë dhe monitorojë reformat në vijë me rregulloret e veta. UNMIK-u gjithashtu ka hartuar Standardet për Kosovën për IPVQ-në. Banka Botërore (BB) dhe Fondi Monetar Ndërkombëtarë (FMN) përkrahin adoptimin e skemave për ulje të varfërisë në shumicën e vendeve në zhvillim, edhe pse iniciativat e tilla duhet të fillojnë në të ardhmen në Kosovë.

Krahasuar me standardet e lartpërmendura, OZHM-të nuk përbëjnë një strategji të veçantë. Objektivat e OZHM-së duhet të integrohen në planifikimet tashme strategjike ekonomike dhe sociale, pa marrë parasyshë se a hartohen ato nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, procesi i fokusuar në BE, apo ndonjë plan eventual i Bankës Botërore për Strategjinë e Zvogëlimit të Varfërisë. Përderisa OZHM-të koncentrohen në zhvillim njerëzor afatgjatë, objektivat dhe indikatorët e OZHM-ve gjithashtu përbëjnë mjete të vërteta për monitorimin dhe qeverisjen e mirë që do të



përmirësonte mundësitë e qeverisë që të hartojë dhe përcjellë performansen e vet. Në këtë mënyrë sfidat e zhvillimit njerëzor (varfëria, shëndetësia, edukimi, barazia gjinore, ambijenti) mund të balansohen me qeverisje dhe standardet e UNMIK-ut të orientuara në ekonomi. Banka Botërore dhe FMN-ja janë partnerë globalë të OZHM-ve. Dhe çfardo negociata të ardhme me këto institucione do të mirëpritnin përpjekjet drejtë OZHM-ve. Adoptimi hartimi dhe monitorimi i OZHM-ve nuk do të përmirësojë vetëm zhvillimin njerëzor në Kosovë, por gjithashtu do të promovojë kooperim më të mirë me komunitetin ndërkombëtarë.

Raporti i parë bazë i Kosovës për OZHM-të<sup>30</sup> jepë disa shifra që tregojë se ku qëndron Kosova sa i përket OZHM-ve. Raporti jepë ide se si të bëhet një proces i mirë dhe i shëndoshë në mënyrë që të arrihen OZHM-të. Aty theksohen strategjitë kryesore publike të bëra deri tashti në mënyrë që të arrihen objektivat dhe sfidat që duhet të tejkalohen në mënyrë që të mundësohet monitorimi i tyre në të ardhmen. Raporti bazë i OZHM-ve bazohet në të dhënat statistikore të vitit 2000 dhe është punuar para se të bëhet AZHNJ.

Si pjesë e komunitetit ndërkombëtarë Kosova është duke u përpjekur të arrijë objektivat e OZHM-së. Më përkrahjen e OKB-së dhe agjencive të tjera donatore, IPVQ-ja mund të ofrojë një zhvillim të mirë për popullatën e vet, pa marrë parasyshë, moshën, gjininë, vendbanimin apo etninë, duke siguruar kështu që më 2015 Kosova të jetë duke shkuar në një rrugë të drejtë zhvillimore. IPVQ-ja duhet të përkushtohet në integrimin e OZHM-ve në politikë bërje. Nëpër institucione duhet të ngritet kapaciteti i stafit në mënyrë që të bëhen politika dhe të implementohen programe që do të sigurojnë pëmbushjen e objektivave. Monitorimi i vazhdueshëm dhe sistematik duhet të ndërtohet nëpër institucione që janë të përgjegjshme dhe do të raportojnë në intervale të rregullta.

TABELA 1.8: OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE TË MILENIUMIT

OBJEKTIVAT	CAQET
1. Zhdukja e varfërisë dhe urisë	<b>Caku 1:</b> Përgjysmimi i numrit të njerëzve që jetojnë me më pak se një dollarë në ditë deri më 2015, bazuar në numrat e vitit 1990 <b>Caku 2:</b> Përgjysmimi i numrit të njerëzve që jetojnë më uri deri më 2015, bazuar në numrat e vitit 1990
2. Edukim fillorë për të gjithë	<b>Caku 3:</b> Të sigurohet se fëmijët në tërë botën, djemt dhe vajzat të kenë të siguruar shkollimin fillorë
3. Promovimi i barazisë gjinore dhe pushtetëzinmi i femrës	<b>Caku 4:</b> Të eliminohet dallimi në mes të djemëve dhe vajzave në shkollimin fillorë dhe ate të mesëm deri më 2005 dhe në të gjitha nivelet e shkollimit deri më 2015
4. Zvogëlimi i vdekshmërisë së foshnjave	<b>Caku 5:</b> Të zvogëlohet për dy të tretat vdekshmëria e fëmijëve nën pesë vjet në mes të viteve 1990-2015
5. Përmirësimi i shëndetit të nënës	<b>Caku 6:</b> Të zvogëlohet për tre çerek shkalla e vdekshmërisë së nënave në mes të vitit 1990 - 2015
6. Lufta kundër HIV/AIDS, malaries dhe sëmundjeve të tjera	<b>Caku 7:</b> Të ndalet dhe të fillohet zbrapsja e HIV/AIDS-it deri më 2015. <b>Caku 8:</b> Të ndalet dhe të fillohet zbrapsja e malaries dhe sëmundjeve të tjera deri më 2015.
7. Sigurimi i qëndrueshmërisë së ambijentit	<b>Caku 9:</b> Të integrohen principet e zhvillimit të qëndrueshëm në politikat e shteteve dhe të bëhen programe për kthimin e dëmeve ambijentale <b>Caku 10:</b> të përgjysmohet, deri më 2015 numri i njerëzve pa ujë të pishëm dhe sanitarije themelore <b>Caku 11:</b> Deri më 2020 të bëhet një përmirësim në jetët e së paku 100 million banorëve të deponive
8. Zhvillimi i partneritetit global për zhvillim	<b>Caku 12:</b> Të zhvillohet edhe më tutje një sistem tregtarë dhe financiarë të bazuar në rregulla të parashikueshëm dhe jo diskriminues. Këtu duhet përfshirë edhe përkushtimin për qeverisje të mirë, zhvillim dhe zvogëlim të varfërisë - në vend dhe ndërkombëtarisht <b>Caku 13:</b> Të adresohen nevojat e vendeve me zhvillim më të ulët. Këtu duhet përfshirë qasjen në eksportet e këtyre vendeve pa tarifa dhe kuota; një program të përmirësuar për lirim nga borgji të vendeve të futura thellë në borgj dhe ndihma më të mëdha për vendet që luftojnë varfërinë <b>Caku 14:</b> të adresohen nevojat e veçanta të vendeve pa dalje në detë dhe ishujve të vegjel (nëpërmes Programit të veprimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të Ishujve të Vegjel dhe Vendeve në Zhvillim) <b>Caku 15:</b> Të veprohet drejtë problemeve të vendeve në zhvillim të zhytura në borgj (Nëpërmes masave kombëtare dhe ndërkombëtare në mënyrë që borgji të bëhet i përbalueshëm në plan afatgjatë) <b>Caku 16:</b> Në bashkëpunim me vendet në Zhvillim të zhvillohen dhe të implementohen strategjitë për punësim të rinisë <b>Caku 17:</b> Në bashkëpunim me kompanitë farmaceutike të ofrohet akses në barërat themelore në vendet në zhvillim <b>Caku 18:</b> Në bashkëpunim me sektorin privat të përfitohet nga teknologjitë e reja në veçanti nga Informatat dhe Teknologjia IT dhe komunikimi.



## SHIKIM NGA AFËR: DISAGREGIMI I INDIKATORËVE TË ZHVILLIMIT NJERËZOR NË KOSOVË

## **Ku qëndrojnë dallimet në zhvillimin njerëzor në Kosovë? Janë këto dallime në relacion me arsimimin, shëndetësinë apo çështjet ekonomike?**

Ky kapitull i bën një vështrim më të thellë indikatorëve të zhvillimit njerëzor në Kosovë. Duke ekzaminuar të dhënat e mirëqenies sociale të cilat janë të disagreguara në raportin meshkuj/femra, urban/rural dhe linja gjeografike, mund të ndriçohen shumë trende të ndryshme shpesh të maskuara në mesataret dhe statistikat kombëtare. Një detyrë e tillë mund të zbulojë dhe tërheqë vëmendjen drejt grupeve tejet të ndieshme sociale, **duke demonstruar pabarazitë në shpërndarjen e resurseve dhe mundësive**<sup>1</sup>. Një numër i raporteve kombëtare të zhvillimit njerëzor kanë bërë qasje inovative ndaj disagregimit statistikor; për shembull, Bullgaria, Egjipti dhe Argjentina kanë kalkuluar indekset e zhvillimit njerëzor në nivel komune dhe distrikti/rajoni. Në Kosovë, këta shembuj kanë shërbyer si praktikë e mirë për metodologjinë e përdorur, përvoja Egjiptiane ka shërbyer për metodologjinë e hulumtimit derisa ajo e Bullgarisë ka shërbyer për shfrytëzimin e të të ardhurave për kokë banori në vend të bruto prodhimit vendor (GDP) për kokë banori për kalkulimin e IZHN në nivel komunal.

Të dhënat e gjeneruara për këtë raport për herë të parë mundësojnë një analizë të detajizuar mbi atë se si përfitojnë të gjithë qytetarët nga procesi i zhvillimit. Të dhënat nga AZHNJ mund të disagregohen në linja komunale, etnike dhe urbane/rurale. Ky kapitull do të paraqesë rezultatet e IZHNJ, IVNJ-1, IVNJ-2, IZHJ, dhe MPGJ krahas këtyre tri dimensioneve kryesore në mënyrë që të theksojë çështjet kritike duke përfshirë pabarazinë gjinore si dhe të ekspozojë grupet më të prekura (rezikuara) sociale.

## **Indeksi i zhvillimit njerëzor në nivel komunal**

Komunat në Kosovë paraqesin dallime të konsiderueshme në raport me zhvillimin njerëzor. Në disa raste, shpërndarja në mes të rezultateve maksimale dhe minimale arrijn në 16%, që është e lartë, duke marrë

parasysh sipërfaqen<sup>2</sup> relativisht të vogël të Kosovës. Me një mesatare të IZHNJ prej 0.680, komunat kosovare gjenden në nivel të ulët të shkallës së mesme të zhvillimit

### **KORNIZA 2.1: ÇËSHTJET E MATJES: GDP KUNDRJET TË ARDHURAVE**

Mungesa e të dhënave në nivelin komunal na ka detyruar të shfrytëzojmë AZHNJ të UNDP-së për të kalkuluar IZHNJ komunal (metodologjia e detajizuar gjendet në Aneksin 1). Kjo ka nënkuptuar dallime metodologjike në kalkulimin e IKZHNJ në krahasim me IZHNJ në nivel të Kosovës, të prezentuar në kapitullin 1. Dallimi më i rëndësishëm është shfrytëzimi i të të ardhurave për kokë banori në vend të GDP-së për kokë banori. Sipas RZHNJ-së së Bullgarisë<sup>1</sup>, për të matur IZHNJ-në në nivel komunal, të ardhurat për kokë banori janë më informuese sesa GDP për kokë banori. Arsyeja më e rëndësishme ka të bëjë me problemin e ndarjes së GDP-së. Për shembull, një komunë mund të ketë një kompani të madhe të prodhimit të mallërave apo shërbimeve prej të cilave përfiton e tërë popullsia, jo vetëm rezidentët e asaj komune; prandaj, ndarja e bruto prodhimit të kompanisë në cilëndo komunë të caktuar është problematik, posaçërisht në Kosovë ku sistemet statistikore ende janë në zhvillim e sipër.

Kalkulimi i GDP-së për kokë banori ka qenë problematik, për shkak të debatit të vazhdueshëm mbi numrin e popullsisë së Kosovës. Prandaj, për të vlerësuar mirëqenien ekonomike të qytetarëve të secilës komune në vend të GDP janë shfrytëzuar nivelet e të të ardhurave të regjistruara sipas AZHNJ.

<sup>1</sup> Raporti i Zhvillimit Njerëzor i Bullgarisë (2001)

njerëzor, sipas kategorizimit të RZHNJ global. Brenda Kosovës, Prishtina ka IZHNJ-në më të madhe (0.723) ndërsa Novobërda e ka më të vogël (0.625).

## **Komponentet e IZHNJ-së komunale**

Indeksi komunal i zhvillimit njerëzor (IKZHNJ) është përbërje e tri matjeve të ndryshme:

- *Mirëqenia ekonomike, e matur nga të ardhurat për kokë banori;*
- *Statusi shëndetësor, i matur sipas jetëgjatësisë; dhe*
- *Arsimimi, matur sipas shkallës së regjistrimit në arsimim primar dhe sekondar, si dhe shkalla e shkrim-leximit të të rriturve (mbi 15 vjeç);*

Bazuar në analizën e IKZHNJ sipas komponentave, pabarazitë më të mëdha në mes të komunave kosovare kanë të bëjnë me të ardhurat për kokë banori, të përcjellura me jetëgjatësinë dhe arsimimi (shiko Kornizën 2.2).

*"Ekzistojnë me mijëra pyetje; kemi menduar për të gjitha ato dhe jemi duke u përpjekur për të gjetur përgjigje", Sergio Vieira de Mello, PSSP i parë në Kosovë*

### KORNIZA 2.2: CILAT JANË DALLIMET NË IKZHJNJ?

Variacionet në komponentet individuale të IZHJNJ-së janë shumë më shumë të theksuara në komuna sesa në rezultate pararendëse të IZHJNJ-së.<sup>1</sup> Nga tri komponentet e IZHJNJ-së, arsimimi dhe jetëgjatësia kanë ndikimin më të vogël në dallimet në mes të komunave, derisa të ardhurat për kokë banori kanë ndikimin më të madh. Kështu, dallimet në mes të komunave të Kosovës duket të burojnë më shumë nga statusi ekonomik dhe ai i jetëgjatësisë (dhe si rrjedhojë e kësaj, nga faktorët e përkujdesjes shëndetësore dhe ata mjedisor) sesa nga arsimimi. Për shembull, rreth 10% i ndan rezultatet më të larta dhe më të ulëta sipas komunave (Zubin Potoku dhe Podujeva, përkatësisht) në analfabetizmin e të rriturve dhe regjistrimin e kombinuar në shkolla, gjersa dallimi në të ardhura për kokë banori në mes të komunave të renditura më së larti dhe më së ulëti është 250% (Prishtina dhe Shtimja).

<sup>1</sup> Variacioni është matur sipas devijimit standard (DS) - matje e distribuimit apo shpërndarjes përreth mesatares. Në distribuim normal, 68% e rasteve bienë brenda një DS të mesatares dhe 95% të rasteve bienë brenda dy DS. Për shembull, në një distribuim normal, duke caktuar moshën mesatare të jetë 45 dhe devijimin standard prej 10, 95% të rasteve të do të bienë brenda 25 dhe 65.

### KORNIZA 2.3: MIGRIMI

Në Kosovë niveli i migrimi në përgjithsi si dhe i migrimit intern është i lartë. Përgjithësisht besohet se rreth 350,000 - 400,000 Kosovarë jetojnë jashtë vendit<sup>1</sup>. Sipas AZHJNJ të UNDP, Gjermania dhe Zvicra janë destinacion primar i emigruesve.

Komuna e Prishtinës dhe regionin e saj<sup>2</sup> kanë regjistruar shkallën më të lartë të migrimit intern nga pjesët tjera të Kosovës. Peja poashtu ka regjistruar numër relativisht të lartë të imigruesve. Kjo është një dukuri afatgjate e cila nuk është në relacion vetëm me konfliktin.

Tabela: Migruesit e përrjetshëm në pesë vitet e fundit për njerëzit e moshës pesë vjeçare e më lartë, sipas rajoneve, 2003

Rajoni i lindjes	Migruesit brenda '000	Migruesit për jashtë '000	Neto migruesit '000	Migruesit brenda në 5 vite të fundit '000	Migruesi për jashtë në 5 vite të fundit '000	Neto migruesit 1998-2003 '000	Totali neto i migruesve '000
Gjakovë	4.9	14.3	-9.4	0.5	2.6	-2.1	-11.5
Gjilan	4.7	14.1	-9.4	1	0.7	0.3	-9.1
Mitrovicë	9.6	16.3	-6.7	0.9	7.1	-6.2	-12.9
Pejë	16	8.2	7.8	3.7	0.4	3.3	11.1
Prizren	6.4	11.8	-5.4	2	1.5	0.5	-4.9
Prishtinë	36.6	14.1	22.5	8.1	1.1	7	29.5
Ferizaj	10.6	10	0.6	1	3.8	-2.8	-2.2

Burimi: ESK. Hulumtim Demografik dhe Shëndetësor i Kosovës, 2004


<sup>1</sup> Hulumtim demografik dhe shëndetësor i Kosovës, (2004), ESK, faqe 24

<sup>2</sup> Të dbënat nga Hulumtim demografik dhe shëndetësor i Kosovës, të disagreguara sipas regjioneve në pajtueshmëri me kodet tbirrëse të rrjetit tokësor të telefonisë; komunat brenda këtyre regjioneve janë: Gjakovë: Deçan, Gjakovë dhe Raboveci; Gjilani: Gjilan, Kamenicë dhe Vitia; Mitrovica: Mitrovicë, Leposaviqi, Skenderaj, Vushtrri, Zubin Potok dhe Zveçani; Peja: Istog, Klinë dhe Pejë; Prizreni: Dragash, Prizren, Suharekë, Malishevë; Prishtinë: Gllgovc, Fushë Kosovë, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Podujevë dhe Prishtinë; Ferizaji: Kaçanik, Shtime, Shtërpca dhe Ferizaj.

### Pesë komunat e para dhe pesë komunat e fundit

Pesë komunat me IZHJNJ-në më të lartë janë: Prishtina, Zubin Potoku, Zveçani, Leposaviqi dhe Shtërpca, derisa ato me IZHJNJ-në më të ulët janë regjistruar të jenë; Novobërda, Malisheva, Shtimja, Kaçaniku dhe Skënderaj. Prishtina ka IZHJNJ-në më të madhe për shkak të faktit se ka indeksin e të ardhurave më të lartë nga të gjitha komunat tjera. Komunat tjera me IZHJNJ më të madhe gjenden në krye të listës për shkak të vlerësimeve të larta në indeksin e arsimimit. Në rastin e Zveçanit, kjo është rezultat edhe i indeksit të të ardhurave.

FIGURA 2.1 TË ARDHURAT PËR KOKË BANORI PËR PESË KOMUNAT E PARA DHE PESË KOMUNAT E FUNDIT



Për pesë komunat e fundit në listë, jetëgjatësia dhe indeksi i të ardhurave duket të ketë ndikimin më të madh në rezultatin e përgjithshëm të IZHJNJ-së. Sidoqoftë, në rastin e Malishevës, IZHJNJ është shumë i ndikuar nga indeksi shumë i ulët i arsimimit.

### Të ardhurat për kokë banori

Prej të gjitha komponenteve të IZHJNJ-së, dallimet në të ardhura janë më të mëdhat në mes të komunave të Kosovës. Siç shihet në figurën 2.1, rezidentët e komunave më të pasura fitojnë tri herë më shumë se sa ata në vende më të varfëra. Siç vërehet, Prishtina është më së larti në këtë dhe është një nga arsyt që shpjegojnë "migrimin" e popullatës në Prishtinë (shiko kornizën 2.3).

Burimi: UNDP Kosovë, AZHJNJ 2004


## Demografia dhe të ardhurat

Ekonomitë më të vogla familjare duket<sup>3</sup> të kenë më shumë fëmijë dhe raport më të lartë të varshmërisë<sup>4</sup>. Në mënyrë mjaft interesante, sa më i madh numri i anëtarëve të moshuar të ekonomive familjare, aq më të mëdha janë tendencat për të ardhura më të mëdha për kokë banori. Kjo mund të reflektojë traditën përmes të së cilës anëtari më i pasur të familjes supozohet të ketë mbi vete përkujdesjen dhe përgjegjësinë, si dhe rëndësinë e të ardhurave nga pensioni.

## Infrastruktura dhe të ardhurat

Nuk është befasi që komunat më të pasura të karakterizohen me qasje më të mirë në infrastrukturë dhe shërbime duke përfshirë kompjuterët, telefonat, ujësjellësin dhe kanalizim. Si kontrast i kësaj, komunat më të varfëra kanë më pak qasje në ujësjellës dhe kanalizim. Poashtu, nuk është befasi që sa më e madhe të jetë shkalla e papunësisë brenda komunës, aq më i vogël është niveli i të ardhurave. Niveli i të ardhurave poashtu tenton të jetë i vogël në komunat me numër më të vogël të popullsisë apo në ato komuna që kanë pasur më shumë dëme gjatë konfliktit<sup>5</sup>. Në anën tjetër, ndoshta si trashëgimi e periudhës komuniste, qasja në rrymë elektrike dhe në televizion është bukur shumë konsistente në të gjitha komunat, pavarësisht nga nivelet e të ardhurave.

FIGURA 2.2 MARRËDHËNIA NË MES TË ARSIMIMIT DHE TË TË ARDHURAVE



Burimi: UNDP Kosovë, AZH NJ 2004

## Përbërja e të ardhurave

Mesatarisht, të ardhurat tentojnë të jenë më të larta në ato komuna kur fitohen kryesisht nga pagat dhe pensionet. Komunitat me të ardhura të ulëta për kokë banori kanë përqindje më të lartë të rezidentëve që jetojnë nga burimet e klasifikuara si "tjera". Kjo sugjeron rëndësinë e "ekonomisë në hije", siç është tregtia joformale.


## Arsimimi dhe të ardhurat

Në komuna mund të vëzhgohet një relacion i vogël por i qartë në mes të nivelit mesatar të arsimimit dhe të të ardhurave mesa-

### KORNIZA 2.4:A ËSHTË PJESËMARRJA E FEMRAVE E DOMOSDOSHME PËR TË ARDHURA MË TË LARTA?

Në mënyrë interesante, në të gjitha komunat me pjesëmarrje më të lartë të femrës në fuqinë punëtore, tentojnë të kenë të ardhura më të larta për kokë banori. Në të njëjtin drejtim, kur shkalla e papunësisë dhe posaçërisht e papunësisë së femrës janë të ulëta, të ardhura komunale për kokë banori tentojnë të jenë më të larta. Me përjashtim të përqindjes së stafit profesional dhe teknik në fuqinë punëtore, treguesit e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe papunësisë ndër femra duket se është parashikues më të mirë të të ardhurave komunave sesa ato të meshkujve.

FIGURA 2.3 MARRËDHËNIA E PJESËMARRJES EKONOMIKE DHE TË TË ARDHURAVE, SIPAS GJINISË




Burimi: UNDP Kosovë, AZH NJ 2004

tare për kokë banori. Sikurse tregon Figura 2.2, sa më e madhe të jetë përqindja e popullsisë në një komunë, që ka kryer shkollën e mesme, shkollën e lartë dhe universitetin, aq më e madhe do të jetë mesatarja e të të ardhurave për kokë banori në atë komunë. Komunitat me nivel të ultë të arsimimit, ku shumica e popullsisë nuk ka kryer shkollën e mesme bile as shkollën fillore, qartazi kanë nivele më të ulta të mesatares së të ardhurave.

## Indeksi i jetëgjatësisë

Jetëgjatësia është faktori më i rëndësishëm pas të ardhurave në përcaktimin e dallimive në renditjen e IKZH NJ. Shpërndarja e jetë-

FIGURA 2.4 PESË KOMUNAT E PARA DHE PESË TË FUNDIT SIPAS JETËGJATËSISË



Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004

gjatësisë në mes të komunës më të lartë dhe më të ultë në listë është përafërsisht 10 vite (71.1 në Gjiilan krahasuar me 61.5 në Skenderaj). Siç shihet në figurën 2.4, Indeksi i Jetëgjatësisë (IL) është më i larti në Gjiilan, Gjakovë, Podujevë, Istog dhe Lipjan; dhe më i ulti në Skenderaj, Novobërdë, Shtime, Malishevë dhe Dragash.

### Indeksi i arsimit

Pabarazitë në komuna në kuptim të arsimit kryesisht burojnë nga mesatarja e viteve të shkollimit. Duke krahasuar pesë komunat e para dhe pesë komunat e fundit, dallimet më të mëdha ekzistojnë në mesataren e viteve të shkollimit, të përcjellura nga shkalla e regjistrimit në arsimimin

TABELA 2.1: PESË KOMUNAT E PARA DHE PESË TË FUNDIT ME INDEKsin E ARSIMIT


	Indeksi i arsimit	Shkalla e arsimit të rritur (15+)%	Shkalla e kombinuar e regj. nëpër shkollë%	Mesatarja e viteve të shkollimit
Podujevë	0.881	89.355	85.684	8.45
Gjakovë	0.886	92.065	81.716	9.37
Rahovec	0.891	90.247	86.842	7.58
Istog	0.903	92.756	85.417	8.96
Malishevë	0.904	92.076	86.957	7.92
Glllogovc	0.950	96.730	91.589	9.66
Mitrovicë	0.954	97.183	91.892	10.58
Zveçan	0.960	97.849	92.308	10.98
Leposaviq	0.961	97.568	93.103	10.47
Zubin Potok	0.967	98.333	93.548	11.47
Shpërndarja në mes të pesë komunave të para dhe të fundit	0.086	8.978	11.832	3.89
Diferenca në përqindje	8.6 %	9.0%	12.0%	34.0%

Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004

primar dhe sekondar dhe mandej nga shkalla e arsimit të të rriturve. Sikurse tregojnë Tabela 2.1, komunat me indeksin më

të ulët të arsimit janë: Podujeva, Gjakova, Rahoveci, Istogu dhe Malisheva, derisa ato me indeksin më të lartë të arsimit janë: Zubin Potoku, Leposaviqi, Zveçani, Mitrovica dhe Glllogovci.

FIGURA 2.5 DIFERENCA NDËRMJET KOMUNAVE NË TREGUESIT E ARSIMIT, SIPAS GJINISË



Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004

### Arsimimi i femrës

Kur treguesit e arsimit disagregohen përgjatë linjave gjinore, dallimet në mes të komunave bëhen edhe më të theksuara. Siç është treguar në Figurën 2.5, dallimi më i madh mbetet në mesataren e viteve të shkollimit, të përcjellur me proporcionin e kombinuar të regjistrimit në shkollë dhe mandej me shkallën e arsimit të të rriturve.

#### KORNIZA 2.5: ARSIMIMI I VAJZAVE: FAKTORËT E LËNIES SË SHKOLLËS

Janë dy faktorë që llogariten si parashikues të fuqishëm në ndjekjen e shkollës fillore dhe të mesme nga vajzat: etniciteti dhe lokacioni gjeografik. Vajzat joshqiptare dhe joserbe kanë gjasa shumë më të mëdha ta lënë shkollën sesa vajzat që iu takojnë këtyre komuniteteve etnike. Për më tepër, vajzat rurale shqiptare kanë më shumë gjasa të ndërprejnë shkollimin e tyre sesa ato urbane.

Një hulumtim i vitit 2001, i udhëhequr nga Fondi i Aksionit Urgjent ka hulumtuar pse vajzat e lënë shkollën. Ndër faktorët kryesorë duket të jenë: 'mungesa e parave', 'mungesa e suksesit në shkollë', 'shkollë është tepër larg nga shtëpia' dhe 'fejesa ose martesë'. Kur janë pyetur 'nese familja juaj ballafaqohet me vështirësi ekonomike, a duhet të favorizohen djemtë apo vajzat', 97% e respondentëve janë përgjigjur në favor të të parëve (djemve).

Burimi: Vjollca Krasniqi "Faktorët e lënies së shkollës nga vajzat, KWI

Arsimimi i femrave qartazi është më prapa se ai e meshkujve. Derisa dallimet më të mëdha shihen në mesataren e viteve të shkollimit, proporcionet neto të kombinuara të regjistrimit në shkolla janë shkak për brengë, duke marrë parasysh se ky faktor afatshkurtër ndikon faktorët tjerë në afat më të gjatë. Për shembull, në komunën e Dragashit më pak se gjysma e të gjitha femrave ndjekin shkollën e mesme. Rritja e pranisë së femrave në shkollën e mesme është prioritet urgjent i politikës përkatëse, duke marrë parasysh lidhjet e fuqishme në mes të investimeve në arsimim të tillë dhe rritjen e agreguar ekonomike.

dhe të tjerët (0.680). Komuniteti RAE dallohet me IZH NJ të ulët (0.578) kundrejt pjesës tjetër të popullsisë, duke u vendosur kështu në nivel më të ulët të zhvillimit njerëzor. Arsimimi është determinanti më i rëndësishëm e renditjeve relative të IZH NJ-ve ndër komunitetet etnike, i përcjellur nga mesatarja e të të ardhurave për kokë banori dhe mandej nga jetëgjatësia.

Në grupet etnike, RAE fiton dy herë më pak se komunitetet e klasifikuara si "Të tjera" dhe përafërsisht tri herë më pak se serbët dhe shqiptarët. Shkalla e analfabetizmit në komunitetin RAE është më shumë se dy

TABELA 2.2 SHPËRNDARJA E KOMUNITETEVE ETNIKE NË AZH NJ

Komunitetet etnike në HDS	Etniciteti
Shqiptarë	Shqiptarë të Kosovës
Serbë	Serb dhe Malazez të Kosovës
RAE	Rom, Ashkali, dhe Egjiptian të Kosovës
Të tjerë	Boshnjak, Turk, Goran të Kosovës, dhe të tjerë.

## Zhvillimi njerëzor dhe komunitetet etnike

Për qëllimet e AZH NJ, komunitetet etnike që jetojnë në Kosovë janë ri-shpërndarë në katër kategori apo grupime, siç është treguar në Tabelën 2.2. Grupimi i tillë ka ndihmuar në zvogëlimin e marginës së gabimit për marrje të mostrave, duke rritur kështu validitetin e rezultateve.

### IZH NJ sipas komuniteteve etnike


Siç shihet në Figurën 2.6, komuniteti i serbëve ka IZH NJ-në më të madhe (0.715), përcjellur më pas nga shqiptarët (0.692)

herë më e lartë se ajo e shqiptarëve dhe komuniteteve "tjera" dhe katër herë më e lartë se ajo e serbëve. Proporcioni i kombinuar i regjistrimit në shkolla filllore dhe të mesme në komunitetin RAE është 60%, që është 30% më i ultë se i tërë popullsisë tjetër, tek e cila mesatarja e regjistrimit në shkolla është rreth 90%. Komuniteti RAE jeton mesatarisht një vit më pak se pjesa tjetër e popullsisë.

### Arsimimi sipas etnicitetit


Figura 2.8 tregon mesataren e viteve të shkollimit për secilin grup etnik. Sikurse me

FIGURA 2.6 IZH NJ DHE KOMPONENTET E TIJ, SIPAS KOMUNITETEVE ETNIKE




Burimi: UNDP Kosovë, AZH NJ 2004

FIGURA 2.7 TREGUESIT E ARSIMIMIT SIPAS KOMUNITETEVE ETNIKE



Burimi: UNDP Kosovë, AZH NJ 2004

FIGURA 2.8 MESATARJA E VITEVE TË SHKOLLIMIT




Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004

treguesit tjerë arsimorë, komuniteti RAE ka renditjen më të ulët, duke kaluar mesatarisht vetëm shtatë vite në shkollë.

Dallimet në treguesit e arsimit në komunitete të ndryshme etnike janë të ngjashme me nivelet e IZHNJ-së. Komuniteti RAE vuan nga rezultatet e ulëta në të gjithë treguesit e arsimit. Serbët janë në krye të radhës me të gjithë treguesit e arsimit, me përjashtim të shkallës së regjistrimit në shkolla fillore ku shqiptarët dhe komunitetet "tjera" renditen më lartë. Posaçërisht bren-gosëse janë shkallët e ulëta të regjistrimit në shkolla të mesme dhe shkallët e larta të analfabetizimit në komunitetin RAE. Figura 2.7 thekson renditjet relative të arsimit sipas komuniteteve etnike.

FIGURA 2.9 NIVELET MESATARE TË TË ARDHURAVE TË EKONOMIVE FAMILJARE SIPAS KOMUNITETEVE ETNIKE



Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004

**KORNIZA 2.6: ARSIMIMI SIPAS KOMUNITETEVE ETNIKE**

**Shqiptarët**

Mesatarisht, shqiptarët studiojnë 9.33 vite. Meshkujt shqiptarë studiojnë përafërsisht dy vite më shumë sesa femrat. Analfabetizmi ndër femrat shqiptare (9%) është tri herë më i lartë sesa tek meshkujt shqiptarë. Brenda komunitetit shqiptar, shkalla e regjistrimit në shkollim fillor është e lartë; sidoqoftë, shkollimi i mesëm është më pak i fuqishëm. Rreth 30% të femrave dhe 20% të meshkujve janë jashtë klasave. Rreth 9.7% e shqiptarëve ndjekin apo kanë mbaruar shkollën e lartë apo universitetin.

**Serbët**

Serbët renditen më së larti në indeksin e arsimit. Mesatarisht, ky grup kalon 10.61 vite në shkollë. Meshkujt serbë studiojnë një vit më shumë sesa femrat. Shkalla e arsimit është e lartë në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë; vetëm 1% e meshkujve dhe 4% e femrave serbe nuk e kanë shkrim-lexim. Përqindja e regjistrimit në shkollimin fillor është pak më e ulët sesa e popullsisë shqiptare, me përafërsisht 5.5% të fëmijëve që nuk ndjekin shkollën fillore. Sidoqoftë, shkalla e regjistrimit në shkollimin e mesëm është më e lartë sesa e pjesës tjetër të popullsisë, përafërsisht 15% e femrave dhe 12% e meshkujve nuk ndjekin këtë nivel shkollimi. Vetëm rreth 12.3% ndjekin apo kanë mbaruar universitetin apo shkollën e lartë.


**Boshnjakët, turqit dhe goranët**

Boshnjakët, turqit dhe goranët renditen menjëherë pas shqiptarëve në indeksin e arsimit. Mesatarisht, ata studiojnë 8.61 vite. Meshkujt studiojnë dy vite më shumë sesa femrat. Shkalla e analfabetizimit është rreth 7% dhe është më së shumti e pranishme tek femrat (12%) derisa tek meshkujt është vetëm 1%. Edhe pse regjistrimi në arsimin fillor është i lartë, regjistrimin në shkolla të mesme është çështje që kërkon vëmendje. Rreth 30% të këtij grupi nuk ndjekin shkollën e mesme dhe ky problem në fakt është më shumë i theksuar ndër meshkuj. Vetëm rreth 9% kanë ndjekur apo kanë mbaruar universitetin dhe shkollën e lartë.

**RAE**

Komuniteti i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve është më së paku i arsimuar. Më shumë se 16% e RAE nuk dinë të lexojnë apo të shkruajnë. Analfabetizmi është më i shpeshtë tek femrat RAE (25%) sesa tek meshkujt (8%). Mesatarisht, meshkujt RAE studiojnë 8 vite gjersa femrat 5.5 vite. Përgjithësisht, një e katërta e të gjithë fëmijve RAE nuk ndjekin shkollën fillore (31% e vajzave dhe 19% e djemve). Situata është edhe më serioze në relacion me shkollimin e mesëm ku rreth 78% e femrave dhe 62% e meshkujve janë jashtë bangave shkollore. Pothuajse asnjë mashkull RAE apo femër nuk ndjek apo mbaron universitetin, dhe vetëm 1.4% e meshkujve dhe femrave RAE ndjekin apo kanë mbaruar shkollën e lartë.

FIGURA 2.10 BURIMET E TË TË ARDHURAVE SIPAS ETNICITETIT



Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004



**KORNIZA 2.7: KARAKTERISTIKAT TIPIKE DEMOGRAFIKE DHE EKONOMIKE TË EKONOMIVE FAMILJARE TË KOSOVËS**

Mesatarja e ekonomisë familjare në RAE dhe ajo shqiptare është më e madhe dhe e karakterizuar me raport më të lartë të varshmërisë sesa tek serbët dhe "të tjerët". Derisa serbët përafërsisht kanë një anëtar të varur për secilin person i cili fiton të ardhura, tek popullsia joserbe, përafërsisht tre njerëz varen nga një person i cili fiton të ardhura.

**Shqiptarët**

Familja tipike shqiptare ka pak më pak se 7 anëtarë. Amvisnitë dhe për secilin person që gjeneron të ardhura janë dy të varur. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqi punëtore është 46%. Rreth 18% e ekonomive familjare nuk posedojnë veprimtari biznensi, tokë, gjedhe, automjete të mekanizuara, apo ndonjë mjet tjetër për gjenerimin e të të ardhurave. Të ardhurat e ekonomisë familjare kryesisht janë të përbëra nga pagat, profiti nga biznesi dhe nga qeraja si dhe nga paratë e huazuara. Shumica e ekonomive familjare kanë TV, rreth 10% kanë kompjuterë dhe vetëm 6% kanë kompjuter dhe linjë telefoni për qasje në internet.

**Serbët**

Familjet tipike serbe dhe malazeze kanë rreth 4.3 anëtarë dhe janë me një fëmijë. Për çdo anëtarë që punon, ekziston një anëtar i varur. Rreth 60% marrin pjesë në fuqinë punëtore. Të ardhurat e ekonomisë familjare kryesisht janë të përbëra nga pagat, pensionet dhe ndihma sociale, shpenzimet nga kursimet dhe prona e shitur. Rreth 15% e ekonomive familjare nuk kanë mjete për gjenerimin e të të ardhurave. Rreth 11% e ekonomive familjare kanë qasje në kompjuterë dhe 9% kanë qasje në kompjuterë dhe linjë telefonike.

**RAE**

Ekonomitë familjare të komunitetit REA mesatarisht përbëhen nga 7 anëtarë, me 2.5 fëmijë. Për çdo person që gjeneron të ardhura, janë dy persona të varur. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 50%. Rreth 60% e ekonomive familjare nuk kanë qasje në mjete që mund të gjenerojnë të ardhura. Burimet kryesore të të ardhurave janë pagat, remitencat (dërgesat) dhe ndihma nga farefisi si dhe pensionet e ndihma sociale. Vetëm 1% e ekonomive familjare kanë kompjuterë, derisa pothuajse asnjë prej tyre nuk kanë mundësi të kenë qasje në internet prej shtëpisë.

**Boshnjakët, turqit dhe goranët**

Mesatarja e ekonomisë familjare boshnjake, turke dhe gorane është e përbërë prej pesë anëtarëve me 1.4 fëmijë. Për çdo person gjenerues i të ardhurave ekzistojnë dy anëtarë të varur. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqi punëtore është 47%. Rreth 30% të ekonomive familjare nuk kanë qasje në mjete gjeneruese të të ardhurave. Tri burimet kryesore të të ardhurave janë: pagat, paratë e huazuara dhe burimet tjera. Rreth 7.6% kanë kompjuterë dhe 5% kanë linjë kompjuteri e telefoni.

**Të ardhurat për kokë banori sipas etnicitetit**

Pas arsimimit, faktori i dytë më i rëndësishëm shkaktar i dallimeve në IZH NJ ndër-mjet komuniteteve etnike janë të ardhura për kokë banori, që ndryshojn në mënyrë të konsiderueshme. Siç është paraqitur në Figurën 2.9, komuniteti RAE duket të jetë më së shumti në disavantazh.

Figura 2.10 tregon burimet e ndryshme të mesatares së të ardhurave të ekonomive familjare për secilin komunitet etnik. Termi "para të huazuara" këtu i referohet jo vetëm huamarrjes formale prej bankave por përfshin edhe huamarrjen joformale prej individëve (shikoni Aneksin III).

**Jetëgjatësia sipas etnicitetit**


Nga të gjitha komponentet e IZH NJ-së, sipas etnicitetit më së paku ndryshon jetëgjatësia. Mesatarisht, femrat jetojnë pothuajse dy vjet më gjatë sesa meshkujt në secilin komunitet etnik. Siç shihet në Tabelën 2.3, grupi më i ndieshëm është komuniteti RAE, derisa pjesëtarët e komuniteteve "tjera" kanë jetëgjatësinë më të lartë, të përcjellur më pas nga serbët dhe mandej nga shqiptarët.

**TABELA 2.3 JETËGJATËSIA SIPAS KOMUNITETEVE ETNIKE**

	Meshkuj	Femra	Totali
Shqiptarë	69.81	71.44	70.59
Serb	70.16	71.75	70.92
RAE	69.05	70.42	69.74
Të tjerë	70.12	71.88	70.97

Burimi: UNDP Kosovë, AZH NJ 2004

**FIGURA 2.11 IZH NJ SIPAS NDARJES URBANE/RURALE**



Burimi: UNDP Kosovë, AZH NJ 2004

TABELA. 2.4 TREGUESIT E ARSIMIMIT SIPAS REZIDENCËS URBANE/RURALE

	Shkalla e arsimimit (përqindje)	Shkalla e regjistrimit (në përqindje)			Mesatarja e viteve të shkollimit
		Fillor	I mesëm	I kombinuar	
Rural	93.95	95.77	70.84	87.27	8.96
Urban	94.55	94.98	80.96	90.14	9.91

Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004


## Ndarja urbane/rurale në zhvillimin njerëzor

Në mes të popullsisë rurale dhe urbane të Kosovës ekziston një dallim i madh në nivelet e zhvillimit njerëzor. Mesatarisht, qytetarët urbanë kanë standard më të lartë të mirëqenies sipas matjeve të IZHJ-së (0.700) sesa qytetarët ruralë (0.615). Disparitetet më të larta urbano-rurale gjenden në fushën e arsimimit, të përcjellura nga jetëgjatësia dhe të ardhurat për kokë banori (shiko Figurën 2.11). Për shembull, regjistrimi në shkolla të mesme në vende

### KORNIZA 2.8: PABARAZITË NDËRMJET KOMUNAVE NË LIDHJE ME KOMPONENTET E VARFËRISË NJERËZORE

- Përqindja e njerëzve që jetojnë në varfëri ekstreme (të definuar sipas përqindjes së njerëzve që jetojnë me më pak se një dollar për ditë dhe sipas linjës nacionale të varfërisë ekstreme) lëviz prej 3% në Shtërpçë deri në 40% në Malishevë.
- Përqindja e njerëzve që nuk kanë qasje në ujësjellës lëviz prej 6% në Shtërpçë në mbi 93% në Malishevë.
- Përqindja e njerëzve që jetojnë me më pak se dy dollarë në ditë lëviz prej 7% në Zubin Potok deri në 71% në Dragash.
- Shkalla e papunësisë në Klinë (67%) është tri herë më e madhe sesa në Zubin Potok (21%).

FIGURE 2.12 MARRËDHËNIA NDËRMJET IVNJ-1 DHE IVNJ-2



Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004

rurale është më i ulët për 10% sesa në vendet urbane. Disparitete tjera urbano-rurale mund të shihen në Tabelën 2.4.

## Varfëria njerëzore

Në analizimin e varfërisë në komuna, treguesit e bazuar vetëm në të ardhura tregojnë pabarazinë më të theksuar, të përcjellur me qasjen në infrastrukturën shëndetësore dhe treguesit e jetëgjatësisë. Treguesit arsimorë janë mjaft të ngjashëm në të gjitha komunat.

Siç u diskutua në kapitullin e parë, RZHN-JK 2004 shfrytëzon dy tregues për të matur nivelet e varfërisë, gjë që është përcaktuar si

e domosdoshme, duke marrë parasysh kompleksitetin e fenomenit në Kosovë (të referoheni tek figura 2.2). Për shembull, krahasimi i niveleve të varfërisë ekstreme (sipas matjeve të IVNJ-1) tregon pabarazi ma të madhe në mes të Skënderajt dhe Dragashit sesa krahasimi i niveleve të varfërisë më pak ekstreme (sipas matjeve nga IVNJ-2). Për komunat e Mitrovicës dhe Prishtinës, vlen e kundërta; krahasimi i treguesve të varfërisë më pak ekstreme (sipas matjeve të IVNJ-2) zbulon dallim më të gjërë.

## Varfëria ekstreme dhe karakteristikat komunale

Një analizë më e afërt e IVNJ-1 tregon se sa më i lartë që është numri i anëtarëve të ekonomisë familjare, aq më e madhe do të jetë përqindja e rezidentëve që jetojnë në linjën e varfërisë njerëzore. Element i ngjashëm është gjetur në lidhje me numrin e fëmijëve për ekonomi familjare. Në komunat me prevalencë më të lartë të varfërisë më të skajshme njerëzore, ekonomitë familjare tentojnë të derivojnë pjesë më të madhe të të ardhurave totale nga paratë e huazuara dhe kursimet, dërgesat (remiten-cat), ndihma nga farefisi si dhe të ardhurat nga shitja e pasurisë. Sa më e madhe që të

jetë përqindja e mjeteve (pasurisë) për prodhim brenda ekonomisë familjare në një komunë, aq më i vogël është niveli i varfërisë njerëzore dhe anasjelltas. Përqindja e njerëzve që jetojnë pa pasur qasje në ujësjellës dhe pa indeks të duhur të standardit të jetesës janë faktorët më të fuqishëm determinues të IVNJ-1. Shkalla e arsimimit të të rriturve ka ndikimin më të ulët në rezultatet e IVNJ-1, përveç në Malishevë, ku kjo çështje ka ndikimin më të madh.

Komunat me nivelet më të larta të varfërisë ekstreme janë Malisheva, Novobërda, Skënderaj, Suhareka dhe Shtimja, derisa ato me nivelin më të ulët të varfërisë ekstreme janë: Mitrovica, Prishtina, Zubin Potoku, Shtërpca dhe Zveçani.

### Varfëria dhe karakteristikat komunale


Pabarazia në të ardhura brenda komunave është ngushtë e lidhur me incidencën e varfërisë më pak ekstreme. Në të gjitha regjionet administrative, sa më i madh që është niveli i pabarazisë në të ardhura<sup>7</sup>, aq më i madh tenton të jetë niveli i varfërisë ekstreme (siç është reflektuar nga IVNJ-2). Në pothuajse të gjitha komunat, determinantat kryesore të varfërisë më pak ekstreme janë shkalla e papunësisë dhe përqindja e popullsisë që jeton me 2\$ në ditë, apo më pak. Përqindja e popullsisë në komuna që pritet të vdesë përpara moshës 60 vjeçare ka ndikimin më të ulët në rezultatin e vet të IVNJ-2, derisa analfabetizmi i të rriturve në mënyrë tipike ka ndikimin më të madh.

Nivelet më të larta të varfërisë më pak ekstreme janë regjistruar në komunat e Dragashit, Gllgovcit, Klinës, Skënderajt dhe Rahovecit, derisa nivelet më të ulëta janë regjistruar në Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Prishtinë, dhe Pejë.

### Varfëria njerëzore në komunitetet etnike

Siç mund të shihet në Figurën 2.13 më poshtë, varfëria e skajshme është më së shumti e theksuar në komunitetin RAE, e përcjellur nga komunitetet shqiptare dhe serbe. Boshnjakët, turqit dhe goranët janë

FFIGURA 2.13 IVNJ-1 DHE TREGUESIT E ZGJEDHUR TË DEPRIVIMIT NJERËZOR, SIPAS ETNICITETIT




Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004

relativisht më mirë sesa pjesa tjetër e popullsisë. Kjo pjesërisht mund t'i atribuohet prevalencës së tyre të lartë në vendet urbane, duke iu dhënë qasje më të mirë në ujësjellës. Ndoshta për të njëjtën arsye, komuniteti RAE ka qasje më të mirë në ujësjellës sesa popullsia shqiptare.


Incidenca e lartë e varfërisë në komunitetin RAE kryesisht i atribuohet faktit se ky komunitet ka përqindjen më të lartë të njerëzve që pritet të vdesin para moshës 40 vjeçare si dhe shkallën më të lartë relative të analfabetizmit. Sa i përket komunitetit shqiptar, nivelet e larta të varfërisë kryesisht janë si rezultat i përqindjes së lartë të njerëzve pa qasje në ujësjellës apo një pjesë e madhe e njerëzve që jetojnë me më pak se 1 \$ USD

FIGURA 2.14 IVN-1 DHE TREGUESIT E ZGJEDHUR TË DEPRIVIMIT NJERËZOR, SIPAS ETNICITETIT



Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004

**FIGURA 2.15 PËRQINDJA E NJERËZVE QË JETOJNË NË VARFËRI - URBAN DHE RURAL**



Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004

në ditë; për të dy treguesit e fundit, komuniteti shqiptar ka përqindjen më të lartë të njerëzve të deprivuar.

### Varfëria në komunitetet etnike

Siç shihet në Figurën 2.14, komuniteti RAE është grupi më i ndieshëm në lidhje me deprivimin njerëzor, sipas definimit në IVNJ-2. Më tutje, përqindja më e lartë e njerëzve që jetojnë në varfëri njerëzore janë: boshnjakët, turqit dhe goranët, kryesisht për shkak të shkallës së analfabetizmit dhe numrit të lartë të njerëzve që jetojnë me 2\$ apo më pak në ditë. Serbët kanë incidencën më të ulët të varfërisë më pak ekstreme.

gjitha më shumë prevalente në rajonet rurale. Dispariteti më i madh ekziston në relacion me qasjen në qendra shëndetësore. Ndoshta, kjo shpjegon pse përqindja e njerëzve të cilët nuk pritet të mbijetojnë moshën 60 vjeçare është katër herë më e madhe në rajonet rurale sesa në ato urbane.

### Zhvillimi gjinor

Në të gjitha komunat e Kosovës, meshkujt kanë të ardhura më të larta për kokë banori dhe arsimim më të mirë sesa femrat, derisa femrat në të gjitha komunat kanë jetëgjatësi më të madhe.

**TABELA 2.5 KOMPONENTET E IVN-1 SIPAS NDARJES URBANE/RURALE**

	Përqindja e njerëzve që pritet të vdesin para moshës 40 vjeçare	Shkalla e analfabetizmit të të rriturve (15+), %	Përqindja e njerëzve që nuk kanë qasje në ujësjellës	Përqindja e njerëzve e cila është më larg se 5 km nga qendra shëndetësore	Përqindja e njerëzve që jetojnë nën indeksin e jetesës standarde
Rural	8.33	6.05	48.12	14.23	21.95
Urban	3.73	5.45	6.08	0.69	3.42

Burimi: UNDP, AZHNJ 2004

### Varfëria njerëzore sipas popullsisë urbane dhe rurale

Pa marrë parasysh treguesin në fjalë, varfëria në mënyrë tipike është më e lartë në vendet rurale (shiko Figurën 2.15)

### Varfëria e skajshme sipas rajoneve urbane/rurale

Si është treguar në tabelën 2.6, përqindja e njerëzve që jetojnë në varfëri ekstreme në rajonet rurale është katër herë më e lartë sesa ajo në rajonet urbane. Përqindja e popullsisë pa qasje në ujësjellës përafërsisht është tetë herë më e madhe sesa në rajonet rurale, derisa përqindja e njerëzve që pritet

### Indeksi komunal i zhvillimit gjinor

Treguesit e arsimimit të femrave dhe pjesëmarrja në fuqinë punëtore janë parashikues të fuqishëm të zhvillimit gjinor në komunat kosovare. Përveç kësaj, sa më i madh është numri i anëtarve të familjes dhe sa më i madh që është numri i fëmijëve, aq më e vogël do të jetë mesatarja e IZH Gj.

### Disa karakteristika të IZH Gj komunale në Kosovë

Tri komunat e renditura më së larti sipas IZH Gj janë: Zubin Potoku, Mitrovica dhe Zveçani, derisa më së ulti të renditura janë: Malisheva, Skënderaj dhe Rahoveci. Në përgjithësi, komunat me përqindje më të lartë të popullsisë rurale kanë IZH Gj më të ulët sesa komunat me përqindje më të ulët të popullsisë urbane. Me përjashtim të Novobërdës, komunat me përqindje të lartë të serbëve, në përgjithësi janë më mirë sesa komunat me shumicë dominante shqiptare.

Determinanta kryesore e IZH Gj-së është indeksi i të ardhurave të shpërndara në mënyrë të barabartë. Në Malishevë, që është komuna me indeks më të ultë në këtë drejtim, për çdo 8 Euro të fituara nga

**TABELA 2.6 DISA KOMPONENTE TË IVN-2 SIPAS RAJONEVE URBANE RURALE**

	Përqindja e njerëzve që pritet të vdesin para moshës 60 vjeçare	Përqindja e njerëzve që jetojnë me 2\$ në ditë apo më pak	Shkalla e papunësisë së të rriturve (në përqindje)
Rural	18.26	49.23	48.62
Urban	4.21	45.79	39.97

Burimi: UNDP, AZHNJ 2004

të vdesin para moshës 40 vjeçare është 2.5 herë më e madhe në rajonet rurale në krahasim me ato urbane.

Varfëria sipas rajoneve urbane/rurale Analfabetizmi, papunësia dhe njerëzit që jetojnë me më pak se 2\$ në ditë janë të

femrat, meshkujt fitojnë 100 Euro. Zubin Potok, që gjendet në anën tjetër të spektrit, meshkujt fitojnë 100 Euro për çdo 87 Euro të fituara nga femrat.

Femrat poashtu janë të pafavorizuara në arsimim, me shkallë të ultë të arsimimit dhe me shkallë të ultë të kombinuar të regjistrimit në shkolla fillore, sekondare dhe terciare, sesa meshkujt. Podujeva ka indeksin më të ultë të arsimimit të shpërndarë në mënyrë të barabartë; analfabetizmi tek femrat në Podujevë është 16%, proporcioni i kombinuar i regjistrimit nëpër shkolla është 84% dhe mesatarja e viteve të shkolimit është vetëm shtatë.

Komponenta e vetme e IZH Gj që është më në favor të femrave meshkujve është jetëgjatësia. Femrat jetojnë mesatarisht dy vite më gjatë sesa meshkujt, në përgjithësi. Skënderaj renditet i fundit, me jetëgjatësi mesatare prej 61.7 vjet dhe me femrat që jetojnë 2.4 vjet më gjatë sesa meshkujt, derisa Gjilani renditet më së larti me jetëgjatësi mesatare prej 71 vite dhe femra që në mënyrë tipike, jetojnë 1.4 vite më shumë se meshkujt.


### Femrat dhe varfëria

Një ekzaminim më i afërt i të dhënave të AZH NJ të UNDP-së ka zbuluar se së paku disa prej efekteve të varfërisë ndikojnë në femra, posaçërisht ato në relacion me zgjedhjet dhe mundësitë e tyre. Siç është parë në Figurat 2.16, pjesëmarrja në fuqi punëtore është skajshmërisht e ulët dhe disproporcionalisht edhe më e ulët për femrat në krahasim me meshkujt në rajonet ku incidenca e varfërisë (IVNJ-1) është më e lartë<sup>8</sup>. Siç është demonstruar në Figurën 2.17, mund të shihet një trend i ngjashëm në relacion me të ardhurat e fituara për muaj.

### Masat e pushtetëzimit gjinorë në nivel komunal


Disparitetet më të mëdha gjinore në komunat mund të shihen në relacion me shkallë të pjesëmarrjes ekonomike dhe me përqindjen e posteve teknike dhe profesionale të mbajtura nga femrat. Në Kosovë, komunat me IZH Gj të lartë poashtu kanë pjesëmarrje më të lartë të femrave në politikë dhe ekonomi. Punësimi është faktori kyç determinues për MPGJ.

FIGURA 2.16 PJESËMARRJA NË FUQINË PUNËTORE SIPAS GJINIVE, NË TRI KOMUNAT E PARA DHE TRI TË FUNDIT NË IVNJ-2



Burimi: UNDP, AZH NJ, 2004

FIGURA 2.17 SHKALLA E TË ARDHURAVE SIPAS GJINISË: 3 KOMUNAT E PARA DHE TRI TË FUNDIT NË IVNJ-2



Burimi: UNDP, AZH NJ, 2004

### Disa karakteristikat e MPGJ komunale në Kosovë

Komunat siç janë: Novobërda, Dragashi, Rahovec, Vushtrria dhe Skënderaj, ekonomitë e të cilave janë të bazuara në bujqësi dhe përmbajnë një pjesë më të madhe të rezidentëve ruralë, janë të renditura shumë ulët në MPGJ. Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi janë tri komunat e para në lidhje me MPGJ, derisa Novobërda, Dragashi dhe Rahoveci renditen në fund të kësaj shkalle.

Në Malishevë, pjesëmarrja e femrave në fuqinë punëtore është 17%, derisa në Leposaviq është rreth 71% dhe në Zubin Potok është rreth 67%. Në Novobërdë asnjë femër nuk mban post profesional apo teknik; për dallim, në Obiliq, 45% të femrave që punojnë mbajnë poste profesionale dhe teknike. Në Malishevë, AZH NJ nuk ka regjistruar asnjë femër juriste, zyrtare të lartë apo menaxhere, më tej në Leposaviq, pothuajse një e treta e këtyre posteve mbahen nga femrat.

Përqindja e femrave në kuvendet komunale ka qenë faktori më së paku i rëndësishëm

*Zhvillimi gjinor dhe zhvillimi njerëzor duken të jenë të ndërlidhur ngushtë. Shpesh është vërejtur që sa më i madh që të jetë një tregues i caktuar i zhvillimit njerëzor për ndonjë komunë të caktuar, aq më e vogël do të jetë pabarazia që ekziston ndërmjet meshkujve dhe femrave.*

TABELA 2.7 KOMPONENTET E IZHNGJ DHE MPGJ SIPAS RAJONEVE URBAN/RURAL

	Jetëgjatësia nga lindja	Shkalla e arsimimit të të rriturve, %	Shkalla e regjistrimit neto të kombinuar, %	Mesatarja e viteve të shkollimit	Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, %	Të ardhurat e fituara për muaj
Rural Meshkujt	67.00	97.03	88.71	10.00	74.39	112
Rural Femrat	69.23	90.97	85.69	7.94	25.54	32
Rural Diferenca	-2.23	6.06	3.02	2.06	48.85	100 (M); 28 (F)*
Urban Meshkujt	70.23	97.54	90.54	10.88	76.64	163
Urban Femrat	71.87	91.74	89.70	8.99	37.19	53
Urban Diferenca	-1.64	5.80	0.84	1.89	39.45	100 (M); 33 (F)

Proporcioni meshkuj/femra në të ardhurat mujore Për çdo 100 Euro të fituara nga meshkujt, femrat fitojnë 28 Euro.  
Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004

në përcaktimin e MPGJ; nga shaku se të gjitha komunat kanë përqindje të njëjtë për shkak të ligjit të elektoratit i cili garanton së paku tridhjetë përqind të ulëseve për femrat.

### Etniciteti dhe fuqizimi i femrave

Femrat serbe kosovare kanë IZHNGJ më të lartë (0.717), përcjellur nga femrat shqiptare kosovare (0.668) dhe komunitetet tjera (0.664), derisa komuniteti RAE ka IZHNGJ më të ulët (0.590). Dallimet më të mëdha në komponentet e IZHNGJ-së burojnë nga pabarazitë në të ardhura dhe arsimim.

Me mesatarisht 28 Euro për muaj, femrat e komunitetit RAE kanë shkallën më të ulët të të ardhurave të fituara. Femrat e komunitetit RAE poashtu kanë shkallën më të ulët të pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (23%). Femrat nga komuniteti shqiptar dhe komunitetet tjera kanë shkallë pak më të larta të pjesëmarrjes së femrave në fuqinë punëtore, me 29%, gjersa pjesëmarrja tek femrat serbe është 40%. Shkalla e analfabetizimit tek femrat e komunitetit RAE (26%) është veçanërisht e lartë, përcjellur nga femrat e komuniteteve "tjera" (11%), femrat shqiptare (8%) dhe femrat serbe (4%). Nga femrat në të gjitha komunitetet, femrat e komunitetit RAE shënojnë mesataren më të ulët të shkollimit (5.7) dhe regjistrimin neto në shkollat fillore dhe të mesme prej 53%.

Nuk ka femra në komunitetin RAE që punojnë si juriste, zyrtare të larta apo

menaxhere. Poashtu, nuk ka femra RAE që punojnë si personel profesional apo teknik, krahasuar me femrat në komunitetin serb, të cilat së paku kanë një përfaqësim marginal në këto fusha, me 15% dhe 28% përkatësisht.

### Zhvillimi urban/rural në relacion me gjinitë

Rajonet rurale shënojnë IZHNGJ më të ulët (0.643) sesa në rajonet urbane (0.692). Sikurse tregon Tabela 2.8, në përgjithësi, shifrat e larta për shumicën e komponenteve të IZHNGJ-së janë të regjistruara në rajonet urbane. Për më tepër, pabarazia në mes të meshkujve dhe femrave ruralë është poashtu e lartë. Treguesit më të dëmshëm të pabarazisë në relacion me gjinitë janë pjesëmarrja në fuqinë punëtore dhe të ardhurat e fituara mujore.


MPGJ nuk ka mundur të kalkulohet për popullsitë urbane dhe rurale, pasi që nuk është e mundur që të vlerësohen shifrat e pjesëve të ulësve në kuvendet komunale dhe në parlament, të mbajtura nga femrat rurale dhe urbane. Sidoqoftë, nga të dhënat e hulumtimeve janë kalkuluar dy komponente të MPGJ. Siç shihet më poshtë në Tabelën 2.8, femrat rurale mbajnë dukshëm më pak poste si jursite, zyrtare të larta dhe menaxhere, në krahasim me femrat urbane. Ngjashëm përqindja e femrave rurale në postet profesionale dhe teknike është më e vogël sesa ajo tek femrat urbane.

TABELA 2.8 KOMPONENTET E ZGJEDHURA PËR MFGJ SIPAS RAJONEVE URBANE/RURALE


	Përqindja e juristëve, zyratrëve të lartë dhe menaxherëve	Përqindja e posteve profesionale dhe teknike
Rural Meshkuj	85	82
Rural Femra	15	18
Urban Meshkuj	82	72
Urban Femra	18	28

Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004

HARTA 2.1: INDEKSI I ZHVILLIMIT NJERËZOR SIPAS KOMUNAVE




HARTA 2.2: INDEKSI I VARFËRISË NJERËZORE 1 SIPAS KOMUNAVE







HARTA 2.4: INDEKSI I ZHVILLIMIT GJINORË SIPAS KOMUNAVE







## RISHQYRTIMI I PJESEMARRJES DHE PËRFAQËSIMIT NË KOSOVË

*Demokracia nuk është çështje e një vendimi apo e zgjedhjeve të organizuara ngutshëm. Kur demokracia është në shërbim të zhvillimit njerëzor, çdo institucion dhe çdo veprim politik duhet të gjykohej me një test kritik: dhe sa i përmbushë aspiratat e vërteta të njerëzve?" - Mahbub ul Haq, themelues i Raportit të Zhvillimit Njerëzor*

## Hyrje

Që nga 17-19 Marsi 2004, pothuajse pesë vite pas intervenimit të bashkësisë ndërkombëtare dhe krijimit të administratës së përkohshme ndërkombëtare në Kosovë, dhuna dhe shkatërrimet materiale kanë shpërthyer në një shkallë të paparë që nga konflikti e pranverës 1999. Ky shpërthim rezultoi me 19 persona të vdekur, zhvendosjen e rreth 4500 serbëve kosovarë, afër 900 të plagosur (më shumë se 20 prej tyre të plagosur rëndë duke përfshirë edhe 65 policë ndërkombëtarë dhe 58 policë të SHPK-së), dëme apo shkatërrime të 700 shtëpive, 10 ndërtesa publike dhe 29 ndërtesa religjioze<sup>1</sup>. Vëzhgues të ndryshëm e kanë atribuar këtë ngjarje si pakënaqësi e papritur ndaj shumë faktorëve duke përfshirë: papunësinë e lartë, pasigurinë nga varfëria, ekstremizmin dhe krimin e organizuar. Euforia që pat kapluar zgjedhjet e viteve 2001 dhe 2002 i ka dhënë rrugë realitetit që ndërtimi i paqes dhe ndërtimi i institucioneve demokratike kërkojnë përpjekje të mëdha e të dhimbshme, kohë, strategji të vendosur dhe përkushtim të fuqishëm personal. Pa zgjerim dhe thellim të mëtejme të kanaleve për dialog më domethënës dhe qeverisje përgjegjëse, frustrimi publik do të vazhdojë të rritet, duke minuar procesin e zhvillimit në Kosovë. Qartazi, përpjekja për të krijuar qeverisje demokratike në Kosovë, sapo ka filluar.

RZHNJK 2002 ka prezentuar konceptin e zhvillimit njerëzor në Kosovë duke e definuar atë si proces të rritjes së zgjedhjes për njerëzit në kuptim të mundësive dhe lirive politike, ekonomike dhe sociale (Shiko Kapitullin 1). RZHNJK 2002 pasuron dialogun mbi zhvillimin njerëzor nëpërmes të ekzaminimit të principeve kryesore demokratike të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit. Ky kapitull ofron një kornizë analitike për kuptueshmërinë se si këto çështje ndikojnë në jetërat e qytetarëve të Kosovës. Në këtë

kornizë, kapitujt vijues hyjnë në disa pyetje urgjente politike me të cilat ballafaqohen Kosovarët dhe partnerët e tyre ndërkombëtarë, siç janë: reformat politike dhe institucionale në detaje më të imta. Edhe pse statusi afatgjatë politik i Kosovës mbetet i ndieshëm dhe i pazgjidhur, përpjekjet për të përmirësuar mirëqenien dhe mundësitë për të gjithë Kosovarët me ndihmën e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit më të mirë, mbetet konstante.

## Pjesëmarrja dhe përfaqësimi: principe të fuqishme demokratike

Duke tejkalluar preokupimin tradicional me inputet ekonomike dhe teknologjike, strategjitë për zhvillim dhe për zvogëlim të varfërisë çdo ditë e më tepër inkorporojnë pjesëmarrje dhe përfaqësim efektiv të qytetarëve të rëndomtë. Si principe kryesore demokratike, pjesëmarrja dhe përfaqësimi janë esenciale që zhvillimi njerëzor të lindë dhe lulëzojë. Demokracia ka dëshmuar të jetë sistemi më i mirë i qeverisjes, të jetë në gjendje të përfaqësojë pikëpamjet e ndryshme dhe të sigurojë pjesëmarrje inkluzive të të gjithë qytetarëve në vendimarrje. Demokracia përfaqësuese ka dëshmuar të jetë sistemi më agil politik për ndërmjetësim dhe parandalim të konflikteve violente dhe për ruajtjen e mirëqenies ekonomiko-shoqërore.

### *Pjesëmarrja si faktor esencial në zhvillimin njerëzor*

Pjesëmarrja kërkon që njerëzit të vendosen në qendër të transformimeve socio-politike dhe ekonomike. Pjesëmarrja në shkallë të lartë në politikë mund të ushtrojë presion të jashtëzakonshëm mbi qeveri dhe elitën politike. Duke sfiduar sundimin e disave dhe sundimin e shumicës, pjesëmarrja demokratike mundet (minimalisht) të ushtrojë presion mbi qeveritarët që të shqyrtojnë pikëpamjet që dallojnë. Ky pluralizëm në esencë gjeneron konflikt, por shoqëritë që ia dalin për të transformuar këtë konflikt në zgjidhje "fitim-fitim" mund të arrijnë nivele të pakrahasueshme të zhvillimit<sup>2</sup>.

Të gjithë diktatorët shumë shpesh paraqesin vendet e tyre si demokraci, të bazuar vetëm në kriterin se a janë mbajtur zgje-

**KORNIZA 3.1: ÇKA ËSHTË PJSËMARRJA?**  
**Pjesëmarrja në qeverisjen publik përfshin por nuk limitohet në:**

- (a) mënyrat e votimit të rregullt në zgjedhje të lira dhe të drejta;
- (b) shoqëri civile vibrante dhe aktive;
- (c) prezencë aktive të lobeve dhe të grupeve të interesit;
- (d) kontribum në mbulesë nga mediat lokale;
- (e) përdorimi i referendumeve dhe peticioneve;
- (f) qasje dhe involvim në nivele dhe faza të ndryshme të bërjes së politikës nga qeveria;
- (g) vullnetarizmi në fushat siç janë ofrimi i shërbimeve edhe avokimi, dhe
- (h) aktiviteti ekonomik i punëtorëve dhe ndërmarësve.

**Pjesëmarrja është e dobishme për shkak se:**

- (a) mundëson involvimin e rritur të qytetarëve në proceset vendim-marrëse;
- (b) obligon figurat e fuqishme shoqërore që të ndajnë

informatat me qytetarët;

(c) lejon të rritet legjitimiteti dhe besimi në sistemin e qeverisjes së shoqërisë;

(d) shpesh ofron rritje në fuqinë shkëmbuese të përfitimeve për qytetarët si dhe rritjen e këtyre përfitimeve;

(e) lehtëson marrjen parasysh në debat të një numri të madh mundësish politike, duke përfshirë edhe mundësitë me më shumë beneficione për qytetarët e randomtë;

(f) rrit kapitalin ose besimin në shoqëri, dhe amplifikon çështjet e rëndësishme të përbashkëta për grupet e individëve të të njëjtit mendim;

(h) ndihmon femrat dhe grupet tjera të marginalizuara në aspektin politik dhe shoqëror për të përmirësuar statusin e tyre, dhe

(i) inkurajon shfrytëzimin më të mirë të njohurive dhe kapaciteteve lokale për të adresuar nevojat e komuniteteve lokale, të cilat si rrjedhojë, mund të udhëheqin në mobilizim më të mirë dhe shfrytëzimin më efikas të resurseve dhe aftësive lokale.

**FIGURA 3.1: DEMOKRACIA DHE LIDHJET E ZHVILLIMIT NJERËZOR**



institucioneve të fuqishme dhe përgjegjëse të qeverisjes demokratike merr kohë dhe do të ishte gabim që demokracia të barazohet me zgjedhje të rregullta dhe të bie në nocionin që nuk shpie askund - "elektoralizmin"<sup>13</sup>.

Përveç zgjedhjeve, pjesëmarrja e vërtetë demokratike kërkon një mjedis të favorshëm (shiko Kornizën 3.1.). Këtu përfshihet prania e: intereseve ndryshuese të grupeve të qytetarëve; qeverisja efektive e decentralizuar dhe lokale; qytetaria aktive e cila mbron interesat e veta nëpërmes të kanaleve siç janë tubimet e sindikatave; diskutimet publike të transmetuara nga mediat; dëgjimet publike nga organet legjislativë nacionale apo lokale; dhe demonstratat publike e peticionet. Në mënyrë që të ndihmohen individët për të marrur pjesë në mënyrë konstruktive në vendim-marrje në kohën/intervalin në mes të zgjedhjeve, partitë politike duhet të plotësojnë funksionet e edukimit politik, mobilizimit dhe përfaqësimit të interesave të ndryshme, duke përfshirë femrat dhe minoritetet<sup>14</sup>. Përveq partive politike, grupet e qytetarëve (siç janë organizatat e komuniteteve dhe ato jo-qeveritare) shpesh luajnë rol me ndikim në edukimin dhe organizimin e publikut rreth çështjeve të rëndësishme shoqërore, ekonomike dhe politike. Për shembull, kur qytetarët nga kooperativat dhe interesat e konsumatorëve gruponen për të siguruar përmbushjen e standardeve të sigurisë dhe mbajtjen e çmimeve të prodhimeve esenciale në nivele të drejta,

dhjet. Prapëseprapë, historia tregon që vetëm zgjedhjet nuk garantojnë përfaqësim efektiv të qytetarisë. Si në vendet e pasura ashtu edhe në ato të varfëra, zgjedhjet shpesh manipulohen, nganjëherë edhe haptazi. Edhe kur udhëhiqen në mënyrë të lirë dhe të drejtë, zgjedhjet ne raste të rralla ndodh të përkthejnë dëshirat e votuesve në vendime që në mënyrë adekuate reflektojnë nevojat dhe aspiratat e tyre. Në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja aktive qytetare që do të rrisë suksesin e programeve që kanë rëndësisë së madhe për një numër të madh qytetarësh të randomtë siç është arsimit fillor dhe përkujdesja shëndetësore, janë të nevojshme më shumë mekanizma përtej zgjedhjeve duke përfshirë resurse adekuate financiare, politike dhe njerëzore. Ndërtimi i

ata marrin pjesë në formësimin e vendimeve fundamentale rreth prodhimit ekonomik dhe kostot e pranuar nga njerëzit e rëndomtë. Në demokraci stabile, asnjë nga rrugët drejt pjesëmarrjes nuk duhet të dominojë, për shkak se qytetarëve duhet t'ju ofrohen kanale të shumta që individualisht dhe kolektivisht të transmetojnë opinionet e tyre dhe të mbrojnë intereset e tyre.

Si rezultat i së kaluarës autoritare, dhe kohë pas kohe të dhunshme, të mungesës së proceseve demokratike dhe të kulturës së debatit, pakënaqësisë dhe padurimit ndaj përpjekjeve ndërkombëtare për të fuqizuar vetëqeverisje më të gjërë, varfërisë së madhe dhe perceptonit se institucionet qeverisëse nuk janë përgjegjëse, pjesëmarrja qytetare ende duhet të evoluojë shumë më shumë sesa demonstratat e kohëpaskohshme në rrugë. Duhet të hapen kanale në mënyrë që qytetarët, nëpërmes tyre, të transmetojnë brengat e tyre legjitime. Vetëm atëherë mund të forcohet lidhja ndërmjet pjesëmarrjes demokratike dhe brengave të zhvillimit njerëzor, siç është zvogëlimi i pabarazive.

tive' dhe 'negative' të pjesëmarrjes, në mënyrë që të kuptohet më mirë nese pjesëmarrja qytetare Kosovare mund të konsiderohet më shumë apo më pak konstruktive nga perspektiva institucionale. Shembujt e pjesëmarrjes pozitive përfshijnë angazhimin paqësor dhe konstruktiv të qytetarëve në procesin e vendim-marrjes nëpërmes të organizimit rreth interesave specifike dhe të përbashkëta. Pjesëmarrja në protestat publike konsiderohet si pjesëmarrje negative, sepse, siç u dëshmuua me 17-19 Mars 2004, ato mund të shpiejnë në përleshje, shkatërrime dhe sulme fizike. Të dhënat (shiko tabelën A.22 në Aneksin III) tregojnë që protesta publike është normë ndër Kosovarët të cilët kanë më shumë gjasa të transmetojnë brengat e tyre jashtë institucioneve sesa nëpërmes tyre. Në të vërtetë, pjesëmarrja pozitive, e njohur si 'aktivitete sindikaliste', 'diskutime publike', 'iniciativa qytetare' dhe 'nënshkrim peticionesh', është katër herë më e ulët sesa pjesëmarrja në protesta publike. Interesi apo grupet e qytetarëve të orientuar kah politika pothuajse janë inekzistente, pjesërisht për shkak të ambientit të papërshtat-

TABELA 3.1: FORMAT E PJESËMARRJES CIVILE NË KOSOVË

Ka implementuar projekt të OJQ-së	Ka qenë përfitues i projektit të OJQ-së	Ka implementuar projekt të qeverisëse lokale	Ka qenë përfitues i projektit të qeverisëse lokale	Ka marrë pjesë në aktivitete të sindikatës	Ka marrë pjesë në diskutime publike	Ka marrë pjesë në iniciativë qytetare	Ka nënshkruar peticion	Ka marrë pjesë në protesta publike
1.7%	2%	0.7%	0.8%	3.8%	6.7%	6.4%	6.1%	21.8%

Burimi: UNDP AZHNJ 2004

### Pjesëmarrja në Kosovë

Edhe pse pjesëmarrja në Kosovë, në krejt dimensionet e veta, është e vështirë të matet, RZHNJK 2004 përipiqet të vlerësojë angazhimin civil në pesë aspekte të jetës publike: (a) aktivitetet e sindikatave, (b) diskutimet publike, (c) iniciativat qytetare, (d) nënshkrimi i peticioneve dhe (e) pjesëmarrja në protesta publike (Shiko Tabelën 3.2.)

Trashëgimia e sundimit autoritar dhe/ose e numrit të kufizuar të kanaleve për pjesëmarrje civile shpjegojnë pse forma më e popullarizuar e pjesëmarrjes publike për Kosovarë është protesta publike në rrugë. Çështjet që kanë të bëjnë me individët Kosovarë nuk duket të jenë, ose së paku nuk shikohen si arritje efektive e sundimit të publikut nëpërmes kanaleve ekzistuese. Raporti bën dallim ndërmjet formave 'pozi-

shëm për të vënë në pah kërkesat e tyre. Edhe aty ku ekzistojnë, të dhënat tregojnë se ato kanë më shumë gjasa të kërkojnë për të adresuar pakënaqësitë e tyre nëpërmes të protestave publike apo demonstratave të dhunshme sesa nëpërmes mjeteve tjera. Kjo dukuri fatkeqësisht sugjeron mungesë besimi të publikut se metodat konstruktive dhe paqësore mund të sjellin ndryshime.

Aftësia e individëve për të shtrirë ndikimin e tyre kulmon me atë se sa të zëshëm janë si dhe me aftësinë e tyre të organizojnë grupe në mënyrë kolektive. Të gjithë mekanizmat për pjesëmarrje të lartpërmendur mbështeten në organizim efektiv në grupe të cilat kanë qëllime specifike. Këto qëllime mundësojnë amplifikimin dhe artikulimin e zërave kolektivë të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e partive politike dhe legjvënësve. Demokraci do të thotë të mbahet

TABELA 3.2: NUMRI I VOTAVE TË DUHURA PËR TË ZGJEDHUR PËRFAQËSUESIN KOMUNAL NË KOSOVË

Viti i zgjedhjeve	2000	2002
Mesatarja	854	1,278
Më e ulët	2	163
Më e lartë	2,165	3,044
Mes. për minoritete	196	620
Mes. për shqiptarë	1,017	1,441

\* Burimi: KIPRED fakte të Shkurtëra për Zgjedhjet (2004).

Nga kjo tabelë shihet se në vitin 2002 shqiptarëve kosovarë për t'u zgjedhur si përfaqësues komunalë iu janë dëshur dyfish më shumë vota sesa kandidatëve të minoriteteve.

*Sfidë primare e demokracisë së re të Kosovës është mënyra si të bartet zëri i individit deri te grupet e interesit dhe partitë politike, pastaj deri te politikë-bërësit që në fund të implementuesit*

rendi nga shumica, derisa në të njëjtën kohë mbrohen të drejtat e grupeve minoritare. Sidoqoftë, ekzistojnë shumë interesa që janë të përbashkëta për grupe të vogla qytetarësh që mund t'iu japin numër të dukshëm votash atyre partive që kanë vullnet për t'i inkorporuar në programet e tyre. Në demokraci, ku partitë e suksesshme normalisht janë përgjegjëse dhe kërkojnë maksimalizim të votave të tyre, edhe grupet e interesit relativisht të vogla por të afta, mund të ndikojnë në sistemin formal politik. Edhe grupet e vogla të interesit dhe asociacionet e organizuara mund t'i përmbushin nevojat e tyre, përderisa arrijnë të mobilizojnë një numër të mjaftueshëm njerëzish dhe artikulojnë qartë nevojat e tyre.

Ngjarjet e 17-19 Marsit, të çiftëzuara me iniciativat e shoqërisë civile (si propozimi nga koalicioni i 250 OJQ-ve për të përmirësuar sistemin elektoral dhe konferenca e mbajtur së voni nga Rrjeti i Aksioni Kosovarë KAN mbi nocionin e qytetarit) janë shembuj të ndryshme por prapëseprapë konkretë të mënyrave sesi Kosovarët kanë kërkuar të ndikojnë në ndryshimin shoqëror (shiko Kornizën 6.1 "Reforma 2004": Model i ri për angazhim konstruktiv qytetar, në Kapitullin 6). Hulumtimet e gjëra kanë ilustruar që kur njerëzit bashkohen rreth çështjeve të posaçme, ata fuqizojnë legjitimitetin e aspiratave të tyre të përbashkëta<sup>5</sup>. Në të njëjtën

kohë, shtytja e tyre e qëllimeve të përbashkëta mund të shpie në konflikt me të tjerët të cilët kundërshtojnë pikëpamjet alternative.

Qytetarët mund të ushtrojnë preferencat e tyre në mënyrë efektive duke u bashkuar në grupe:

- (a) Në demokraci, është përgjegjësi e individëve dhe grupeve që të kërkojnë dhe ngrisin zërin për brengat e tyre, dhe grupet duhet të ndihmojnë në amplifikimin e interesave të qytetarëve individualë;
- (b) Pakënaqësitë e theksuara nga grupe të ndryshme ka më shumë gjasa të mbulohe nga mediat dhe të rrisin gjasat që partitë politike të adoptojnë dhe shtyjnë përpara politikat për përgjigje konstruktive ndaj brengave që kanë dalur në publik.

Sfida primare e demokracisë së re kosovare është si të amplifikohet zëri i individit, që nga adoptimi i idesë së tij/saj nga grupet e interesit dhe partitë politike deri tek formulimi i politikave dhe implementimi si hap i fundit. Skema e prezentuar më poshtë (Figura 3.2) përvijon sesi idetë individuale mund të realizohen plotësisht brenda një sistemi pjesëmarrës të qeverisjes demokratike.

Kjo skemë ilustron procesin me anë të të cilit individi mund të shprehë brengat e tij/saj janë të përbashkëta me të tjerët.

FIGURA 3.2: NGA ZËRI I NJË INDIVIDIT DERI TEK NDRYSHIMI I POLITIKËS DHE IMPLEMENTIMI





Grupet e komuniteteve, OJQ-të, asociacionet apo sindikatat e krijuara shërbejnë për qëllim të bashkimit të zërave individualë në çështjet e fitimit të votave. Nese votimi direkt përkthehet në fuqi politike dhe nese individët që përbëjnë një grup të caktuar do t'iu japin votat një partie që i merr në konsideratë pikëpamjet e tyre, varet nga shumë faktorë. Ndër të tjerë, ata në masë të madhe varen nga drejtësia dhe transparencja e sistemit elektoral, temë kjo që do të diskutohet në detaje të mëtejshme. Institucionet e forta dhe shoqëria e fortë civile, e mbështetur nga vlerat demokratike dhe respekti për të drejtat e njeriut, janë poashtu kyçe për të dhënë llogari dhe balansuar kundrejt politikanëve popullistë dhe akterëve të fuqishëm jashtë qeverisë.

### *Përfaqësimi si faktor esencial për zhvillim njerëzor*

"Nuk ka tatimim pa përfaqësim!" ishte bërë thirrje standarde e kolonialistëve amerikanë të viteve 1770-ta që kërkonin të ndryshojë marrëdhëniet e tyre politike me Mbretin e Anglisë dhe Parlamentin në Westminster. Që nga ditët e hershme të demokracisë, përfaqësimi i interesave dhe aspiratave të grupeve dhe individëve të ndryshëm në shoqëri përmes zyrtarëve të zgjedhur dhe organeve tjera qeveritare dhe joqeveritare, është bërë gurthemel për krijimin e institucioneve qeveritare efektive dhe përgjegjëse. Kur njerëzit ndjehen të përjashtuar nga vendimet e rëndësishme mbi çështjet që ndikojnë në ta apo në komunitetet e tyre, qoftë nëpërmes të dështimit për të marrur pjesë direkte në procese apo duke përfaqësuar pikëpamjet e dikujt nëpërmes individit apo organizatës, ata i nënshtrohen mundësisë për të ndërmarrur veprime ekstreme apo për të humbur besimin në sistem dhe të ndërprejnë pjesëmarrjen.

Thjesht, transmetimi i pikëpamjeve të dikujt në forum publik apo përfaqësimi i interesave e domosdoshme por jo e mjaftueshme për të krijuar qeverisje demokratike dhe përgjegjëse. Vendim-marrja për politika si dhe rezultatet duhet të reflektojnë përfaqësimin e interesave të ndryshme madje edhe rivale. Përfaqësimi është fundamental për të siguruar që akterët e fuqishëm (qoftë brenda apo jashtë qeverisë) të mbahen përgjegjës për veprimet e tyre dhe të mba-

hen nën presion për të shpërndarë në mënyrë të barabartë resurset publike. Pa marrur parasysh se sa pjesëmarrëse mund të jetë një qeveri në kuptim të zgjedhjeve të rregullta, të lira dhe të drejta dhe kanaleve të shumta për qytetarët që të mund të shfaqin pikëpamjet e tyre dhe që zërat e tyre të dëgjohen, nese udhëheqësit politikë dhe partnerët e tyre në shërbimet civile, sektorin e biznesit, media dhe organizata tjera shmangin rendin e ligjit dhe normat e qeverisjes së mirë demokratike, ata poashtu dështojnë të përfaqësojnë njerëzit dhe interesat e tyre.

Demokracia, kohë pas kohe, mund të jetë e ngadalshme, e rëndë dhe madje proces i ngatërruar për të arritur tek vendimet dhe implementimi i tyre. Por, pa kanalet e duhura për pikëpamje të ndryshme që duhet të përfaqësohen dhe mandej të inkorporohen në drejtimin e veprimit, rreziqet janë të larta që dhuna apo apatia të fitojnë legjitimitet tek një numër individësh që ndjejnë veten "të lënë anash" dhe të papërfaqësuar në shoqërinë e tyre (shiko Kornizën 3.2).

Në mënyrë që institucionet legjislative dhe ato qeveritare të mund të kenë nivelin më të lartë të legjitimitetit, duhet të jenë të afta të përfaqësojnë të gjitha pjesët e shoqërisë, duke përfshirë femrat, minoritetet etnike

#### **KORNIZA 3.2. ÇKA ËSHTË PËRFAQËSIMI?**

**Nuk ekziston ndonjë definicion standard për përfaqësimin, por karakteristikat kryesore të tij janë:**

- (a) institucioni publik ose privat siguron involvim të rregullt të grupeve dhe individëve të ndryshëm;
- (b) vendim-marrja reflekton pikëpamje të ndryshme, idealisht në formë vendim-marrje me koncenzus;
- (c) rezultatet politike përfaqësojnë drejtë dhe menaxhojnë intereset e pjesëmarrësve të ndryshëm, dhe
- (d) akterë të fuqishëm mbahen përgjegjës për veprimet e tyre, nëpërmes të kontrollit publik nga grupe dhe individë të ndryshëm, sidoqoftë të vegjël në numër dhe resurse.

#### **Çka ndihmon përfaqësimi të arritet në sistem demokratik?**

- (a) Perceptioni i drejtësisë dhe llogaridhënies;
- (b) Besueshmëri më të madhe në sistem, që shpie tek legjitimiteti;
- (c) Krijim të konstituentëve efektivë dhe sensin e të takuarit në një elektorat;
- (d) Përgjegjësia më e madhe e liderëve politikë dhe akterëve tjerë me pushtet në shoqëri;
- (e) Mbrojtja e nevojave dhe interesave të minoriteteve, grupeve të marginalizuara dhe të vogla të interesit;
- (f) Promovim i diversitetit në shoqëri, që, si rezultat promovon tolerancë më të madhe;
- (g) Kulturë dialogu, debati dhe negociata paqësore, dhe
- (h) Rritje të gjasave për stabilitet dhe qeverisje të përgjegjshme demokratike.

dhe fetare si dhe spektrin e besimeve ideologjike. Organet përfaqësuese janë parakusht për qasje përfaqësuese në zhvillim duke involvuar grupe dhe individë të ndryshëm (shiko tabelën 3.). Në anën tjetër, nivelet e larta të përfaqësimit janë të nënshtrueshme ndaj konfliktit dhe kërkojnë sisteme fleksibile për qeverisje. Nëse vendimarrja reflekton spektër të gjërë të pikëpamjeve dhe identiteteve, pjesëmarrja e kënaqshme duket të jetë iluzore.

nga 48 shtete me zhvillim të lartë njerëzor janë demokratike<sup>7</sup>.

Qeverisja demokratike fuqizon qytetarët dhe liderët e zgjedhur për të përcaktuar prioritetet politike të cilat reflektojnë vlera solide. Si rezultat, demokracitë jo gjithmonë mund të promovojnë ndarjen më të barabartë të mundshme të resurseve dhe rezultateve publike, posaçërisht kur grupe të papërgjegjshme ushtrojnë ndikim të pa-

*Format e dobëta të qeverisjes që reflektojnë nivele të ulëta të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit shpiejnë në probleme persistente shoqërore siç janë: zhvillimi i pabarabartë, geto me varfëri ekstreme, korrupsion në tërë vendin dhe keqpërdorime të pushtetit.*

**FIGURA 3.3: Pjesëmarrja dhe përfaqësimi: Lidhjet ndërmjet llogaridhënies, përgjegjëse dhe zhvillimit njerëzor**



Qeverisja e mirë thirret në institucione dhe rregulla efektive të cilat mbajnë vlerat e transparencës, pjesëmarrjes, përgjigjes, llogaridhënies dhe sundimit të ligjit. Si rezultat, qeveria inkluzive-ku njerëzit ndihen të përfaqësuar në mënyrë adekuate-promovon barazinë e mundësive, funksionim efikas të tregut dhe shërbime më të mira publike. Në një sistem të tillë, qytetarët kanë më shumë prirje për të paguar tatime dhe të besojnë në qeveri të drejtë, pasi që ata janë dëshmitarë të rezultateve të prekshme që dalin prej sakrificave të tyre personale dhe pjesëmarrjes në procesin e qeverisjes.

drejtë. Por, për dallim nga regjimet autoritare, në sistemet demokratike ekzistojnë incentiva për të promovuar rezultate të mira dhe të barabarta për të mirën më të mundshme për të gjithë qytetarët. Kur krijohen institucione të fuqishme demokratike dhe kulturë demokratike, historia e tridhjetë viteve të fundit tregon se sistemet përfaqësuese dhe pjesëmarrëse të qeverisë ofrojnë sfida të vërteta për liderët e zgjedhur: menaxhimi më i mirë i konflikteve të brendshme dhe të jashtme, ndihma shoqërisë për të shmangur kriza në ushqim apo katastrofa, dhe ndihma në avokim rreth çështjeve kritike shëndetësore siç janë implikacionet negative për të numër të madh të lindjeve, përfitimi nga ushqimi i foshnjëve me gji, dhe rreziqet nga marrëdhënet e pambrojtura seksuale në kontekst të HIV/AIDS-it<sup>8</sup>.

Argumentet se regjimet autoritative mund të menaxhojnë në mënyrë më efektive resurset publike dhe të marrin vendime të vështira në interesin e njerëzve, nuk janë të përkrahura me ndonjë fakt empirik. Në fakt, ekziston një arsye për të besuar që sistemet përfaqësuese ofrojnë rezultatet më të mira për njerëzit. Siç mund të shihet nga një studim i bërë së voni nga Banka Botërore, me vetëm dy përjashtime, të gjitha vendet më të pasura të botës-ato me të ardhura për kokë banori mbi 20,000\$ USD (Në 2000 pariteti i fuqisë blerëse)-kanë sistemet më demokratike të botës<sup>9</sup>. Përveq kësaj, 42

**Pjesëmarrja dhe përfaqësimi: Determinantat kryesore të një demokracie të suksesshme**  
Demokracia është forma e vetme e regjimit politik, kompatible me respektimin e të pesë kategorive të të drejtave-ekonomike, shoqërore, politike, civile dhe kulturore<sup>9</sup>. Kur pjesëmarrja dhe përfaqësimi arrijnë nivelet

e kënaqshme, sistemet demokratike të qeverisjes kanë gjasa të jenë shumë më efektive sesa sistemet e tyre homologe autoritare në:

(a) menaxhimin e konfliktit dhe stabilitetit

(b) zhvillimin ekonomik dhe shpërndarjen e drejtë të përfitimeve ekonomike

(c) zhvillimin shoqëror për grupe të ndryshme

(d) promovimin e drejtësisë dhe llogaridhënies

(e) shmangien e katastrofave dhe rënieve të befasishme ekonomike

Format e dobëta të qeverisjes që reflektojnë nivele të ulëta të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit shpiejnë në probleme persistente shoqërore siç janë: zhvillimi i pabarabartë, geto me varfëri ekstreme, korrupsion në tërë vendin dhe keqpërdorime të pushtetit. Edhe pse nuk është konstatuar lidhje direkte shkakore në mes të zhvillimit njerëzor dhe demokracisë, varfëria dhe nivelet e ulëta të zhvillimit njerëzor mund të parandalojnë zhvillimin e demokracisë<sup>10</sup>. Në vendet si Kosova, demokracia nuk duhet të shikohet si luks. Përkundrazi, siç është ilustruar në figurën 3.1, qeverisja demokratike në vete ka vlera të zhvillimit njerëzor, për shkak se ka lidhje të forta me liritë politike dhe civile dhe mund të kontribuojë në zhvillimin ekonomik-shoqëror. Për dallim prej regjimit demokratik, regjimet tjera që nuk janë përfaqësuese dhe që dështojnë të pranojnë pjesëmarrje konstruktive nga qytetarët, kanë shumë gjasa të rrëshqasin në rrethin vicioz të jotolerancës, ekstremizmit, mohimit të të drejtave të njeriut, korrupsionit, kriminit dhe trafikimit të drogës dhe të njerëzve.

Pa nivele adekuate të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit domethënës, performansa e përgjithshme e qeverisjes si dhe llogaridhënia nuk do të jenë në nivelin e duhur, duke rrezikuar kështu bllokimin e krijimit të një sistemi demokratik efektiv dhe përgjegjës. Sikurse tregon figura 3.3 mëposhtë, mungesa e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit mund të shpiejnë tek mangësitë në bërjen e politikave dhe legjimitetit të cilat në fund i kontribuojnë dështimit të qeverisjes.

Përfaqësimi dhe pjesëmarrja janë të lidhura ngushtë në qëllimin e përbashkët për të arritur qeverisje të mirë demokratike. Derisa qytetarët të mos përfaqësohen mirë, ka pak gjasa që ata të marrin pjesë në mënyrë konstruktive në proceset demokratike. Këto procese janë përforcuese reciprokisht. Niveli i lartë i pjesëmarrjes e rritë legjitimitetin e institucioneve; grupet sociale pjesëmarrëse njejnë më pak diskriminimin dhe kështu ka më pak gjasa që të transformohen në "grupe armiqësore" jobashkëpunuese.

Në vitet e fundit, koncepti i qeverisjes ka evoluar nga definicioni i ngushtë i përdorur nga Banka Botërore si "mënyrë me të cilën ushtrohet fuqia në menaxhimin e resurseve ekonomike dhe shoqërore të një vendi", në një nocion më të gjërë të qeverisjes pjesëmarrëse dhe përfaqësuese, të adoptuar në RZHNJK 2004. Është e rëndësishme që sistemi i qeverisjes t'i mundësojë qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit privat të shpiejë përpara rritjen ekonomike në bazë të gjërë si dhe zhvillimin shoqëror, si mjete për të rritur mirëqenien njerëzore<sup>11</sup>. Por, poashtu njëjtë edhe për Kosovarët, duhet të avancojë liritë e rëndësishme politike si dhe liritë tjera themelore për të ndihmuar në ruajtjen dhe zgjerimin e progresit shoqëror dhe ekonomik dhe për t'i dhënë secilit hapësirë për të krijuar një shoqëri të mirë ku askush nuk lihet anash.

## Pengesat në pjesëmarrje dhe përfaqësim më të madh në Kosovë

Vitet e kontrollit autoritar dhe perceptioni shoqëruar i sundimit jolegjitim kanë parandaluar Kosovarët të krijojnë sensin e pronësisë së përbashkët dhe të vetëqeverisjes. Për shumë vite, dhe posaçërisht gjatë viteve '90, shqiptarët e Kosovës kanë provuar të shmangin pagesën e tatimeve si mënyrë për të minuar regjimin të cilin e kanë parë si të huaj, autokratik dhe të korruptuar. Kanë pasur shumë pak besim në kërkim të llogarisë së shpenzimeve të parave të tatimpaguesve dhe protestat ishin normë kur perceptioni publik ka arritur limitin e tolerancës. Edhe në ditët e sotme, shumë kosovarë nuk bëjnë automatikisht lidhje në mes të përgjegjësiave themelore qytetare siç është

*Kur ka pasur pak shpresë në përmirësimin e mënyrës së shpenzimit të fondeve publike dhe kur durimi i njerëzve nga mungesa e shërbimeve publike e arrin limitin esaj, Kosovarët bënë atë që dëjnë më së miri ta bëjnë - dolën rrugë për të protestuar*

pagesa e tatimeve dhe konsumimit të shërbimeve publike.

Adoptimi i "zhvillimit pjesëmarrës njerëzor" si princip i rëndësishëm në Kosovë kërkon rindërtimin të asaj se si Kosovarët kuptojnë disa terme themelore. Kur Kosovarët kanë kërkuar "demokraci" në vitin 1989, çka ata në të vërtetë kanë menduar ishte "liria". Demokracia kërkon: (a) dialog ndërmjet grupeve që nuk janë të mësuar të negociojnë me njëri-tjetrin, (b) llogaridhënie, dhe (c) të drejta të minoriteteve. Shumë njerëz thjeshtë nuk e kuptojnë se çka është në pyetje dhe në të vërtetë disa e shikojnë si kërcënim: "Në demokraci flitet shumë dhe bëhet pak." Siç zbulon raporti, Kosovarëve iu duhet të "përqafojnë demokracinë" në mënyrë të duhur, dhe të mos e shikojnë si kërcënim. Duhet të provohet qartë ku qeverisja demokratike pjesëmarrëse dhe përfaqësuese të mund të ofrojë përfitime afatshkurtëra dhe afatgjata për të gjithë qytetarët. Por për të ndodhur ky rast, të gjithë Kosovarët duhet t'i nënshtrohen sundimit të ligjit, të pranojnë një spektër përgjegjësish

dhe të kenë vullnetin për t'u përkushtuar personalisht me kohë, energji dhe para për të siguruar që demokracia në të vërtetë mund të funksionojë për njerëzit dhe e udhëhequr nga njerëzit. Demokracia në këtë kuptim mund të përkufizohet si "përdore ose humbe".

Në rastet kur Kosovarët nuk marrin përsipër detyrat e tyre qytetare, siç janë votimi dhe pagesat e tatimeve, seriozisht rrezikojnë funksionimin e institucioneve demokratike. Derisa elita politike është e papërvajë në menaxhimin e qeverisjes demokratike, perceptimi ndërmjet liderëve politikë dhe votuesve të tyre është një nga sfidat kryesore të demokratizimit. Politikanët Kosovarë poashtu janë nën presion për t'u përgjigjur interesave dhe prioritetëve të komunitetit ndërkombëtar-një situatë e përbërë nga statusi i pazgjidhur politik i Kosovës-që përbën një klas tjetër të tërë të "konstituentëve" që duhet të menaxhohet.

Që nga viti 2002, besimi në liderët e zgjedhur politikë ka rënë vazhdimisht. Për shem-

TABLE 3.3 TRENDS IN SATISFACTION WITH INSTITUTIONS

	UNMIK	SRSQ	Government	Assembly	KFOR	KPS
November 2002	63.8	73.1	74.1	76.7	87.8	90.0
March 2003	51.9	64.1	74.9	71.9	85.5	87.9
July 2003	43.1	71.4	78.1	74.7	81.4	84.5
November 2003	28.4	43.1	68.5	65.3	77.6	85.2
March 2004	24.9	32.4	73.9	64.3	83.0	84.9

**KORNIZA 3.3. NGRITJA DHE RËNIA E VULLNETARIZMIT NË KOSOVË**  
Gjatë viteve 1980, posaçërisht gjatë viteve 1990, ka pasur shumë storie të vetëskrificave të përditshme të individëve anembanë Kosovës. Disa vëzhgues e shohin këtë vullnetarizëm si "ngjitës" që e mbajti bashkë shoqërinë Kosovare.

Studimi i fundit për vullnetarizmin në Kosovë tregon që vullneti i njerëzve për të shkuar më tej për ndihmë për të tjerët në të mirë të komunitetit, ka rënë shumë që nga viti 1990, posaçërisht tek shumica e shqiptarëve kosovarë. Arsytet janë (por nuk limitohen me këto), ndryshimi i kushteve të jetës (politike dhe shoqërore), kuptueshmëri e ulët e vullnetarizmit dhe çmuarje e vogël institucionale e punës vullnetare. Përvoja e kaluar tregon se vullnetarizmi në Kosovë ka qenë më së shumti i dukshëm gjatë kohëve kur zhvillohej betejë për të drejtat dhe liritë themelore.

Vullnetarizmi është shumë më i lartë në komunitetet vullnetare, për shkak të madhësisë së vogël, kohezionit më të lartë shoqëror dhe përfitimeve konkrete nga veprimet e tyre. Njerëzit angazhohen në projekte vullnetare që sjellin përfitime për komunitetet e tyre të vogla. Por njerëzit duket të jenë më pak të gatshëm për të marrur pjesë në aktivitete vullnetare ku përfitimet nuk janë aq të prekshme dhe aq imediate. Sot për të promovuar dhe zgjeruar etikën e vullnetarizmit në Kosovë, nevojiten përpjekje shumë më të mëdha.

Për shumë njerëz, epoka pas vitit 1999 ka hapur mundësi të reja politike, shoqërore dhe ekonomike, dhe u ka dhënë njerëzve pritje për jetë më të mirë. Sidoqoftë, rritja e ngadalshme ekonomike e kombinuar me statusin e paqartë politik të Kosovës ka zvogëluar këto pritje. Kështu, shumë njerëz mendojnë se aktivitetet vullnetare nuk priten të bëhen prej tyre ose nuk priten të jenë përfituese.

Në të vërtetë, vlerësimi institucional dhe shoqëror i akteve vullnetare është në pikë të ulët. Tani njerëzit janë më shumë të brengosur me sigurimin e ushqimit për familjet e tyre e jo për punë vullnetare. Sipas një qytetari nga Gjakova, i intervistuar për këtë studim, "të rinjtë që ballafaqohen me probleme ekonomike duhet të fitojnë për të jetuar, dhe ata kurrë nuk do të mendojnë për aktivitete vullnetare pasi që ata ballafaqohen me vështirësi në përmblidhjen e nevojave të tyre themelore."

Pak individë dhe organizata që marrin pjesë apo që janë udhëheqës në zgjidhjen e sifdave shoqërore, marrin mirënjohje apo përkrahje publike ose institucionale. Posaçërisht në adresimin e tensioneve ndëretnike, ku njerëzit nganjëherë janë të dënuar për shkak se ofrojnë ndihmë në promovimin e pajtimit.

*Burimi: "Vullnetarizmi në Kosovë", Index Kosova, Maj 2004*

### **KORNIZA 3.4. LËVIZJET SHOQËRORE DHE ASPIRATAT KOMBËTARE: PAJTIMI I GJAQEVE**

Në vitet e hershme të periudhës 1990, Anton Çetta, një folklorist dhe etnologjist i pensionuar, pat filluar fushatën e cila u përkrah nga i gjithë spektri politik shqiptar. Lëvizja ishte e drejtuar kah pajtimi i gjaqeve, të cilat ishin prezente me shekuj në Shqipëri e Kosovë. Këto gjaqe e kanë origjinën nga ligji Kanuni i Lekë Dukagjinit, një bujar nga Shqipëria Veriore, i cili ka qeverisur organizimin e marrëdhënieve pronësore, familjare dhe zakoneve. Turpi, lidhja farefisnore, nderi i burrit dhe gruas ishin koncepte të rëndësishme në këtë ligj.

Akademikë e ekspertë të ligjit tradicional kanë vëzhguar se Kanuni ka pasur rol kyç në kohezionin e brendshëm të shqiptarëve kundrejt kërcënimeve të jashtme. Kanuni është ruajtur si gojëdhanë që nga shekulli i pesëmbëdhjetë ndërsa është shkruar nga At Shtjefen Gjeçovi në Shkodër, Shqipëri 1933. Deri atëherë, gjaqet kanë persistuar si rezultat i respektimit të ligjeve të Kanunit.

Për shembull, gjatë erës socialiste, në Kosovë ligji tradicional ekzistonte si mjet për t'i rezistuar regjimit socialist (ngjashëm sikurse disa kisha dhe rrjete tjera joformale që ekzistonin në të gjitha vendet e Europës socialiste lindore). Krime të ndryshme, mosmarrëveshje dhe konflikte janë zgjidhur sipas Kanunit nga këshillat e fshatrave. Kjo dukuri ka ndihmuar që të pengohet efekti i kontrollit të shtetit dhe ligjeve socialiste, posaçërisht për ato efekte që janë parë si përpjekje serbe për të shkatërruar kulturën shqiptare dhe mënyrën e jetesës së tyre. Në të njëjtën kohë, respektimi selektiv i këtij ligji i ka ndihmuar ruajtjes së strukturave patriarkale në jetën publike dhe private.

Lëvizja për pavarësi, e dalë nga suprimimi i autonomisë së Kosovës nga ana e Serbisë në vitin 1991. Dezintegrimi vijues i Jugosllavisë përfshiu rrjete të ndryshme brenda dhe jashtë shtetit, si: këshillet e fshatrave, anëtarët e respektuar të komuniteteve, akademikët të cilët u mobilizuan për të funksionuar si ndërmjetësues në pajtimin e gjaqeve. Për shqiptarët e Kosovës, pajtimi ishte i nevojshëm për ruajtjen e kombit; dhe nderi kombëtar ka nënkuptuar më shumë rëndësi për njerëzit dhe ligjin sesa për familjen. Sido që të jetë, pajtimet nga shumë njerëz shiheshin si përkushtim i shqiptarëve ndaj jo-dhunës dhe respektimit të të drejtave njerëzore të bazuara në principe demokratike. Pajtimi i gjaqeve u identifikua me demokracinë.

Fuqia e veçantë e kësaj lëvizjeje buronte nga respektimi i traditave kulturore. Si lëvizje e dalë nga populli, në mënyrë të drejtpërdrejtë përmeshte nevojat e qytetarëve të rëndomtë dhe i fuqizoi ata për të marrur vendime relevante me jetërat e tyre dhe të familjeve të tyre. Nese pjesëmarrja dhe përfaqësimi janë të lidhura ngushtë me qëllim të arritjes së një qeverisjeje të mirë demokratike, atëherë pajtimet e gjaqeve të viteve 1990 janë model i mirë.

Në vend të identifikimit të armiqëve në vija kombëtare, Kosovarët tani duhet të mobilizohen kolektivisht kundrejt kërcënimeve të reja: varfërisë, korrupsionit dhe pabarazisë. Duke u thirrur në përvojat paraprake në pjesëmarrjen në lëvizje shoqërore joviolente dhe në kritikën përkatëse të praktikave të korrupsionit në qeveri dhe institucione tjera, ekziston një potencial për të mobilizuar njerëzit drejt qëllimeve demokratike.

bull, në të gjitha komunat kosovare (përveq në një), partia udhëheqëse (pa marrur parasysh se cila) ka humbur vota të konsideruara (shiko tabelën 4.2. "Jovotuesit" tani janë partia më e madhe, në Kapitullin 4). Raportet e Paralajmërimit të Hershëm me të madhe theksojnë pakënaqësinë në rritje dhe besueshmërinë e ulët ndaj Kuvendit të Kosovës. Tabela 3.4 tregon rënien e besueshmërisë për 12 pikë të përqindjes në mes të Nëntorit 2002 dhe Marsit 2004 (edhe pse pakënaqësia ndaj punës së disa akterëve ndërkombëtarë ka rënë në mënyrë edhe më dramatike gjatë të së njëjtës periudhë)<sup>12</sup>.

Qarku i ndërtimit të besimit dhe konfidencës nuk mund të krijohet brenda nate. Demokratizimi përmes pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të zgjeruar është proces. Procesi i thellimit dhe zgjerimit të demokracisë në Kosovë është i komplikuar nga shumë faktorë. Ndër faktorët më sfidues është: fuqia punëtore me aftësi të ulët; mungesa e traditës në vetëqeverisje dhe demokracia, papunësia e lartë që shkon në 40% të popullsisë së rritur, arsimiti joadekuat i tejkaluar kundrejt kërkesës për aftësi të reja dhe perceptonin për korrupsion të gjërë dhe krim të organizuar.

Derisa rritja e organizatave qytetare ka qenë impresionuese në vitet e fundit, shpirti i njëjtë i vullnetarizmit dhe vetësakrificës që ka mbajtur shoqërinë kosovare në vitet e '90-ta ka rënë (shiko Kornizën 3.3) Kosovarët poashtu duhet të harmonizojnë format tradicionale të pjesëmarrjes me normat e demokracisë moderne (shiko Kornizën 3.4: Lëvizjet shoqërore dhe aspiratat kombëtare: Pajtimi i Gjaqeve). Siç tregon RZHNJK 2004, qytetarët urbanë/ruralë të etnive dhe gjinive të ndryshme nuk kanë nivelin e njëjtë të zhvillimit njerëzor dhe nuk kanë pritjet e njëjta për qeverisje demokratike.

Në të njëjtën kohë, elita e re udhëheqëse e Kosovës ka përgjegjësitë e qeverisjes me ide të freskëta dhe vullnet për të shqyrtuar praktikën e mira të qeverisjes demokratike nga vendet e ndryshme të botës. Qasja e hapur ndaj këshillave të reja dhe relevante, nga brenda dhe jashtë regjionit është karakteristike definuese e qeverive të suksesshme në këtë epokë të ndërvarshmërisë globale.

Sistemi i mëparshëm jugosllav i qeverisjes ka qenë i bazuar në udhëheqje të fuqishme të njerëzve dhe tregut. Politikanët kosovarë ishin të përjashtuar në masë të madhe nga


ai sistem. Në sistem kapitalist, derisa tregjet si bazë e qeverisjes dominojnë, njerëzit mbesin aktiv në rolin e tyre. Njerëzit duhet të udhëheqin shtetin dhe tregun, të cilët duhet të punojnë në tandem, me njerëz të mjaftueshëm për të ushtruar influencë sa më efektive në të dyja palët<sup>13</sup>. Si dhënës primar i fuqive në Kosovës sot, Administrata e Përkohshme e OKB-së në Kosovë (UNMIK) poashtu duhet të ketë përgjegjësi primare në promovimin e qasjeve më pjesëmarrëse dhe përfaqësuese të qeverisjes në Kosovë.

## Forcimi i vetëqeverisjes demokratike në Kosovë

Që nga kalimi i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB dhe krijimit të UNMIK-ut në Qershor 1999, është bërë shumë progres drejt ndërtimit të themeleve për një proces afatgjatë të ndërtimit të demokracisë në Kosovë. Në Maj të vitit 2001, është aprovuar Korniza Kushtetuese e Kosovës, e

përpiluar nga ekspertët ndërkombëtarë dhe vendorë. Qëllimi kryesor i Kornizës Kushtetuese ka qenë krijimi i Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) në Kosovë nëpërmes të zgjedhjeve të lira dhe të drejta. Si rrjedhojë, në Nëntor të vitit 2001 janë mbajtur zgjedhjet parlamentare, për parlamentin e përbërë nga 120 ulëse. Këto zgjedhje janë përcjellur nga zgjedhja e Presidentit të Kosovës (Ibrahim Rugova) nga anëtarët e parlamentit, i cili president përfaqëson unitetin e popullit të Kosovës dhe garanton funksionimin demokratik të IPVQ-së. Përgjegjësia kryesore e Presidentit herët në vitin 2002 ishte emërimi i Kryeministrit (Bajram Rexhepi), i cili si rrjedhojë ka siguruar aprovimin nga Parlamenti për emërimin e tetë anëtarëve të kabinetit (ministrave). Për më tepër, që nga krijimi i tij Parlamenti ka luajtur një rol të rëndësishëm në shqyrtimin dhe aprovimin e kandidatëve, të caktuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB, që të shër-

FIGURA 3.4: STRUKTURA E SISTEMIT QEVERISËS NË KOSOVË 2004



bejnë si gjykatës dhe prokurorë në sistemin juridik. Ju lutemi ti referoheni figurës 3.4. për skemën e plotë të strukturës së IPVQ-së. Këto hapa të rëndësishëm, si dhe zgjedhjet komunale të vitit 2000 dhe 2002, kanë qenë momente definuese në zgjerimin e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes në proceset formale politike të Kosovës. Me kohë pritet rritja e transferit të autoritetit qeverisës nga UNMIK-u tek Kosovarët. Disa nga

tucion të Kosovës, ku është e vendosur korniza për funksionimin e ekonomisë së tregut dhe ku Trupat Mbrojtëse të Kosovës operojnë në mënyrë strike brenda mandatit të tyre ...<sup>141</sup>. Dokumenti "Standardet për Kosovën" është publikuar në Prishtinë me 10 Dhjetor 2003 dhe menjëherë është përkrahur nga Këshilli i Sigurimit të KB- me deklaratën e tij të 12 Dhjetorit (Shiko Kornizën 3.5).

### **KORNIZA 3.5. STANDARDET PËR KOSOVËS: ÇKA DO TË DUHET PËR IMPLEMENTIMIN E TYRE?**

Politika "Standardet për Kosovën" ka për qëllim të bëjë një "Kosovë ku të gjithë-pa marrur parasysh përkatësinë etnike, racën apo religjionin - të jenë të lirë të jetojnë, punojnë dhe udhëtojnë pa frikë, dhunë apo rrezik dhe ku ka tolerancë, drejtësi dhe paqe për të gjithë." Kjo politikë përbëhet prej tetë standardeve:

1. Funksionimi i Institucioneve Demokratike; 2. Sundimi i ligjit; 3. Liria e Lëvizjes; 4. Kthimi i qëndrueshëm dhe të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre; 5. Ekonomia; 6. Të drejtat pronësore; 7. Dialogu; dhe 8. Trupat Mbrojtëse të Kosovës

Në planin për implementimin e standardeve për Kosovës është definuar një seri standardesh për secilën nga tetë pikat e standardeve. Për

1. funksionimin e institucioneve demokratike këto standarde përfshijnë:

- Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) të jenë të zgjedhura lirshëm, drejtë dhe në mënyrë demokratike.
- IPVQ të qeverisë në mënyrë objektive, transparente dhe llogaridhënese, në përputhje me Rezolutën e KS OKB 1244 dhe Kornizën Kushtetuese.
- Interesat dhe nevojat e të gjitha komuniteteve kosovare janë të përfaqësuara në të gjitha degët dhe institucionet e qeverisë dhe ato komunitete marrin pjesë në qeverisje
- Ligjet dhe funksionet e IPVQ-së t'i qaset standardeve europiane.
- IPVQ duhet të ofrojë shërbime për të gjithë popullin e Kosovës në të gjithë territorin e saj, dhe strukturat paralele duhet të shpërbëhen.

*Burimi: IPVQ-UNMIK, "Plani për implementimin e standardeve të Kosovës", (31 Mars 2004).*

përgjegjësitë tanimë janë transferuar dhe ato janë: financat, arsimit, shëndetësia, ambienti, kultura, bujqësia dhe shërbimet publike. Kompetencat dhe përgjegjësitë tjera mbeten funksione të rezervuara të PSSP (siç shihet në figurën 3.4) edhe pse janë krijuar "zyrat ndërlidhëse" brenda IPVQ-së

Në implementimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB, në vitin 2002, ish-PSSP-ja Michael Steiner pat përpiluar një seri standardesh për të përgatitur shoqërinë dhe institucionet kosovare përpara fillimit të diskutimeve për statusin e Kosovës. E njohur si "Standardet për Kosovën", kjo kornizë politike përshkruan Kosovën si vend ku "institucionet publike janë të përfaqësuara dhe demokratike, ku sundimi i ligjit është efektiv, i respektuar dhe me qasje për të gjithë, ku ata njerëz të zhvendosur brenda vendit të cilët dëshirojnë, janë të lirë dhe në gjendje të kthehen në Kosovë pa asnjë pengesë, sulme apo kërcënime, ku të gjithë individët pa marrur parasysh etnicitetin e tyre, mund të udhëtojnë dhe punëojnë të sigurtë dhe mund të përdorin gjuhën e tyre (dhe se përdorimi i saj është kudo i respektuar) në cilindo insti-

Masat e aprovuara nga IPVQ, UNMIK-u dhe institucionet tjera partnere në arritjen e standardeve janë themelore për realizimin e plotë të një Kosove të drejtë dhe demokratike. Posaçërisht, siç është thënë në Planin për Implementimin e Standardeve të Kosovës, të finalizuar me 31 Mars 2004, "është esenciale që institucionet e Kosovës, duke përfshirë institucionet e qeverisë, parlamentin dhe organet e niveleve komunale të shënojnë progres më të mirë në lejimin e pjesëmarrjes së plotë të të gjitha komuniteteve dhe në përpilimin dhe implementimin e politikave të cilat në mënyrë të plotë mbrojnë të drejtat e njeriut dhe reflektojnë nevojat e të gjitha komuniteteve<sup>151</sup>". Dokumenti "Standardet për Kosovën" ofron një seri pikash udhërrëfyese të lidhura dhe të afatizuara, për realizimin e këtij vizioni për të mirën e të gjithë Kosovarëve.

### *Shoqëria Civile dhe OJQ-të: zemra e pjesëmarrjes qytetare*

Zhvillimi i një shoqërie të qëndrueshme civile është shtyllë kryesore e zhvillimit demokratik të Kosovës. Që nga viti 1999, Bashkimi Evropian (UE), agjencitë e jashtme

*It is a vibrant civil society that will serve as the strongest driving force toward the generation of creative proposals to deepen democracy in Kosovo*

për zhvillim dhe fondacionet private kanë investuar dhjetëra milionë Euro në organizatat joqeveritare të Kosovës. Numri i OJQ në Kosovë ka proliferuar me një shpejtësi dramatike duke iu falënderuar përkrahjes së jashtme financiare dhe lirive të posazbuluara. Që nga viti 1999, janë krijuar rreth 2,300 OJQ lokale. Derisa shumica e tyre gjenden me seli në Prishtinë, të tjerat janë të shpërndara gjeografikisht në të gjithë Kosovën, me spektër shumë të gjërë aktivitetesh.

Shoqëria civile apo organizatat jo-qeveritare shpesh definojnë si: "...organizata që kontribuojnë në arritjen e disa qëllimeve të dobishme për shoqërinë, por nuk marrin profit në të mirë të ndonjë individi"<sup>16</sup>...". Ekziston një numër shumë i vogël i OJQ-ve të organizuara përreth minoriteteve apo të udhëhequra nga ato. Për dallim nga partitë politike, OJQ-të ballafaqohen me më pak pengesa në udhëheqjen e projekteve të përbashkëta dhe në krijimin e koalicioneve ndëretnike. Posaçërisht rinia është duke udhëhequr në adresimin e probleme kryesore shoqërore (Korniza 3.6). Organizatat dhe lëvizjet e grave, si vendore poashtu edhe ndërkombëtare, poashtu gjenerojnë disa nga liderët më të dukshëm të zhvillimit në Kosovë, në përgjigje të drejtpërdrejtë ndaj nevojave të femrave kosovare. Përkrahja ndërkombëtare financiare dhe akumulimi i njohurive vendore dhe ndërkombëtare janë duke ndihmuar punën e OJQ-ve dhe duke përmirësuar dramatikisht rezultatet e tyre.

Forca kryesore shtytëse në zhvillimin e sektorit të OJQ-ve ka qenë disponueshmëria e fondeve nga donatorët. Si rrjedhojë, shumica e OJQ-ve tentojnë të jenë të orientuara nga shërbimet, nga organizimet në afate të shkurtëra, nga projektet e financuara nga donatorët dhe të jenë pa përbërje të fortë. Për më tepër, shumica e tyre janë të përkohshme dhe kanë tendencën e shkrirjes apo të inaktivitetit pasi që të shpenzohen paratë e donatorëve. Një numër i vogël OJQ-sh kanë tentuar që vazhdimisht të formësojnë politika në interesin e këshillave të caktuara, qofshin ato femra, minoritete, invalidë apo grupe tjera marginale. Derisa Kosova është dëshmitare e një "bumi" në shoqërinë civile, varshmëria nga donatorët hedh dyshim në qëndrueshmërinë e nivelet të tanishme të angazhimit civil. Sidoqoftë, është shoqëria civile vibrante e cila do të shërbejë si forca më e madhe shtytëse drejt gjenerimit të propozimeve kreative për thellimin e demokracisë në Kosovë. Derisa Kapitulli 6 pranon se agjenda e grupeve të shoqërisë civile në Kosovë është mjaft e gjërë, rekomandon vëmendje immediate në tri fusha dhe çështje të: promovimit të barazisë gjinore në punë dhe shtëpi, përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike dhe në ndihmën për problemet psikosociale. Në të njëjtën kohë, struktura dhe statusi politik i Kosovës kanë ofruar vetëm disa incentiva për OJQ-të që në mënyrë direkte të formësojnë politika të caktuara. Me çështjet më të ndieshme politike dhe ato të sigurisë merret UNMIK-u dhe KFOR-i. IPVQ-së i mbetet të krijojë kanale të

### **KORNIZA 3.6. RINIA E KOSOVËS: LIDERËT E ZHVILLIMIT DHE INTEGRIMIT SHOQËROR**

Me një popullsi ku gjysma e saj është nën moshën 25 vjeçare, Kosova ka popullsinë më të re në Europë. Një raport i kohëve të fundit nga Rrjeti Rinor i Kosovës sheh të rinjtë si "anëtarë aktiv dhe kompetent të komuniteteve të tyre, të cilët kanë kapacitet për të bërë kontribute pozitive për shoqërinë." Ky raport thekson rolin e rëndësishëm që e luan rinia në inkurajimin dhe lehtësimin e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në të gjitha nivelet e vendim-marrjes.

Aktualisht, rreth 102 organizata rinore dhe OJQ janë regjistruar dhe punojnë në Kosovë, shumica e tyre në rajone urbane. Nese zvogëlohet financimi nga donatorët dhe qeveria, ardhmëria e shumicës së organizatave do të jetë në rrezik. Për shembull, buxheti i Departamentit të Rinisë pranë IPVQ-së ka zbrit-

ur prej 0.39 milionë Euro në 2002 në 0.24 milionë Euro në vitin 2003, bizneseve nuk iu jepen incentiva tatimore për të dhënë donacione për OJQ-të, derisa taksat për anëtarësim dhe aktivitete të gjenerimit të të ardhurave vetëm sa i rrisin këto shuma të limituara.

Edhe pse mungesa e kapaciteteve vazhdon të jetë çështje, Organizatat Rinore kanë shumë nevojë për t'u ndihmuar në adresimin e disa prej problemeve të shumta me të cilat ballafaqohet Kosova, duke përfshirë papunësinë, kualitetin e arsimit dhe keqpërdorimin e drogës. Ambienti politik nuk është aq i favorshëm për pjesëmarrjen apo zhvillimin e të rinjve. Ambienti shoqëro-kulturor nuk është i favorshëm në marrjen me seriozitet të problemeve të veçanta të rinisë, apo në konsiderimin e rinisë si akterë më influencë.

*Burimi: Hulumtim për rininë, Rrjeti Rinor i Kosovës, 2003*



mjaftueshme formale dhe joformale nëpërmes të cilave grupe civile të mund të kanalizojnë brengat e tyre dhe të japin këshilla në këto çështje. Shumica e Kosovarëve i shikojnë OJQ-të si organizata që nuk shërbejnë më funksionit përfaqësues në çështje të caktuara, pasi që përfaqësimi politik përgjithësisht kuptohet si funksion i partive politike, derisa OJQ-të shihen si domen i segmenteve të caktuara shoqërore. Funksionimi në formë asocionesh përmes organizatave formale jo-partiake është më pak i zhvilluar, edhe pse janë krijuar një numër gurbesh, duke përfshirë: koalicionin e familjeve të personave të zhdukur, organizatat e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), grupet e pensionistëve dhe sindikatat që përfaqësojnë segmente më të gjëra të popullsisë së Kosovës.

Demokratizimi në Kosovë duhet të vazhdojë, në qendër të ketë nevojën për të zhvilluar shoqëri të begatshme civile. Nese shoqëria civile vazhdon të konsiderohet si prerekuizitë për tranzicionin e Kosovës në demokraci, atëherë statusi i OJQ-ve, femrat dhe rinia duhet të përdoren si indikatorë për matjen e progresit të Kosovës. Politika "Standardet para Statusit" është kyçe në këtë proces, në atë se i ravijëzon hapat që shoqëria dhe institucionet kosovare duhet t'i ndërmarrin në rrugën e tyre drejtë stabilitetit, prosperitetit dhe integritetit Euro-pian.

### *Struktura e pjesës së mbetur të RZHNJK 2004*

Në temën kryesore të RZHNJK 2004 janë analizuar trendet dhe përvojat e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në Kosovë, në bazë të të cilave ofrohen propozime me qëllim të forcimit të procesit të ndërtimit të paqes dhe institucioneve demokratike. Në thelbin e vet, ky report tenton të kërkojë përgjigje në pyetjet vijuese:

- A marrin pjesë plotësisht qytetarët në qeverisjen demokratike dhe a ndihmojnë në formësimin e saj?
- A mendojnë qytetarët se pikëpamjet dhe interesat e tyre janë të përfaqëuara plotësisht në vendimet që ndikojnë në ta si individë dhe si anëtarë të komuniteteve të veçanta?
- A janë të përmbushura nevojat e të vërfërve dhe të marginalizuarve në këtë sistem të qeverisjes?

- A janë femrat partnerë të barabartë me meshkujt?
- A janë të garantuara të drejtat e njeriut për secilin njeri?
- A merren parasysh nevojat e rinisë dhe gjeneratave të ardhshme në politikat aktuale?
- Shkurtazi, si mund të mbajnë shpresë kosovarët dhe si mund të kërkojnë pjesëmarrje më të madhe në qeverisjen e tyre të ardhme duke marrë parasysh çështjen e ndjeshme të statusit të pazgjidhur politik të Kosovës?

Zgjedhjet e ardhshme në Tetov ofrojnë një mundësi për Kosovarët që të marrin pjesë formalisht në procesin demokratik. Reformat elektorale mund të inkurajojnë debate të informuara dhe domethënëse mbi problemet me të cilat ballafaqohet Kosova dhe të ndihmojnë që të kalohet përtej personaliteteve dhe retorikës emocionale. RZHNJK 2004 tenton të ndez debat dhe reforma të tilla që do të zgjasnin shumë kohë pas zgjedhjeve.

Ekziston hapësirë e konsiderueshme për kosovarët për të inkurajuar dhe forcuar përkushtimin për institucione dhe praktika demokratike tek të gjithë qytetarët. Nëse Kosovarët njihen si pjesë e rëndësishme e sistemit të qeverisjes demokratike, ata do të marrin më shumë përgjegjësi për të dhe do të përpiqen t'a përmirëojnë atë. Shumë akterë brenda dhe jashtë qeverisë, përfshirë këtu liderët politikë, mësuesit, gazetarët, shoqërinë civile dhe biznesmenët, të gjithë mund të japin kontribut të rëndësishëm në procesin e zgjerimit të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit, në forma të ndryshme dhe në mbarë Kosovën. Derisa bashkësia ndërkombëtare, e udhëhequr nga UNMIK-u, poashtu ka rol të rëndësishëm në lehtësimin e procesit, demokratizimi duhet të rritet organikisht nga brendësia. Nëse të gjitha këto figura mund të plotësojnë efektivisht kontributet e tyre në qeverisjen e ardhme të Kosovës, atëherë do të krijohet një etikë e re civile në të cilën individët do të përqafonin dhe mbronin të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre për të përmbushur kësh-tu nevojat dhe aspiratat e të gjithë qytetarëve. Kuptueshmëria dhe përkushtimi i thellë në avancimin e principeve kryesore demokratike të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit ngjashëm gjatë viteve të ardhme do të krijojë kulturën e tolerancës, fuqizimit dhe drejtësisë.

*If Kosovans are acknowledged as an important part of their system of democratic governance, they will take greater responsibility for it, and strive to improve it*



# QEVERISJA: SA ËSHTË LARG NGA NJERËZIT?

"Kosova është në rrugë të mirë të ndërtimit të një demokracie aktive dhe moderne...",  
Ibrahim Rugova, President i Kosovës

## Hyrje

Siç është diskutuar në Kapitullin e Tretë, krijimi i strukturave demokratike të qeverisë dhe vendim-marrjes përfaqësuese dhe të hapura ndaj pjesëmarrjes qytetare, janë esenciale për zhvillimin njerëzor. Sikurse që zhvillimi njerëzor kuptohet si rritje e mundësive për njerëzit, demokracia ka për qëllim t'iu ofrojë mundësi qytetarëve të zgjedhin liderët e tyre dhe çështjet të cilat vëhen si prioritet nga qeveria e tyre.

Që nga viti 1999, strukturat demokratike në Kosovë janë krijuar në pajtueshmëri me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe sipas Kornizës së përkohshme Kushtetuese. Aktualisht, Kuvendet Komunale, të zgjedhura nga zgjedhjet e dyta komunale të mbajtura në pjesën e dytë të vitit 2002, janë duke punuar në 30 Komuna. Në vitin 2002, Parlamenti i Kosovës (i zgjedhur në fund të vitit 2001) krahas Zyrës së Presidentit, kanë krijuar qeverinë e koalicionit<sup>1</sup>.

Duke marrë parasysh sfidat komplekse me të cilat ballafaqohet ky model i ri qeverisjes, institucionet dhe praktikat demokratike janë duke zënë vend ngadalë. Sfidat përfshijnë ritmin e ngadalshëm të progresit në adresimin e brengave që ushtrojnë presion si: papunësia, varfëria, refugjatët dhe kthimi i personave të zhvendosur dhe rendi i ligjit<sup>2</sup>. Treguesit që demonstrojnë nivelin e çkyqjes në mes të proceseve vendim-marrëse dhe popullit të Kosovës përfshijnë:

- *Trendi i rënies së votuesve në tri zgjedhjet e fundit (79% në 2000, 64% në 2001 dhe 54% në 2002)*<sup>3</sup> (Shiko Figurën 4.1).

- *Rënja e satisfaksionit me trendet politike dhe ekonomike*<sup>4</sup>.


- *Përqindja e vogël e njerëzve që mendojnë se mund të ndikojnë në proceset vendim-marrëse në komunën e tyre (13%) dhe në nivel të Kosovës (12%).*

- *Rënja e satisfaksionit ndaj strukturave kryesore qeveritare (Parlamentit, Partive Politike, UNMIK-ut, PSSP-së, etj)*<sup>5</sup>.

- *Ngjarjet e dhunshme të 17-19 Marsit.*

Ky kapitull analizon nivelin e hapjes së strukturave qeveritare ndaj pjesëmarrjes së të

FIGURA 4.1 TRENDET VOTUESE NË ZGJEDHJET E VITIT 2000, 2001 DHE 2002



Burimi: Misioni i OSBE-së në Kosovë, <http://www.osce.org/kosovo/elections/>

gjithë Kosovarëve në vendim-marrje si dhe pjesëmarrjen adekuate në kuptim të përfaqësimit të të gjitha segmenteve të shoqërisë. Pasi që mungesa e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit janë faktorët kontribues të problemeve të përmendura më herët, RZH-NJK 2003 arsyeton se procesi i demokratizimit do të mund të avancohej përmes përmirësimit të kualitetit dhe kuantitetit të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të shoqërisë. Analiza aktuale, për rrjedhojë, do të fokusohet në fushat të cilat më së shumti ndikojnë në procesin e demokratizimit. Marrëdhënia në mes të pjesëmarrjes, përfaqësimit dhe zhvillimit njerëzor hulumtohet duke eksaminuar sistemin elektoral, partitë politike, vendim-marrjen qendrore, sektorin e drejtësisë dhe sigurisë në Kosovë. Disa nga sfidat kryesore institucionale në qeverisjen demokratike të Kosovës, të ilustruara nga kjo analizë, janë adresuar me propozime kreative për reforma politike dhe institucionale në Kapitullin e Gjashtë.

Në analizimin e çështjeve shoqërore, është e vështirë të ilustronhet parimi "pa ekzagjeruar shumë çështje dhe pa anashkaluar në shumë çështje" në analizën të përgjithshme<sup>6</sup>. Kjo është posaçërisht e vërtetë kur të merret parasysh situata komplekse shoqërore, ekonomike dhe politike e Kosovës. Në pesë vitet e fundit, Kosova ka pasur shumë tranzicione të llojeve të ndryshme: nga komunizmi në demokraci liberale, nga konflikti ndëretnik në tolerancë multietnike, nga ekonomia socialiste në ekonomi të tregut të lirë dhe (gjatë dy viteve të fundit) nga rindërtimi i fazës emergjente në zhvillim. Në dritën e të gjitha këtyre tranzicioneve, është e pamundur të analizohet ndonjë fenomen i veçantë social e të mos thjeshetohet pasqyra e përgjithshme sociale.

"Një nga definicionet e fundit të demokracisë, nga juristi eminent ndërkombëtar, e përshkruan atë si proces të pjesëmarrjes dhe konsultimit të vetë qytetarëve në vendim-marrje. Ndoshta kjo formulë demokratike është e lehtë të aplikohet në të ashtuquajturën "demokraci interne", por si do të mund të aplikohet në "demokracitë e kontrolluara ndërkombëtarisht", pas situatave post-konfliktuale? Si mund të ushtrohen parimet demokratike nën kushtet e bashkëqeverisjes asimetrike, nga dy autoritete të ndryshme me legjitimitet dhe fuqi të ndryshme? Si mund të aplikohet llogaridhënia ndaj autoriteteve ndërkombëtare, dhe kujt i japin llogari ata? Së fundi, si mund të shfrytëzohet më së miri faktori njerëzor në tranzicionin aktual të Kosovës?" **Profesor Blerim Reka, Konsultimi i RZHNJK në Kosovë, Dhjetor 2003**

## Sistemet zgjedhore dhe zhvillimi njerëzor

Pjesë integrale e konceptit të "zhvillimi nga njerëzit" është e drejta për të përcaktuar udhëheqësinë e një komuniteti. Në sistem demokratik, mënyra themelore për të ushtruar këtë të drejtë është votimi i përfaqësuesit i cili do të mbrojë dhe shtyjë përpara interesat e komunitetit të vet. Prandaj, zgjedhjet janë në qendër të marrëdhënies reciproke sforcuese ndërmjet pjesëmarrjes dhe përfaqësimit; në të vërtetë, sistemi elektoral definon këtë marrëdhënie.

Edhe pse sistemet elektorale nuk duhet të jenë të njëjta në të gjitha demokracitë, ato duhet të jenë të përshtatshme për një shoqëri të caktuar; përndryshe, ato mund t'a dëmtojnë demokrazimin dhe, si pasojë, edhe zhvillimin njerëzor.

Ky seksion ekzaminon sistemin elektoral në Kosovë dhe vlerëson ndikimin e këtij sistemi, nëse forcon apo pengon zhvillimin njerëzor. Ekzistojnë tri kritere për të gjetur masën se sa sistemi aktual i Kosovës iu jep qytetarëve zë të mjaftueshëm në vendim-marrje dhe këto janë:

- Niveli se sa organet e zgjedhura pasqyrojnë shoqërinë;
- Llogaridhënia; dhe,
- Stabiliteti.

Nese këto kritere nuk përmbushen, sistemi do të jetë i mbuluar nga një rreth vicioz ku qytetarët do të humbin besimin ndaj përfaqësuesve të tyre, shkalla e pjesëmarrjes do të bie dhe strukturat qeveritare do të neglizhohen nevojat e njerëzve dhe do të humbin legjitimitetin e tyre.

## Sistemi elektoral në Kosovë

Sistemi aktual elektoral në Kosovë është një nga llojet e përfaqësimit proporcional (PP) sipas listës së partisë. Kjo do të thotë se në këtë sistem Kosova konsiderohet si një distrikt elektoral për zgjedhjet e Parlamentit Qendror me ulëse të alokuara proporcionalisht. Për të kalkuluar transferin e votave në ulëse të parlamentit, përdoret formula e Saint-Lague-s<sup>7</sup>. Parlamenti i Kosovës në total ka 120 ulëse, me 20 prej tyre të rezervuara për komunitetet etnike joshqiptare. Këto ulëse janë të caktuara sipas mënyrës në vijim: 10 për komunitetin serb, 4 për komunitetin RAE, 3 për komunitetin boshnjak, 2 për komunitetin turk dhe një për komunitetin goran. Këto ulëse janë shtesë e çfarëdo ulëseje shtesë të fituar nga komuniteti, ulëse këto të fituara nga 100 vendet tjera, të përcaktuara nga votat e të gjithë votuesve. Lista e kandidatëve është e mbyllur, që do të thotë se votuesi zgjedh partinë politike e jo kandidatin individual. Partitë renditin kandidatët në listë për të përcaktuar kështu se cilët përfaqësues do të fitojnë ulëset e fituara. Ky sistem poashtu obligon që femrat të përbëjnë një të tretën e listës së kandidatëve për çdo parti, apo që çdo i treti kandidat të jetë femër<sup>8</sup>. Në parlament nuk ekziston asnjë prag (përqindje minimale) për përfaqësim nga cilido entitet politik<sup>9</sup>.

Në shoqëritë post-konfliktuale, sistemet elektorale të përfaqësimit proporcional janë mjaftë të shpeshta. (Ali dhe Mathews, 1999; Lake dhe Tothchild, 1996). Ky trend është informuar nga një numër i dukshëm i literaturës për formimin e institucioneve politike për të menaxhuar marrëdhëniet ndërgrupore në shoqëri të tilla<sup>10</sup>. Sistemi elektoral i Kosovës është dizajnuar në premisën që përfaqësimi proporcional iu jep minoriteteve shans më të madh që të zgjedhen në legjislacion, së këndejmi duke i bërë qytetarët individual të ndjehen më sigurtë pasi që zërat e tyre do të përfaqësohen në nivel kombëtar.

## *Pika deri në të cilën organet e zgjedhura pasqyrojnë shoqërinë*

Pika deri në të cilën organet e zgjedhura pasqyrojnë diversitetin e shoqërisë në kuptim gjeografik, gjinor, etnik, religjioz dhe të statusit social mund të rrisin perceptcionet e legjitimitetit. Nëse një organ i zgjedhur me të vërtetë reflekton elektoratin, do të ketë më shumë gjasa që të zhvillohet një sens më i madh i pronësisë dhe përkrahjes ndaj institucioneve qeverisëse. Me legjitimitet dhe besim të rritur, njerëzit inkurajohen më shumë për të punuar brenda sistemit për të adresuar pakënaqësitë e tyre, për të mbajtur konfliktin në nivel të menaxhueshëm dhe për të parandaluar eskalimin e mundshëm të dhunës.

Sistemi i përfaqësimit proporcional me lista të mbyllura në Kosovë, në mënyrë efektive mundëson proporcionalitet të plotë, përmes të cilit të gjitha komuniteteve i'u sigurohet përfaqësim në parlament. Ky sistem kontribuon në rritjen e përfaqësimit gjinor, pasi që rregulla e kuotës mund të aplikohet lehtë duke mos shkaktuar marrëdhënie kontraverze brenda partive. Prandaj, PP me lista të mbyllura, është një nga sistemet më të mira për të arritur qëllimin (në kuptimin kuantitativ) të përfaqësimit. Sidoqoftë, sfida për të influencuar agjendat e ndieshme për minoritetet dhe gjinitë kanë të bëjnë më shumë me kualitetin sesa me kuantitetin e përfaqësuesve. Për shembull, derisa Kosova renditet e 17-ta në botë në kuptim të përfaqësimit gjinor, aftësia e deputeteve për të sjellur çështjet gjinore në krye të agjendës politike, mbetet e limituar. Ngjashëm, garancioni i përfaqësimit kuantitativ nuk ka qenë i mjaftueshëm për të bindur komunitetin serb për të marrur pjesë plotësisht në institucionet e qeverisë kosovare.

Duke trajtuar Kosovën si një distrikt të vetëm elektoral me proporcionalitet të plotë për komunitetet etnike, ky sistem aktual është në kundërshtim me parimin e përfaqësimit gjeografik. Përkatësia partiake dhe etnike nuk janë përcaktuesit kryesor të interesave të qytetarëve. Përfaqësimi gjeografik shpesh është i dukshëm, posaçërisht në shoqëri siç është Kosova, e cila është e bazuar në mbijetesë nga bujqësia dhe lidhjet familjare. Ofrimi i për-

faqësimit gjeografik shpërndan proporcionalisht fuqinë nga kryeqyteti në të gjitha rajonet e territorit dhe krijon sensin e inkluzivitetit (përfshirjes) pa marrë parasysh faktin se sa të izoluar fizikisht të jenë disa komunitete të caktuara. Për më tepër, përfaqësimi gjeografik rrit gjasat që interesat specifike regjionale të kanalizohen dhe të adresohen në Parlamentin Qendror.

Sistemi aktual disproporcionalisht favorizon kandidatët nga Prishtina, derisa një numër komunash nuk përfaqësohen aspak, për shkak se kandidatët nga ato komuna nuk janë renditur lart sa duhet në listat e partive të tyre. Për shembull, komuna e Vitisë, e cila në zgjedhjet e fundit LDK-së i ka japur mbi dhjetë mijë vota, nuk ka asnjë përfaqësues i cili kupton dhe mundohet të adresojë nevojat themelore të tyre në kuptim të papunësisë dhe varfërisë, e cila në këtë komunë shënon kuotën prej 52% përkatësisht 40%<sup>11</sup>. Kjo ka implikime të dukshme në llogaridhënie. Derisa është e pamundur që nëpërmes të një sistemi elektoral të arrihet përfaqësim i plotë gjeografik, i komuniteteve dhe gjinive; bilanci, sidoqoftë, është i dëshirueshëm. Në Kosovë, ky sistem në masë të madhe vlerësohet me anë të proporcionalitetit etnik dhe gjinor në dëm të përfaqësimit gjeografik

## *Llogaridhënia*

Sistemi elektoral funksionon si mekanizëm me anë të cilit njerëzit mund të kërkojnë llogari nga përfaqësuesit e tyre. Votimi është një nga mënyrat më të qarta që njerëzit të mund të adresojnë sukseset apo dështimet e qeverisë së tyre. Vendosija e një lidhjeje direkte në mes të elektorateve dhe përfaqësuesve të tyre, i detyron politikanët të kuptojnë nevojat e votuesve të tyre dhe i detyron të përpilojnë platforma politike për të adresuar ato nevoja. Nëse sistemi nuk fuqizon një lidhje të tillë, atëherë nga politikanët nuk do të ketë incentivë që të japin llogari për veprimet e tyre.

Pasi që në Kosovë lista partiake është e mbyllur, votuesit janë të kufizuar në zgjedhje të kandidatëve të partive politike dhe nuk kanë mundësi të vlerësojnë meritat individuale të kandidatëve individualë. Ky faktor zvoglon lidhjen e llogaridhënies në mes të përfaqësuesve të zgjedhur dhe qytetarëve.

*Derisa është e pamundur që nëpërmes të një sistemi elektoral të arrihet përfaqësim i plotë gjeografik, i komuniteteve dhe gjinive; bilanci, sidoqoftë, është i dëshirueshëm*

*Zgjedhja për të mos votuar është tregues i fuqisë në besimit të shoqërisë ndaj partive politike dhe kandidatëve të tyre. Numri i jvotuesve në Kosovë është rritur në mënyrë të vazhdueshme. Në vitin 2002, numri i kosovarëve që nuk votuan ishte dy herë më i madh se numri i atyre që votuan për partinë e mazhorancës.*

Politikanët kanë shtytje më të madhe që të rrisin profilin e tyre brenda partisë dhe të marrin poste më të larta në listën partiake, e jo të adresojnë kërkesat e votuesve të tyre. Politikanët janë të preokupuar me politikën brendapartiake dhe me fitimin e favorit nga udhëheqësi i partisë, për shkak se ky është përcaktuesi kryesor i zgjedhjes për në Parlament. Në Kosovë, kjo praktikë ka edhe më tepër gjasa të ndodhë, ku partitë politike kanë origjinën e tyre në betejën për pavarësi dhe njerëzit u ofrojnë përkrahje këtyre partive duke u bazuar në përkushtimin e tyre gjatë kësaj beteje. Sistemi i listave të mbyllura poashtu iu jep një pjesë të konsiderueshme fuqie të pakontrolluar liderëve partiakë. Pasi që këta liderë nuk zgjedhen në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk ekziston ndonjë mekanizëm për t'i parandaluar nga sjellja autokratike, duke ndërruar kur të dojnë pozitën e kandidatëve në listën e partisë.

### **Stabiliteti**

Stabiliteti i referohet aftësisë së institucioneve qeveritare për të balancuar interesat konkurruese politike në shoqëri duke krijuar kushte të favorshme për kompromise. Qeveritë stabile kanë më shumë gjasa të arrijnë qëllime të cilat janë në të mirën e tërë shoqërisë siç është ekonomia e përparuar, shërbimet efektive publike, dhe shëndetësia e përmirësuar. Derisa stabiliteti absolut nuk është realist dhe as i dëshiruar<sup>12</sup>, një sasi e caktuar e stabilitetit parandalon polarizimin dhe fragmentimin ndërmjet komuniteteve dhe inkurajon përfaqësuesit e tyre të bëjnë aranzhime në ndarjen e fuqive, të cilat tejkalojnë ndarjet shoqërore duke kontribuar në pajtim dhe riintegrim.

Siç është diskutuar më herët, listat e mbyllura kufizojnë mundësinë e votuesve që të kërkojnë llogari nga përfaqësuesit e tyre në kuptim të përgjigjes ndaj kërkesave të tyre. Kjo iu mundëson politikanëve që të mbesin të fokusuar në një numër të kufizuar çështjesh politike, siç është statusi final. Ndarjet etnike poashtu thellohen, pjesërisht për shkak se sistemi PP nuk iu jep invencion partive për të drejtuar thirrjen përtej grupit të tyre etnik. Bashkarisht, këto dy influenca negative në fakt promovojnë polarizim të interesave dhe ekstremizëm ndërmjet komuniteteve rivale. Siç mund të shihet,

partitë fitojnë duke u bërë më ekstreme. Prandaj, ky sistem pengon stabilitetin duke dekurajuar moderimin dhe kompromisin ndërmjet partive të bazuara në etnicitet duke fuqizuar kështu jostabilitetin.

### **Trendet votuese**

Sistemi elektoral i cili u jep mundësi njerëzve që të drejtojnë ardhmërinë e tyre duke ndikuar në vendim-marrjen e qeverisë, promovon zhvillimin njerëzor. Sistemi elektoral i Kosovës ka arritur proporcionalitet të plotë. Kjo është një arritje e dukshme e cila i kontribuon perceptcionit se organet e zgjedhura janë përfaqësues të shoqërisë dhe së këndejmi, legjitim. Sidoqoftë, kjo gjendje është arritur në dëm të përfaqësimit gjeografik dhe në dëm të llogaridhënies së drejtpërdrejtë ndaj votuesit. Për pasojë, partitë janë shkëputur shumë nga populli, politikanët nuk japin llogari, dhe platformat partiake janë sipërfaqësore, duke neglizhuar nevojat reale të popullsisë. Këta faktorë kanë kontribuar në një deziluzionim të gjërë për demokracinë në Kosovë. Pjesëmarrja në votim qysh nga zgjedhjet e para ka rënë vazhdimisht, pjesërisht për shkak se njerëzit nuk shohin asnjë përfitim nga pjesëmarrja në to (shiko Figurën 4.1). Në mënyrë që ky trend të kthehet në anën e kundërt, popullsia duhet të bindet që mund të ndikojë në procesin politik. Në Kapitullin e Gjashtë janë paraqitur sugjerime krahas këtyre vijave.

### **Partitë politike, pjesëmarrja dhe përfaqësimi**

Debati mbi sistemin elektoral nuk mund të paraqitet si i izoluar nga natyra dhe puna e partive politike. Partia është mjet që artikulon interesat specifike të një grupi qytetarësh tek institucionet demokratike. Në këtë aspekt, ato janë një ndër institucionet kryesore të demokracisë.

Edhe pse në demokraci partitë politike nuk janë platforma e vetme për përfaqësimin e interesave të njerëzve, ato mbesin si faktorë esenciale për rekrutimin e liderëve, strukturimin e mundësisë së zgjedhjes për elektoratin dhe për organizimin e qeverisë. Sipas Carother-it<sup>13</sup>, partitë politike luajnë së paku tri role esenciale në jetën politike dhe këto janë:

1. akumulimi dhe artikulimi i interesave të qytetarëve;

2. strukturimi i konkurrencës elektorale dhe formësimi i ambientit politik; dhe

3. ofrimi i mundësisë për grupet koherente që të udhëheqin qeverinë

## Konteksti i Kosovës dhe partitë politike

Për dallim nga partitë në demokracitë përëndimore, të cilat kanë dalur nga grupet e intereseve (p.sh. socialdemokratët të krijuar përreth agjendës sociale) apo nga klasa sociale, partitë politike shqiptare buro-

### KORNIZA 4.1. PARTITË POLITIKE NË KOSOVË

Skena politike shqiptare para intervenimit ndërkombëtar ka qenë e organizuar në një sistem paralel të dominuar nga një parti politike, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Përkundër dominimit politik të LDK-së, përgjatë konfliktit ajo është sfiduar nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, si më militante. Që nga zbankimi i paqeruajtësve, ish-militantët e UÇK-së u angazhuan në procesin politik post-konfliktit në mënyra të ndryshme. Një numër i liderëve të UÇK-së themeluan Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), e cila mbledhi shumicën e pjesëtarëve të organizatës. Një numër më i vogël i liderëve të UÇK-së të kohës së luftës themeluan parti të veçantë politike, Aleancën për Ardhmëri të Kosovës (AAK).

Sa i përket anës serbe, në vitin 1999 dinamika politike përreth Kosovës ishte edhe më e komplikuar. Dinamika politike serbe brenda Kosovës ende operon me referenca nga një proces politik më i madh në Serbi.

Në Kosovë, aktualisht ekzistojnë dy sisteme partish politike, ku të dy këto sisteme mbështeten shumë në debatin në lidhje me statusin final të Kosovës, për të determinuar kështu legjitimitetin e tyre. Sistemi serb i partive politike është i ndarë ndërmjet dy koalicioneve të organizuara lokalisht dhe përfaqësimeve lokale të partive me seli në Serbi. Partitë e të dy sistemeve nuk janë të diferencuara qartë sipas qëndrimeve të tyre ideologjike në ekonomi, politikë apo zhvillim civil, por më shumë referohen në rolet e tyre në luftën Shqiptaro-Serbe e cila çoi në intervenimin ndërkombëtar në vitin 1999, si dhe në politikën etno-nacionaliste që nga ky intervenim.

Derisa nuk është befasi që ndarjet etnike dhe nacionaliste dominojnë në dinamikën politike në Kosovë, efektet e kësaj mbështetjeje të vazhdueshme në legjitimitet etnik dhe nacionalist nuk janë të kuptuara aq qartë. Perceptimet e përgjithshme se çështjet ekonomike në mënyrë rapide janë duke zëvendësuar brengat për identitet si fokus primar i publikut, janë konfirmuar nga një anketë e kohëve të fundit e bërë në Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, në Kosovë. Me një shumicë të madhe, Shqiptarët e Kosovës papunësinë e identifikojnë si çështjen më të rëndësishme me të cilën ballafaqohet kjo provincë, dhe shumë më poshtë, në vendin e dytë qëndron çështja e statusit. Për komunitetin serb, çështjet e sigurisë personale dhe lirisë së lëvizjes mbeten brengat kryesore. Përkundër brengës në rritje drej çështjeve më lokale, partitë politike të të dyja komuniteteve definojnë rolet e tyre nëpërmes pozicioneve karshi konfliktit të mëparshëm dhe në qëndrimet/garën rreth statusit final.

Edhe pse partitë shqiptare dhe serbe kanë kërkesat e tyre legjitime, përkrahja e ideologjisë nacionaliste me fokus në pyetjet e roleve të përbashkëta etnike në histori dhe pavarësinë e Kosovës apo reintegrimin në Serbi, partitë serbe janë duke operuar me një dinamikë më të komplikuar. Koalicioni 'Pobratka' (Kithimi) si struktura e parë politike serbe që u angazhua në sistemin e administruar nga KB, është një koalicion divers që nuk i ka mbajtur në vete partitë e njëjta në të dy zgjedhjet e mbajtura. Për partitë serbe që kanë selitë e tyre në Serbi, disa prej të cilave kanë marrë pjesë në Povratka, legjitimiteti i tyre është i bazuar në pozicionin e partisë në politikën më të gjërë të Serbisë.

Partitë e minoriteteve jo-serbe janë të ngujuara në mes të të dy blloqeve konkurruese. Legjitimiteti i tyre mbështetet në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve të cilat i përfaqësojnë. Këtu përfshihen: boshnjakët, sllavët muslimanë (goranët dhe torbeshët), romët, ashkalinjtë dhe egiptianët (RAE) dhe turqit. Këto parti kanë opcionin të identifikojnë veten si parti "minoritare" dhe të formojnë bllok me komunitetin serb; të pranojnë strukturën dominante shqiptare duke u përpjekur që të marrin një pjesë brenda këtij blloku; apo të kërkojnë organizatë të bashkuar të "minoriteteve tjera". Tani për tani, ky grup është i bashkuar në Parlamentin e Kosovës si "minoritete tjera", edhe pse zakonisht votojnë për mazhorancën shqiptare. Për shkak se partitë shqiptare dhe serbe, poashtu edhe komuniteti ndërkombëtar, janë të fokusuar në debatin rreth statusit final dhe çështjeve përreth tij, brengat e këtyre partive dhe komuniteteve të tyre nuk adresohen shpesh.

*Nga: Fred Cocozzelli. Partitë Politike në Kosovë, 2003. GSC Quarterly 11 (Dimër 2004).*

#### KORNIZA 4.2. PERCEPCIONET DHE SHFAQJA PUBLIKE E FEMRAVE POLITIKANE

"Femrat kanë flokë të gjata dhe mendje të shkurtëra" është një nga stereotipet e kulturës shqiptare. Fatkeqësisht, ky stereotip ende ndikon në percepcionet për femrat në politikë. Një nga percepcionet më të shpeshta është se femrat përfaqësohen në strukturat e vendim-marrjes vetëm për shkak të kuotës. Femrat politikane shpesh shihen si "numër" e jo agjentë të ndryshimit apo akterë autentik me ndikim të madh në zhvillimet shoqërore dhe politike.

Femrat politikane nuk shihen aq shumë në arenën politike. Mediat luajnë rol kyç në rritjen e shfaqjes publike të femrave politikane. Në monitorimin e mediave të shkruara në Kosovë gjatë zgjedhjeve komunale në vitin 2002, Agjencia INTERNEWS ka gjetur se, nga 3,238 artikuj të botuar në 10 gazeta ditore dhe javore në Kosovë, 24 artikujt të gazetave janë fokusuar ekskluzivisht në aktivitetet e grave politikane.

jnë nga beteja për pavarësi, derisa partitë politike serbe në Kosovë, të organizuara nga dy koalicione lokale, janë zgjatime të partive të Serbisë. Të dy sistemet politike mbështeten fortë në debatin për statusin final të Kosovës, për të përcaktuar kështu legjitimitetin brenda komuniteteve të tyre.

Klima politike kosovare favorizon liderët e fuqishëm dhe partitë e dobëta politike. Disa ekspertë besojnë se përkrahësit iu bashkohen partive politike kryesisht bazuar në lidhjet emocionale me liderët e kohës së luftës<sup>14</sup>. Shpesh, përcaktuesi i fundit për përkatësi partiake është mundësia për të gjetur punë; diferencat lokale ndërmjet partive zbrasin në nivel individual. Shëndërimi i një aktivisti politik në politikë-bërës është dëshmuar të jetë sfidë pakapërcyeshme, derisa aktiviteti politik dhe ndikimi i femrave mbetet fare pak i parë. Proceset e politikave nuk janë as inkluzive e as pjesëmarrëse, dhe pak dëgjohe debate mbi konceptet si tregtia e lirë apo mirëqenia sociale në relacion me dallimet ideologjike (shiko Kornizën 4.1. mbi partitë politike në Kosovë).

Ngjashëm me vendet tjera në tranzicion, partitë politike në Kosovë mbesin të organizuara dobët dhe keq, me anëtarësi të kufizuar dhe fonde të pakta. Ato shikohen si konstruksione elitiste dhe patriarkale, ku femrat kanë shumë pak hapësirë për veprim (shiko kornizën 4.2). Partitë kosovare prodhojnë liderë të fuqishëm dhe rreth personaliteteve të liderëve të caktuar (e jo rreth ideve të tyre) zhvillohen klika interne, shpesh të bazuara në shtrirje gjeografike.

#### Përfaqësim më i mirë apo humbje e kredibilitetit?

Analizimi i partive politike në Kosovë rreth funksioneve bazë të definuara nga

Carothers-i është e vështirë, për shkak të faktit se partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje, janë në zhvillim e sipër. Numri i

#### KORNIZA 4.3. TRENDET VOTUESE

Siç tregon grafikoni 1 (më poshtë), partitë që kanë kontrolluar qeveritë e ndryshme komunale në mes të zgjedhjeve në vitet 2000 dhe 2002, kanë humbur mbi 80,000 vota. Kjo dukuri vë theks pakënaqësinë e përgjithshme me të gjitha partitë në fuqi në nivelin lokal. Zakonisht, më së shumti nga kjo pakënaqësi ka humbur partia kryesore opozitare. Ky trend i ka lënë së paku 50,000 votues në kampin e "të pavendosurve", gjë që sugjeron se shumë votues vendosën të abstenojnë e edhe më pak që të votojnë pa kriter për opozitën. Për shembull, partia nacionale e dytë për nga madhësia, PDK, ka mbledhur vota në komuna ku ishte parti opozitare, por ka humbur në ato komuna të cilat i ka kontrolluar.

#### DIFERENCA NË NUMRIN E VOTAVE PËR SECILËN PARTI NË MES TË VITEVE 2000 DHE 2002 (ME TË BARDHË ËSHTË POZITA, ME TË NGJYROSUR ËSHTË OPOZITA)

	LDK	PDK	AAK
Deçan	-926	-275	3,122
Gjakovë	-9,442	-238	2,007
Gillogovc	-438	-1,274	211
Gjilan	-2,890	1,769	-33
Dragash	-1,625	-458	35
Istog	-1,966	358	110
Kaçanik	841	-659	-56
Fushë Kosovë	-138	757	-681
Klinë	-1,867	114	648
Kamenicë	-1,615	279	595
Mitrovicë	-5,269	2,778	767
Lipjan	-795	1,966	-269
Obiliq	-344	459	-1,426
Rahovec	-5,108	1,500	-1,854
Pejë	-7,985	-332	5,741
Podujevë	-3,470	906	-1,135
Prishtinë	-11,967	2,386	-1,014
Prizren	-12,058	2,541	815
Skenderaj	-543	-2,507	95
Shtime	568	1,150	-20
Suharekë	-4,077	2,105	-425
Ferizaj	-2,395	1,571	837
Viti	-1,420	496	257
Vushtrri	-2,114	875	-4
Malishevë	-1,383	2,391	150
<b>Gjithsejt</b>	<b>-78,426</b>	<b>18,658</b>	<b>8,473</b>
<b>Mesatarja:</b>	<b>-3,210</b>	<b>678</b>	<b>347</b>

\* pasi që tri partitë kryesore kanë pasur shumë pak vota në pesë komuna të dominuara nga serbët, ato rezultate nuk janë përfshirë këtu.

Legjenda: Pozita Opozita

Leon Malazogu. *Letër Diskutimi: KU NË TË VËRTETË MBËSHTETET LEGJITIMITETI I KOSOVËS? (KIPRED). 2004*



partive politike është rritur më shumë se dyfish. Në zgjedhjet komunale të vitit 2000, kanë marrë pjesë njëzet e katër parti dhe insiativa qytetare<sup>15</sup>, derisa në vitin 2002 morrën pjesë 57 entitete politike dhe 11 kandidatë të pavarur.

Ky proliferim i partive politike në Kosovë mund të konsiderohet si zhvillim pozitiv, posaçërisht për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e minoriteteve në kuvendet komunale. Sidoqoftë, poashtu mund të theksohet fakti se tri partitë kryesore shqiptare të Kosovës (LDK, PDK dhe AAK) si dhe koalicioni serb i Kosovës 'Kthimi' janë duke humbur kredibilitetin dhe janë duke dështuar në artikullimin e interesave të votuesve të tyre.

Përkundër skenës së fragmentuar politike, partitë e reja duket të mos jenë të afta që të absorbojnë plotësisht votuesit e shumtë të pakënaqur. Edhe pse numri i jvotuesve është trefishuar prej vitit 2000 deri në 2002 në zgjedhjet komunale (nga më pak se 20.000 në më shumë se 600.000), numri i votuesve që zgjedhin parti të ndryshme nga tri partitë kryesore shqiptare vetëm sa është dyfishuar (nga më pak se 40.000 në përafërsisht 100.000).

Treguesi i tretë i rëndësishëm në këtë aspekt është përkrahja e zvogëluar e partive udhëheqëse (mazhoritare) në shumicën e komunave prej zgjedhjeve të vitit 2000 deri në ato të vitit 2002, pa marrë parasysh se cila parti ishte në fuqi. Për shembull, partia më e madhe në Kosovë, LDK, prej vitit 2000 deri në vitin 2002, ka humbur vota në secilën komunë të kontrolluar nga kjo parti (Shiko Kornizën 4.3, komuna e Prishtinës, Gjilanit, Vushtrisë, Suharekës, Podujevës, etj), duke humbur mesatarisht 3,210 vota për komunë. Trendi i njëjtë ka kapur edhe PDK-në, e cila ka humbur vota në tri prej katër komunave ku pati shumicën (Glllogovc, Skenderaj dhe Kaçanik).

Statusi i pazgjidhur i Kosovës vazhdon të ketë "efekt ngrirës" në kulturën lokale politike, duke mbajtur shumicën e kosovarëve të përqëndruar në probleme më të gjëra, siç është pavarësia. Sidoqoftë, mund të vërehen disa ndryshime pozitive. Në zgjedhjet e vitit 2002, për shembull, problemet lokale janë theksuar më shumë se në zgjedhjet e

vitit 2000 dhe fushata ka qenë më e disiplinuar. Është paraqitur sistemi i llogaridhënies me auditimin financiar të partive dhe kandidatëve, gjë e cila inkurajon transparencën dhe llogaridhënien.

## Fuqizimi i kulturës për pjesëmarrje në politikë

Stabilitetit kërkon evolucion edhe përshtatshmëri nga ana e partive politike. Ato duhet të jenë në gjendje të zgjerohen, moderohen dhe të kanalizojnë pjesëmarrjen e qytetarëve me grupe të reja e të mobilizuara shoqërore, dhe në anën tjetër të mbajnë ekuilibrin e sistemit. Sistemi demokratik do të jetë i fortë nëse partitë politike zhvillojnë kulturën pjesëmarrëse politike, e cila do të rezultojë në shfrytëzimin maksimal të kapitalit të disponueshëm njerëzor dhe inkorporimin e ideve të reja në debate politike.

Mospjesëmarrja e madhe e votuesve nuk mund t'u atribuohet vetëm partive politike. Ekzistojnë disa faktorë që poashtu mund të luajnë rol:

### KORNIZA 4.4. FEMRAT DE FAKTO NË VENDIM-MARRJE ?

Fakti që përqindja e femrave në kuvendet komunale dhe në parlamentin e Kosovës është më e larta në rajon, e edhe më e lartë se në shumicën e vende euro-perëndimore, nuk do të thotë që femrat kosovare mbajnë postet kyçe në udhëheqje. Kur është formuar në fillim, Qeveria e Kosovës nuk ka pasur asnjë femër ministre. Vetëm pas suspendimit të Ministrit të Shëndetësisë, si ministre u emërua një femër. Siç tregon Tabela 4.2, femrat mbajnë një prej 10 posteve të sekretarëve permanentë, kryesojnë vetëm 7 prej 18 komisioneve parlamentare dhe udhëheqin vetëm një prej 30 komunave. Kjo të shpie tek konkludimi se ambienti politik në Kosovë është ende i dominuar nga meshkujt. Meshkujt kanë fuqinë e vërtetë politike (edhe pse kjo nuk do të thotë se femrave iu mungon kapaciteti i lidershipit). Kultura dhe mentaliteti kosovar i favorizon meshkujt në shumicën e çështjeve shoqërore dhe veçanërisht në politikë. Në të njëjtën kohë, femrat vazhdojnë të kenë vështirësi në hyrjen në sferën politike, përkundër sistemit të kuotës, për shkak të paragjykimeve tradicionale, historike dhe kulturore.

Ndarja sipas gjinive në pozitat vendim-marrëse

Pozitat	Total	Femra	Meshkujt
Ministra	10	1	9
Sekretarë permanent	10	1	9
Deputetë të Parlamentit	120	35	85
Kryesues të komisioneve parlamentare	18	7	11
Kryetar komunashh	30	1	29
Deputetë të Kuvendeve Komunale	1172	262	910

Source: KWI

Duke shikuar në strukturat internet të të tri partive më të mëdha politike, dominanca e meshkujve është e evidente. Si LDK poashtu edhe AAK kanë vetëm 20% në udhëheqësinë e tyre, derisa PDK ka vetëm 10% në lidershipin e vet. Femra në Kosovë nuk mban asnjë post të lartë në asnjë parti të përfaqësuar në Parlament.

Burimi: IGK

- *Debati politik në Kosovë mbetet i stagnuar mbi të njëjtat çështje sikurse në vitin 1999, siç është statusi final i Kosovës, duke mos shtyrë përpara çështjet e përditshme sikurse papunësia, varfëria, qëndrueshmëria dhe qasja në furnizimin me rrymë elektrik.*

- *Mungesa e kompromisit ndërmjet partive politike që ka çuar në vonesa të vazhdueshme në formimin e qeverive komunale dhe në ndalimin e shqyrtimit të çështjeve urgjente. Për shembull, pas zgjedhjeve të vitit 2002<sup>16</sup>, në 10 kuvende komunale janë bërë bojkote nga opozita.*

- *Mungesa e strukturave demokratike brenda partive politike dhe fuqizimi i përgjithshëm i liderëve partiakë nga sistemi elektoral i cili ka vepruar me lista të mbyllura (shiko Kornizën 6.1 "Reforma 2004": Modeli i ri për angazhim konstruktiv civil).*

## **Vendim-marrja qendrore, pjesëmarrja dhe përfaqësimi**

Siç është vërejtur në kapitullin e tretë, përfaqësimi dhe pjesëmarrja efektive mund të rrisë legjitimitetin, llogaridhënien dhe besimin në strukturat e qeverisë. Pas zgjedhjeve të vitit 2001, janë dashur tre muaj që të zgjedhet<sup>17</sup> Presidenti dhe Kryeministri dhe të formohet qeveria. Ministrat janë caktuar sipas një marrëveshjeje ndërmjet liderëve të të tri partive kryesore politike, marrëveshje kjo e nënshkruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm<sup>18</sup>. Kryeministri nuk ka marrur pjesë në këtë çështje.

Mënyra me të cilën është formuar qeveria e Kosovës, ka ndikuar shumë në rrjedhën e natyrës së vendim-marrjes qendrore të saj<sup>19</sup>. Derisa Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244 shkaktonte sfida në kuptim të funksionalitetit dhe interpretimit të roleve, nga mungesa e përvojës paraprake në demokraci, të mekanizmave të dobët të administrimit publik dhe defekteve në proceset buxhetore, u shkaktuan kufizime substanciale

### *Kufizimet procedurale*

Formula konstitucionale për përfaqësim në nivel qendror nuk gjeneroi shumicën e

duhur për të qeverisur vetë<sup>20</sup>, duke kërkuar intervenim të domosdoshëm nga organi mbikonstitucional. Kundrejt ecjes prapa dhe startit zhgënjyes dhe mosbesimit, të lindur që nga fillimi, formula e konkonzusit në vendim-marrje, në mes të partive politike, u përcaktua të jetë si më e përshtatshme.

Pasi që Korniza Kushtetuese kërkonte ligjërisht që vendimet e qeverisë të arrihen me konkonzus apo votën e mazhorancës<sup>21</sup>, Kryeministri ishte i bllokuar për të luajtur rol aktiv ndërmjetësues për të zgjidhur këtë krizë.

### *"Harresa" ligjore*

Korniza kushtetuese qartazi thekson vendimet të cilat mund t'i marrë Kuvendi (fuqinë ligjvënëse), por është e heshtur ndaj fuqive rregulluese të Qeverisë. Qeveria ka përgjegjësi kushtetuese që të "ushtrojë autoritet ekzekutiv" dhe të "implementojë ligje të Kuvendit dhe ligje tjera brenda fushës së përgjegjësisë të IPVQ-së", por Kushtetuta nuk përfshin dispozita specifike për të siguruar implementimin e ligjeve (p.sh. lëshimin e legjislativit sekondar). Kundrejt kësaj "harrese" ligjore, Qeveria e Kosovës është duke luftuar të definojë parametrat e fuqisë vendim-marrëse.

## **Vendim-marrja konkonzuale**

Mungesa e mjeteve efektive e substanciale dhe procedurale të Kryesuesit të Qeverisë, ka detyruar atë të ofrojë hapësirë apo të lë që vendim-marrja të nënkuptohet. Për një numër arsyes, kjo nuk është ideale. Arritja e konkonzuseve ka nënkuptuar debate të stërzgjatura, edhe në çështje relativisht të thjeshta, të cilat përndryshe nuk është dashur të arrijnë deri tek niveli i Kabinetit. Si implikacion i kësaj, prospektet për uljen e delegimin e autorizimit të vendim-marrjes në nivele më teknike, janë të limituara. Ministrat kanë zhvilluar një mentalitet në të cilin duhet të pranojnë ose refuzojnë vendimin kolektiv. Kjo situatë krijon rrezik për rihapjen dhe kontestimin e çështjeve për të cilat tanimë janë marrë vendimet.

Mënyra në të cilën është formuar Qeveria, së bashku me kufizimet tjera ligjore dhe praktike, ka nënkuptuar që asnjë formë e vendim-marrjes përveç konkonzusit nuk

mund të merret në konsideratë. Sidoqoftë, vendim-marrja e qeverisë në nivel qendror nuk mund të gjykohej sipas standardit se sa gjërë ishte arritur të bëhej koncenzusi për një vendim të caktuar e as nga numri i rasteve kur është kërkuar mazhoranca në vend të koncenzusit dhe vendimeve, por sipas kualitetit të këtyre vendimeve. Këtu përfshihet edhe niveli sesa të informuara janë vendimet e tilla, dhe si janë të koordinuara dhe monitoruara në implementimin e tyre. Një iniciativë pozitive e kohëve të fundit ka për qëllimin bërjen e një drafti të një strategjie të përbashkët të zhvillimit ekonomik në bashkëpunim me Shtyllën IV, që implementohet nga Iniciativa Europiane për Stabilitet.

### *Ndikimi në lidhje me qëllimet zhvillimore*

Programi i qeverisë<sup>22</sup> paraqet një dokument të lartë i cili përshkruan vizionin dhe strategjinë zhvillimore të qeverisë, ky program inkorporon të gjitha objektiva kryesore të zhvillimit të Kosovës: zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, promovim të bujqësisë dhe zhvillimit rural, përmirësim të standardeve në arsimim; modernizim të transportit, postës dhe telekomunikacionit; reformimi i sistemit shëndetësor; krijimi i skemave të mbrojtjes sociale dhe skemës së pensioneve; rritja e nivelit të punësimit; përmirësimi i ambientit, planifikimi hapësinor; dhe përkrahja e kulturës, rinisë dhe sporteve. Ky program paoshtu ilustron mënyrën e vendim-marrjes nga ana e qeverisë, si organi më i lartë ekzekutiv.

Ky program është zhvilluar përgjatë një kohe disajvare pa hulumtim të mjaftueshëm, qoftë nga personeli i brendshëm apo ekspertët e jashtëm. Pjesëmarrja në këtë program ishte minimale<sup>23</sup>: si efekt i kësaj, u ndërlihdën konsultime në seri të takimeve me të punësuar (shumica këshilltarë politikë) nga të gjitha ministrinë, në të cilat mbledhje u prezentuan vizionet e ministrive përkatëse. Në drejtimin e disa mbledhjeve vijuese të grupeve punuese, u bënë draft prioriteteve e disa ministrive në një program final. Përkundër faktit se shumica e ministrave mendonin se prioriteteve e tyre përkatëse nuk ishin përkthyer sinqerisht në program, një formë koncenzusi në vendim-

marrje lejoi që të përkrahet verzioni final, pa ndonjë ndryshim të dukshëm.

Të metat e këtij procesi nuk janë adresuar ende. Në të vërtetë, vendimet në fusha tjera kritike përgjithësisht merren në formën ad hoc, pa hulumtim të thukët, pa shënjestrim të pjesëmarrësve, dhe pa pjesëmarrje të gjërë. Ende nuk ekziston ndonjë rrugë për të tërhequr iniciativa, apo për të kanalizuar vërejtjet tek autoritetet qendrore.

Në të njëjtën kohë, koncenzusi ende përgjithësisht përcjellet si forma e preferuar e vendim-marrjes. Posaçërisht në rastet e koncenzusit të nënkuptuar, kjo situatë i hap dyert konfuzionit ose obstrukcionit në procesin e vendim-marrjes.

### *Të metat në gjendjen aktuale*

Krahas programit të përpiluar me nguti, kanë dalur pengesa tjera në vendim-marrjen qendrore. Zyra e Kryeministrit (ZK) konsiderohet si Ministri në vete, sipas Rregullores mbi Degën Ekzekutive të Vetëqeverisjes së Përkohshme. Si rezultat i kësaj, roli i saj në koordinimin dhe monitorimin e punës së bërë nga ministrinë e ndryshme është i kufizuar nga perceptcionet e mungesës së autoritetit<sup>24</sup>. Implementimi i Programit të Qeverisë, agjendës legjislative dhe vendimeve tjera të mëdha u janë lënë tërësisht Ministrive. Si i tillë, nuk është vendosur asnjë mekanizëm i duhur koordinimi<sup>25</sup>. Defekt tjetër serioz është mungesa aktuale e ciklit të vlerësimit, vendosjes, implementimit dhe monitorimit të vendimeve dhe politikave. Qartazi, ekziston nevoja për krijimin e Njësisë për Planifikime të Politikave<sup>26</sup>. Me gjasë, roli i kësaj njësie do të duhej të ishte përcjellja e implementimit të programit të Qeverisë, ofrimi i analizave adekuate të politikave dhe vlerësimi i reperkusioneve financiare të vendimeve politike.

Shumë ministrive iu mungon struktura dhe hierarkia konsistente për delegim, përcjellje, monitorim dhe intervenim të duhur në relacion me bërjen e politikave. Pas publikimit të Rregullores 2001/19, nuk është lëshuar asnjë udhëzim administrativ që thekson strukturat e standardizuara formale brenda ministrive<sup>27</sup>.

*Mënyra në të cilën Qeveria është krijuar që nga fillimi i saj, në mënyrë serioze ka zvogëluar zgjidhjen e mundshme për vendim-marrje të dubur të hapur dhe demokratike.*

### *Dykuptimsitë ligjore*

Mungesa e mekanizmave të qartë dhe të thjeshtë të intervenimit ligjor në baza ditore, pengon funksionimin e ministrive. Ngjashëm, marrëveshja politike që ka krijuar qeverinë, e çiftëzuar me formulën e konzenzimit për vendim-marrje, ka hasur në vesh të shurdhër duke u kthyer në devijime prej vendimeve dhe në tolerancë ndaj lëshimeve në planet e punës së ministrive. Si pasojë e kësaj, janë përgatitur së paku disa draft-ligje të pafokusuar.

### *Kakofonia e iniciativave ligjore*

Një vendim tjetër i rëndësishëm që pasoi që nga adoptimi i programit të qeverisë ishte agjenda legjislativë. E formuluar ngjashëm nga një grup i vogël i stafit të ministrive, e ashtuquajtura matricë e iniciativave ligjore i është prezentuar qeverisë dhe mandej është përkrahur nga ajo, me disa vërejtje.

Agjenda legjislativë nuk është detajizuar deri në fund brenda kornizës së programit të qeverisë, dhe asnjë njësi legjislativë nuk është përgjegjëse për të përputhur këto iniciativa me draft-ligjet në matricën ligjore. Si pasojë e kësaj, në Kabinet konkurrojnë iniciativa ligjore në formë kakofonie, që vijnë nga ministri të ndryshme-jo domosdoshmërisht konform prioriteve politike. Nga ana e vet, Kabineti ka tentuar të mos vëjë

Procedurave të Parlamentit paraqet presedan të mirë për të hapur takimet e komisioneve të veta ndaj individëve të interesuar. Prapëseprapë, nuk ekziston ndonjë ndarje e qartë ndërmjet fazave në të cilat janë të involvuar pjesëmarrësit si dhe roli që duhet të kenë. Konsultimet me shoqërinë civile kanë qenë për së tepërmi spontane, pa orar të qartë të involvimit në vendim-marrje. Një mënyrë për të bërë të rregullt involvimin e pjesëmarrësve do të ishte përpilimi i një letre të bardhë për një spektër më të gjërë pjesëmarrësish përpara të cilëve do të paraqitej pjesa e legjislationit të caktuar, në mënyrë që të merren mendime në mënyrë më të fokusuar dhe brenda afatit kohor.

### *Inter-relacioni ndërmjet prioritetëve dhe buxhetit*

Përmirësimet në procesin buxhetor kanë filluar në vitin 2003, kur secila ministri ka prezentuar prioritetet e veta përkatëse tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Poashtu ishte themeluar edhe komisioni buxhetor (i kryesuar nga Kryeministri), me qëllim të rregullimit të mundësive strategjike ekonomike me qëllimet tjera zhvillimore. Sidoqoftë, deri në aprovimin e buxhetit 2004, procesi buxhetor është bërë nëpërmjet alokimit të shumave të parave ministrive, të cilat, kohës pas kohe, janë përpjekur për ti shpenzuar ato.

TABELA 4.1: BUXHETI I KONSOLIDUAR I KOSOVËS 2004 PËRMBLEDHJA E PËRCAKTIMEVE BUXHETORE

Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 2004	Të punësuarit 2004	Të punësuarit 2003	Përcaktimet buxhetore në Euro FY 2004-2005	Totali i përcaktimeve buxhetore %
Institucionet e IPVQ-së	17 286	16 357	289 045 594	45.71%
Institucionet e fuqive të rezervuara	17 968	16 371	167 498 508	26.48%
Komunat	42 150	N/a	175 781 460	27.79%
Totali		N/a	632 325 922	100.00%

Burimi: MEF, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, 2004

në pyetje iniciativat ligjore që vijnë nga ministritë dhe në secilën iniciativë është gjetur përkrahje tipike.

### *Përfshirja ad hoc e qytetarëve*

Si dukuri më pozitive është vullneti i arsyeshëm dhe mendjehapur për të përfshirë ekspertë të pavarur, përfaqësues të OJQ-ve, asociacione dhe pjesëmarrës të tjerë relevantë në vendime të rëndësishme. Për shembull, drafti final i Rregullave dhe

Tabela 4.1 paraqet Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (BKK) në kuptim të ndarjeve në IPVQ, Komuna dhe fuqi të rezervuara, për vitin 2004. Më shumë se një e katërta e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës është e alokuar për institucionet nën fuqitë e rezervuara, mbi të cilat Parlamenti apo Qeveria e Kosovës nuk ka autoritet apo mundësi që të thërrasë përfaqësuesit e këtyre institucioneve për të raportuar në Kuvend.

## Fuqizimi i përgjegjësive

Pasojat e paqartësive ligjore, efektet në shpejtësinë e vendim-marrjes dhe improvizimi evident në procesin e hartimit të programit të qeverisë, nuk janë adresuar në mënyrë adekuate. Anash strukturës së sekretarëve permanentë dhe takimeve të tyre javore, nuk ekziston asnjë njësi përgjegjëse për lehtësimin e vendim-marrjes në nivelin qendror dhe monitorimin e implementimit të vendimeve. Poashtu, nuk ekziston mekanizëm i organizuar (qoftë si një njësi e vetme brenda zyrës së Kryeministrit apo në Ministri tjera përgjegjëse për koordinimin e inputeve të pjesëmarrësve. Në të njëjtën kohë, kërkesat e prezentuar që vijnë jashtë qeverisë në shumicën e rasteve përbëhen nga kërkesat apo peticionet e limituara në veprime përmirësimi e jo në përshkrimin proaktiv të ndonjë iniciative politike.

Më tej, pamjaftueshmëritë institucionale e bëjnë Qeverinë të paaftë të përcjellë implementimin e vendimeve të veta edhe në Ministrinë e veta. Kështu Ministrive, ju mbetet në përgjegjësi observimi i prioritetëve dhe vendimeve të përbashkëta. Kjo praktikë ka implikacione të thella, posaçërisht në kuptim të implementimit të "Standardeve për Kosovën".

## Qeverisja lokale në Kosovë: Sa e afërt me njerëzit?

"Qeverisja e suksesshme lokale e afron fuqinë vendim-marrëse me njerëzit e rëndomtë"<sup>28</sup> **Mozaiku i Kosovës**

Nese decentralizimi implementohet efektivisht, ai mund të jenë një nga mekanizmat më të rëndësishëm në afrimin e qeverisjes dhe të njerëzve. Mund të rrisë besimin ndaj sistemit, mund të mundësojë monitorim dhe mbikqyrje më të afërt nga njerëzit, rritë mbledhjen e tatimeve dhe do të përmbushte më mirë intersat e komuniteteve të ndryshme, duke iu lejuar atyre që të marrin një numër më të madh vendimesh për veten e tyre (shiko kornizën 4.5. mbi Rolin e Qeverisjes Lokale).

Në të njëjtën kohë, decentralizimi mund të jetë nikoqir i efekteve negative nese adoptohet ngutshëm apo në mënyrë refleksive.

Qëllimi i decentralizimit është të përcjellen problemet politike dhe si të tilla të diskutohen.

### KORNIZA 4.5. ROLI I QEVERISË LOKALE

Koncepti i zhvillimit lokal, i kuptuar si proces i ndryshimit dhe përmirësimit të strukturave ekonomike brenda një territori homogjen, nuk është i ri në Kosovë. Sipas Nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/45, komunave u është dhënë roli kryesor në ofrimin e "kushteve themelore bazike për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik". Sidoqoftë, realiteti i tanishëm socio-ekonomik dhe politik kanë ndërprerë rolin kyç të komunave si politikëbërëse, inovatorë dhe lojtarë kyç në krijimin e prosperitetit lokal. Paqartësitë politike dhe ligjore kanë penguar procesin e decentralizimit dhe, si pasojë, aftësinë e qeverisë për të ndarë fuqinë me autoritetet lokale. Procesi efektiv i decentralizimit do të mundësonte demokracinë të lëshojë rrënjë, që në fund do të lejonte vullnetin e shoqërisë civile për të marrë pjesë në qeverisjen e çështjeve lokale.

Zhvillimi i brendshëm i bazuar në resurse lokale njerëzore dhe natyrore dhe qasja e vetëdeterminimit bazuar në nevojat lokale dhe në shfrytëzimin e njohurisë në nivelin lokal, kërkojnë vizion të ri të qeverisë lokale. Këtu duhet të përfshihet promovimi i rritjes ekonomike, reduktimi i pabarazisë, rritja e pjesëmarrjes dhe eliminimi i varfërisë. Pjesëmarrja në zhvillimin ekonomik lokal nuk është i kuptuar si përfundim por si mjet nëpërmes të të cilit mund të arrihen qëllimet e zhvillimit lokal.

*Intenca e tij është të minimizojë nivelet e burokracisë në mes të popullit dhe shërbimeve, por në anën tjetër mund të përfundojë duke krijuar nivele të panevojshme të burokracisë.*

## Pjesëmarrja në qeverisjen lokale në Kosovë

'Mozaiku i Kosovës: Percepionet e Qeverisjes Lokale dhe Shërbimet Publike në Kosovë', ka vërejtur se në Janar 2003, 63% të Kosovarëve ishin të kënaqur me kuvendet e tyre komunale dhe 52% besonin se komuna e tyre ishte në rrugë të mirë. Megjithatë, anketa e njëjtë ka zbuluar mungesën e interesit (që është problematik) të qytetarëve në punën për komunitetin e tyre lokal. Vetëm 30% e respondentëve kanë shprehur vullnetin për të punuar vullnetarisht në punë të ndryshme në komunën e tyre. Ngjashëm, AZHNJ e UNDP-së ka treguar nivele të ulëta të pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme (shiko poashtu Kapitulin e Tretë). Çka është më e rëndësishme për qeveritë lokale, më pak se 1% e njerëzve kanë marrë pjesë ose kanë besuar që janë përfitues të projekteve të qeverisë lokale. Më tutje, pak njerëz (vetëm 13%) kanë menduar se mund të ndikojnë në vendim-marrje në komunën e tyre - vetëm 1% më shumë se numri i atyre që kanë

*"Qeverisja e suksesshme lokale e afron fuqinë vendim-marrëse me njerëzit e rëndomtë" Mozaiku i Kosovës*

menduar se mund të ndikojnë në vendim-marrje në nivelin qendror.

politike të komuniteteve të nivelit më të ulët.

#### **KORNIZA 4.6. VËSHTRIM: ZHVILLIMI NJERËZOR DHE SATISFAKSIONI ME SHËRBIME**

Analiza krahasuese nuk tregon lidhje të qartë në mes të satisfaksionit me shërbime dhe IZHNJ. Sidoqoftë, ekzistojnë disa çështje që ja vlen të theksohen:

- Komunat e dominuara nga serbët më veri të Kosovës, kanë IZHNJ-të më të larta (krahas Prishtinës) dhe të njëjtat janë të fund të listës sa i përket satisfaksionit të përgjithshëm me shërbime. Ngjashëm, Shtërpca renditet në mes të kësaj liste në kuptim të satisfaksionit, por sa i përket IZHNJ-së është ndër pesë komunat e para.
- Malisheva, Dragashi dhe Obiliqi në mënyrë konsistente janë të renditura ulët në kuptim të satisfaksionit me shërbime dhe IZHNJ.
- Shtimja dhe Kaçaniku janë 7 komunat e para në kuptim të satisfaksionit me shërbime, por sa i përket IZHNJ-së bëjnë pjesë në 5 komunat e fundit.

#### **KORNIZA 4.7. MEKANIZMAT PËR PJESËMARRJE DHE VENDIM-MARRJEN KOMUNALE**

Në kuptim të mekanizmave institucionale, Rregullorja 2000/45 bën disa referenca të rëndësishme ndaj pjesëmarrjes publike:

- *Neni 8 - thekson që komuna duhet të mbajë së paku dy takime publike në vit dhe çdo person apo organizatë ka të drejtë të paraqesë peticion tek kuvendi komunal.*
- *Neni 4.1 në lidhje me rregulloret komunale - statuti komunal duhet të ofrojë dispozitave për adoptimin e rregulloreve "pas konsultimeve publike".*
- *Neni 7.1 - të gjithë pjesëtarët e publikut, duke përfshirë shtypin, u lejohet të marrini pjesë në të gjitha mbledhjet e kuvendit komunal dhe të komisioneve të tyre.*
- *Neni 7.2 - çdo person mund të inspektojë çfarëdo dokumenti të mbajtur në komunë.*
- *Neni 7.5 - Statuti i komunës mund të ofrojë dispozita për publikën në mënyrë që publiku të merr pjesë në mbledhjet e kuvendit.*
- *Neni 21.4 - lejon komisionet e kuvendeve që të angazhojnë persona që nuk janë anëtar (deputet) të kuvendeve komunale.*

Mund të ketë interpretime të ndryshme për këto divergjenca; sidoqoftë, një nga parimet kryesore për pjesëmarrje është që rregulloret të jenë të thjeshta dhe institucionet të jenë me qasje<sup>29</sup>. Për qeverisje efektive dhe pjesëmarrje qytetare në procesin e vendim-marrjes është i nevojshëm kuptimi i qartë i ndarjes së roleve ndërmjet autoriteteve lokale dhe qendrore<sup>30</sup>. Në Kosovë, ndarja e kompetencave ndërmjet strukturave vendore qeverisëse (IPVQ) dhe atyre ndërkombëtare (UNMIK) duhet të qartësohet urgjentisht.

### **Teoria e decentralizimit**

Decentralizimi është i ndarë në dy kategori të gjëra: horizontale (shpërndarja e fuqisë tek institucionet dhe agjencitë e nivelit të njëjtë) dhe vertikale (transferimi i disa fuqive në nivele më të ulëta-siç janë regjionet, qeveritë lokale dhe këshillat e fshatrave). Derisa decentralizimi horizontal është i dëshirueshëm për monitorim të zakonshëm, në anën tjetër shkakton ulje të llogaridhënies. Llogaridhënia vertikale, në anën tjetër, përmbush kërkesat politike dhe/ose

Ekzistojnë tri llojë të decentralizimit vertikal:

- *Shpërqëndrimi* - "vetëm transfer i fuqive administrative të nivelit qendror i cili mund të tërhiqet në çdo kohë",
- *Delegimi* - "kalimi i një mase autoriteti dhe fuqie vendim-marrëse tek zyrtarët lokalë", dhe
- *Transferimi* - "fuqitë vendim-marrëse iu kalohen autoriteteve lokale duke i lejuar ato që të marrin përgjegjësinë e plotë duke mos referuar prapa tek qeveria qendrore".

Derisa shpërqëndrimi dhe delegimi në të vërtetë nënkuptojnë që fuqia të mbetet në qendër, sukcesi i transferit në kuptim të rritjes së pjesëmarrjes politike varet përfundimisht nga kualiteti i përfaqësimit në institucionet lokale<sup>31</sup>.

### **Avantazhet**

Decentralizimi mund të rrisë mbikqyrjen dhe llogaridhënien në mbledhjen e tatimeve dhe shpenzimet buxhetore. Përvoja e vendeve tjera tregon që shkollat dhe spitalet të cilat mbështeten në financime lokale janë më efikase, dhe operojnë

*"Qeveria qendrore, apo lokale, UNMIK-u apo Beogradi, cila institucione janë përgjegjëse për çka? Qeveria lokale duhet të gjykojë përballë kompetencave të veta. Por çka nese këto kompetenca nuk janë të definuara qartë?"*  
**Mozaiku i Kosovës, 2003**

më kosto më të ulët. Mbikqyrja e shkollave nga ana e njerëzve lokalë poashtu ka përmirësuar punën e mësuesve.

Shpeshherë thuhet që decentralizimi promovon zhvillimin, edhe pse në realitet marrëdhënia është më gjasë sforsuese në kuptimin reciprok. Me rritjen e intereseve lokale në projekte relevante, poashtu edhe vullnetarizmi dhe mobilizimi mund të rriten. Pjesëmarrja ekonomike poashtu mund të rritet me anë të strategjive të decentralizuara të investimeve të cilat promovojnë

## Llogaridhënia dhe qeverisja lokale


Konfuzioni aktual mbi atë se kush është përgjegjës për çka, posaçërisht në relacion me ofrimin e shërbimeve (shiko kutinë 4.9), buron nga sistemi tejet kompleks dhe konfuz që tërheq linja të paqartësisë në përgjegjësi dhe parandalon qytetarët që të kërkojnë llogari nga qeveria e tyre. Gjatë konsultimeve, zyrtarët komunalë në mënyrë të vazhdueshme kanë theksuar brengat e tyre që komunat janë zakonisht të konsideruara

### KORNIZA 4.8. SATISFAKSIONI DHE PJESËMARRJA POZITIVE:

1. Njerëzit në komuna që kanë shkallë më të lartë të satisfaksionit poashtu kanë shkallë më të lartë të pjesëmarrjes pozitive.

2. Marrëdhënia më e fuqishme është ndërmjet sensit se komuna është duke shkuar në drejtim të duhur dhe pjesëmarrjes pozitive..

### KORELACIONI NDËRMJET SATISFAKSIONIT DHE PJESËMARRJA



industri të shkallës së lartë dhe shfrytëzim më të mirë të resurseve lokale, lëndës së parë dhe aftësive.

### Disavantazhet

Ekziston një numër i disavantazheve brenda decentralizimit, por këto disavantazhe mund të shmangen nese procesi menaxhohet mirë. Decentralizimi mund të fuqizojë elitat lokale dhe nuk prodhon automatikisht përfitime në efikasitet, duke shtuar kështu kostot e jo duke i zvogëluar ato. Një rrezik tjetër është se përfitimet nga decentralizimi në kuptim të ofrimit të përmirësuar të shërbimeve mund të fillojnë me humbje të ekonomisë së shkallë. Poashtu edhe standardet mund të rrëshqasin. Involvimi i komunitetit shpesh rrit kualitetin e shërbimeve, por nganjëherë, përkundër afërsisë së shfrytëzuesve të fundit, distanca nga qeveria qendrore rezulton në shërbime të kualitetit të ultë. Në këtë kuadër, mund të rrisë disparitetet në mes të grupeve të ndryshme sociale.

### KORNIZA 4.9. KONFUZIONI RRETH PËRGJEGJËSIVE

Masa e konfuzionit të respondentëve është determinuar duke pyetur respondentët se cili autoritet ata besojnë është përgjegjës për funksionimin dhe zhvillimin e secilit shërbim. Respondentët në përgjigjet e tyre kanë ofruar disa autoritete: autoritetet komunale lokale, autoritetet qendrore të Kosovës, UNMIK-un, ndërmarrjet publike dhe autoritetet e Beogradit. Niveli i konfuzionit ishte matur me masën e variacionit ndërmjet opcioneve 'për servis' që do të thotë, sa herë respondentë të ndryshëm zgjedhën autoritete të ndryshme për të njëjtin shërbim. Variacionet janë mjaft të larta për të gjitha shërbimet në Kosovë. Tregues tjetër i konfuzionit ka qenë masa deri në të cilën një përqindje e lartë e respondentëve u atribuon përgjegjësi autoriteteve lokale të cilat përgjegjësi janë qartazi në duart e UNMIK-ut, sipas Rregulloreve. Për shembull, shumica e respondentëve iu kanë atribuuar përgjegjësi autoriteteve lokale komunale për konsistencë në furnizimin me ujë dhe kanalizim, dhe sanitari (66% dhe 65%, përkatësisht). Derisa Rregullorja 2000/45 thotë se komunat janë përgjegjëse për ofrimin e këtyre shërbimeve, Rregullorja 2000/49 ka themeluar Departamentin e Shërbimeve Publike dhe ndërmarrjet publike për ofrimin e këtyre shërbimeve. Sipas Rregullores 2000/49 (shiko Nenin 3.1 të Rregullores 2000/45 dhe Nenin 1.2 dhe 2.2 të Rregullores 2000/49), struktura komanduese dhe kontrolluese e këtyre ndërmarrjeve nuk është në duart e komunës. Ngjashëm, është e pamundur të sigurohemi nese shumica e respondentëve e kanë pasur përgjigjen e saktë ose "të pasaktë" për secilin shërbim për shkak së në disa raste ndarja e kompetencave nuk është e definuar qartë, e jo vetëm pak e kuptuar nga publiku Kosovar. Si pasojë, mund të argumentohet se për shërbime të caktuara nuk ekziston përgjigje e "saktë".

Mozaiku i Kosovës, UNDP, 2003

si struktura që kanë shumë kompetenca ose autoritet, gjë të cilën nuk e kanë, dhe kjo mund të minojë legjitimitetin e tyre në sytë e votuesve, kur ata (komunat) nuk sjellin rezultatet e pritura. Sidoqoftë, organizatat e shoqërisë civile kanë kritikuar qeveritë komunale se kanë qenë të paqarta në deklarinimin e kompetencave për të arsyetuar pasivitetin e tyre dhe shërbimet e dobëta, duke thënë se komunat shumë rrallë ndërmarrin ndonjë aksion për të informuar më mirë publikun për kompetencat që i kanë<sup>32</sup>.

## Decentralizimi në kontekstin e Kosovës

Sipas AZHNJ, popullsia në Kosovë beson se mund të ndikojë më shumë në vendimet në lidhje me fqinjësinë e tyre sesa në vendimet në lidhje me komunat e tyre apo në lidhje me Kosovën si tërësi. (shiko figurën 4.2). Ekziston një perceptcion që sa më

AZHNJ poashtu ka gjetuar se sa më afër që të jetë ekonomia familjare ndaj objektit

**TABELA 4.2 DISTANCA NGA OBJEKTET SHËNDETËSORE DHE ARSIMORE DHE GJASAT PËR AKTIVITET POLITIK**

Distanca deri tek objektet më të afërta themelore shëndetësore dhe arsimore	Anëtar i ekonomisë familjare në qeverinë lokale apo në parti politike (%)
Më pak se një 1 km	52.375
Prej 1 deri në 3 km	34.675
Prej 3 deri në 5 km	9.325
Prej 5 deri në 10 km	3.05
Mbi 10 km	1.2


Burimi: UNDP Kosovë, AZHNJ 2004

shëndetësor apo arsimor, aq më i madh do të jetë shansi që ndonjë anëtar i asaj familjeje të jetë zyrtar lokal i qeverisë apo anëtar i ndonjë partie politike. (shiko tabelën 4.2) "Lidhjet" e banorëve në vendet rurale bijnë në mënyrë drastike në proporcion me distancën nga qendra, e më to edhe ndikimet. Prandaj, aspektet e decentralizimit janë prioritet urgjent, përndryshe Kosova mund të ekperiencojë shkatërrim gradual të kushteve të jetesës në vendet rurale dhe migrim masiv në vendet urbane.

Edhe pse njerëzit e rëndomtë kanë besim të madh në decentralizim, institucionet dhe shoqëritë e ndryshme kanë shfaqur brengat e tyre rreth decentralizimit si proces. Në kontekstin Kosovor, decentralizimi është politizuar në vija etnike. Ky polarizim mund të zvogëlohet nëpërmes të një procesi i cili siguron mekanizma pjesëmarrës për të gjitha komunitetet. Propozimi i Këshillit të Europës për decentralizim diskutohet në Kapitullin e Gjashtë.


Për shkak të konfliktit etnik dhe madhësisë së vogël, Kosova duhet të fokusohet në zgjidhje politike e jo në modelime administrative apo "kantonizime". Shumë shtresa të qeverisë janë të panevojshme ose kundërproduktive. Për shkak të nevojës që komuniteti serb të ketë në duart e veta proceset vitale dhe për shkak të frikës së shumicës së komunitetit shqiptar që çfarëdo zgjidhje administrative mund të shpie në ndarje të Kosovës, duhet të gjendet një zgjidhje e cila i përkrah të gjitha komunitetet etnike dhe risiguron ato se fuqia nuk do t'iu merret arbitrarisht pa pajtimin e tyre.

**FIGURA 4.2 PËRQINDJA E NJERËZVE QË MENDOJNË SE MUND TË NDIKOJNË NË VENDIM MARRJE DUKE QËNDRUAR NË DISTANCË NDAJ PROCESIT TË VENDIM-MARRJES**



Burimi: UNDP, HDS, 2004

**FIGURA 4.3 SHËRBIMET QË DO TË DUHEJ TË FUNKSIONONIN MË EFEKTIVISHT NË NIVELIN LOKAL**



Burimi: Mozaiku i Kosovës 2003

afër vendim-marrjes të jenë njerëzit, aq më shumë ndikim mund të ushtrojnë. Kjo pikë është ilustruar në "Mozaikun e Kosovës", i cili ka raportuar që njerëzit do të dëshironin të shihnin transferin e kompetencave në komuna të shërbimeve më themelore, siç është rryma elektrike (shiko figurën 4.3).



## Qeverisja në sektorin e drejtësisë dhe të sigurisë në Kosovë

Ky seksion tenton të identifikojë marrëdhënien në mes të zhvillimit njerëzor dhe temave të pjesëmarrjes dhe përfaqësimi, apo mungesat në këtë rast, në sektorin e drejtësisë dhe sigurisë (shiko kutinë 4.13). Për qëllimet e këtij raporti do të shqyrtohen vetëm shërbimet juridike/korrektuese, shërbimet e emergjencës civile dhe ato institucione civile të ngarkuara me menaxhimin dhe mbikqyrjen e këtyre organeve.

### KORNIZA 4.10. DEFINIMI I SEKTORIT TË DREJTËSISË DHE SIGURISË

Përgjithësisht, sektori i drejtësisë dhe sigurisë është i definuar si grup institucionesh ku përfshihen, por edhe nuk kufizohen: organet të cilat janë të autorizuara dhe të organizuara nga shteti për të përdorur forcën sikurse shërbimi policor, forcat e mbrojtjes, organizatat e emergjencës civile, shërbimet e zbulimit/inteligjencës, forcat paramilitare, kontrolli i kufijve, shtëpitë përmirësuese, dhe jurisprudenca. Ky sektor poashtu përfshin institucionet civile të ngarkuara me menaxhimin dhe mbikqyrjen e ekzekutivit (duke përfshirë zyrat e presidentit/kryeministrit, organet e koordinimit të sigurisë kombëtare dhe ministrisë si ajo e mbrojtjes, e brendshme dhe e drejtësisë), legjislativin (parlamentint, kuvendet dhe komisionet e tyre relevante të mbrojtjes, të çështjeve të brendshme dhe të drejtësisë) si dhe mekanizmat e kontrollit financiar të menaxhuar, për shembull, nga ministria e financave dhe komisioni parlamentar për financa.

Duke marrë parasysh statusin aktual politik të Kosovës, shumë sektorë kanë mbetur si fuqi të rezervuara të UNMIK-ut. Si të tilla, pjesëmarrja dhe përfaqësimi Kosovar është i kufizuar rëndë apo edhe joekzistent. Sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB, Shërbimi Policor i Kosovës dhe Shërbimi Juridik/Korrektues është vendosur nën autoritetin e Zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) dhe COMKFOR-it (Komandantit të Forcave në Kosovë) të NATO-s. Duke e marrë parasysh këtë, duhet të theksohet se në esencë Kosovarët e formojnë shtyllën e policisë dhe sistemit juridik. Në fakt, momentalisht janë rreth 6,000 zyrtarë të SHPK-së (15% prej të cilëve janë femra<sup>33</sup>) dhe vetëm rreth 15 prokurorë ndërkombëtarë. Për më tepër, më shumë se 90% e rasteve kriminale dhe afër 100% e rasteve civile janë dëgjuar nga gjykatësit lokalë.

## Rasti i zhvillimit njerëzor për mbikqyrjen demokratike të sektorit të drejtësisë dhe sigurisë

Institucionet publike që janë të drejta, transparente dhe efektive janë pika kyçe në krijimin e një ambienti të duhur shoqëro-ekonomik, të nevojshëm për të siguruar zhvillim njerëzor në Kosovë. Pa mbikqyrje demokratike të institucioneve të sigurisë dhe pa qasje të barabartë në drejtësi, zhvillimi njerëzor nuk do të ec përpara.

Të gjithë Kosovarët e dijnë shumë mirë që institucionet e sigurisë mund të sulen në pjesëtarët më të ndieshëm të shoqërisë, duke penguar betejat e tyre të përditshme për mbijetesë dhe duke i prerë liritë themelore të tyre. Përgjatë gjithë historisë, qeveritë autoritare kanë rezistuar ose i kanë zbrapsur lëvizjet drejt pjesëmarrjes dhe përfaqësimit më të madh, duke u arsyetuar se demokracia është jokompatible me rendin publik dhe sigurinë personale<sup>34</sup>. Por të dhënat sugjerojnë që e kundërta e kësaj është e vërteta: mbikqyrja demokratike dhe civile e qeverisë dhe sektorit juridik, larg nga rrezikimi i sigurisë personale, në fakt janë esencale për këtë sistem.

Forcat jugosllave të sigurimit dhe sistemi juridik, të udhëhequra nga Serbia kanë dështuar në përfaqësimin e nevojave dhe aspiratave të shumicës së qytetarëve, dhe në kohë të caktuara, në mënyrë të vendosur kanë kërkuar të minojnë pjesëmarrjen Koso-

TABELA 4.3 BUXHETI I PËRGJITHSHËM I KOSOVËS 2004 PËRMBLEDHJA E PËRCAKTIMEVE: DREJTËSIA DHE SIGURIA

Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës 2004	Përcaktimet në Euro FY 2004-2005	Përqindja e përcaktimeve totale
Rendi dhe Siguria Publike (SHPK, Jurisprudenca etj)	80 861 846	12.78%
Shërbimi Policor i Kosovës	52 960 000	8.37%
Drejtësia (duke përfshirë Departamentin e Admin. juridik)	14 228 250	2.25%
Shërbimet përmirësuese	11 000 000	1.73%
<b>Totali</b>	<b>632 325 922</b>	<b>100.00%</b>

Burimi: MEF, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, 2004

vare në vendim-marrje në lidhje me çështjet që ndikonin drejtpërdrejtë në jetërat e tyre. Në këtë aspekt konflikti (si ai paqësor dhe lufta e armatosur) ka qenë rezultat i paevitueshëm. Sot, pjesëmarrja dhe përfaqësimi Kosovar në drejtësi dhe siguri është ende i kufizuar. Në të njëjtën kohë, prania e strukturave paralele vazhdon të jetë prezente.

Njerëzit e varfër dhe të rezikuar përgjithësisht theksojnë se siguria e dobët është pengesa kryesore në zhvillimin e tyre njerëzor. Në një anketë të kohëve të fundit, 81% e Kosovarëve të intervistuar besonin se situata e sigurisë në Kosovë është përmirësuar ose ka mbetur e njëjtë me atë të vitit 2003, dhe 56% punën e SHPK-së e konsiderojnë si të shkëlqyeshme ose të mirë<sup>35</sup>. Sidoqoftë, respondentët serbë nga Kosova pothuajse në dy herë më shumë besonin se kushtet e sigurisë ishin edhe më të dobëta gjatë periudhës së njëjtë (29% krahasuar me 16%).

Shumë vende kanë rënë në kurthin e rrethit vicioz të varfërisë dhe konfliktit, posaçërisht ato vende të cilave iu mungojnë institucione të qëndrueshme juridike dhe të sigurisë, për të mbajtur paqen dhe rendin. Sidoqoftë, në shumë vende, fuqia e madhe e shërbimeve juridike dhe të policisë mund të jetë pengesa më e madhe në ndërtimin e institucioneve njëmend të hapura dhe demokratike. Drejtësia dhe siguria nuk ushtrohen thjesht nga akterët qeveritarë (ose jo-qeveritarë) mbi individët dhe komunitetet; ato duhet të aplikohen në mënyrë të duhur nëpërmes të menaxhmentit dhe mbikqyrjes së këtyre institucioneve. Ky është element fundamental i qeverisjes demokratike dhe sundimit të ligjit. Për sundimin e ligjit në Kosovë, prioritet kryesor është krijimi i një sistemi të unifikuar (duke përfshirë edhe shpërbërjen e strukturave paralele) dhe me qasje më të lehtë.

Derisa qeveria ka përgjegjësin për t'i ofruar qytetarëve të vet drejtësi dhe siguri, asnjë qeveri nuk mund të jetë e sigurtë apo prosperuese nese populli i vet ka frikë nga ofruesit e shërbimeve juridike apo të sigurisë. Kjo posaçërisht është e vërtetë në shoqëritë e dala nga konfliktet e dhunshme dhe që janë në tranzicion nga institucionet dhe praktikat autoritare.

### *Plani për implementimin e standardeve për Kosovës: rruga përpara*

Bashkësia ndërkombëtare i vlerëson lartë standardet e qeverisjes së mirë të institucioneve të reja publike të Kosovës si parakusht për diskutimet mbi statusin e ardhshëm politik të Kosovës. Si pasojë, pas

konsultimeve disamujore në mes të zyrtarëve të IPVQ-së dhe UNMIK-ut, në fund të Marsit 2004 është bërë plani për implementimin e standardeve për Kosovën. I cili mund të shikohet si 'udhërrëfyes', kundrejt të cilit mund të matet sektori i drejtësisë dhe sigurisë së Kosovës.

- 'Standardet për Kosovën' e përshkruajnë Kosovën si vend ku institucionet publike janë përfaqëuese dhe demokratike, ku sundimi i ligjit është efektiv, i respektuar dhe me qasje për të gjithë...<sup>36ii</sup>. Duhet të bëhet çdo përpjekje për të filluar me angazhimin e qytetarëve dhe institucionet lokale në dialogun për të gjitha aspektet e qeverisjes dhe respektimin të ligjit, duke përfshirë këtu fushat e ndieshme ku fuqitë nuk janë transferuar ende në IPVQ. Në demokracitë e fuqishme, edhe çështjet më delikate zyrtare i nënshtrohen mbikqyrjes civile dhe shpeshherë analizimit publik.

- PISK përshkruan aksionet që duhet ndërmarrë nga ana e IPVQ-së dhe institucionet tjera për të arritur këto standarde. Aksionet e UNMIK-ut në pjesët më të madhe të planit, janë në përkrahje të IPVQ-së. Në disa raste, posaçërisht në fushat e kompetencave të rezervuara (siç është sundimi i ligjit), UNMIK-u mban përgjegjësin primare për veprim, pasi që mban përgjegjësinë ligjore dhe funksionale për këto Standarde<sup>37</sup>.

- Në dritën e dhunës së 17-20 Marsi 2004, prioritet imediat është krijimi i rendit të ligjit, ndjekja e shkaktuesve të dhunës dhe respekti publik i rendit dhe iligjit.<sup>38ii</sup> Edhe pse kompetenca janë në dorë të UNMIK-ut, konsultimet e rregullta me IPVQ-në për çështjet e rendit dhe ligjit mund të kontribuojnë shumë në restaurimin e stabilitetit të nevojshëm për të adresuar në mënyrë efektive burimet e shpërthimit të dhunës së fundit.

- Është esenciale që institucionet e Kosovës, duke përfshirë institucionet e qeverisë, parlamentin dhe organet e nivelit komunal, të shënojnë progres në lejimin e pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve dhe në përpilimin dhe implementimin e politikave që mbrojnë plotësisht të drejtat

dhe reflektojnë nevojat e të gjitha komuniteteve<sup>39</sup>. " Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave njerëzore involvon të gjitha nivelet e qeverisë dhe duhet të jetë e pranishme të gjitha institucioneve publike, por posaçërisht në institucionet e sektorit të drejtësisë dhe sigurisë.

Përkundër numrit të pafundëm të sfidave që ballafaqohen me rritjen e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në Kosovë, ekzistojnë disa shenja të progresit në sektorin e sigurisë, që duhet të inkurajohen. Kapaciteti i ndërtuar gjatë pesë viteve të fundit, është themel për çdo vendim-marrje në këtë sektor, është përgjegjësi e Kosovarëve.

Si dokument i gjallë, PISK do të shqyrtohet dhe revidohet në muajt e ardhshëm për të siguruar se aksionet e implementuar në afat të shkurtër do të maksimalizojnë progresin drejt arritjes së standardeve. Për shembull, seksioni për kthimin dhe lirinë e lëvizjes është duke iu nënshtruar disa ndryshimeve në dritën e ngjarjeve të Marsit, në mënyrë që të sigurohet që aksionet e planifikuara të mund të përmbushin standartet.

Ka mbetur vetëm edhe një vit deri në Korrik 2005. Prandaj, në sektorin e drejtësisë dhe sigurisë duhet të krijohet vëmendje e bashkërenditur për të ndërtuar përgjegjësitë e menaxhmentit dhe mbikqyrjes civile, në mënyrë që të përgatiten për një pako të re realitetesh operacionale. Këtu ka gjasa të përfshihen:

- Redukime të dukshme në policinë e UNMIK-ut, si dhe në personelin ndërkom-bëtar në Departamentin e Drejtësisë, (shiko tabelën 4.4).

**TABELA 4.4: REDUKTIMET NË POLICINË E UNMIK-UT**

Data	Totali i SHPK-së	Totali i UNMIK-P
Përqindja		
Rritje/Zvogëlim	20% Increase	18% Decrease
Dhjetor 2003	5 704	3 735
Shtator 2003	5 769	3 727
Qershor 2003	5 207	4 067
Mars 2003	5 247	4 389
Tetor 2002	5 240	4 274
Qershor 2002	4 770	4 524

Burimi: UNMIK Police Press Office

- Transferimi i shumicës së operacioneve regionale policore tek SHPK-ja, të shoqëruara me dorëzimin e funksioneve qendrore deri ka mesi i vitit 2006. Deri në këtë kohë, SHPK duhet të jetë bërë entitet plotësisht i vetëqëndrueshëm, i financuar nga Buxheti i Kosovës.<sup>40</sup>

- Zhvillimi i mëtejshëm i Zyrës Ndërlidhëse për Siguri Publike, e krijuar në Janar 2004 brenda Zyrës së Kryeministrit, duhet të rrisë rrjedhën e informacioneve në çështjet që kanë të bëjnë me rendin dhe ligjin.

Me përsheptimin e përgjegjësive operacionale dhe politike, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë angazhimit të civilëve (nga brenda dhe jashtë qeverisë) në menaxhimin dhe mbikqyrjen e akterëve të drejtësisë dhe sigurisë. Korniza politike që balanco interesat dhe pjesëmarrjen e akterëve të ndryshëm në sektorin e drejtësisë dhe sigurisë - duke përfshirë qeveritë lokale dhe atë qendrore, ekzekutivin, legjislatoren, mediat dhe shoqërinë civile - do të promovojë qëllimet e ndërlidhura të qeverisjes demokratike dhe zhvillimit njerëzor.

Analiza e prezentuar në këtë kapitull ka shkoqitur disa sfida kryesore për thellimin dhe zgjerimin e qeverisjes demokratike në Kosovë; sidoqoftë, në këtë dokument nuk janë përfshirë shumë çështje tjera të rëndësishme. Kapitulli i Pestë fokusohet në "Shumicën e Heshtur" në kuptim të pjesëmarrjes; grupet e ndjeshme janë të lëna jashtë procesit në masë të madhe. Në këtë linjë, Kapitulli i gjashtë rekomandon reformat kryesore politike dhe institucionale për zgjerimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të qytetarëve dhe për fuqizimin e qeverisjes së mirë demokratike në Kosovë.



# SHUMICA E HESHTUR

## Hyrje

"Fuqia e një shoqërie mund të matet me atë se si i trajton anëtarët e vet më të dobët..." - **Mahatma Gandhi**

Pjesëmarrësja dhe përfaqësimi kanë për qëllim fuqizimin e njerëzve që të kenë zë domethënës në vendim-marrje dhe për të kërkuar llogari nga liderët e tyre. Por, çka ndodh me pjesëtarët më pak të fuqishëm të shoqërisë, të cilët zakonisht kanë më pak kohë të ushtrojnë të drejtat e tyre politike në betejën e tyre për t'u përballur me jetën e përditshme? Që nga femrat e paarsimuar dhe rinia e papunë e deri tek minoritetet që frikësohen për (pa)sigurinë e tyre, dhe invalidët e të moshuarit të cilët kanë nevojë për vëmendje të përditshme, Kosova ka një pjesë bukur të madhe të grupeve 'të ndieshme' që në shoqërinë e saj janë të marginalizuara. E kujt është përgjegjësia për të siguruar që çështjet e tyre kritike, shpesh çështje këto për jetë a vdekje, janë të prioritetuara në qeverinë e preokupuar me presione të panumërta konkurruese në baza ditore.

Pa marrë parasysh se sa të hapura ndaj pjesëmarrjes janë strukturat e qeverisjes, apo sa përfaqësuese mund të jenë grupe të caktuara shoqërore lehtë dhe pa qëllim mund të lihen jashtë procesit të vendim-marrjes dhe për pasojë edhe jashtë procesit të zhvillimit. Siç është vërejtur në disa RZHNJ, pothuajse secili vend (pavarësisht nese është i pasur apo i varfër) ka një apo më shumë grupe etnike që nuk përfiton në mënyrë të plotë nga frytet e zhvillimit dhe që niveli i tyre i zhvillimit njerëzor është shumë më poshtë se mesatarja në nivel nacional<sup>1</sup>. Siç ilustron RZHNJ Regjionale e titulluar "Romët në Europën Qendrore dhe Lindore", grupet e marginalizuara siç janë romët, kanë nevojë për vëmendje dhe politika të vecanta për të lehtësuar kyçjen e tyre në shoqëri<sup>2</sup>.

Ky kapitull përqëndron vëmendjen në disa grupe të ndjeshme, posaçërisht tek femrat, rinia e papunësuar, fermerët me kushte minimale për jetesë dhe minoritetet (posaçërisht RAE - romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët). Derisa pranon se kjo në asnjë mënyrë nuk është listë e gjatë e njerëzve të

margjinalizuar në Kosovë, ky kapitull do të ofrojë diskutim më të thellë për ato grupe që në kapitullin e dytë janë konstatuar të jenë në ekstremin e ulët të shkallës së zhvillimit njerëzor. Poashtu do të përmenden dhe grupet tjera të marginalizuara duke përfshirë invalidët dhe njerëzit më çrregullimet traumatike në Kosovë, pesë vite pas përfundimit të konfliktit.

Kur parimet demokratike të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit ia dalin të sigurojnë zhvillimin njerëzor, duhet të bëhet çdo përpjekje e mundshme që të ndihmohen edhe grupet më të ndieshme. Zërat dhe ndikimi i tyre në vendim-marrje lehtë mund të mos merret parasysh nese nuk ekziston përkrahja nga promovuesit e drejtësisë sociale që mund të flasin në mënyrë aktive dhe të llobojnë në emrin e tyre. Në njëfarë mënyrë, agjenda për të eliminimin e pengesave të shumta me të cilat ballafaqohet Kosova, është mjaft komplekse dhe e gjërë. Në anën tjetër, rrjetet për ndryshimin dhe disponueshmërinë e resurseve njerëzore, qoftë brenda shoqërisë civile dhe qeverisë, janë impulsionuese. Ndoshta shenja më inkurajuese është kur individët e ndieshëm apo të stigmatizuar në kuptimin shoqëror aktivizojnë fuqinë dhe kreativitetin e tyre të brendshëm për të udhëhequr zhvillimin e tyre dhe për të përmirësuar kushtet jetësore brenda komuniteteve të tyre. Edhe pse si proces është i ngadalshëm dhe i mundimshëm, kjo saktësisht është sfida me të cilën ballafaqohen me mijëra Kosovarë dhe familje të tyre që kërkojnë mundësi më të mira jetese dhe barazie para ligjit.

## Femrat

Sikurse në vende tjera të Europës Lindore, aranzhimet socialiste që "garantonin" barazi gjinore dhe zakone tradicionale që thirrshin në respektimin e femrave, i kanë dhënë hapësirë argumentit që Kosovës nuk i duhen ligje, institucione apo zëdhënës të posaçëm për femrat. Aranzhimet e reja, arsyetohej, vetëm se do t'i marginalizonin femrat si grup i posaçëm interesi dhe do t'i "getoizonte" brengat e tyre. Siç është treguar në Figurën 5.1, kjo pikëpamje në Kosovë nuk ka mbizotëruar dhe është arritur shumë në kuptim të kyçjes së femrave në rrjedhat shoqërore. Në të vërtetë, siç është diskutuar

*Pa marrë parasysh se sa të hapura ndaj pjesëmarrjes janë strukturat e qeverisjes, apo sa përfaqësuese mund të jenë grupe të caktuara shoqërore lehtë dhe pa qëllim mund të lihen jashtë procesit të vendim-marrjes dhe për pasojë edhe jashtë procesit të zhvillimit*

### KORNIZA 5.1. KYÇJA E GJINIVE NË RRJEDHAT SHOQËRORE

Kombet e Bashkuara e definojnë kyçjen e gjinive në rrjedhat shoqërore si "proces të vlerësimit të implikimeve për femrat dhe meshkujt në çfarëdo veprimi të planifikuar, duke përfshirë legjislationin, programet apo politikat në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet. Është strategji që ka për qëllim bërjen e brengave të meshkujve dhe femrave dimension integral të dizajnit, implementimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore në mënyrë që si femrat poashtu edhe meshkujt të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe që pabarazia të mos zëjë vend.

"Gender Mainstreaming in Practice: A Handbook" (UNDP: Regional Bureau for Europe and CIS)

Kyçja e gjinive në rrjedhat shoqërore në Kosovë është definuar nëpërmes të krijimi të mekanizmave institucionale, ligjeve, zyrave, standardeve dhe aktiviteteve, qëllim i të cilave është "fuqizimi i femrave në Kosovë". Në këtë kuadër, Zyra për Qeverisje të Mirë, e cila është formuar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, është duke punuar në një spektër politikash dhe strategjish:

- Krijimi i administratës dhe shërbimeve civile në nivelin lokal dhe qendror, të bazuar në standardet ndërkombëtare.
- Institucionalizimi i çështjeve gjinore dhe barazisë gjinore në Kosovë.
- Krijimi i politikës që promovon barazinë gjinore në administratën civile.
- Përmirësimi i rolit dhe shtytja e pozitës së femrës në proceset vendim-marrëse.

• Krijimi i një bashkëpunimi më të suksesshëm në mes të institucioneve lokale dhe shoqërisë civile.

Krijimi i një bashkëpunimi më të mirë në mes të gjitha hallkave të zinxhirit që qeverisin në Kosovë, posaçërisht në qeverinë ekzekutive dhe atë ligjvënëse, ku si parim dhe themel është barazia gjinore dhe roli i femrave<sup>1</sup>.

Në Kosovë deri më tani janë krijuar disa mekanizma institucionale, duke përfshirë:

- Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të femrave (KEGFD) është pjesë e Kornizës Kushtetuese të Kosovës<sup>2</sup>.
- Zyra e UNMIK-ut për Çështje Gjinore.
- Zyra e Qeverisjes së Mirë, të drejtave njerëzore, mundësive të barabarta, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
- Komisioni për mundësi të barabarta dhe çështje gjinore pranë Parlamentit të Kosovës
- Grupi ndër-ministror i barazisë gjinore, brenda qeverisë së Kosovës
- 10 përfaqësues të ministrive në çështjet gjinore
- 30 zyra komunale për çështje gjinore
- 12 komisione për barazi gjinore të kuvendeve komunale
- Zyra e Ombudspersonit
- Ligji mbi Barazinë Gjinore
- Ligji i Anti-diskriminimit.
- Plani veprues për arritjen e barazisë gjinore.

Një sukses i rëndësishëm që është arritur në Kosovë është kërkesa që së paku 30% e ulëseve parlamentare t'u takojnë femrave.

<sup>1</sup> Marrur me leje nga raporti i IGK-së në konferencën "A jemi në drejtimin e dubur të fuqizimit të femrës në Kosovë," (në shtyp 2004). Prezentim nga Cyme Mabmutaj, Zyra Kësbilluese për Qeverisje të Mirë, të drejta njerëzore, mundësi të barabarta dhe barazir gjinore, pranë Zyrës së Kryeministrit.

<sup>2</sup> Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të femrave (KEGFD): "Vendet që kanë ratifikuar KEGFD-në janë të përkushtuara për të realizuar barazinë ndërmjet femrave dhe meshkujve nëpërmes të sigurimit të qasjes së barabartë dhe mundësive të barabarta në jetën politike dhe publike, si dhe në arsimim dhe punësim. Për më tepër, komisioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe implementimin e KEGFD periodikisht lëshon rekomandime të cilat mund të udhërrëfjojnë vendet për ndërveprime konkrete për të eliminuar diskriminimin gjinor." In Astrida Neimanic dhe Arkadi Tortisyn, "Gender Thematic Guidance Note #2," UNDP Human Development Report Office/National Human Development Report Series, July 2003, 8.

në Kornizën 5.2., promovimi i barazisë gjinore është bërë pjesë integrale e zhvillimit politik të Kosovës.

### Varfëria e mundësive

Përkundër këtyre arritjeve, ekziston një numër i madh sfidash që duhet të tejkalohen për të siguruar se femrave Kosovare iu ofrohen mundësi të barabarta. Kosova mund të përfitojë shumë nga angazhimi proaktiv i femrave në fushat e politikës, ato sociale, të ekonomisë dhe ato kulturore. Sidoqoftë, shumë femra ballafaqohen me varfëri në mundësi, jo vetëm në kuptim të arsimimit siç shihet në Kapitullin 2, por poashtu edhe në kuptim të roleve të paracaktuara të tyre shoqërore. Ky seksion analizon sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen femrat Kosovare në shtëpi dhe në tregun e punës.

### Trajtimi i femrave në shtëpi

Shtëpia është vendi më i zakonshëm ku manifestohet pabarazia gjinore dhe Kosova nuk përbën përjashtim. Siç është vërejtur tek Folbre<sup>3</sup>, "tranzicioni" në Europën Lindore ka krijuar në disekuilibër të punës së papaguar, në mes të meshkujve dhe femrave. Eliminimi i shërbimeve të ofruara pa pagesë nga shteti në të kaluarën (përkujdesja shëndetësore, përkujdesi ndaj fëmijëve, etj.), të gjitha shpesh kanë rezultuar në plotësimin e zbrazëtisë së krijuar dhe tani femrave u mbetet të bartin barrën e tranzicionit. Në Kosovë, femrave iu caktohet sasi në rritje e punës, siç janë punët e shtëpisë dhe përkujdesi ndaj fëmijëve. Përveq kësaj, përkrahja e arsimimit të femrave nga familjet është e ulët apo mungon. Ngjashëm, pjesëmarrja në përmirësim e sipër në jetën publike (në organizata qeveritare e jo-

## KORNIZA 5.2. NDRYSHIMI I REGJIMEVE GJINORE NË KOSOVË

Dezintegrimi i socializmit shtetëror dhe përfundimi i Luftës së Ftohtë ka bërë transformime të shumta në shoqëritë e Europës Lindore: ndryshime në sistemin politik; përpjekje për të zhvilluar tregjet e hapura; shoqëri civile dhe media të lira; rikthim të pronës, bile edhe konflikt. Të gjitha këto ndryshime përshkruhen nga studiues të ndryshëm si "dhimbje të tranzicionit". Të gjitha proceset tranzicionale janë të karakterizuara me përpjekje për të ristrukturuar institucionet shtetërore dhe ligjore dhe të ridefinojnë konceptet e drejtësisë dhe barazisë. Ridefinimi i roleve gjinore dhe lëvizjeve të femrave kanë pjesë integrale të këtyre transformimeve. Shpesh nëpërmes mjeteve të dhunshme, siç është dhuna seksuale e bërë gjatë konflikteve etnike në Jugosllavi, transformimet "gjinore" ka qenë thelbi i përpjekjeve për të krijuar legjitimitet dhe autoritet politik për formacionet e reja politike (shtetet-komb, "demokracia", anëtarësi në NATO dhe BE, etj.).

Regjimi i mëparshëm socialist ka krijuar garancione dhe mbrojtje ligjore për të siguruar se femrat kanë të drejta të barabarta në punësim, çështje pronësore dhe në fusha tjera të ndryshme. Hapja e Universitetit të Prishtinës në vitin 1968 ka qenë ngjarje shumë e rëndësishme jo vetëm për arsimimin në Kosovë si tërësi, por posaçërisht për arsimimin e femrave. Kushtetuta e Jugosllavisë, e vitit 1974 ka ofruar më shumë të drejta për femrat, në kohën kur arsimimi fillor u bë i detyrueshëm dhe shkollat e analfabetizmit pat rënë dukshëm. Femrat me të madhe iu bashkuan radhëve të doktorëve, juristëve, ekonomistëve, profesorëve të universitetit, etj.

Prapëseprapë, femrat vazhdonin të jenë përgjegjëse në rolet e punës tradicionale dhe paguheshin më pak sesa meshkujt. Kombinimi i barazive të parapara me ligj dhe roleve të detyruara shoqërore për femrat si amvise, nëna, dhe kujdestare, ka krijuar të ashtuquajturën "ngarkesë të dyfishtë". Për shembull, në Kosovë edhe pse shkalla e arsimimit të femrave është rritur, shkalla e natalitetit vazhdon të mbetet më e larta në vend.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Janet Reineck, "Seizing the Past Forging the Present: Changing Visions of Self and Nation Among the Kosova Albanians," in *Anthropology of East Europe Review*, Autumn 1993 (Special Issue: War Among the Yugoslavs).

<sup>2</sup> Nira Davis-Yuval dhe Floya Anthias, Eds., *Women-Nation-State* (New York: St. Martin's Press, 1989). Si riprodhues biologjikë të kolektiviteteve etnike; si riprodhues të kufijve të grupeve etnike/nacionale; si pjesëmarrëse qendrore në riprodhimin ideologjik të kolektivitetit dhe si përçues të kulturës së vet; si dallues të diferencës etnike/nacionale-si fokus dhe simbol në diskutimet ideologjike të sjfrytëzuara në konstruktimin, riprodhimin dhe transformimin e kategorive etnike/nacionale; si pjesëmarrëse në betejat kombëtare, ekonomike, politik dhe ushtarake.

<sup>3</sup> Astrida Neimanic dhe Arkadi Tortisyn, "Gender Thematic Guidance Note #2," Zyra e raportit të zhvillimit njerëzor në UNDP/Seritë e raporteve kombëtare të zhvillimit njerëzor, Korrik 2003.

Një ndërrim i rëndësishëm ndodhi në vitet 1990 kur filloi dezintegrimi i Jugosllavisë. Thirrjet për pluralizëm dhe formim të partive të reja politike ka përkrahur një ambient të përshtatshëm për krijimin e organizatave jo-qeveritare të femrave (p.sh. Motrat Qiriaz, Qendra për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Gruas) dhe qarqet politike të orientuara kah feminizmi filluan të shfaqen. Forumi i Gruas brenda LDK-së (Lidhja Demokratike e Kosovës) ishte një mjet i hershëm dhe i rëndësishëm për organizimin dhe inkurajimin e grave shqiptare për të marrur pjesë në jetën politike. Këto forume të ndryshme patën krijuar një themel mbi të cilat më vonë u formuan organizata dhe rrjete tjera të grave, të cilat adresonin brengat nga më të ndryshme të femrave në Kosovë (në vendet rurale dhe urbane, ndër femrat e arsimuara dhe të paarsimuara, nënat, profesionistet, aktivistet, etj.).

Në të njëjtën kohë, diskurset fillestare nacionaliste me vete kanë ofruar forma të reja të dominimit, dhe shumë njerëz ato i quanin "kthimin në vlerat tradicionale". Të mobilizuar në të gjitha mënyrat e vërejtura nga Yuval-Davis dhe Anthias, femrat u bënë "reprodukuesit" e kombit<sup>2</sup>. Ekistonte një presion i jashtëzakonshëm që gratë shqiptare së pari duhet të luftojnë për pavarësinë e tyre dhe mandej të brengosen për barazinë gjinore. Në periudhën e pasluftës, ky nuk është më qëllimi kryesor i aktivisteve për femra si dhe anëtarëve të shoqërisë civile. Emancipimi i femrave shihet si proces fundamental në zhvillimin politik.

*Vërejtje: Shpesh nuk vlerësohet si dubet fakti se këto ndërrime politike kanë dbënë ridefinime të meshkujve dhe rolit të tyre në shoqëri. Si për shqiptarët e poashtu edhe për serbët në Kosovë, konstruktionet e burrërisë mbi martirizmin, heroizmin dhe patriotizmin kanë qenë dominante. Në mënyrë që IZHGJ të vendosjes në qasjen të lidhur me pjesën tjetër të shoqërisë në kycjen e gjinive në rrjedhat shoqërore<sup>3</sup>, poashtu dubet të përfsibibet edhe analiza sociale e roleve të paracaktuara të meshkujve.*


qeveritare) dhe në ndërtimin e kapitalit shoqëror në këtë grup, nuk është gjërësisht e promovuar. Realitetet shoqëro-ekonomike, si këto që u përmendën, dekurajojnë femrat Kosovare për të kërkuar standard më të mirë të jetesës dhe për të ngritur zërat për brengat e tyre të veçanta.

## Preferenca për djemtë

Pozita e pafavorshme e femrave në shoqërinë Kosovare është e ilustruar mirë nga preferenca për të pasur fëmijë meshkuj. Sipas Anketës Demografike të Shëndetit të Kosovës<sup>4</sup>, në të cilën respondentët janë pyetur rreth numrit të djemve dhe vajzave që dëshirojnë të kenë, është regjistruar preferencë e dalluar për djemtë.

Mesatarisht, femrat preferonin që të keni më shumë djemë sesa vajza (22%), dhe gratë e vjetra dëshironin të kenë më shumë fëmijë sesa ato të rejtat.

FIGURA 5.1 PREFERENCA PËR DJEMTË SIPAS MOSHËS DHE VENDIT URBAN/RURAL




Burimi: SZK ADSHK 2004

## Femrat në tregun e punës


Shumica e femrave të Kosovës (69%) nuk marrin pjesë në fuqinë e punës dhe, në rajonet rurale tre të katërtat e të gjitha femrave nuk marrin pjesë në fuqinë formale të punës.

FIGURA 5.2 TË PAPUNËSUAR DHE NË KËRKIM TË PUNËS



Burimi: AZH NJ 2004 UNDP Kosovë

## F5.3 PËRQINDJA E FEMRAVE JASHTË FUQISË PUNËTORE DHE ARSYET, SIPAS MOSHËS



Burimi: AZH NJ 2004 UNDP Kosovë

Siç shihet në Figurat 5.2, 5.3 dhe 5.4, analiza më e afërt e AZH NJ zbulon disa trende shqetësuese të mundësive në dispozicion për shumë femra në Kosovë. Siç është pritur ndoshta, përqindja e femrave që nuk marrin pjesë në fuqinë punëtore është më e lartë në komunat me IZH NJ më të ulët, e edhe më e lartë ku papunësia e përgjithshme është më e madhe. Në komunat ku femrat janë më pak të arsimuara, pjesa e femrave që rrijnë në shtëpi poashtu është e lartë

Përqindja e femrave të papunësuar që në mënyrë aktive kërkojnë punë, ka gjasa të bie dukshëm, kur ato mbërrijnë moshën 26 vjeçare. Në këtë moshë, shumica e femrave martohen dhe dalin nga fuqia punëtore.

## Ndarja gjinore e punës

Duke shkoqitur të dhëna nga shifrat e përgjithshme, AZH NJ zbulon se mbi 85% të femrave që punojnë janë të punësuar në sektorin e shërbimeve, derisa vetëm 8% punojnë në industri dhe rreth 6% në bujqësi. Anketa<sup>5</sup> e vitit 2003 mbi Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM-të) në Kosovë, ka gjetur se 23% e të punësuarëve në këtë sektor janë femra dhe vetëm 6% të NVM-ve janë pronë e femrave. Më pak se 30% të juristëve, zyrtarëve të lartë dhe menaxherëve janë femra, dhe shifrat e njëjta qëndrojnë për postet profesionale dhe teknike.

Rregulloret aktuale të zgjedhjeve detyrojnë të arrihet kuota prej 30% për femrat. Për shkak të kësaj, 30% e deputetëve të Parlamentit të Kosovës janë femra. Edhe pse 8 nga 19 kryesuesit e komisioneve parlamentare janë femra, vetëm një femër aktualisht është Ministre në qeveri dhe asnjë femër nuk udhëheq ndonjë kuvend komunal. Në postet e larta të qeverisë komunale, femrat janë të mbinumëruara nga meshkujt. Prej totalit të 326 udhëheqësve të departamenteve komunale, vetëm 22 janë femra dhe ky numër është i ndarë në dy pjesë të barabarta ndërmjet femrave shqiptare dhe serbe. Siç është diskutuar në Kapitullin 4, femrat poashtu mungojnë shumë në strukturat e udhëheqësisë brenda partive politike në nivelet qendrore dhe lokale.

Siç është diskutuar më lartë, është bërë shumë në përmirësimin e pozitës së femrave në shoqërinë Kosovare si dhe në promovimin e përfshirjes së tyre në jetën publike; megjithatë, mbeten shumë sfida që duhet të zgjidhen. Në Kapitullin 6 janë paraqitur sugjerimet për reformat specifike në këtë aspekt.

## Rinia


Meshkujt dhe femrat e reja në Kosovë (nën moshën 25 vjeçare) përbëjnë 52% të popullsisë dhe janë resurs i vlefshëm njerëzor për t'u kapitalizuar në zhvillimin e ardhshëm të Kosovës. Këtij grupi shoqëror duhet t'i ofrohen mundësi që të vendosen në linjë të barabartë me homologët e tyre evropianë, ose së paku të adresohen nivelet aktuale të ndjeshmërisë



## Papunësia

Rinia kosovare ballafaqohet me sfida shumë të mëdha, jo pak prej të cilave nënkuptojnë shkallën shumë të lartë të papunësisë; kjo shkallë është mbi 63% për të rinjtë e moshës prej 15 deri në 24 vjeç. Sipas ESK-së<sup>7</sup>, 85% e të rinjve prej 15 deri 19 vjeçar dhe të diplomuarve të gjeneratës së fundit apo të atyre që kanë lënë shkollën, janë të papunë. Shifrat nga Departamenti i Punës dhe Punësimi<sup>8</sup> tregojnë se në vitin 2003, të rinjtë kanë vuajtur nga rritja më e madhe e papunësisë (14.6%). Shkalla e papunësisë tek femrat e reja është 74%, (shiko Figurën 5.2) derisa për meshkujt e rinj është 56%. Duke marrur parasysh që rreth një e treta<sup>9</sup> e popullsisë është nën moshën 14 vjeçare, kriza e punësimi me të cilën ballafaqohet gjenerata e ardhshme e Kosovarëve është më shumë se alarmuese.

FIGURA 5.4 PAPUNËSIA SIPAS GJINISË DHE MOSHËS



Burimi: AZH NJ 2004 UNDP Kosovë

## Sfidat në tregun e punës

Sfidat me të cilat ballafaqohen të rinjtë që hyjnë në tregun e punës në Kosovë kërkojnë vëmendje. Me rastin e hyrjes në fuqinë punëtore, Kosovarët e rinj i bashkohen një turmë të madhe njerëzish (rreth 580,000<sup>10</sup>) të cilët poashtu janë në kërkim të pjesëmarrjes domethënëse në ekonomi. Për më tepër, aftësitë e tyre janë të formësuara nga një sistem arsimor i kualitetit të dyshuar. Andaj, shumica e tyre janë nën presion të marrin punë joformale, siç janë shitjet në rrugës dhe kështu me radhë. Sipas Bankës Botërore<sup>11</sup>, mungesa e njohurive praktike dhe përvojës së punës, e kombinuar me aftësi të pakta, paraqesin barrierën kryesore

të punësimi për të diplomuarit dhe të rinjtë që lëshojnë shkollat. Siç është diskutuar në Kapitullin 1, shkalla e regjistrimit në arsimimin universitar në Kosovë ka rënë. Mungesa e zhvillimit në sektorin e arsimimit ka nënkuptuar që nuk ka vende të mjaftueshme në dispozicion për popullsinë e madhe të re. Një Raport i kohëve të fundit nga Riinvesti thekson nevojën urgjente për reforma në këtë sektor, për të përgatitur në mënyrë të duhur popullsinë e re të Kosovës për nevojat e tregut të punës në shekullin 21<sup>12</sup>. Përndryshe, ka shumë gjasa që shumë të rinj në Kosovë të mbesin të paafte për një kohë të gjatë, të kenë nivele të ulëta pagash dhe, si rezultat, të rezikohen që të bijnë në varfëri. Siç është elaboruar në Kapitullin 6, duhet të bëhen përpjekje të veçanta për të krijuar mundësi dhe zgjedhje më të mira për këtë grup kryesor shoqëror.

## Të varfërit ruralë

Siç është vërejtur në Kapitullin 2, incidenca e varfërisë është më e larta në vendet rurale, ku banon përafërsisht 60% e popullatës. Tri herë më shumë njerëz jetojnë në varfëri ekstreme<sup>13</sup> në vende rurale sesa në vende urbane. Posaçërisht alarmues është fakti se përqindja e qytetarëve ruralë që jetojnë me 1\$ në ditë apo më pak është 13% dhe përqindja e njerëzve që jetojnë pa qasje në ujësjellës (48%) nuk tregon shenja të përmirësimit.

## Fermerët në mbijetesë

Mbi 57 % të ekonomive rurale familjare raportojnë se vetëprodhimi iu ofron pjesë të konsiderueshme të nevojave ushqimore për ekonomitë e tyre familjare (shiko Tabelën 5.1).

TABELA 5.1: PJESA E BUJQËSISË MBIJETUESE

	Rural (%)	Urbane (%)	Total (%)
Pa prodhim shtëpiak	26.6	80.3	51.4
Prodhim mesatar	15.8	7.4	11.9
Prodhim të konsiderueshëm	57.6	12.2	36.6

Burimi: AZH NJ 2004 UNDP Kosovë

Remitencat nga farefisi që jeton jashtë Kosovës, të cilat vlerësohet të jenë përafërsisht rreth 500 milionë euro për vit<sup>14</sup>, janë ende mbështetje e rëndësishme ekonomike për një numër të madh ekonomish rurale familjare shqiptare. Për shumë njerëz ruralë, zhvillimi bujqësor do të ndihmonte

### KORNIZA 5.3. KAPITALI SHOQËROR DHE KOOPERATIVAT

Koncepti i 'kapitalit shoqëror' avokon krijimin e shoqërisë së vlerës së shtuar në përgjigje të nevojave të shoqërisë, duke ndërtuar një model për zhvillimin e përvojës praktike të demokracisë e cila inkurajon pjesëmarrjen ekonomike dhe qytetare.

Kapitali shoqëror në esencë është i ndërtuar përmes kooperativave, shoqërive reciproke, asociacioneve dhe fondacioneve. Katër fushat e brendshme të zhvillimit të këtij kapitali janë: 1) ndërmarrësia shoqërore, demokratike dhe pjesëmarrëse; 2) punësimi dhe kohezioni/inkluzioni shoqëror; 3) zhvillimi lokal; dhe 4) mbrojtja reciproke shoqërore.

Kooperativat, me gjasë forma më e shpeshtë ligjore, është asociacion e njerëzve të cilët vullnetarisht bashkohen për të avancuar aspiratat dhe nevojat e tyre të përbashkëta ekonomike, shoqërore dhe kulturore, nëpërmes të ndërmarrjeve me pronë të përbashkët dhe të kontrolluara demokratikisht. Ato nuk janë të njëjta me ndërmarrjet socialiste apo kooperativat e kontrolluara nga shteti.

Në Evropë ekzistojnë shumë shembuj të kooperativave që janë bërë akterë të suksesshëm në ekonominë e globalizuar të tregut. Në shumicën e ekonomive tranzicionale (posaçërisht në Europën Lindore), kooperativat janë motori i zhvillimit bujqësor.

Kooperativat bujqësore thuhet të ofrojnë avantazhe të ndryshme, siç janë:

- Përmirësimi i fuqisë së imponimit të çmimit nga fermerët (furnizuesit dhe procesuesit e inputeve);
- Lejimi i fermerëve që të shfrytëzojnë ekonomitë e shkallës,
- Mundësimi i përmirësimeve në kualitet duke imponuar standarde strikte dhe kontroll kualiteti për të siguruar përmbushjen e pritjeve të konsumatorëve,
- Krijimin e vendeve të punës dhe ngritjen e të ardhurave të fermerëve,

Pjesëmarrja e fermerëve në kooperativat bujqësore mund të bëhet në shumë mënyra. Një shembull i suksesshëm në Kosovë është asociacioni i fermerëve 'Agroflora', i krijuar në Pejë në vitin 2002. Ky asociacion është i përbërë nga 45 fermerë të cilat janë prodhues të qumështit. Me përkrahjen e një OJQ-je italiane, Agroflora ka krijuar dhe pajisur një Qendër Mbledhëse, ku qumështit procesohet dhe shitet në fabrikat lokale të produkteve ushqimore. Kjo qendër menaxhohet nga Agroflora, nëpërmes të Bordit të Drejtorëve.

Qumështi paguhet në bazë të kualitetit, kështu që fermerët kanë tendencë për të përmirësuar kualitetin e produktit të tyre.

në redukimin nga varshmëria prej remiten-cave dhe në të njëjtën kohë do të ofronte rrugë për të dalur nga varfëria. Sidoqoftë, aktualisht ekziston tendencë apo mundësi e vogël për të dalur nga bujqësia mbijetuese, që është forma dominuese e aktivitetit bujqësor sot në Kosovë. Rreth 80% të fermave kanë përafërsisht prej 0,5 deri në 2,0 hektarë<sup>15</sup>. Duke marrë parasysh sipërfaqe kaq të vogël, qasja në kredi është e kufizuar; për më tepër, pronësia e tokës mbetet e paqartë për shumë njerëz. Banka Botërore poashtu ka vërejtur mungesë të ekspertizës teknike dhe shfrytëzimit të dobët të mjeteve moderne nga ana e fermerëve. Për shembull, prodhuesit e gjedheve është konstatuar të kenë njohuri të kufizuar mbi kërkesat për ushqim të kostos më të ulët dhe për nevojat veterinarë, duke rezultuar në sasi shumë të vogla qumështit të prodhuar<sup>16</sup>.

Bujqësia "mbijetuese" është tregues dhe pasojë e varfërisë. Në Kosovë, numri i njerëzve që jetojnë në këtë nivel dhe së këndejmi janë jashtë procesit shoqëro-ekonomik dhe politik, ka nevojë për vëmendje serioze. Derisa Korniza 5.3 ilustron përfitimet e kooperativave bujqësore, Kapitulli 6 ofron disa sugjerime të mëtejme për të promovuar zhvillimin bujqësor dhe zhvillimin e bazuar në rajone në Kosovë.

### Minoritetet në Kosovë

Enti Statistikor i Kosovës (ESK) vlerëson se, prej popullsisë totale të 1.9 milionëve, 88% janë shqiptarë, 7% janë serbë, dhe 5% janë "të tjerë" (boshnjakë, romë, turq, ashkali, egjiptianë dhe goranë).

Dokumenti 'Standardet për Kosovën' parashtron situatën ideale të Kosovës multietnike ku të gjithë njerëzve iu ofrohen të

*"Prioritet i Kosovës  
dubet të jetë ndërtimi  
i një shoqërie stabile,  
civile e cila do të  
respektonte të drejtat  
dhe liritë njerëzore,  
pavarësisht nga  
përkatësia etnike apo  
religjioze e tyre"  
At Sava Janjic*

### KORNIZA 5.4. TË DREJTAT E MINORITETEVE

Që nga viti 1999<sup>1</sup> përfaqësuesit ndërkombëtarë dhe ata vendorë të IPVQ-së kanë promovuar parimet e të drejtave njerëzore të minoriteteve në Kosovë. Deri më tani janë ndërmarrë disa hapa në shumë fusha:

- Nga 120 ulëse në parlament, 20 janë të rezervuara për minoritetet dhe 11 të tjera shtesë janë siguruar nga zgjedhjet, duke dhënë totalin prej 33 ulëseve parlamentare për minoritetet.
- Nga dhjetë ministri të kontrolluara nga IPVQ, dy janë siguruar për minoritetet, një për serbët (Ministria e Bujqësisë) dhe tjetra (Ministria e Shëndetësisë) për minoritetet tjera (sipas një marrëveshjeje të rotacionit në mes të turqve, boshnjakëve dhe RAE).
- Në zgjedhjet komunale nevojiten më pak vota për minoritete sesa për shqiptarë<sup>2</sup>
- Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) ka mbipërfaqësim të lehtë të minoriteteve në vete, shiko tabelën 5.2.

<sup>1</sup> OSBE dhe UNHCR, "The Tenth Assessment of the Situation of Ethnic Minorities in Kosovo," March 2003, mund të gjendet në Web faqen e UNMIK-ut. <http://www.unmikonline.org/press/reports/MinorityAssessmentReport10ENG.pdf>

<sup>2</sup> Shiko tabelën 3.2, Kapitullin 3 të këtij raporti.

**TABELA 5.2 PËRBËRJA E SHËRBIMIT POLICOR TË KOSOVËS (QERSHOR 2003)**

Etniciteti	Numri	Përqindja në SHPK	Përqindja në popullsi
Shqiptarët e Kosovës			
Serbët e Kosovës	4.387	84.2	88
Minoritetet tjera	495	9.5	7
Totali	325	6.2	5
	5.207	100	100

Burimi: faqja e internetit të ESK-së: <http://www.sok-kosovo.org/>

drejtat dhe liritë e njëjta, dhe ku dominon toleranca kulturore dhe fetare. Siç është diskutuar në Kornizën 5.4 dhe në Tabelën 5.2, në Kosovë është bërë shumë që të sigurohen të drejtat e të gjitha minoriteteve. Sidoqoftë, në nivel komuniteti, ende ekziston ndarje e konsiderueshme në mes të komuniteteve.


Shumë vëmendje poashtu i është kushtuar marrëdhënieve të polarizuara etnike dhe shumë të politizuara ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës<sup>17</sup>. Partitë politike shqiptare dhe serbe nuk janë (sikurse definohehen nga Fred Cocozzelli<sup>18</sup>) të dalluara nga qëndrimi i tyre ndaj zhvillimit ekonomik, politik ose shoqëror, por dallohen për nga rolet e tyre në luftën shqiptaro-serbe dhe në politikën etno-nacionaliste që nga intervenimi i NATO-së në vitin 1999. Derisa shpenzohet sasi disproporcionale e kohës në aspektet e tranzicionit, çështjet në thelb të zhvillimit dhe të brengave të minoriteteve tjera, siç janë: RAE, boshnjakët, turqit dhe goranët, duket të jenë të lëna anash. Si rezultat, gjasat për bashkëpunim, koekzistencë dhe pjesëmarrje efektive qytetare në vendim-marrje nga të gjitha komunitetet, janë zvogëluar.

Ky seksion detajizon format e varfërimit brenda dy komuniteteve minoritare në Kosovë, që janë jashtë kufijve të shoqërisë Kosovare. E para është në relacion me kushtet e ashpra ekonomike që ndihen nga shumë pjesëtarë të komunitetit RAE, derisa e dyta ka të bëjë me nivelin e lartë të frikës dhe pasigurisë që ndjehet nga shumica e serbëve Kosovarë.

Dokumenti 'Standardet për Kosovën' parashtron situatën ideale të Kosovës multietnike ku të gjithë njerëzve iu ofrohen të drejtat dhe liritë e njëjta, dhe ku dominon toleranca kulturore dhe fetare. Siç është

diskutuar në Kornizën 5.4 dhe në Tabelën 5.2, në Kosovë është bërë shumë që të sigurohen të drejtat e të gjitha minoriteteve. Sidoqoftë, në nivel komuniteti, ende ekziston ndarje e konsiderueshme në mes të komuniteteve.

**FIGURA 5.5 PAPANËSIA TEK RAE SIPAS MOSHËS DHE GJINISË**



Burimi: AZHNJ 2004 UNDP Kosovë

Enti Statistikor i Kosovës (ESK) vlerëson se, prej popullsisë totale të 1.9 milionëve, 88% janë shqiptarë, 7% janë serbë, dhe 5% janë "të tjerë" (boshnjakë, romë, turq, ashkali, egjiptianë dhe goranë).

### Komuniteti RAE dhe varfëria

Komuniteti RAE si duket është më i marginalizuar në Kosovë. Përgjithësisht ata jetojnë në qyteza e qytete dhe popullojnë lagje të ndara që quhen "Mahalla". Tradicionalisht të angazhuar në punë dore dhe së fundit duke bërë kryesisht punë joformale, në këtë komunitet nivelet e varfërisë njerëzore janë ndër më të lartit (78% jetojnë me më pak se 2\$ për ditë). Komuniteti RAE poashtu ka shkallë të lartë të papunësisë, 58%.


Shtatëdhjet e pesë përqind e rinisë së komunitetit RAE (prej 15 deri në 24 vjeç) janë të papunësuar, derisa 90% e femrave RAE në këtë grupmoshë janë të papunësuar. Ata pjesëtarë të komunitetit RAE që punojnë, në përgjithësi kanë punë të profilit të ultë: vetëm 8% e pjesëtarëve RAE që punojnë mbajnë poste legislative dhe menaxheriale, derisa 11% kanë poste profesionale dhe teknike. Asnjë femër RAE nuk mban asnjërin lloj të këtyre pozitive.

Shansat për punësim të pjesëtarëve të komunitetit RAE janë të sfiduara nga profili relativisht i ulët arsimor<sup>19</sup> si dhe nga qasja e vogël në resurset ekonomike. Shumë pak RAE mbarojnë universitetin dhe shumë prej tyre e ndërprejnë shkollimin qysh në nivelin fillor. Shkalla e analfabetit tek RAE është afër vlerës 17%, dhe pak përmbi 25% për femrat RAE.

Krahasuar me komunitetet tjera, RAE kanë qasjen më të vogël në mjetet ekonomike,

duke përfshirë tokën dhe gjedhet (mbi 59 përqind nuk kanë asnjërin)<sup>20</sup>, dhe shkallën më të ultë të pronësisë së biznesit. Qasja e tyre në telefona, kompjuterë, kanalizim dhe shërbime tjera themelore janë në mënyrë tipike më të ulëtat ndër komunitetet etnike Kosovare. Mungesa e qasjes në shërbime dhe resurse produktive, i kufizon zgjedhjet dhe mundësitë e njerëzve në përmirësimin e jetërave të tyre.

FIG. 5.6 TRENDI I PËRQINDJES SË RESPONDENTËVE QË NDJEHEN "TË SIGURTË" OSE "SHUMË TË SIGURTË" NË RRUGË.



Burimi: Instituti Riinvest: Raporti i Paralajmërimit të Herëshëm # 5, Shtator - Dhjetor, 2003. faqe 25

### KORNIZA 5.5. BASHKËJETESA NË KOSOVË

Shpesh thuhet se tolerimi është gjithmonë marrëdhënie e pabarazisë në të cilën grupet apo individët e toleruar janë të vendosur në pozitë më të ulët. Për të toleruar dikënd tjetër është akt i fuqisë, të jesh i toleruar është pranim i dobësisë.<sup>1</sup>

Pra, sa ka ecur shoqëria kosovare drejt bashkëjetesës?

Sipas Walzer-it, bashkëjetesa kërkon aranzhim stabil politik dhe moralisht legjitim. Në Kosovë paqja ende është e thyeshme dhe evoluuar kryesisht nga mungesa e luftës. Koncepti i mungesës së dhunës strukturore në shoqëri, "hapi pozitiv",<sup>2</sup> nuk ekziston ende. Mungesa e resurseve shoqërore dhe ekonomike që detyrojnë popullsinë që të luftojë për të mbijetuar, e plotësuar më mungesën e kulturës politike, ka rënduar paqen e pasigurtë dhe të thyeshme.

Sidoqoftë, për të bashkëjetuar do të thotë të ndash vlerat e për-bashkëta dhe të ketë respekt reciprok, i cili në Kosovën pas vitit 1999 ka ndodhur jo shpesh. Zhvillimi i vlerës së besimit ndërmjet grupeve të ndryshme duke mos u konfrontuar me të kaluarën mund të jetë i dhimbshëm dhe të kërkojë shumë përkushtim; dhe, sidoqoftë, ky proces shpesh është më i suksesshmi në shërimin e viktimave dhe sulmuesve dhe në sigurimin e pajtimit dhe të ardhmërisë më të mirë dhe më paqësore.

"Paqja pozitive" mund të arrihet vetëm duke formësuar qëndrimet në afat të gjatë përmes arsimimit, siç është aplikimi në shkolla fillore i planprogrameve të edukatës qytetare dhe të të drejtave njerëzore. Edukimi i tillë i rinisë është proces afatgjatë i cili duhet të konsiderohet si përgjegjësi e të gjithë Kosovarëve të cilët dëshirojnë të kenë një shoqëri paqësore ku qytetarët e saj të mund të kenë të drejta të barabarta dhe respekt reciprok.

Konfrontimi me të kaluar është i nevojshëm për të krijuar të vërtetën, drejtësinë dhe pajtimin me të tjerët dhe historinë..

Krijimi i një kulture të tillë paqësore është sfidë e madhe, jo vetëm në Kosovë, por në të gjithë Ballkanin. Deri më tani janë bërë disa akomodime pozitive dhe programet e bashkëjetesës, të inicuar nga disa OJQ ndërkombëtare dhe lokale, për të bashkuar komunitetet etnike. Edhe në ditët e sotme, në shumë rajone, ekziston bashkëpunim në nivel të punës i cili është i ndërmjetësuar nga zyrtarët e UNMIK-ut. Edhe pse në shumicën e sektorëve ende nuk është krijuar kontakti pa ndërmjetësim në mes të Prishtinës dhe Beogradit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tani mban takime të rregullta me homologët e saj nga Beogradit. Në këtë nivel të posaçëm, zyrtarët serbë punojnë drejtpërdrejtë me zyrtarët relevantë të IPVQ-së me ndërmjetësim të paktë të personelit të UNMIK-ut. Rezultatet e tyre deri më tani kanë shënuar kthim në vendet e veta të 50 personave me aftësi të kufizuara.

Një projekt që ia vlen të përmendet është qyteti i Gjilani, ku Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) kanë ndërtuar një qendër rome të resurseve dhe kanë formuar ekip pune me serbët për të rikonstruktuar parkun e qytetit.<sup>3</sup> Aktivitetet tjera përfshijnë bashkëpunimin në mes të Rrjetit të Grave Kosovare dhe Rrjetit të Grave të Serbisë 'Zora' në organizimin e një serie prej gjashtë punëtorive të titulluara 'Menaxhimi i OJQ-ve në ambientin e ri ligjor'. Këto punëtori, të cilat kanë filluar në Shkurt 2004, do të vazhdojnë gjatë gjithë vitit; katër punëtori do të organizohen në Kosovë dhe dy të tjera në Beograd. Një numër projektesh kanë bashkuar të rinjtë nga Kosova dhe Serbia për të folur dhe mësuar, për të hapur kanalet për paqe dhe dukuri synuar në paqe, tolerancë dhe bashkëjetesë.

<sup>1</sup> Michael Walzer, *On Toleration*, (New Haven: Yale University Press), 52.

<sup>2</sup> Johan Galtung, [www.transend.org](http://www.transend.org)

<sup>3</sup> Ky raport (40pp., ISBN no. 1903818079) është publikuar në Janar 2002 nga Qendra për Studimin e Faljes dhe Pajtimin, dhe mund të merret nga: [www.coventry-isl.org.uk/forgive/about/boëard-doc.pdf](http://www.coventry-isl.org.uk/forgive/about/boëard-doc.pdf) apo të blebet në Coventry

## Serbët e Kosovës dhe siguria

Sipas OSBE-së dhe UNHCR-së,<sup>21</sup> në Serbi dhe Mal të Zi jeton një numër substancial<sup>22</sup> i serbëve kosovarë, derisa ata që jetojnë në Kosovë janë kryesisht të vendosur në Mitrovicë, Leposaviq, dhe Zubin Potok. Pjesa tjetër jeton në Gjilan, Prishtinë, dhe Shtërpçë.

Siç ilustron grafikisht ngjarjet e Marsit 2004, rreziku për dhunë etnike mbetet shumë real. Derisa minoritetet 'tjera' kanë përjetuar përmirësime substanciale<sup>23</sup> në kuptim të sigurisë dhe lirisë së lëvizjes, serbët kosovarë në mënyrë konsistente e renditin sigurinë si një nga problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet Kosova<sup>24</sup>. Siç mund të shihet në Figurën 5.9, gjatë vitit të fundit ndjenja e pasigurisë ndër serbët kosovarë është rritur.

Serbët kosovarë kanë indekse relativisht më të larta të zhvillimit njerëzor sesa komunitetet tjera. Sidoqoftë, të ardhurat e tyre kryesisht derivojnë nga pagat dhe pensionet e marrura nga strukturat paralele të financuara nga qeveria e Serbisë dhe Malit të Zi<sup>25</sup>. Shumë pjesëtarë të këtij komuniteti vazhdojnë të jetojnë në enklava të ruajtura shumë, dhe kanë liri të kufizuar të lëvizjes. Kjo situatë vështirë se mund të konsiderohet si e qëndrueshme dhe kualiteti i jetës për shumicën e tyre është i penguar nga kjo ndjenjë.

Siç është theksuar në Kornizën 5.5, në Kosovë janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të forcuar marrëdhënie më të mira ndëretnike. Sidoqoftë, mbetet shumë për t'u bërë në mënyrë që të krijohen kushte që mundësojnë të gjitha komunitetet etnike që të angazhohen në mënyrë proaktive në jetën politike, kulturore, shoqërore dhe ekonomike. Në këtë kuadër, rekomandimet janë theksuar në Kapitullin 6.

## Grupet tjera të margjinalizuara

Në Kosovën post-konfliktuale ekziston një numër i konsiderueshëm i njerëzve që vuajnë nga pasojat e konfliktit dhe (si pasojë) kanë barriera substanciale ndaj pjesëmarrjes substanciale në jetën shoqërore dhe në

atë politike. Këto grupe shoqërore mund të ndahen në dy kategori të veçanta: ata që vuajnë nga paafërsia fizike që, për disa, është pasojë direkte nga konflikti i armatosur apo nga minat tokësore dhe ata që vuajnë nga çrregullimi nga stresi post-traumatik.

## Njerëzit që jetojnë me aftësi të kufizuara

Numri i saktë i njerëzve me aftësi të kufizuara në Kosovë është i panjohur. Sipas Handikos-it, organizatë lokale e kosovarëve me aftësi të kufizuara, ky numër është rreth 40,000. Ky vlerësim është i bazuar në një supozim shumë konservativ që 3 deri në 5 përqind të popullsisë së përgjithshme janë në një mënyrë apo në një tjetër me aftësi të kufizuara. Handikos-i ka anketuar dhe identifikuar përafërsisht 16,000 njerëz me aftësi të kufizuara<sup>26</sup>. Sipas Kornizës Politike Gjithëpërfshirëse të Aftësive të Kufizuara të vitit 2001 të Grupit Punues për Aftësitë e Kufizuara (i përbërë nga zyrtarë e qeverisë, OJQ-të ndërkombëtare dhe vendore), mund të ketë rreth 150,000 Kosovarë që kanë aftësi të kufizuara. Kjo shifër në të vërtetë përputhet me vlerësimet e OBSH-së që rreth 10% e popullsisë së Kosovës ka aftësi të kufizuara.

Së bashku me organizata tjera, Handikos-i dhe një numër i madh OJQ-sh të vogla kanë punuar në promovimin e të drejtave të

*Nëse "psikologjia kolektive problematike" e Kosovës nuk merret në përkujdesje, ajo do të parandalojë zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe shoqëror. Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave nga Torturat (QKRVT),*

### **KORNIZA 5.6. QENDRA KOSOVARE PËR REHABILITIMIN E TË MBIJETUARVE TË TORTURËS (QKRMT)**

Në Tetor të vitit 1999, një ekip mjekësh që kanë punuar në kampe refugjatësh në Shqipëri dhe të përkrahur nga Këshilli Ndërkombëtar i Rehabilitimit të Viktimave të Torturës (KNRVT), kanë krijuar Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT).

QKRMT është organizatë e pavarur joprovitabile me seli në Prishtinë. Kjo qendër ka shtatë qendra satelite në Skenderaj, Podujevë, Gjilan, Suharekë, Rahovec, Pejë dhe Deçan. Këto qendra satelite janë ndërtuar në vende në të cilat kanë ndodhur shkatërrimet dhe krimet më të rënda ndaj njerëzimit.

QKRMT ofron trajtim dhe rehabilitim urgjent për kosovarët e traumatizuar, si dhe trajnimet për doktorë dhe mësues.

njerëzve me aftësi të kufizuara. Edhe pse përkrahja nga familja vazhdon të jetë e madhe dhe se ekziston skema pensionale për njerëzit me aftësi të kufizuara (edhe pse e kufizuar), në kushte praktike ekziston një stigmatizim i madh i individëve me aftësi të kufizuara si dhe mungesë e infrastrukturës së përshtatshme për njerëzit me aftësi të kufizuara. Si pasojë, personat me aftësi të kufizuara përjetojnë probleme substanciale në kuptim të qasjes së tyre në shërbime, punësim dhe në pjesëmarrjen e tyre të përgjithshme në jetën shoqërore dhe politike.

## Konflikti dhe mirëqenia psikologjike në Kosovë

Ndikimi i drejtpërdrejtë i konfliktit dhe i probleme psikologjike, të cilat hendikepojnë individët që funksionojnë në shoqëri është i

dokumentuar fare mirë. Ky ndikimi është posaçërisht destruktiv në shoqëritë si Kosova, shoqëri që përpiqet të krijojë paqe dhe stabilitet.

Siç është diskutuar në Kornizën 5.6, ngjarjet e Marsit 2004, theksojnë faktin se në Kosovë, problemet psiko-sociale nuk kanë marrë vëmendjen e duhur që meritojnë

### Çregullimi nga stresi post-traumatik

Problemet psiko-sociale zvogëlojnë gjasat e vazhdimit të arsimimit, të gjetjes apo mbajtjes së punës dhe ato rrisin gjasat e problemeve kronike shëndetësore, ku të gjitha janë dimensione të zhvillimit njerëzor.

Problemi psikologjik më i shpeshtë dhe i rëndë që del nga një konflikt është Çregullimi nga Stresi Post-traumatik (PTSD).

#### **KORNIZA 5.7: PLAGËT E FRESKËTA: TRAZIRAT E MARSIT**

Për një moment, skenat nga e kaluara u shfaqën përsëri. Ajo që filloi qetë dhe me solidaritet, kaloi në kthim mbrapa në kaos, shkatërrime, djegie dhe vdekje. Çka shkaktoi një eskalim të tillë të dhunës? Derisa shkaqet janë të llojeve të ndryshme, një nga shkaqet kryesore është ndezja psikologjike që mbizotëron në jetën shoqërore, politike dhe ekonomike në Kosovë. Fatkeqësisht, për shumë njerëz, pesë vitet e kaluara nuk kanë përmirësuar nivelin e tyre të mirëqenies, por në fakt kanë testuar durimin e popullsisë dhe kanë keqësuar situatën tanimë të rënduar psikologjike.

Një nga shkaqet kryesore të eskalimit të dhunës nga protestat është rikujtimi i emocioneve të dëshpërimit nga lufta. Individët që kanë rënë në depresion mund të reagojnë në mënyra të ndryshme për t'u konfrontuar, shmangur apo luftuar gjendjen e tyre depresive. Simptomat kryesore të konstatuara në këtë vuajtje janë: trauma, depresioni, neuroza dhe, në raste të caktuara, edhe shpërthimi i psikozës. Kjo pjesë e popullsisë është duke u munduar të kuptojë politikën dhe të përqafojë tolerancën, por e konfrontuar me emocionet e veta, vështirë se mund t'i kontrollojë ato.

Një reaksion i mundshëm për të shprehur frustrimin, stresi dhe ankthin e akumuluar për pesë vite ishte dhuna e drejtuar ndaj komuniteteve tjera në Kosovë si dhe ndaj autoriteteve të UNMIK-ut dhe KFOR-it.

Ngjarjet e fundit në Kosovë vëjnë në pah psikologjinë e shqetësuar kolektive. Askush nuk mund të përmirësojë kushtet sociale dhe ekonomike pa synuar së pari të përmirësojë situatën kolektive psikologjike të pikëlimit të popullsisë. Është e evidente se individë të ndryshëm vazhdojnë të manipulojnë një segment të caktuar të popullsisë për të përmbushur qëllimet dhe interesat e veta. Shpërthimet e shpeshta që burojnë nga fusha politike vazhdimisht "gërrithin" plagët e freskëta të luftës.

Në aspektin profesional, psikosocial dhe të qeverisjes, duhet të bëhet çdo gjë që është e mundur që të ndihmohet kjo kategori individësh. Organet më të larta duhet të angazhohen më shumë dhe të jenë më shumë përgjegjës në të kuptuarit e nevojave të shoqërisë në përgjithësi dhe në veçanti të nevojave të atyre që kanë përfituar pak nga kjo liri, përveq humbjes së dinjitetit, qetësisë shpirtërore dhe familjarëve më të afërt..

*Nga një artikull i Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), botuar në Kohën Ditore, Mars 2004, i rishtypur me lejen e QKRVT*

Simptomet e këtij çrregullimi përfshijnë ripërjetimin e ndjenjave në lidhje me ngjarjen (siç janë kujtimet e mbyllura në vete, mendimet dhe pamjet), shmangia në kuptim të sjelljes (sikurse hipervigjilenca apo informatat në lidhje me traumën). Pikëllimi, fajësia dhe zemërimi poashtu janë të asociuara me këtë çrregullim. PTSD zakonisht është i shoqëruar me efekte tjera psikosomatike (p.sh. depresioni, pagjumësia, kokëdhembjet). Për më keq, shfaqja e këtij çrregullimi mund të vonohet për disa vite. Ngjarjet që shkaktojnë PTSD-në janë: lufta, dhunimi, aksidentet e trafikut (për fëmijët), plaçkitjet e bankave dhe fatkeqësitë tjera natyrore apo të shkaktuara nga njeriu.

Pas trazirave të 17-18 Marsit, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave nga Torturat (QKRVT) ka pyetur për arsyet e eskalimit të dhunës. Ata drejtojnë gishtin kah prevalenca e PTSD-së në Kosovë, për të cilën thonë se përfshin rreth 25% të njerëzve, por përgjithësisht mbetet e padiagnostifikuar dhe e patrajtuar.

### *Ankthi, depresioni dhe ndjenjat e urrejtjes*

Në vitet e fundit, Kosovarët kanë përjetuar seri të ngjarjeve të mëdha traumatike, duke përfshirë zhvendosje masive<sup>27</sup>, dhunë dhe humbje të familjarëve të afërm apo miqve.

Ndoshta studimi më valid në këtë çështje është bërë në fund të vitit 1999 me anëtarët (mbi moshën 15 vjeçare) e më se 558 ekonomive familjare shqiptare të Kosovës, duke arritur një total prej 1,358 pjesëmarrësve<sup>28</sup>. Ky studim pat zbuluar se prevalenca e lartë e problemeve psikologjike me 43% të respondentëve që kanë përjetuar probleme jospesifike psikiatrike. Simptomet somatike dhe ankthi i asociuar me traumat e luftës ishin evidente, si dhe disfunksioni social apo depresioni. Një konstatim i rëndësishëm ka të bëjë me ndjenjat e urrejtjes së motivuar në baza etnike. Rreth 89% e meshkujve dhe 90% e femrave kanë raportuar ndjenja të urrejtjes, derisa gjysma e meshkujve dhe rreth 43% e femrave kanë raportuar ndjenjë të fortë urrejtjeje ndaj serbëve. Konstatimet tjera relevante përfshijnë zvogëlimin linear në statusin e shëndetit mental dhe në funksionimin social si rezul-

tat i një numri të ngjarjeve traumatike të përjetuara. Njerëzit e zhvendosur brenda vendit është konstatuar të jenë më të ndieshmit ndaj problemeve psikologjike dhe disfunksionit social<sup>29</sup>.

Një studim i ngjashëm është bërë edhe tek serbët e Kosovës. Rezultatet pasqyruan rezultatet e studimit të bërë tek shqiptarët, duke zbuluar kështu incidencë të lartë të simptomave somatike, ankthit, depresionit dhe disfunksionit social<sup>30</sup>.

Adresimi i problemeve të shëndetit mental dhe funksionimit të dëmtuar social të grupeve të ndieshme të Kosovës janë pika kritike në përkrahjen e një ambienti stabil dhe produktiv. Sikurse sugjerojnë studimet, numri i madh i ndjenjave të urrejtjes dhe dëshirës për hakmarrje, është alarmues. Edhe pse të dhënat e fundit nga anketat e SPH sugjerojnë se është shënuar një përmirësim i kësaj situatë<sup>31</sup>, duhet të bëhet një studim i mirfilltë në mënyrë që të përcillen këto çështje dhe të bëhet vlerësimi i progresit të arritur në katër vitet e fundit.

Ky kapitull ka tentuar të vëjë thekse mbi sfida me të cilat ballafaqohen grupet e ndieshme në Kosovë. Për ndryshim pozitiv në këtë kuadër janë të nevojshme rrjete që kanë për qëllim ndryshime dhe më shumë resurse njerëzore, brenda shoqërisë civile dhe qeverisë. Kapitulli 6 rekomandon ndërtimin e aleancave në shoqërinë civile, media dhe sektorin privat për pjesëmarrje dhe përfaqësim më të lartë qytetar të grupeve të ndieshme. Kapitulli 6 poashtu do të elaborojë rëndësinë e eliminimit të barrierave ekonomike të cilat pengojnë ndërmarrësinë lokale dhe krijimin e vendeve të punës.



# NGRITJA E QYTETARIT: PËRQAFIMI I TË DREJTAVE DHE PËRGJEGJËSIVE



"Është e vërtetë se ndoshta kurrë nuk do të krijomë një shoqëri perfekte. Është e vërtetë se ndoshta kurrë nuk do të mund të anulohet të gjitha padrejtësitë sociale dhe ekonomike apo të ofrojmë mundësi të njejtë për të gjithë. Por gjithsesi se mund të marrim disa hapa praktike për ta bërë shoqërinë tonë më të ndjeshme dhe më humane" - **Mahub ul Haq**

Sfida kryesore e Kosovës sot është thellimi dhe shtrirja më e gjërë e qeverisjes demokratike në mënyrë që të përmirësohen kushtet e jetës dhe të zgjerohen mundësitë e njerëzve të zakonshëm. Në mënyrë që të arrihet kjo, duhet të shpejtohet një pjesëmarrje etike civile, një pjesëmarrje e tillë që do t'i motivonte njerëzit që të përqafojnë dhe të mbrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre përkitazi me komunitetet e tyre lokale. Së dyti duhet të bëhen politika dhe reforma institucionale që të zgjerohen mundësitë e qytetarëve për pjesëmarrje dhe përfaqësim në mënyrë që të pasurohet zhvillimi njerëzor për të gjithë kosovarët. Në fund, strategjia e gjërë e implementimit që do të përfshinte qeverinë, shoqërinë civile, sektorin privat dhe komunitetin ndërkombëtar, duhet të krijohet dhe të propozojë reformën për qeverisje më të fuqishme demokratike.

Së bashku këto reagime të përbashkëta për situatën e tashme në Kosovë mund të ofrojnë disa përgjegje në pyetjen: "Si mundën kosovarët të marrin më shumë përgjegjësi në çështjet e tyre dhe si mund të marrin një hisë më të madhe në qeverisjen e gjërave të veta duke mbetur të ndjeshëm në statusin e pazgjedhur politik të Kosovës?"

## I. Ndërtimi i ideve të qytetarisë

Demokracia është shumë më e gjërë dhe nënkupton shumë më shumë se hedhja e një vote në kuti, apo edhe më shumë se formimi i një sistemi përfaqësues legjislativ, juridik, dhe ekzekutiv. Siç është prezantuar në RZHNJK 2004 demokracia kërkon edhe pjesëmarrje dhe përfaqësim jo vetëm në atë mënyrë që të "përfshijë" njerëzit por në atë mënyrë që të pushtetëzohet ata që vet njerëzit të mund të marrin vendime për çështjet që përfshijnë jetët e tyre. Njerëzit duhet të kenë rolin udhëheqës në mbajtjen

e liderëve përgjegjës për veprimet e tyre dhe të krijohen regulla inkluzive në institucionet dhe praktikatat qeverisëse.

Duhet të bëhet një përpjekje e koncentruar në mes të akterëve lokal dhe ndërkombëtarë që të përforcohet nocioni i qytetarisë apo qytetarit me të drejtat dhe përgjegjësitë e të gjithë kosovarëve të mbledhura në ndjenjën se ata i përkasin një shoqërie. Ky veprim është zemra e përpjekjeve që Kosova të përgaditet për një të ardhme më të mirë. Përderisa statusi politik i Kosovës mbetet i pazgjedhur, populli i Kosovës duhet të inkurajohet që të kuptojë, promovojë dhe të mbrojë të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale që janë themeli i qytetarisë. Vetëm atëherë kur femrat janë partnerë të barabartë me meshkujt si në sferën private ashtu edhe publike, kur politikat ekonomike dhe sociale janë në vijë me nevojat dhe aspiratat e njerëzve dhe kur njerëzit janë të lirë nga diskriminimi i bazuar në etni, racë, klasë, gjini apo në ndonjë formë tjetër, vetëm atëherë njerëzit mund të jetojnë me dinjitet<sup>1</sup>. Kjo është esenca e qytetarisë moderne: ajo i definon njerëzit, i bashkon dhe siguron ata që të marrin përgjegjësi kolektive për jetën dhe veprimet e tyre. Pa lider-ship, sakrificë, dhe ndjenja individuale dhe kolektive të përgjegjësive, të drejtat dhe liritë e qytetarit do të humben.

Qytetarizmi gjithashtu përfshinë edhe përkushtimin e veçantë për zhvillimin e të rinjëve dhe fëmijëve. Në Kosovë të rinjtë nën moshën 25 vjeçare përbëjnë më shumë se gjysmën e popullatës, dhe pjesa më e madhe e tyre nuk kanë vende pune apo mundësi zhvillimi që do të garantone një jetë plot shpresë. Kjo gjendje ishte e përshtatshme për organizatorët e dhunës dhe shkatërrimit material të ngjarjeve të marsit. Një nga faktorët që kanë kontribuar në veprimet e tyre të turpshme kanë qenë kanalet e kufizuara të komunikimit të mirëfillt në mes të një pjese të rinisë të pakënaqur dhe liderëve të tyre të zgjedhur në mënyrë demokratike. Siç përkrahajnë analizat e RZHNJK 2004, nevojat e gjeneratave të ardhshme dhe mundësitë e tyre për zhvillim nuk kanë qenë të adresuara siç duhet në prioritetet e politikave të tashme. Adresimi i nevojave dhe aspiratave të të rinjëve është një gjë shumë e rëndësishme që

*Demokracia është shumë më e gjërë dhe nënkupton shumë më shumë se hedhja e një vote në kuti, apo edhe më shumë se formimi i një sistemi përfaqësues legjislativ, juridik, dhe ekzekutiv*

*Addressing the needs and aspirations of young people is critical to transforming them into responsible, active citizens in Kosovo's young democracy*

ata të transformohen në qytetarë aktiv dhe të përgjegjshëm të demokracisë së re të Kosovës.

Si përmbledhje qytetaria e mirë do të përfshinte përqaftimin e tolerancës dhe nocionin e komunitetit, respektimin e vetës dhe të tjerëve, veprimin e përbashkët me mirëbesim pa marrë parasysh, fenë, etnicitetin apo dallimet tjera. Qytetaria e mirë funksionon brenda edhe jashtë kufinjëve të bërë nga njerëzit. Për të ndërtuar mirëkuptim dhe shpërndarje të ideve të qytetarisë, rekomandohen këto katër veprime:

### Veprimet e menjëherëshme:

Të organizohet një fushatë mediale për të drejtat dhe detyrimet e kosovarëve: Fushata mund të koordinohet nga Institucionet e Përkohëshme të Vetqeverisjes (IPVQ), por do të duhej të përmbante mbështetje dhe bekim të liderëve të njohur të shoqërisë civile, komuniteteve fetare, mediave dhe biznesit.

Vizita të sponsoruara të anëtarëve të kuvendeve komunale të komunave me shumicë serbe respektivisht shqiptare që të diskutojnë përgjegjësitë dhe të drejtat e njëri tjetrit: Pjesërisht si rezultat i ngjarjeve të 17 deri 19 marsit, vizitat duhet të disenjohen që të promovojnë dialog të hapur dhe të kuptueshëm për barrierat dhe hapat konkret për arritjen e bashkëjetesës paqësore dhe ndjenjës së përbashkët të komunitetit në Kosovë.

### Veprimet afatgjate:

Të fillohen mësimet e qytetarisë dhe qeverisjes së mirë dhe demokratike në shkolla: Të përgatiten tekste shkollore dhe manuale të ndryshme në mënyrë që mësuesit t'i mësojnë nxënësit për funksionimin e institucioneve demokratike të Kosovës dhe rëndësinë e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve.

Të sponsorohen ndërrime të studentëve në mes të komunave në veçanti në mes të komunave me shumicë shqiptare me ato me shumicë serbe. Asgjë nuk mëson e as nuk promovon tolerancën më shumë se komunikimi i ndërsjellë, në veçanti në mesin e të rinjëve të cilët janë më të gat-

shëm të pranojnë diversitetin se sa të rriturit. Ngjashëm ndërrimet kulturore mund t'i ndihmojnë shoqërisë multi etnike të promovojnë respektin dhe mirëkuptimin në mesin e grupeve sociale që mund të kenë keqkuptim dhe injorancë për njëri tjetrin.

## II. Reformat kyçe për zgjerimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit për zhvillim njerëzor në Kosovë

Siç është prezantuar në RZHNJK 2004, Kosova është ende në një fazë të historisë së vet që reflekton jostabilitet politik, social dhe ekonomik. Nevojat e kosovarëve janë të shumta dhe atyre ju nevojitet kujdes urgjent. Besimi në fuqinë e qeverisjes demokratike për zhvillimin e talenteve biznesore dhe liderëve lokal për të dhënë përgjegje në nevojat e kosovarëve për zgjerimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit duhet të mirren këto veprime. Edhe pse UNMIK-u dhe komuniteti ndërkombëtarë vazhdojnë të kenë një rol të rëndësishëm, kosovarët duhet të jetë të kujdesshëm që të mos adaptojnë pa menduar ndonjë model të veçantë të demokracisë. Çfarëdo reforma për promovimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit duhet të udhëheqen nga një princip bazë:

*"A i pushtetëzohet reforma kosovarët me të vërtetë, a i ndihmon ata që të reagojnë në mënyrë efektive ndaj nevojave të tyre dhe të inkuadrohen plotësisht në tranzicionet e shumta në zhvillim"*

Bazuar në këtë princip, reformat e prezantuara ndahen në dy kategori të veçanta:

*I) Zgjerimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit me transformim drejtë qeverisjes së mirë demokratike*

*II) Ndërtimi i aleancave në mesin e shoqërisë civile, mediave dhe sektorit privat në mënyrë që të arrihet një pjesëmarrje dhe përfaqësim më i gjërë*

Një pjesëmarrje dhe përfaqësim më i madh do të ishte në vijë me politikën "Standardet

për Kosovën" dhe do të ndihmonte pjesëmarrësit dhe liderшипin kësaj politike (ne veçanti IPVQ-në). Kështu shumë nga propozimet e theksuara më lartë do të zgjerohin fushën e veprimit të "Planit për Implementimin e Standardeve për Kosovën" dhe do të ndihmonin në përfundimin e qëllimit.

**Zgjerimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit nëpërmes transformimit të qeverisë:**

*Reformimi i sistemit elektoral për ta bërë demokracinë më përfshirëse dhe përgjegjëse:*

Siç është artikuluar në kapitullin e katërt lidhja në mes të partive politike dhe qytetarëve është e dobët, platformat e partive janë sipërfaqësore, dhe politikanët nuk janë duke u ndjerë përgjegjës kundrejt një elektorati të informuar. Gjatë viteve të

ardhshme nevojiten reforma të sistemit elektoral në mënyrë që të përmirësohet përfaqësimi gjeografik, të rritet përgjegjësia direkte, të motivohen partitë që të kërkojnë përkrahjen e grupeve specifike sociale, dhe të përmirësohet praktika dhe proceset brenda nëpër parti. Këto brengosje kanë qenë në krye të agjendës së një koalicioni të gjërë të shoqërisë civile dhe individëve nën titullin "Reforma 2004" (Shiko Kornizën 6.1).

Krijimi i zonave zgjedhore, një punë mjaft e vështirë, duhet të mirret në konsideratë si një nga mënyrat e përmirësimit të përfaqësimit gjeografik. Secila zonë zgjedhore duhet të pëmbajë një grup votuesish të ngjashëm, të jetë kompakte gjeografikisht dhe përfshijë komunitete të ngjashme dhe një territor të përbashkët. Për një sistem të tillë nevojiten shënime të reja të regjistrimit të popullatës. Zonat zgjedhore duhet të jenë të mëdha e jo të vogla në mënyrë që të zmadhohet mundësia e zgjedhjes së femrave dhe grupeve minoritare.

*Një pjesëmarrje dhe përfaqësim më i madh do të ishte në vijë me politikën "Standardet për Kosovën" dhe do të ndihmonte pjesëmarrësit dhe liderшипin e kësaj politike (ne veçanti IPVQ-në)*

**KORNIZA 6.1: "Reforma 2004": NJË MODEL I RI PËR ANGAZHIM KONSTRUKTIV TË QYTETARËVE**

"Reforma 2004" një koalicion i gjërë qytetarë ka avokuar për nevojën e listave të gjëra dhe të hapura zgjedhore në shtatë njësi të ndryshme zgjedhore shumë anëtarëshe, në vend të një njësie të vetme zgjedhore, lista të mbyllura përfaqësimit proporcional. Puna e tyre përfaqëson një nivel të lartë të pjesëmarrjes pozitive në një çështje që është qëndrore në procesin e demokratizimit. E përpiluar në një forum të qytetarëve në shkurt të vitit 2004 inisiativa u nis nga disa reforma konkurente të zgjedhjeve, të udhëhequr nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KLDMNJ), Instituti Kosovarë për Hulumtime dhe Zhvillim të Politikave dhe Forumi.

Pasi që u finalizua nga një grup punues nga dhjetë organizata civile Reforma 2004 u nis që të mbledhë nënshkrime nga OJQ-të më të mëdha për të bërë reformat më të mëdha në sistemin zgjedhorë të Kosovës. Shumë shpejtë disa shumë rrjete qytetare ju bashkuan në përkrahje të ndryshimeve të propozuara në sistemin zgjedhorë. Për të arrihur më shumë përkrahje publike, janë organizuar disa debate televizive, demonstrata publike dhe shumë letra janë dërguar në adresa të liderëve lokal dhe ndërkombëtarë. Më shumë se 250 grupe të mëdha qytetarësh kanë përkrahur Reformën 2004, këtu janë përfshirë edhe organizata që kanë të bëjnë pak apo aspak me njëra tjetrën. Në të vërtetë kjo ishte aleanca më e madhe e organizatave të qytetarëve që janë mbledhur rreth një çështjeje. Edhe pse kjo inisiativë nuk ka arritur që të ndryshojë sistemin zgjedhorë për zgjedhjet e ardhme aho ka arritur që të bëjë një debat publik rreth një çështjeje të caktuar, e cila më heret ishte e pasfiduar në publik.

Falë Reformës 2004 tashti në debat janë shumë çështje të rëndësishme publike siç është demokracia e brendshme partiake, përgjegjësia e qeverisë, përfaqësimi gjeografik, kuotat e gjinisë dhe përfaqësimi i minoriteteve. Shumë qytetarë tashti ndjehen të pushtetëzuar që të sfidojnë partitë politike për zgjedhjet e ardhme dhe të mendojnë më thellë dhe në mënyrë kritike para se të japin votën. Tutje një mekanizëm i demokracisë interne i avokuar nga Reforma 2004 është vendosur që të rregullohen zgjedhjet. Nëpërmes përvajtës disa organizata civile kanë mësuar për teknikat e mira të lobimit sa shumë ndikim mund të kenë shumë organizata e sa një, dhe se bashkëpunimi i vazhdueshëm i akterëve është i nevojshëm për të arritur një cak ambicioz.

*Nuk është e mundur që të arrihet paqja pa formimin e institucioneve demokratike të mbikqyrura nga institucionet civile që janë në gjendje të forcojnë sundimin e ligjit*

Një reformë tjetër zgjedhore që mund të ketë rezultat pozitiv për pabarazi etnike dhe gjinore është futja e "Vendeve plotësuese". Idea përfshin ndarjen proporcionale të një numri të vendeve nga listat e mbyllura për të promovuar përfaqësimin etnik dhe gjinorë. Kjo natyrisht do të balancohej me ndarjen e vendeve me sistemin mazhoritarë të përshkruar më lartë. Me fjalë të tjera "Vendet plotësuese" janë të disenjuara nga listat e mbyllura që të kompenzojnë efektin mazhoritarë të alokuar nga përfaqësimi gjeografik i listave të hapura.

### *Forcimi i funksioneve legjislative, përfaqësuese dhe mbikqyrëse të Kuvendit:*

Kuvendi i Kosovës është qendra e demokracisë së Kosovës dhe përbëhet nga 120 vende që përfaqësojnë interesa dhe komunitete të ndryshme. Agjenda për sforcimin e funksioneve bazë të Kuvendit të Kosovës dhe partive politike që ata përfaqësojnë duhet të përfshijë minimumin e strategjive në vazhdim:

- Të sigurohet supremacia e Kuvendit ndaj ekzekutivit si legalisht ashtu edhe praktikisht, si burim kryesor dhe autoritetit legjitim i demokracisë lokale për pjesët e përgjegjësive që i takojnë;
- Të përmirësohet zingjiri i vendim marrjes në partitë politike duke e shtuar "demokracinë e brendshme" (shembull: mbajtja e kongreseve të rregullta dhe decentralizimi i pushtetit në degët lokale në zgjedhjet e rregullta të përfaqësuesve të partisë);
- Përmirësimi i transparencës së partive nëpërmes publikimit (nëpërmes web faqeve apo medimeve të tjera) të platformave të partive politike, burimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve (financat e partive duhet të auditohen dhe të jenë të hapura për publikun);
- Të rritet efektiviteti i komiteteve të partive për iniciimin e legjislacionit të ri dhe ato të shërbejnë si vëzhgues të pjesës ekzekutive të institucioneve;
- Të formohet një Qendër Hulumtuese e Kuvendit në mënyrë që anëtarët e Kuvendit të kenë qasje në informata relevante dhe analiza në punën e tyre si ligjvënës dhe mbikqyrës;

- Të bëhet regjistrimi i popullatës sa më parë që është e mundur. Statistikat janë qenësore për zhvillimin e politikave dhe vendim marrje të mirë. Për fat të keq Enti i Statistikës së Kosovës është e ballafaquar me shumë mungesa të shumta infrastrukture, pa regjistër të statistikave biznesore, dhe dështimi që të bëhet një regjistrim i besueshëm popullatës që nga viti 1981 dhe i bujqësisë që nga viti 1960 dhe i popullatës që nga viti 1981.

### *Të rritet qasja në drejtësi dhe respektim të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe të drejtat e minoriteteve*

Nuk është e mundur që të arrihet paqja pa formimin e institucioneve demokratike të mbikqyrura nga institucionet civile që janë në gjendje të forcojnë sundimin e ligjit. Një sistem juridik i paanshëm dhe profesional është pjesë integrale e themeleve të këtyre institucioneve. Kjo është në veçanti e rëndësishme për shoqëritë multietnike pas konflikteve. Këto institucione mund të mbrojnë të drejtat themelore të minoriteteve dhe grupeve të tjera të drejtat e të cilëve mund jenë të rezikuara.

Agjenda për rritjen e qasjes në gjyqësi dhe ruajtjen e të drejtave të njeriut është e madhe. Bashkësia ndërkombëtare e udhëhequr nga UNMIK-u ka shpenzuar resurse të mëdha për të hapur rrugë për të krijuar një sistem juridik modern. Megjithatë duhet të inicohet një debat i gjërë rreth vizionit ndërkombëtarë për strukturat e ardhshme. Menjëherë duhet të krojohet një bazë e shënimeve ku do të mblidhej i tërë legjislacioni lokal dhe rregulloret e UNMIK-ut; kjo bazë e shënimeve mund të përdoret për ngritjen e vetëdijes në mesin e juristëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve lokal dhe ndërkombëtarë për rregullat juridike si dhe do të ndihmonte shoqërinë civile në një luftë kundër korrupsionit.

Integriteti i shoqërisë demokratike mund të konsiderohet si reflektim i mënyrës se si qytetarët trajtojnë njëri tjetrin; kjo mund të vlerësohet nga fakti se si sillen grupet e fuqishme sociale (shpesh më të numërta)

me grupet më të dobëta sociale (më pak të numërta)? Dhuna e marsit të vitit 2004 e ka dëmtuar imazhin global të Kosovës. Ripërtrirja e përpjekjeve për mbrojtjen e minoriteteve është esenciale për mbijetimin dhe thellimin e demokracisë (shih Kornizën 6.2), duke filluar nga forcimi i sistemit juridik dhe adoptimi i legjislaturës së re për

#### **KORNIZA 6.2: MBROJTJA E TË DREJTAVE TË MINORITETEVE: NJË PJESE QENËSORE E DEMOKRACISË**

Si në shumë shoqëri multietnike dhe multikulturore (ku mund të përfshihen edhe SHBA-të, Spanja apo India), Kosova duhet efektivisht të konfrontohet me "thembrën e Akilit" të demoracive mazhoritare: përjashtimi dhe marginalizimi i minoriteteve. Të drejtat e njeriut janë mbrojtje ndaj shkeljeve që njerëzit mund ti pësojnë. Të drejtat e pakicave i mbrojnë të drejtat e tyre prej vendimeve të shumicës. Kërcënimi tipik përfshinë:

- Përjashtimi nga pjesëmarrja - manipulimi me të drejta politike dhe media për të rritur fuqinë e shumicës në politikë.
- Tejkalimi i sundimit të ligjit - largimi nga sundimi i ligjit në kohët e stresit të madh, shpesh duke i sulmuar minoritetet që perceptohen si jolojalë. Në vlerësimin e të drejtave të minoriteteve në Kosovën demokratike, janë dy çështje relevante. Cilat të drejta për mbrojtjen e tyre janë në Kornizën Kushtetuese dhe trupin e ligjeve në Kosovë? Sa i mbron këto të drejta në praktikë sistemi politik?
- Opresioni - vendosja e barrierave të tilla siç është ndalimi i përdorimit të gjuhës dhe kulturave të minoriteteve
- Varfërimi - veprimet e shumicës që më tutje të pasurojë vetën në dëm të minoriteteve, nëpërmes për shembull zhvendosjes së tyre nga vendet e pasura.

Dhuna kundër minoriteteve mbetet edhe më tutje një çështje serioze. Edhe me mbrojtjen nga Korniza Kushtetuese, policia e KFOR-i dhe sistemi gjyqësorë minoritetet në Kosovë ballafaqohen me kërcënime të mëdha, siç është ilustruar në mënyrë dramatike më 17 dhe 18 mars të këtij viti. Dështimi i integritimit të minoriteteve mund të dërgojë në shkelje më të mëdha të të drejtave të njeriut e deri te lufta. Demokracia e Kosovës duhet të bëhet më përfshirëse (legalisht dhe praktikisht), duke e përqafuar idenë se pushteti duhet të shpërndahet më shumë.

*Burimi RZHNJK 2004 Ekipi i Raportit dhe UNDP, RZHNJ 2000, (Oxford: Oxford University Press, 2002), 60*

të drejtat e njeriut. Në këtë aspekt duhet të mirret parasysh edhe formimi i një komisioni të pavarur për të drejtat e njeriut i përbërë nga profesionistët e të drejtave të njeriut nga të gjitha komunitetet. Edhe pse komisioni i të drejtave të njeriut nuk do të zëvendësonte rolin e judikaturës në dënimin e krimeve, ky komision nëpërmes përdorimit të suksesshëm të mediave do të mund të sjellte pushtetin moral në rastet të cilat institucionet e tjera publike nuk do të arrinin ti adresonin në mënyrë adekuate.

#### **Decentralizimi adekuat për përmirësimin e pjesëmarrjes dhe përmirësimin e shërbimeve:**

Kur decentralizimi bëhet në mënyrë adekuate nga qeveria qendrore në ate lokale, qytete, fshatëra atëherë ai mund të jetë mjeti më i mirë dhe më i rëndësishëm në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe përparimit të zhvillimit njerëzor. Me decentralizimin e pushtetit, qasja e njerëzve në vendimmarrje dhe efikasiteti i shërbimeve publike do të rritet. Pjesa më e madhe e shërbimeve publike momentalisht menagjohet nga Prishtina, megjithatë ka shumë konfuzion në mes të Prishtinës dhe komunave rreth përgjegjësisë. Për fat të keq decentralizimi është bërë një çështje shumë e politizuar, dhe procesi është penguar nga tensionet ndëretnike.

Në Nëntor të vitit 2003, Misioni për Decentralizim në Kosovë i Këshillit të Evropës ka bërë një raport të rëndësishëm "Reforma e Vetqeverisjes Lokale dhe Administrimit Publik në Kosovë"<sup>12</sup>. Pjesa kryesore e propozimit për reforma ishte thirrja për formimin e 280 Njësive Nën-komunale (NJNK), në mënyrë që vendim marrja të afrohet më shumë te qytetari (princiipi i përkrahjes) dhe ofrimi i shërbimeve të decentralizuara administrative për njerëzit nëpërmes një të katërtes së NJNK (60 nga totali). Përderisa propozimi është në vijë me propozimet demokratike që i avokon Këshilli i Evropës në Kartën për Vetqeverisje Lokale, propozimi për reformim ka ngritur pyetje siç janë linjat e përgjegjësisë për ofrimin e shërbimeve publike.

Nëse kjo mbështetet nga kosovarët gjatë viteve të ardhshme procesi i decentralizimit

*Me decentralizimin e pushtetit, qasja e njerëzve në vendimmarrje dhe efikasiteti i shërbimeve publike do të rritet*

*Përparësia e shoqërisë civile do të shërbejë si kontrollori më i rreptë i keqpërdorimit të pushtetit dhe krijimit të propozimeve për të thelluar demokracinë*

do të duhej të nisesh nga përgatitjet e aktiviteteve, inter alia:

- Bërja e një analize të mirëfilltë financiare të çmimit të decentralizimit dhe beneficioneve nga reforma;
- Rishikimi i përparësive dhe krahasimit çmim beneficion për krijimin e "qendrave shërbimore rajonale" që do të përmbushnin shërbimet publike në mes të qendrës dhe nivelit komunal;
- Definimi i roleve dhe përgjegjësive për njësitet komunale dhe nënkomunale viza-vi me qendrën bazuar në përparësitë krahasimtare me rezultatet dhe mundësinë e kyçjes së qytetarëve në vendim marrje në fushën e shërbimeve publike
- Artikulimi i mekanizmave për trupat qeverisëse të komunave që të arrihet një autonomi më e gjërë dhe të ipen fuqi tak-sambledhëse për to në mënyrë që komunat të mbledhin së paku 30 për qind të shpenzimeve të tyre, dhe
- Formimi i bazave të shënimeve të cilat do të mbanin informatat në nivel komunal, (për shembull, për shënimet pronësore, shënimet e ndara të regjistrimit të popullatës, rezultatet e projekteve lokale zhvillimore)

Për fat të mirë disa nga këto hapa tashmë janë duke u marrë parasysh në formën e një projektligji të ri në vetqeverisjen lokale. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve nëpër komuna do të jetë qenësore në formulimin e legjislacionit që e qartëson dhe forcon autoritetin e funksioneve publike në qeverisjen komunale në Kosovë.

### *Sigurimi i mbikqyrjes civile mbi sektorin e sigurisë:*

Edhe pse KFOR-i dhe UNMIK-u ende rezervojnë autoritetin mbi çështjet e ndjeshme të sigurisë së brendshme dhe të jashtme, tashti duhet të mirren hapat e parë për të siguruar bazat e mbikqyrjes civile për të gjitha institucionet e ardhshme të sigurisë. Për shembull, edhe anëtarët e Kuvendit e edhe zyrtarët e Zyrës së Kryeministrit duhet të kenë trajnim në politikat e sigurisë dhe si të vlerësojnë çështjet buxhetore në sektorin e sigurisë në vijë me vlerësimin e nivelit të përgjegjësive në këtë sektor në të ardhmen. Kjo do të ndihmojë që trupat e ardhme të

sigurisë të mbahen në balans dhe të sigurohet efikasiteti dhe profesionalizmi maksimal i tyre në kryerjen e punëve publike.

Duke pasur parasysh përgjegjësitë e SHPK-së që do të merr gjatë 12 deri 14 muajve të ardhshëm, kujdes i veçantë duhet të ipet përgatitjes së IPQV-së në menagjimin e tyre. Kësaj duhet shtuar konsultime të rregullta dhe thelbësore me komunitetin rreth çështjeve të sigurisë dhe punës së policisë. Momentalisht kontaktet strukturale në mes të policisë dhe komunitetit janë minimale, siç edhe ka dëshmuar një anketë mbi punën e policisë.

"Ka një interes të madh të njerëzve - siç ka edhe në mesin e policëve të SHPK-së - për të formuar një forum gjithpërfshirës dhe mekanizma të tjerë për përmirësimin e shërbimit policor nëpërmes informimit të komunitetit dhe dhënies së informatave"<sup>13</sup>. Ky rast duhet të shfrytëzohet.

